



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
QERSHOR 2024

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2024

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 2, datë 20.06.2024
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i bordit

Gjeneral Brigade **Bardhyl Nuredinaj**

Anëtarët e Bordit

Kolonel Msc. **Ulsi Rexhaj**

Prof. Asoc. Dr. **Etleva Smaçi**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Nënkolonel (R) Dr. **Enrik Ago**

Nënkolonel Dr. **Fitim Karasani**

Kolonel Msc. **Hysni Gjergji**

Msc. **Fatjon Hoxhalli**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2023 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në "Revista Ushtarake" janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: Qershor 2024

PËRMBAJTJA E REVISTËS USHTARAKE

RUBRIKA E PARË:

Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen 7

Revolucioni teknologjik, “luftërat Proxy”, sfida dhe mundësi për operacionet e ardhshme ushtarake..... 9

Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj

Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak

Kolonel Msc. Hysni Gjergji

Shef Departamenti në Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak

A mund të nxisë paradigma e re idenë e ‘smart defense’ midis Shqipërisë dhe Kosovës..... 25

Prof. Dr. Kristaq Xharo

Universiteti European i Tiranës

Strategjia ushtarake, në një realitet gjeopolitik që ndryshon me shpejtësi.... 43

Kolonel Arben DHULLI

Shef Grupi në Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak

Strategjia globale e Kinës dhe angazhimi i saj ndaj rendit multilateral ekzistues 55

Kapiten Msc. Hekuran Budani,

Msc. Orgest Xhangoli

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

RUBRIKA E DYTË:

Arsimimi dhe stërvitja 67

Disa këndvështrime mbi drejtuesin toksik 69

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi

Pedagog, AFA

Forca e armatosur si formë e dhunës institucionale.	
Një qasje teorike me bazë vende të demokracive liberal-demokrate.....	85
Nënkolonel Latif Shurdhi	
Pedagog në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë	
Kontrolli demokratik i Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë.....	97
Major. Msc. Kujtim Zeka	
Akademia e Forcave të Armatosura	
RUBRIKA E TRETË:	
Inteligjenca artificiale dhe zhvillimet inovative.....	113
Zhvillimet e inteligjencës artificiale në SHBA, vendet e BE-së dhe NATO-s dhe efektet e saj në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë globale.....	115
Kolonel Msc. Dilaver Hoxha	
Shef Departamenti në Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak	
Inteligjenca Artificiale dhe Siguria Kombëtare.....	131
Kolonel (R) Shyqyri Dekavelli	
Ish-drejtor i DSIK	
Metodologji dhe Strategji për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike.....	145
Nënkolonel Msc. Dashnor Beta	
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak	
Përgatitja intelektuale për luftën e ardhshme. Si inteligjenca artificiale do të ndryshojë arsimin profesional ushtarak?.....	167
Nënkolonel (R) Msc. Besnik Daci	
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak	
RUBRIKA E KATËRT:	
Studime historike.....	175
Modernizimi i katërt i ushtrisë greke, rikthehet dilemën mes “armatosjes politikës së gjalpit “.....	177
Dr. Glevin Dervishi	
Shef Departamenti , AFA	
Përpjekjet për depolitizimin e Ushtrisë Shqiptare.....	195
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj	
Nënkolonel. Msc. Arben Zavalani	
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak	

RUBRIKA E PARË

ANALIZA DHE VLERËSIME PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Revolucioni teknologjik, “luftërat proxy”, “ushtria e askujt” dhe operacionet “false flag”, sfida dhe mundësi për operacionet e ardhshme ushtarake

Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj,
Kolonel Msc. Hysni Gjergji
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Mjedisi aktual i luftës rezulton të jetë një përzierje e paqëndrueshmërisë globale, ekonomike, politike, ushtarake dhe teknologjike në një shkallë që nuk është parë ndonjëherë.¹ Lufta me tastierë dhe maus, është një lloj i ri konflikti në të cilin një shtet ose një organizatë ndërkombëtare është përfshirë në aktivitete, të cilat kanë synuar, sfiduar ose dëmtuar infrastrukturën teknologjike dhe ushtarake të një shteti tjetër.

Në dekadën e fundit, shumë shtete anëtare ose jo të NATO-s², e kanë njohur dhe pranuar hapësirën kibernetike si domeni i 5-të i luftës, pas tokës, detit, ajrit dhe hapësirës kozmike. Në samitin e Uashingtonit që pritet të mbahet më 9 deri 11 korrik të këtij viti³, revolucionarizimi teknologjik i aleancës, në dritën e epokës së inteligjencës artificiale të luftës, do të jetë një nga pikat kryesore të diskutimit.

¹Gjeneralmajor Robert H. Latiff, Komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së, te “Future war preparation” (2017).

²<https://www.ncia.nato.int/about-us/newsroom/save-the-date-nato-edge-2024.html>

³https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_50115.htm

Forcat e armatosura, duke qenë instrumenti kryesor në fuqinë kombëtare të një kombi⁴, janë kthyer në një target të rëndësishëm për një shtet apo edhe organizatë kundërshtarë. Kështu, Shqipëria, si pjesë e Aleancës më të madhe politiko-ushtarake, është bërë objekt i sulmeve të këtyre aktorëve edhe për këtë arsye⁵. Në këtë punim, do të analizojmë rritjen e digjitalizimit në fushën ushtarake, i cili ka promovuar zhvillim nga njëra, por gjithashtu ka krijuar edhe një shqetësim të madh që lidhet me sigurinë e kësaj hapësire të padukshme, të paprekshme dhe pa kufij të konfiguruar. Këto luftëra të reja në zhvillim, në Ukrainë, në Gaza apo gjetkë, po fshehin interesat dhe përfitimet ekonomike, politike, ushtarake apo të treja bashkë, pasi po zhvillohen në formën e luftërave proxy⁶, me mercenarë dhe mjete të tjera të mohueshme⁷.

Fjalët kyçe: NATO, luftë proxy, forcë e armatosur, domen kibernetik i luftës, ushtri e askujt⁸, operacioni “false flag”⁹

1. Evoluimi teknologjik i luftës, drejt domain-it kibernetik dhe inteligjencës artificiale.

Viti 2024 e gjen botën më të zhvilluar pasi teknologjia e informacionit i ka përmirësuar marrëdhëniet midis njerëzve dhe shteteve duke përfshirë këtu edhe drejtimin dhe menaxhimin e luftës në përgjithësi dhe konflikteve të armatosura në veçanti. Luftërat, qysh në konfliktet e para të grupeve shoqërore, të organizuara në fise apo perandori, kanë filluar kryesisht me qëllim shtimin e territoreve ku shtriheshin edhe burimet e jetesës në minerale, bimë, kafshë etj. Kapja e më shumë sipërfaqe tokësore nga njëra palë dhe mbrojtja e këtyre hapësirave nga pala tjetër, e ka shoqëruar njerëzimin për shumë shekuj¹⁰. Me shpikjen e anijeve luftarake dhe flotave, lufta u zhvendos në një tjetër hapësirë, në atë detare, ku aktorët synonin sa më shumë akses në oqeanë si në burimet që ofronte, ashtu edhe rrugëkalimet që siguronin. Aeroplani dhe aftësia e njeriut për të fluturuar bëri që fuqitë ushtarake të pajisura me flotë ajrore të siguronin supermaci në ajër, e cila siguronin supermaci në tokë dhe det gjithashtu. Sot, shoqëria njerëzore ka hyrë në fazën e përdorimit dhe të ndërvarjes përditë e më shumë nga interneti. Aktualisht, jemi të varur nga hapësira kibernetike në çdo gjë, nga tregtia deri te komunikimi, duke ndryshuar në një masë të

⁴DIME–Instrumente të fuqisë kombëtare: Diplomacia, Inteligjenca, Forcat Ushtarake,Ekonomia

⁵<https://www.zeriamerikes.com/a/6734669.html>

⁶<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/proxy-war>

⁷<https://shp.al/sq/a-ka-nje-shkak-lufta-ne-ukraine/>

⁸<https://www.shtepiaelibrit.com/store/sq/historia-aktualiteti/7520--ushtria-e-askujt-paul-scharre-9789928286987.html>

⁹<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/false-flag>

¹⁰Luftërat në proces të Izraelit me Palestinën dhe Rusisë kundër Ukrainës e vërtetojnë këtë tezë.

konsiderueshme mënyrën, zakonet tona të jetesës, por edhe konceptin e konfliktit të armatosura. Luftërat deri më sot janë zhvilluar në një rajon të caktuar gjeografik dhe në një periudhë kohe të përcaktuar. Sot natyra e luftës ka ndryshuar totalisht me njohjen e komponentit kibernetik të saj. Kufijtë nuk ekzistojnë më, fronti i luftës nuk ka më kuptim dhe aktorët ndërluftues nuk kanë rëndësi të jenë përballë njëri-tjetrit dhe të kenë kontakt me njëri-tjetrin.

NATO e pranoi “hapësirën kibernetike” si fushën e zhvillimit të operacioneve luftarake të NATO-s, për të cilën aleanca duhet të stërvitet dhe trajnohet për të mbrojtur veten dhe anëtarët e saj, njëlloj si edhe në fushat e tjera të zhvillimit të luftës (det, tokë, ajër, kozmos). Tashmë kërcënimi kibernetik mjafton që me një numër të vogël hakerësh mund të gjuhëzojë një komb në disa minuta, duke goditur infrastrukturën kritike shtetërore dhe ushtarake, centralet elektrike, komunikacionin, portet, aeroportet, spitalet dhe zyrat qeveritare. Një nga rastet e para të këtij lloji sulmi është regjistruar në vitin 2007, kur në periudhën e tre javëve pati një valë masive të sulmeve kibernetike të Rusisë kundër Estonisë, të cilat çuan në paralizimin total të ministrive, bankave dhe kompanive të komunikimit të Estonisë. Në 2013, Ukraina pati gjithashtu një paralizim dhe *black out* total të energjisë elektrike si rezultat i sulmeve kibernetike ruse. Këto ishin sulmet e para që shërbyen edhe si alarmi i parë i sulmeve kibernetike edhe për NATO-n, e cila kishte filluar të zgjerohej në republikën e ish-BS. Tendencia e incidenteve kibernetike për 2022-2023 konsiderohet alarmante pasi ka pasur rritje dhe është kaluar nga sulme kundër objektivave civile drejt objektivave dhe infrastrukturës qeveritare. Nga këndvështrimi i Shqipërisë si shtet anëtar i NATO-s, sulmi kibernetik nisur nga metodat që përdor dhe objektivat që përzgjedh, është së pari sabotazh, që ka qëllim shkatërrimin e pikave nevralgjike, ekonomike ushtarake të vendit tonë, për rrjedhojë edhe të NATO-s. Një tjetër kërcënim merr formë gjatë një sulmi kibernetik kundër sistemeve të informacionit sensitive kombëtare duke i vjedhur, manipuluar apo shkatërruar ato. Kjo veprimtari spiunazhi kryesisht është drejtuar nga shërbime inteligjente armiqësore me NATO-n, kundër njërit apo disa shteteve të aleancës, pasi modernizimi i teknologjisë ka ndryshuar edhe mënyrën e të bërit spiunazh. Në epokën digjitale, nuk është nevoja të hapësh kasaforta për të futur në dorë planet, burimet dhe strategjitë ushtarake të një shteti, por mjafton një haker i trajnuar pa asnjë kontakt fizik me dokumentet e synuara, t’i marrë dhe përdorë këto dokumente, shumë herë edhe pa lënë gjurmë.

Veprimtaria kriminale dhe armiqësore, që mund të ndërmarrin aktorët shtetërorë kundërshtarë të NATO-s kundër anëtarëve të aleancës, mund të klasifikohet edhe si veprimtari subversive, pasi minimi dhe humbja e besimit të publikut tek institucionet e sigurisë është një nga pasojat që sjell një sulm kibernetik. Në momentin që sulmet kibernetike godasin objektivat civile me qëllim

arritjen e objektivave të tyre politike duke përhapur frikë pasiguri dhe tmerre, atëherë ky sulm plotëson kushtet e të qenit terrorist. Konflikti i armatosur në hapësirën kibernetike nga njëra anë kërkon sigurinë kibernetike, por nga ana tjetër kjo siguri nuk është vetëm subjekt teknik, siç thuhet rëndom, por ajo është strategji, politikë doktrinë, procedurë veprimi, madje edhe instrument luftarak. Nisur nga rastet e analizuara dhe trendin e zhvillimit teknologjik, është evidentuar një ndërgjegjësim i strukturave ligjzbatuese me qëllim adaptimin nga ana e tyre të kundërmasave të nevojshme për ti bërë ballë këtij kërcënimi të ri shumë dimensional. “Sulmi kibernetik kundër njërit apo disa anëtarëve të aleancës, nisur nga pasojat e njëjta që mbart me një sulm ushtarak, duhet të trajtohet si subjekt i nenit 5, duke parashikuar edhe kundërpërgjigje të strukturave të armatosura të NATO-s kundër këtij kërcënimi të shekullit¹¹”. Ka pasur një zhvendosje përfundimtare nga unipolariteti amerikan, me Kinën dhe Rusinë duke përfituar nga kjo tërheqje. Akset gjeopolitike të pushtetit po riorganizohen dukshëm me SHBA-në dhe BE-në në njërën anë dhe një bosht anti-SHBA të Kinës, Iranit, Rusisë dhe Koresë së Veriut në anën tjetër. Kjo po çon në veprime më të guximshme, më pak të parashikueshme dhe një mjedis global më të rrezikshëm dhe të pasigurt. Do të vazhdojmë edhe për 2024 të jemi dëshmitarë të këtij ndryshimi, i cili mund të përkeqësohet nga qëndrimi i vendeve të paangazhuara dhe rritja e blloqeve konkurruese siç është BRICS (Brazil, Rusia, India, Kina).

Edhe nëse nuk i bëjmë luftërat, ne duhet t’i lexojmë ato, të mësojmë nga gabimet por dhe përparësitë, qofshin këto edhe të kundërshtarit. Nuk kemi nevojë të shkojmë shumë larg në histori pasi së pari, ky kërcënim është i ri dhe së dyti agresioni rus mbi Ukrainë bashkë me sulmin e Hamasit kundër Izraelit shënojnë përdorim masiv dhe sfidues të teknologjisë, në funksion të konflikteve ushtarake. Mjedisi aktual i luftës rezulton të jetë një përzierje e paqëndrueshmërisë globale, ekonomike, politike, ushtarake dhe teknologjike në një shkallë që nuk është parë, ndonjëherë¹²”. Pothuajse çdo mjet konsiderohet akt lufte, pasi kufiri ndarës është në pikën që quhet kontrolli dhe dominimi i një grupi njerëzish, mbi një grup ose mbi njerëz të tjerë¹³. Sulmi i Hamasit më 7 tetor shënoi dështim për të monitoruar kanalet elektronike kryesore të komunikimit të përdorura nga sulmuesit palestinezë. Rënia në grackën e operativëve të Hamasit, të cilët e dinin që përgjoheshin, komunikonin mes

¹¹Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, në takimin me ministrat e mbrojtjes së aleancës, më 28 qershor 2017.

¹²Gjeneralmajor Robert H. Latiff Komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së, *Future war preparation* (2017).

¹³Naz Modirzadeh, Harvard Law School Program on International Law and Armed Conflict” (PILAC).

tyre me mesazhe mohuese të një sulmi mbi Izrael¹⁴. Mbështetja e tepërt në pajisjet teknologjike të mbikëqyrjes kufitare që mbylleshin lehtësisht nga sulmuesit, i lejuan terroristët të bastisnin bazat ushtarake dhe të vrisnin ushtarë në shtretërit e tyre të gjumit¹⁵, duke u kthyer në një leksion të përgjakshëm për izraelitët.

Dështimi operacional ishte grumbullimi i drejtuesve nga divizioni i Gazës në një vend të vetëm përgjatë kufirit. Pasi baza u pushtua, shumica e oficerëve të lartë u vranë, u plagosën ose u morën peng. Përqendrimi i komandantëve në një bazë të vetme kufitare që u godit në fazën e parë të sulmit pengoi komunikimin me pjesën tjetër të forcave të armatosura. Ushtarakët izraelitë ishin të sigurt në pa përshkueshmërinë e sistemit teknologjik që posedonin. Ushtarët izraelitë duke besuar verbërisht në teknologjinë dhe nuk mundën të shikonin videot e manipuluar nga Hamas¹⁶. Rrethimi me mur dhe mjete teknologjike i Gazës rezultoi të ishte më i lehtë për t'u kapërcyer, duke bërë faktorin njeri të pazëvendësueshëm në drejtimin e Cyberwar. Kombinimi në të njëjtën kohë i përdorimit të “Wagner” në Ukrainë, “Hamas” në Gjirin Persik dhe i “Houthi” në Detin e Kuq, e ka futur botën në një etapë dhe formë të re të luftës.

Bazuar në trendin e krijuar, pa dyshim që përkufizimi i “luftës” do të ndryshojë, madje kjo do të sjellë edhe përcaktim të ri se cili do të emërtohet luftëtar dhe palë ndërluftuese. Individë, megjithëse duke u fshehur në shumë mënyra dhe nuk përdorin armë zjarri, mundet edhe të mos jenë të përgjegjshëm kur ata transformohen në palë luftuese. Për këtë ata mund të vihen nën akuzë, njësoj si ushtarët në shërbimin nën uniformë. Të tillë janë hakerat kibernetikë, përdoruesit e dronëve etj., të cilët duke kontribuar në dominimin e një pale mbi një tjetër, mund të vihen nën akuzë për krime lufte. Përparimi në teknologjinë ushtarake, vlerësohet veçanërisht shumë pozitiv për aftësinë që një pajisje “cyber” ne duart e personave apo shteteve të përgjegjshëm. Këto aftësi të veçanta të këtyre pajisjeve teknologjike, i reduktojnë shumë kostot e jetëve njerëzore në një luftë tradicionale .

Me zhvillimin teknologjik dhe inteligjencën artificiale¹⁷ që po e shoqëron teknologjinë e luftës në përgjithësi, duhet të konsiderojë faktin se këto rregulla nuk vlejnë më vetëm për aktorët shtetërorë, pasi objektivi i radhës i zgjedhur

¹⁴Tzachi Hanegbi, këshilltari i sigurisë kombëtare i Izraelit, në një intervistë radiofonike gjashtë ditë para sulmit.

¹⁵Deklaratë e Brig. Gjeneral Dan Goldfuss, komandant izraelit që ndihmoi në drejtimin e kundërsulmit.

¹⁶<https://www.nytimes.com/by/patrick-kingsley>

¹⁷Inteligjenca artificiale përkufizohet si aftësia e një kompjuteri ose programi kompjuterik për të kryer funksione dhe arsyetime, që aktualisht janë tipike vetëm të trurit dhe mendjes njerëzore, të cilat supozohen të barazohen në vitin 2030.

si shënjestër mund të jetë po kështu edhe një kompani apo person privat. Sukses po rezulton për ushtrinë ukrainase përdorimi i smartphonëve dhe dërgimi i vendndodhjeve, fotove dhe videove të instalimeve ruse në Ukrainë, nga popullsia lokale. Ministria e Mbrojtjes Ukrainase i fton qytetarët e saj të dërgojnë foto, video dhe lokacione të agresorëve ruse, me sloganin motivues “Bëhuni drejtues të dronëve “Bajraktar” direkt nga smartphoni juaj”. Beteja ruse *cyber* në Ukrainë ka treguar që skenarët “fals” të luftës, të përhapen më shpejt dhe më larg, falë teknologjisë *cyber* të përdorur gjerësisht atje. Për t’iu kundërvënë dezinformacionit rus, u organizua dhe funksionoi nga aleatët perëndimorë në Ukrainë, një fushatë e cila e “bombardoi” hapësirën mediatike botërore me “të vërtetat”.

Befasia dhe supermacia e siguruar nga teknologjia e lartë ushtarake në duart e palës që sulmon, është elementi ushtarak i vjetër sa dhe vetë lufta, e cila ka gjasa të vendosi fatin e betejës madje edhe luftës së ardhshme. Dizavantazhi që vjen nga teknologjia, qëndron edhe tek aftësia e hakerëve kundërshtarë, të aftë të gjenerojnë variante të reja *malware* brenda sistemit tonë, të manipulojnë shënjestrat e sulmit, të shpërndajnë propagandë, si dhe të zbatojnë mekanizma automatikë vetëshkatërrues. Si rezultat i përdorimit të gabuar të teknologjisë smart, rezultoi “dështim” rasti i përdorimit të telefonave smart, nga ana e ushtarëve rusë. Në orën 00:01 të vitit të ri 2023, gjashtë raketa u lëshuan kundër trupave ruse në strehim, duke vrarë 89 ushtarë bashkë me komandantin e regjimentit. Rusët pranojnë se “është e qartë¹⁸ që trupat tona u zbuluan nga përdorimi masiv i celularëve nga ushtarët, pavarësisht se ishte i ndaluar përdorimi i tyre. Ky “gabim” e lejoi ushtrinë ukrainase, që të gjente koordinatat e personelit ushtarak rus dhe të godiste me raketa.

Agjencitë e zbulimit të NATO-s i ndanë këto vlerësime me homologët e tyre ukrainas, të cilët i krahasuan dhe i pasuruan me burimet dhe analizat e tyre kombëtare. Në kohë reale u arritën të bashkoheshin shumë pjesë të “mozaikut rus”, i cili po qartësohej dita ditës.

Imazhet nga kompania amerikane e teknologjisë hapësinore “Maxar” dhe postimet e mbledhura në mediat sociale, shfaqnin një grumbullim të madh dhe të pazakontë të forcave ruse. Këto imazhe të bashkuara edhe me të dhënat sekrete dhe HUMINT, çuan në përfundimin se Rusia, së shpejti po përgatitej të kryente një agresion kundër Ukrainës, pasi armatosja e Rusisë falë medias, u zhvillua në sy të gjithë botës. Informacioni rreth aftësive të personelit, pajisjeve, teknikës luftarake, armatimit dhe infrastrukturës së armikut, është

¹⁸Në deklaratën e saj për shtyp, më datë 4 janar 2023, Ministria e Mbrojtjes Ruse u shpreh se sulmi me raketa që vrau 89 ushtarë rusë në Donetsk, erdhi si rezultat i përdorimit të telefonave nga ushtarët, lokacioni i të cilëve bëri që të zbulohesh vendstrehimi i ushtarëve.

relativisht i thjeshtë, ndërsa zbulimi dhe vlerësimi i “qëllimit” të kundërshtarit nuk është aspak i tillë. Për të zbuluar qëllimin e kundërshtarit, duhet futur në kokën e tij, të mendosh dhe të funksionosh si ai. Vlerësimet nga fuqitë perëndimore për “qëllimin e Putinit”, paralajmëruan për agresion të mundshëm ushtarak, bazuar kryesisht në stërvitjet e shtuara ushtarake ruse përgjatë vitit 2021, si dhe “esëve” patriotike të Putin, publikuar disa muaj para sulmit. Në prill 2021, Rusia kreu një “kontroll të befasishtëm” të dislokimeve të saj jugore dhe perëndimore, me pretekstin e lëvizjeve të “supozuara agresive” nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e NATO-s në rajon. “Tani po shohim përqendrimin më të madh të forcave ruse në kufijtë e Ukrainës, që nga viti 2014”, deklaroi Sekretari i Shtetit Antony Blinken në një takim në selinë e NATO-s në janar 2022. Sulmi frontal befasoi disa aleatë të NATO-s por edhe anëtarë të qeverisë ruse. Në janar 2022, Shtetet e Bashkuara publikuan në shtyp informacione mbi subversionin rus. “Rusia ka drejtuar shërbimet e saj të inteligjencës që të rekrutojë zyrtarë aktualë dhe ish-zyrtarë të qeverisë ukrainase për t’u përgatitur që të marrë qeverinë e Ukrainës dhe për të kontrolluar infrastrukturën kritike të saj me një forcë pushtuese ushtarake,”- vazhdon me deklaratën e tij Blinken.

Ky mesazh u përforcua edhe nga deklarata e Sekretares së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Liz Truss dhe nga shefi i Inteligjencës së Mbrojtjes së MB, gjeneraljejtënant Sir Jim Hockenhull, i cili në deklaratën për shtyp, më 19 shkurt, u tha gazetarëve se: “...ne nuk kemi parë deri sot prova që Rusia ka tërhequr forcat nga kufijtë e Ukrainës. E kundërta po ndodh, Rusia vazhdon të rrisë kapacitetet ushtarake pranë kufirit të Ukrainës.”

Hera e parë, e regjistruar, e përdorimit të dronëve plotësisht të pavarur u përdor nga izraelitët për të lokalizuar, identifikuar dhe goditur militantët Hamas¹⁹.

Ushtria e Izraelit konsiderohet ndër më të mirat në botë, por më 7 tetor, me dështimet ushtarake dhe të inteligjencës e çuan besimin ndaj tyre në kuotat më të ulëta ndonjëherë. Luftëtarët e Hamasit përdorën një kombinim të armëve të lehta dhe raketa luftarake të kombinuar dhe mbështetur me teknologjinë kibernetike. Hamasi dërgoi dronë të luftës elektronike për të çaktivizuar disa nga stacionet e komunikimit celular të ushtrisë izraelite dhe kullat e vëzhgimit përgjatë kufirit, duke penguar oficerët e shërbimit të monitorojnë zonën nga distanca me kamera video. Dronët e teknologjisë së lartë pjesë e luftës kibernetike, shkatërruan sistemin e telekomandimit të mitralozave që Izraeli kishte instaluar në mur, duke i hequr izraelitëve mjetin kyç për të luftuar në frontin tokësor. Teknologjia kibernetike e bëri më të lehtë për sulmuesit e

¹⁹David Hambling, “Izraeli përdori për herë të parë në botë dronin që drejtohet dhe operon plotësisht me IA”, 30 qershor 2021.

Hamasit të afroheshin dhe të hidhnin në erë pjesë të gardhit kufitar dhe ta shpërthenin atë në disa vende me lehtësi, duke lejuar mijëra palestinezë të kalonin nëpër këto boshllëqe.

“Pushtimi” i menjëhershëm i më shumë se 20 qyteteve dhe bazave të ushtrisë izraelite në atë sulm ishte shkelja më rëndë e mbrojtjes së Izraelit në 50 vjet, duke shkatërruar ndjenjën e sigurisë dhe besimin tek ushtria e kombit. Ushtria më e fortë në Lindjen e Mesme u shfaq e pafuqishme për të luftuar kundër një armiku shumë më të dobët, duke i lënë izraelitët të pambrojtur për pjesën më të madhe të ditës kundër skuadrave të terroristëve që vranë më shumë se 1000 izraelitë duke përfshirë ushtarë në gjumë, rrëmbyen të paktën 150 persona, pushtuan të paktën katër kampe ushtarake dhe u përhapën në më shumë se 30 milje katrore të territorit izraelit. Sipas katër zyrtarëve të lartë izraelitë të sigurisë që guxuan të flisnin në kushte anonimiteti, “këto dobësi operacionale ushtarake ishin ndër një sërë gabimesh logjistike dhe inteligjente nga shërbimet izraelite të sigurisë që hapën rrugën për inkursionin e Gazës në Izraelin jugor”. Pasojat janë katastrofike për sigurinë e Izraelit, po aq edhe të dëmshme për reputacionin e tij në rajon si një partner i besueshëm ushtarak. Para 7 tetorit 2023, Izraeli ishte një shembull për shumë vende në rajon për çështjet e sigurisë²⁰. Ai nuk është më një shtet i pathyeshëm, por shumë i cenueshëm dhe këtë e tregoi dorëheqja e shefit të zbulimit ushtarak më 20 prill 2024.

Në perspektivën kombëtare është detyrë e çdo vendi të mbrojë rrjetet e veta, pasi NATO nuk ka kapacitete të veçanta për kërcënimin kibernetik, por është e përbërë nga shumatorja e kapaciteteve të 30 vendeve anëtare. Konkurrentët e NATO-s kanë investuar gjatë vitit 2023 shumë para në teknologji për të arritur avantazhe, përfshirë edhe konfliktin e armatosur. Ky evoluim paralajmëron se shtetet autoritare mund të zhvillojnë në mënyrë indirekte teknologjinë kibernetike, duke e fshehur qëllimin e vërtetë nën avancimin e IA te pajisjet civile, deri tek armët e dëmtimit në masë. Inteligjenca artificiale në teknologjinë e luftës vlerësohet si një shumëfishues i fuqisë së sulmeve kibernetike²¹.

2. Sfidat e luftërave të ardhshme me “proxy war”, “ushtri të askujt” dhe operacionet “false flag”

Nëse e shkuara e luftërave na ndihmon për të parashikuar tendencën e të ardhmes së tyre, besohet se “lufta proxy”, “ushtria e askujt” dhe “false flag” do të zgjerohen dhe do të dominojnë luftërat e të ardhmes. Për shkak të kostove

²⁰<https://www.zeriamerikes.com/a/7579656.html>

²¹James S. Johnson, hulumtues në Qendrën James Martin (march 2020)

njerëzore, politike dhe diplomatike shumë të larta, ka gjasa që operacionet me flamur të rremë, të ruhen shumë gjatë të pazbuluar. Vendosja e këtyre grupeve me mercenarë ose me “ushtarë të askujt”, vë në pikëpyetje rolin e “luftës proxy”, si e shkuara apo e ardhmja e luftërave. Luftërat e ardhshme parashikohen të jenë të përmbledhura në betejat e zhvilluara në hapësirën kibernetike, ushtarë të përmirësuar biologjikisht, si dhe sisteme autonome që mund të përpunojnë informacionin dhe të godasin përpara se një qenie njerëzore të mund të reagojë. Në rastin më të mirë, teknologjia e avancuar vepron më shpejt se kurrë për të shpëtuar jetën e ushtarëve; në rastin më të keq, vendosja e teknologjisë së re në mënyrë të pakontrollueshme mund të ketë pasoja shkatërruese afatgjata. Në luftën e teknologjisë përfshin ndryshimin e mënyrave të luftës dhe teknologjitë e armëve që do të përdorim, duke përcaktuar se çfarë do të thotë në të ardhmen që të jesh një ushtar. E ardhmja e luftërave po rikthehet në një cikël që risjell metoda dhe forma të vjetër në kontekst dhe interes bashkëkohor.

Kremlini në 2014 hartoi një operacion me “flamur të rremë” për aneksimin e Krimesë dhe i quajti “burrat e vegjël të gjelbër²²”, si anëtarë të “grupeve të vetëmbrojtjes” lokale, të cilët kërkonin që territori i Krimesë të kthehej në Rusi. Kremlini është shprehur se burrat i kishin blerë armët, veshjet dhe pajisjet ushtarake nga dyqanet civile dhe ishin të detyruar t’i dilnin zot vendit, të zaptuar padrejtësisht nga Kievi. Sa më e kufizuar të jetë dhuna për arritjen e qëllimit të operacionit, aq më mirë do të jetë. Për shembull, “burrat e vegjël të gjelbër” të Rusisë nuk përdorën dhunë masive në Krime. Duke përdorur vetëm forcat ekzistuese lokale ruse, që ishin të pranishme në Ukrainë, forcat konvencionale ruse qenë në gjendje të hynin në Krime në vitin 2014, duke krijuar konfuzion masiv, si dhe duke vonuar çdo kundërpërgjigje. Brenda pak ditësh, Rusia e pushtoi “de fakto” Krimenë, duke u përballur me pak rezistencë. Ukraina e paralizuar e shikonte vetëm të pafuqishme, ndërsa fuqitë e mëdha u ndodhën përballë faktit të kryer, duke qenë në gjendje të përgjigjeshin vetëm me sanksione.

Kosova gjithashtu më 24 shtator 2023²³ nuk ra pre e një sulmi tjetër me “flamur të rremë” të Serbisë, që në fakt i tregoi perëndimit fytyrën e Beogradit pa maskë, të pandryshuar nga ajo e 1999-ës. Marija Zaharova, zëdhënësjja e Moskës, më 4 tetor 2023, e kishte të gatshme narrativën ruse të përdorur edhe më parë për sulmin mbi Ukrainë; shkak i sulmit terrorist ishte “Spastrimi etnik i Kosovës ndaj serbëve etnikë në veri”!?. Vuçiç ka përdorur të njëjtin “libër

²²<https://nacionale.com/politike/cka-jane-burrat-e-vegjel-te-gjelber-qe-i-permendi-kurti-ne-mediumin-britanik>

²³<https://www.kosova-sot.info/opinione/691889/cka-ndodhi-me-24-shtator-2023/>

rus justifikimesh” për sulmin në Bënjskë më 24 shtator 2023, njëlloj si rusët me Krimenë. Vuçiq i quan mercenarët serbë, si qytetarë lokalë të revoltuar nga qeveria represive kosovare, ndërsa armët dhe uniformat serbe, si të “blera në tregun e lirë”. Por në ndryshim nga Rusia, qeveria serbe i strehon, mbron dhe dekoron terroristët e vrarë, duke e legjitimuar kështu autorësinë e këtij akti, që në fakt është një operacion proxy dhe “false flag” i shkuar keq. Në materialet luftarake të kapura nga policia e Kosovës, janë gjetur dokumente që dëshmojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në këtë aksion të Millan Radoiqiq²⁴, bashkë me truporjen e Aleksandër Vulin, ish-drejtor i BIA-s, të cilët janë në listën e zezë të SHBA-ve.

Synimi i vërtetë i paramilitarëve serbë të fshehur në Manastir duket se ishte krijimi në Kosovë i një vatre të re dhe shumë të ndjeshme konflikti të armatosur. Sipas skenarit me “flamur të rremë”, “*serbët të strehuar* në një vend të shenjtë (manastir ortodoks), *sulmohen nga policia shqiptare, madje myslimane e Kosovës*. Asosacioni do kishte pas kësaj edhe martirët e tij, ndoshta edhe klerikë ortodoksë “të vrarë nga shqiptarët”. Për dëmtimin e reputacionit të Kosovës dhe vendosjen e Prishtinës nën akuzë, shërbimi serb i inteligjencës BIA kishin planifikuar një “false flag” për të vrarë prokurorin Dick Marty²⁵, i cili ka akuzuar rëndë dhe padrejtësisht UÇK në GJND. Meqenëse ‘urrejtja e kosovarëve’ ndaj prokurorit gënjeshtar dihej botërisht, vrasja do t’i faturohej me lehtësi Kosovës. Ky operacion me “flamur të rremë” nëse nuk zbulohej, do të ngrinte në favor të Serbisë një tjetër akuzë e padrejtë kundër Kosovës.

Moska po e përforcon praninë e saj tregtare dhe lidhjet me rajonin dhe vendet jo anëtare të NATO-s dhe BE-së, përmes vizitave të përsëritura të nivelit të lartë, fushatave të fuqishme informuese²⁶ dhe partneriteteve me media lokale, bloggerë dhe politikanë që nxisin lajme miqësore ruse ose narrativa antiperëndimore. Sponsorizimi i korporatës ruse i ekipeve të futbollit²⁷, ngjarjeve bamirëse, shkollave, shoqatave atletike dhe shoqatave të gjuhës ruse ose kulturore, rrit gjithashtu vullnetin e mirë midis popullatave të synuara. Këto mjete të fuqisë së butë që burojnë nga sektori privat përbëjnë një pjesë të madhe të diplomacisë publike të Rusisë në rajon, duke plotësuar shtrirjen më formale të shtetit rus ²⁸përmes ambasadave, qendrave kulturore, shoqërive të miqësisë, kishës dhe konsujve të nderit.

²⁴<https://sinjali.com/n1-arrestohet-milan-radoiqiq-i-caktohet-masa-e-paraburgimit-per-48-ore/>

²⁵<https://balkaninsight.com/2023/12/28/dick-marty-author-of-explosive-kosovo-war-crimes-report-dies-at-78/>

²⁶<https://www.nytimes.com/2018/04/10/world/europe/european-union-balkans.html>

²⁷<https://www.gazprom-football.com/en/gazprom.htm>

²⁸http://www.kas.de/wf/doc/kas_51729-544-2-30.pdf?180306092933

Mediat miqësore të rajonit të mbështetura nga Moska në rajon theksojnë me padurim pakënaqësitë lokale²⁹ ndaj Brukselit, Uashingtonit ose politikanëve ballkanikë që i shtyjnë vendet e tyre shumë larg drejt perëndimit. Këto narrativa në përgjithësi e paraqesin Perëndimin si shkaktar të mangësive demokratike të rajonit, telasheve ekonomike dhe ndarjeve të vazhdueshme etnike. Ata pretendojnë se mbështetja me çdo kusht nga SHBA ose BE për disa elita politike pro-perëndimore është shkaku kryesor i dështimeve të shteteve për të trajtuar korrupsionin gërryes ose për të zhvilluar sisteme politike të bazuara në sundimin e ligjit dhe shoqëri civile të fuqizuara.

Operacionet luftarake të shpërqendrimit me ‘proxy’ janë veprime luftarake që kryesisht ushtritë kundërshtarë i përdorin kundër njëri-tjetrit për të shmangur të vërtetën e sulmit, e qëllimit të gjendjes dhe madje edhe të shkaktarit të një incidenti apo lufte. Lufta në Ukrainë është një luftë Proxy, pasi në tokën ukrainase po ndeshen Perëndimi me aleancën Rusi – Kinë - Iran dhe Koreja e Veriut. Kjo vërtetohet si e tillë nëse supozojmë ndërprerjen e menjëhershme të furnizimit të Rusisë me dronë dhe predha artilerie nga Kina dhe Irani, si dhe ndërprerjen e ndihmave të perëndimit për Ukrainën. Sigurisht kjo luftë do të përfundonte dhe do të shkonte në tryezën e marrëveshjes.

Historikisht, anijet në det nuk kishin asnjë detyrim kundër përdorimit të flamujve të rremë, madje edhe anijet luftarake përdorin sot teknikën për t’u afruar me anijet e armikut duke i quajtur “operacione mashtrimi”. Me aftësinë e kufizuar për të parë flamujt dallues të anijeve në det në distancë të largët, veçanërisht në kohë me mot të keq, marinarët nuk mund të përcaktonin anijet me flamur të saktë, dhe si rezultat, flamujt e rremë ishin shumë efektivë. Një anije luftarake lejohet të mbajë herë pas here flamurin e një kombi neutral apo edhe armik, në mënyrë që t’i afrohet sa më shumë një luftanijeje armiqësore përpara se të hapë zjarr. Praktika njihej si mashtrim ushtarak në një epokë kur efektiviteti i topave të anijeve luftarake ishte i kufizuar. Një sjellje e tillë dhe akte të tjera të ngjashme mashtrimi, nuk konsideroheshin të paligjshme, me kusht që flamuri i vërtetë të ishte duke u valëvitur gjatë operacionit të luftimit aktual.

Në përdorimin modern, një operacion me flamur të rremë është një hile e planifikuar qëllimisht për ta bërë të duket sikur një shtet është sulmuar, duke justifikuar kështu operacionet ushtarake hakmarrëse kundër shkelësit të supozuar. Përveç justifikimit të luftërave, këto operacione minojnë besueshmërinë e kundërshtarëve dhe marrëdhëniet e tjera në skenën kombëtare ose ndërkombëtare, duke i bindur të tjerët për fajësinë e një veprimi që ata nuk

²⁹<https://www.reuters.com/article/us-serbia-russia-media-analysis/on-serbian-airwaves-a-battle-for-heart-of-balkans-idUSKBN17Z0X1>

e kanë kryer. Suksesi i operacioneve të tilla mund të ndryshojë në mënyrë drastike një situatë taktike ose strategjike, qoftë në konfliktet ekonomike midis fuqive tregtare apo edhe kundërshtarëve politikë që bëjnë fushatë kundër njëri-tjetrit në zgjedhje.

Një operacion kibernetik është një “flamur i rremë” perfekt, nëse aktori i kërcënimit që qëndron pas tij, do të ndërmarrë hapa për të imituar ose përdorur infrastrukturën, taktikat, teknikat ose procedurat e veçanta të një aktori tjetër kërcënimi. Ndërsa nuk janë të zakonshme në tokë në fushën detare, ajrore ose hapësinore, është e zakonshme që krimi kibernetik dhe lufta kibernetike të maskohen si aktorë të tjerë për të fajësuar dhe për të shmangur fajin e dikujt. Përveç justifikimit të luftërave, këto operacione “hibride” kibernetike minojnë besueshmërinë e kundërshtarëve dhe marrëdhëniet e tjera në skenën kombëtare ose ndërkombëtare, duke i bindur të tjerët për fajësinë e një veprimi që ata nuk e kanë kryer. Suksesi i operacioneve të tilla mund të ndryshojë në mënyrë drastike një situatë taktike ose strategjike, qoftë në konfliktet ekonomike midis fuqive tregtare apo edhe kundërshtarëve politikë që bëjnë fushatë kundër njëri-tjetrit në zgjedhje.

Bota e teknologjisë kërkon që ne t'i mësojmë në akademitë tona dhe kushtojmë më shumë vëmendje çështjeve me të cilat do të përballemi, përpara se të jetë tepër vonë për t'i kontrolluar ato. Duke denoncuar atë që përshkruhet si një marrëdhënie “e prishur” midis ushtrisë dhe publikut të cilit i shërben, për planifikuesit ushtarakë dhe teknologët e armëve, vihet re rritja e fenomenit të ushtrive private ose “ushtrive të askujt”³⁰. Inteligjenca artificiale, e cila gjeneron të dhëna të reja, si tekste, imazhe apo dizajn, për të cilën jemi dëshmitarë të përdorimit të saj në luftërat “smart” kibernetike, si dhe në të gjitha aspektet e jetës sonë, pritet të gjenerojë dhe të rrisë sintezën e të folurit, përkthimin dhe automatizimin kaq të përdorshëm në komandim-kontroll (C2). *ChatGPT pritet të bëjë revolucion sidomos në përpunimin rekord të informacionit dhe inteligjencës, si bazë e marrjes së vendimit ushtarak*. Sistemet gjithnjë e më të sofistikuar të IA kërkojnë fuqi përpunuese dhe analizuese, që nënkupton një theks të industrisë në teknologjinë ushtarake të ardhmes. Shpejtësia e përpunimit të informacionit dhe analiza e tij e të dhënave janë në një nivel shumë të lartë që kërkon që personeli ushtarak të trajnohet më shpejt me aftësi të zgjeruara për vetë-evolucion.

Ekspertët e IA nuk mund t'i kuptojnë implikimet e teknologjisë në të ardhmen e luftërave si shqetësim duke pasur parasysh ritmin e ndryshimit, palën që e disponon dhe ndikimin e tij mbi teknologjinë ushtarake dhe luftën në

³⁰ Paul Scharre; <https://bukinist.al/sq/oferta-te-ndryshme/10652-ushtria-e-askujt.html>

përgjithësi. Marrëveshja Teknike për Mbrojtjen Kibernetike ndërmjet Aftësisë për Reagim ndaj Incidenteve Kompjuterike të NATO-s (tani e njohur si Qendra e Sigurisë Kibernetike e NATO-s) dhe Ekipit të Reagimit ndaj Emergjencave Kompjuterike për institucionet, organet dhe agjencitë e BE-së (CERT-EU)³¹ ofron një mundësi për shkëmbimin e informacionit, praktikat më të mira ndërmjet ekipeve të reagimit ndaj emergjencave.

Në samitin e NATO-s 2023 në Vilnius³², aleatët u angazhuan të kërkojnë më tej të zhvillojnë partneritete reciproke dhe efektive, duke përfshirë vendet partnere, organizatat ndërkombëtare, industrinë dhe akademitë ushtarake. Duke njohur nevojën për të marrë ndihmë me shpejtësi, NATO lançoi gjithashtu Kapacitetin Mbështetës të Incidentit Virtual Kibernetik (VCISC)³³ për të mbështetur përpjekjet kombëtare zbutëse në përgjigje të aktiviteteve të rëndësishme keqdashëse kibernetike. Ndërsa vendi ynë dhe Forcat tona të Armatosura vazhdojnë të ndjekin, përshtaten e të zhvillojnë programe dhe të ngrenë qendra inovacioni³⁴. Është e rëndësishme për brezin e ri të studentëve ushtarakë që të formohen, ndjekin dhe të përditësohen me të reja që shkenca dhe teknologjia sjell për Forcat e Armatosura të RSH. Kundërshtarët tanë jo vetëm zhvillojnë kapacitetet teknologjike, por edhe ndjekin me kujdes hapat tanë³⁵.

Përfundime

- Viti 2024 dhe përtej, duket se do të dëshmojë një mjedis të rritjes së luftërave “të mohueshme” si rezultat i (AI) dhe përpjekjeve për ta integruar atë, si nga institucionet e NATO-s ashtu edhe të tjera të sigurisë, të cilëve u nevojiten njohuritë e teknologjisë.
- Operacionet kibernetike, “lufta proxy”, përplasje me “ushtri të askujt” dhe operacionet me “flamur të remë”, priten të jenë e ardhmja e konflikteve të armatosura midis shteteve.
- Sektori privat është konfirmuar një lojtar kyç edhe për të ardhmen e luftës

³¹https://www.googleadservices.com/pagead/aclk?sa=L&ai=DChcSEwi44aHyoYyCAxX5kYMHHQEpC7oYABABGgJlZg&gclid=EAIAIQobChMIuOGh8qGMggMV-ZGDBx0BKQu6EAAYASAAEgLOQPD_BwE&ohost=www.google.com&cid=CAASJuRoG0GDmRrVMOUUEyXKh9Ps6EdFoOeNNsh_uNgqxcJsfUgz6u-V&sig=AOD64_29KX58tvovCuKBcgBioTalbf3w&q&adurl&ved=2ahUKEwi3upryYyCAxX4_7sIHVi5BXEQ0Qx6BAgCEAE

³²<https://www.evropaelire.org/a/agjenda-samiti-nato-kosova-jashte/32497257.html>

³³<https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Kategorite-e-incidentit.pdf>

³⁴<https://www.kryeministria.al/qendra-e-inovacionit-te-sigurise-dhe-mbrojtjes/>

³⁵<http://www.panorama.com.al/rama-inauguroi-qendren-e-re-te-inovacionit-te-sigurise-dhe-mbrojtjes-reagon-rusia-qender-kibernetike-e-orientuar-per-sulme-ndaj-nesh/>

në hapësirën kibernetike, ku pasojat pritet të jenë thelbësore për doktrinat e NATO-s, për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive kërcënimeve kibernetike³⁶.

- IA pritet të gjenerojë dhe rrisë sintezën e të folurit, përkthimin dhe automatizimin kaq të përdorshëm në komandim-kontroll (C2). ChatGPT nga ana e saj, pritet të bëjë revolucion sidomos në analizën e shpejtë të informacionit dhe inteligjencës, si bazë e marrjes së vendimit ushtarak.
- Sistemet gjithnjë e më të sofistikuara të IA kërkojnë fuqi përpunuese dhe analizuese, që nënkupton një hop të industrisë në teknologjinë ushtarake të së ardhmes. Shpejtësia e përpunimit të informacionit dhe analiza e tij e të dhënave janë në një nivel shumë të lartë që kërkon, që personeli ushtarak të trajnohet më shpejt me aftësi të zgjeruara për vetë-evolucion.
- Aktualiteti gjeopolitik, tregon se jemi prag të një “agimi” të ri për njerëzimin, me teknologjitë e së ardhmes, me IA dhe inxhinierinë gjenetike parashikohet të arrihet zhvillim galopant por edhe me efekte anësore të padëshiruara për sigurinë³⁷.
- Siç po na tregojnë luftërat në Evropën Lindore dhe Lindjen e Mesme, ne jemi në pikën delikate në gjeopolitikë. Animi drejt autoritarizmit dhe thyerja e parashikuar prej kohësh e hegjemonisë së demokracisë perëndimore, më në fund ka ndodhur.

Bibliografia:

1. Caprile A. dhe Delivorias A., *BE sanksionet në Rusia: Vështrim i përgjithshëm*, ndikimi, sfidat , EPRS, Parlamenti Evropian, mars 2023.
2. Jon Harper, *Ukraina është laborator i jashtëzakonshëm për studime ushtarake dhe AI*; 1 gusht 2023; shih: <https://defensescoop.com/2023/08/01/ukraine-is-extraordinary-laboratory-for-military-ai-senior-dod-official-says/>
3. “Lufta”, *USNI Procedurat*, qershor 2023, <https://www.usni.org/magazines/proceedings/2023/june/struggle-black-sea-russian-navys-frailty-russo-ukrainian-war>
4. “Rusia jep paralajmërimin e anijeve në Detin e Zi ndërsa Ukraina dënon sulmet ‘djallëzore’”, Reuters, 19 korrik 2023, <https://www.reuters.com/world/europe/russia-strikes-uk-raines-Odessa-port-hellish-attack-official-2023-07-19/>

³⁶<https://www.cnn.com/2024/03/25/europe/ukraine-starlink-drones-russia-intl-cmd/index.html>

³⁷<https://www.the-coming-wave.com/>

5. “Ukraina intensifikon përpjekjet të thyejë bllogadën e detit të zi”, 17 shtator 2023, shih: <https://www.ft.com/content/f2c8312f-feac-4d1d-983f-f1798258de9f>
6. Paul Pedrozo, *Lufta Rusi-Ukrainë në det: bllokada detare, vizita kërkimi dhe shënjestrimi i objekteve që mbështesin luftën*, Lieber Institut, 25 gusht 2023, shih: <https://lieber.westpoint.edu/russia-ukraine-war->
7. Dominika Kunertova, “Lufta në Ukrainë tregon se efekti i ndryshimit të lojës së dronëve varet nga loja”, *Buletini i Atomike Shkencëtarët*, Vëllimi 79, 2023 - Çështje 2, shih: <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/00963402.2023.2178180>
8. “Anija e çmuar ruse u godit nga raketa”, *The New York Times*, prill, 2022, <https://www.nytimes.com/2022/04/15/us/politics/Russia-moskva-ship-sunk-ukraine.html>
9. Burimi elektronik: <https://www.reuters.com/world/europe/ukraina-ushtara-thotë-goditi-zalyv-plant-port-city-kerch-crimea-2023-11-04/>
10. Justin Bonk, *Forca dhe kufizimet luftarake ajrore ruse: Mësim nga Ukraina*, 17 prill 2023, Dokument i rastësishëm i CNA, <https://www.cna.org/reports/2023/05/russian-combat-air-strengths-and-limitations>
11. A. Horton, R. Mellen, S. Granados & A. Galocha, *Këto janë sistemet përëndimore të mbrojtjes ajrore që mbrojnë Ukrainë*, The Washington Post, 19 maj 2023, <https://www.washingtonpost.com/world/2023/05/19/ukraine-air-defense-sistemet-patriot/>
12. Mathew Luxmore, *Ukraina ndeshet me epërsinë ajrore ruse*, The Wall Street Journal, 17 qershor 2023, <https://www.wsj.com/articles/ukraine-runs-into-russian-air-superiority-82c621c>
13. Ulrike Franke, *Dronët në Ukrainë dhe përtej*: 11 gusht 2023, <https://ecfr.eu/article/drones-in-ukraine-and-beyond-everything-you-need-to-know/#:~:text=Drones%20kanë%20dokumentuar%20shkatërrimin%20,ndihmë%20direkt%20dhe%20kryer%20goditje>
14. Christian Triebert, Haley Willis, Yelyzaveta Kovtun dhe Alexander Cardia, *Kundërsulmi tjetër i Ukrainës: Sulmet me dron në tokën ruse*, The New York Times, 31 korrik 2023, <https://www.nytimes.com/2023/07/31/world/europe/ukraine-drone-greva-rusi.html>
15. https://www.armyrecognition.com/defense_news_april_2023_global_security_army_industry/list_of_the_808_tanks_that_ukraine_will_receive_from_nato_allies_with_a_part_already_delivered.html
16. William A. Arkin, *Si Ukraina po shtyp artilerinë e famshme të Rusisë*

- “Zoti i Luftës”, *Newsweek*, 92 gusht 2023, <https://www.newsweek.com/russias-god-war-failing-1816722>
17. Sebastien Philippe, *Duke u shfaqur teknologjitë, gara e armeve bërtamore dhe siguria globale* NASA Astrofizika- Të dhënat -Sistemi (ADS), 2021, <https://ui.adsabs.harvard.edu/abs/2021APS..APRY05003P/abstract>
 18. Maks Hunder, Xhonatani Landay dhe Stefania Bern, Reuters, 13 dhjetor 2023, <https://www.reuters.com/technology/cybersecurity/ukraines-biggest-mobile-operator-suffers-massive-hacker-attack-statement-2023-12-12/>
 19. 14 nëntor 2023, <https://time.com/6334176/ukraine-clearview-ai-russia/>
 20. David Hambling, *Dronët e AI të Ukrainës kërkojnë dhe sulmojnë forcat ruse pa mbikëqyrje njerëzore*, Forbes, 17 tetor, 2023, <https://www.forbes.com/sites/davidhambling/2023/10/17/ukraines-ai-drones-seek-and-attack-russian-forces-without-mbikëqyrje-njerëzore/?sh=649dbc8e66da>
 21. Daisy Stephens, *Nëse ne biem, t'i bie*: Video e rreme tregon Parisin të sulmuar nga Ukraina, *Independent*, 12 mars, 2022, <https://www.independent.co.uk/tv/news/ukraine-paris-bomb-deep-fake-b2034714>.
 22. htmlpr@ep.europa.eu
 23. www.eprs.ep.parl.union.eu
 24. www.europarl.europa.eu/thinktank

A mund të nxisë paradigma e re idenë e 'smart defense' midis Shqipërisë dhe Kosovës...?

Prof. Dr. Kristaq XHARO
Universiteti Evropian i Tiranës

Trajtesë e shkurtuar.

Kypunim analizon sfidat dhe mundësitë që vendet e vogla përballen në një mjedis global gjithnjë e më të ndërlidhur dhe konkurrues. Kjo analizë përqendrohet në paradigmen e re të sigurisë dhe mbrojtjes, e cila përfshin kapacitetet e fuqisë "hard" dhe "soft", si dhe modernizimin e sistemit të mbrojtjes dhe të infrastrukturës së integruar. Në këtë kontekst, është theksuar rëndësia e një qasjeje holistike për të investuar në kapacitetet ushtarake dhe për të përdorur "soft power" për të promovuar një imazh të plotësuar të imazhit kombëtar. Komponentët kyç të kësaj paradigme përfshijnë strategji të adaptueshme të mbrojtjes që adresojnë kërcënimet bashkëkohore dhe rekomandojnë rrugë për të përmirësuar kapacitetet e fuqisë përmes 'smart defense'. Duke adoptuar këtë paradigmë, vendet e vogla në kategorinë ku përfshihet Shqipëria dhe Kosova, mund të navigojnë më efektivisht në kompleksitetin gjeopolitik, të rrisin prezencën e tyre globale dhe të kontribuojnë në paqen dhe prosperitetin ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: paradigmë; siguri; mbrojtje; reformë; kapacitete fuqie; strategji; aleancë; mbrojtje inteligjente.

Hyrje

Në këtë material synohet të trajtohen aspektet për vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të fuqisë, duke përfshirë elementët e fuqisë së fortë, referuar Josep Ney 'hard power' dhe të fuqisë së butë, 'soft power'¹, në kontekstin e indeksit të fuqisë së fortë dhe të butë, si dhe duke krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Synimi i kësaj trajtese është vlerësimi i mjedisit dhe mundësisë për një projekt të gjerë kombëtar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Kjo pasqyrohet në analizën dhe vlerësimin e mundësisë së projekteve të përbashkëta kombëtare, veçanërisht me Kosovën, dhe mund të shtrihet edhe në projekte të fuqisë së butë duke përfshirë diasporën.

Ideja e ndjekur buron nga Mearsheimer, një analist i njohur i politikës ndërkombëtare, i cili gjatë analizës së rivalitetit midis shteteve, veçanërisht në "teorinë e konfliktit të madhësive", përfshin edhe vendet e vogla në rivalitetet e tyre me njëri-tjetrin dhe me fuqitë më të mëdha². Koncepti që vendet e vogla mund të zgjerojnë kapacitetet cilësore në fushën e mbrojtjes për të kompensuar pamundësinë për zgjerim numerik gjen trajtim nëpërmjet një varg elementesh. Dilema qëndron në hapësirat dhe kufizimet që i ofrojnë Shqipërisë dhe Kosovës për projekte të përbashkëta, edhe në fushën e mbrojtjes.

Metodologjia e ndjekur fillimisht identifikon sfidat kryesore të sigurisë dhe të mbrojtjes për vendin tonë në kontekstin rajonal dhe më gjerë. Duke u bazuar në analizën e sfidave, mundësive dhe kapaciteteve të tanishme, vërehet një drejtim drejt angazhimeve të ardhshme. Në këtë kontekst, mund të shikohen tregues si përmirësimi i aftësive ushtarake, modernizimi i pajisjeve, si dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë e të mbrojtjes. Pas përcaktimit të qëllimeve dhe analizës, synohet të propozohen disa ide për implementimin e këtyre angazhimeve në fushën e mbrojtjes.

1. Koncepti i paradigmës së re në mjedisin e sigurisë dhe të mbrojtjes

Paradigma e re në mjedisin e mbrojtjes së vendit tonë rrjedh nga faktorë të rëndësishëm, që janë reflektim në peizazhin e ndryshueshëm të sigurisë e, në këtë linjë, edhe me sfidat specifike që ballafaqohet një vend i vogël. Fillimisht, çfarë është paradigma dhe më pas paradigma e sigurisë dhe e mbrojtjes? Koncepti i paradigmës, siç e shpreh Thomas Kuhn në "Teoria e Struktura e Revolucionit Shkencor"³, shërben si një kontekst themelor për të kuptuar

¹ Ney, Joseph (2005), *Soft Power* Little Brown Book, New York.

² Mearsheimer, John (2001), *The Tragedy of Great Power Politics* W.W. Norton & Company

³ Thomas Kuhn (1962), *The Structure of Scientific Revolutions*. University of Chicago Press.

zhvillimet në mendimin dhe praktikën shkencore. Ai përfshin një set besimesh të përbashkëta, vlerash dhe metodologji që udhëheqin analizën, kërkimin, vlerësimin, brenda një fushe të caktuar. Në fushën e studimeve të sigurisë, kjo shprehje gjen rezonancë në diskutimet rreth paradigmës së sigurisë.

Barry Buzan, një nga figurat kryesore në studimet e sigurisë, ka kontribuar në zgjerimin e konceptit tradicional të sigurisë përtej dimensioneve ushtarake. Vepra e tij "Njerëz, Shtete dhe Frika"⁴ shpalos nevojën për të përfshirë faktorët shoqërorë, mjedisore dhe ekonomikë në kuptimin e kërcënimeve të sigurisë. Buzan thekson natyrën dinamike të këtij koncepti dhe rëndësinë e adaptimit ndaj sfidave të zhvillimit në një mjedis të ndryshëm. Ken Booth, duke u fokusuar në kritikën e paradigmave tradicionale të sigurisë, ka ndikuar në debatin mbi teorinë dhe konceptin. Duke sjellë një perspektivë më holistike, Booth shpalos dinamikat e identitetit, raportet e fuqisë dhe ndërtimin e kërcënimeve, duke sfiduar qasjet konvencionale ndaj sigurisë⁵. Në studimet e sigurisë, një ndër kornizat më të rëndësishme është ajo e studimeve të sigurisë kritike, e cila shtron pyetje themelore në lidhje me parimet e paradigmave dominuese të sigurisë. Kjo përmbledhje e perspektivës së Booth dhe të studimeve të sigurisë kritike tregon interesin e shkencëtarëve dhe politikë-bërësve për të kuptuar thellësisht konceptin e sigurisë. Në fund, nuk mund të neglizhohet edhe perspektiva feministe që sjell Cynthia Enloe në studimin e paradigmave të sigurisë, e cila shton një dimension të rëndësishëm, duke theksuar rolën e gjinisë në analizën e sigurisë⁶. Në punimet e saj, Enloe tërheq vëmendjen për nevojën për përfshirje dhe ndër-sektoriale në analizën e sigurisë, duke sfiduar kuptimet e ngushta të sigurisë të përhapura në diskursin kryesor.

Pra, në sintezën e vështirimeve të Kuhn, Buzan, Booth dhe Enloe e mjaft autorëve të tjerë, qartas shprehet se koncepti i paradigmës përfshin zhvillimet në mënyrën se si e kuptojmë sigurinë. Paradigma e sigurisë, ndikuar nga perspektivat shkencore të ndryshme, zhvillohet në përgjigje të kërcënimeve që lindin dhe dinamikave nacionale, rajonale e globale në ndryshim. Duke u ballafaquar me pikëpamje të ndryshme dhe duke analizuar në mënyrë kritike paradigmata aktuale, analistët, studiuesit, por edhe vendimmarrësit mund të ndërtojnë një kuptim më të gjerë dhe të detajuar të sfidave të sigurisë, mund të hapin rrugën për strategji inovative dhe efektive të sigurisë.

⁴ Buzan, B. (1991). *People, States, and Fear: An Agenda for International Security Studies*. ECPR Press

⁵ Booth, K. (2007). *Theory of World Security*. Cambridge University Press

⁶ Enloe, C. (2014). *Bananas, Beaches and Bases: Making Feminist Sense of International Politics*. University of California Press.

2. Njohja e kufizimeve si hap i parë për konceptimin e paradigmës

Vendi ynë si vend i vogël përfshihet në kategorinë e vendeve me burime të kufizuara, si në kapacitetin ushtarak ashtu edhe në aspektin ekonomik. Barry Buzan dhe Ole Ueiver në "Regions and Powers," theksojnë se shtetet e 'vogla' ballafaqohen me vështirësi të natyrshme për shkak të madhësisë së tyre, popullsisë dhe pozicionit gjeopolitik⁷. Këto vulnerabilitete mund të shfrytëzohen nga kundërshtarët, duke bërë të domosdoshme adoptimin e një qasje më strategjike dhe inovative në mbrojtje që maksimizon burimet në dispozicion dhe përdor partneritetet ndërkombëtare, qoftë edhe brenda organizatave si NATO. Natyra e kërcënimeve që përballen shtetet ka ndryshuar ndjeshëm, ku përveç luftës konvencionale janë shpeshuar kërcënimet në rritje të luftës hibride dhe sulmeve kibernetike, që paraqesin sfida të reja për strategjitë tradicionale të mbrojtjes. Studiuesi Frank G. Hoffman në "Conflict in the 21st Century"⁸ thekson zbehjen apo zhdukjen e vijave ndërmjet kërcënimeve konvencionale dhe atyre jo-konvencionale, duke detyruar një kalim drejt strategjive të përgjithshme të mbrojtjes. Më thellë, disa nga këto kufizime dhe vështirësi mund të përfshijnë:

Resurset e kufizuara: Shqipëria ka burime të kufizuara njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës në krahasim me vende më të mëdha, çka mund të bëjë më të vështirë përgjigjen ndaj sfidave të sigurisë. Për një vend të vogël si Shqipëria, është e rëndësishme të njihen kufizimet dhe vështirësitë që dalin nga madhësia e saj të vogël dhe pozicioni gjeostrategjik. Siç thekson eksperti në siguri Robert E. Harkavy, "Vendet e vogla janë zakonisht të varura nga partnerët e tyre të mëdhenj për mbështetjen e sigurisë dhe të mbrojtjes."⁹

Varësia nga burimet e jashtme: Si një vend i vogël, Shqipëria është ndikuar nga burimet e jashtme për siguri dhe mbrojtje. Varësia nga furnizimet e armatimit, asistencat ushtarake dhe mbështetja financiare nga partnerët ndërkombëtarë mund të shkaktojë kufizime në aftësinë e saj për të menaxhuar kërcënimet potenciale. Eksperti i sigurisë Mark Galeotti thekson se "vendet e vogla si Shqipëria janë shpesh më të prekshme ndaj kërcënimeve të jashtme si pasojë e burimeve të kufizuara dhe varësisë nga bashkësia ndërkombëtare për mbrojtje."¹⁰

⁷ Barry Buzan dhe Ole Wæver (2003), *Regions and Powers*, Cambridge, University Press.

⁸ Frank G. Hoffman (2008), *Conflict in the 21st Century*, Praeger USA.

⁹ Harkavy, Robert E. (2009), *The International Relations of Small States: An Overview*. In "The International Relations of Small States: Persistent and Emerging Issues," University of British Columbia Press.

¹⁰ Galeotti, Mark (2013). *Small States: Insecurity and Strategic Culture*. "Journal of Strategic Studies" 36, no. 21.

Rreziku për përshkallëzimin e konflikteve rajonale: Si një vend i vogël në një rajon të ndërlukuar, Shqipëria mund të preket nga përshkallëzimi i tensioneve dhe konflikteve në rajon. Kjo mund të sjellë pasoja negative për stabilitetin dhe sigurinë e vendit. Duke njohur dhe kuptuar këto kufizime, Shqipëria mund të përgatitet për të menaxhuar më mirë kërcënime të mundshme dhe për të zhvilluar strategji të sigurisë të përshtatshme për interesat dhe nevojat e saj të specifika. Në një analizë të bërë nga John Mearsheimer, theksohet se “vendet e vogla janë më të prekshme nga tensionet dhe konfliktet rajonale, pasi nuk kanë forcën dhe influencën për të mbrojtur interesat e tyre në mënyrë të pavarur.”¹¹

Gjithë sa më sipër tregojnë se, për vendin tonë është e rëndësishme, të kuptojë kontekstin e kufizimeve dhe vështirësive të tij si një vend i vogël në skenën ndërkombëtare. Duke analizuar dhe vlerësuar faktorët kryesorë, del e nevojshme zhvillimi i një strategjie sa më efektive të sigurisë e të mbrojtjes, e aftë për të adresuar sfidat e mundshme dhe për të arritur një nivel të lartë sigurie në një mjedis të ndryshueshëm. Ndaj paradigma e re synon të imponojë reflektim në një reformë të domosdoshme që lidhet ngushtësisht me ndryshimet në natyrën e kërcënimeve.

3. Në themel të paradigmës së re: dilema e sigurisë dhe balanca e fuqisë

Konceptet e "dilemës së sigurisë" dhe "balancës së fuqisë" mbeten koncepte bazë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë në të gjitha nivelet. Edhe pse ato kanë evoluar dhe kanë ndryshuar në varësi të kontekstit historik dhe politik, përsëri ndikimi i tyre qëndron në themel dhe me ndikim të konsiderueshëm në strategjitë e të gjitha niveleve dhe po aq në kontekstin e politikës së jashtme, si derivat të tyre. Konceptet e "dilemës së sigurisë" dhe "balancës së fuqisë", si elemente bazë të paradigmës së sigurisë, filluan të shfaqen e të përdoren fillimisht në literaturën dhe analizat e politikës ndërkombëtare në fillim të shekullit të 20-të dhe u thelluan gjatë periudhës së rritjes së tensioneve ndërkombëtare para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore e në vazhdim. Ndryshe nga ‘balanca e fuqisë’ si shprehje e realizmit ofensiv, *‘dilema e sigurisë’ vjen si një supozim thelbësor i realizmit defensiv*. Sipas Kenneth Ualtz, për shkak se bota nuk ka një qeveri të përbashkët dhe është “anarkike”, mbijetesa është motivimi kryesor i shteteve. Shtetet nuk kanë besim në synimet e shteteve të tjera dhe si pasojë, gjithmonë përpiqen të maksimizojnë sigurinë e tyre¹². Dilema e sigurisë shpjegon pse shtetet që kërkojnë siguri (në krahasim me jo-kërkuessit e sigurisë) mund të përfundojnë në konflikt.

¹¹ Mearsheimer, John (2001). *The Tragedy of Great Power Politics*. Norton & Company.

¹² Kenneth Ualtz (1979). *Theory of International Politics*. "McGraw-Hill" New York.

Koncepti i dilemës së sigurisë u përshkrua për herë të parë nga analistët e politikës ndërkombëtare, përfshirë Hans Morgenthau dhe John Herz, gjatë viteve 1950. Ata shpalosën se si përpjekjet e një shteti për të rritur sigurinë e vet mund të trembin dhe të rrisin tensionet me shtetet e tjera, duke krijuar një ambient të përgjithshëm të pakënaqësisë dhe frikës në arenën ndërkombëtare. Koncepti i dilemës së sigurisë u prezantua dhe u zhvillua formalisht nga John Herz në fund të viteve 1950. Herz, një shkencëtar politik gjermano-amerikan, përshkroi se si përpjekjet e shteteve për të rritur sigurinë e tyre mund të çojnë në rritje të papritur të pasigurisë dhe tensioneve me shtete të tjera. Kjo ide u eksplorua dhe zgjerua më tej nga studiues të tjerë gjatë viteve 1960 dhe më tej¹³.

Ndryshe nga 'dilema e sigurisë', 'balanca e fuqisë' vjen me një histori edhe më të gjatë në debatin teorik për rolin dhe vendin në kontekstin e sigurisë, luftërave dhe krizave. Ndoshta në formën e saj më të thellë si koncept, u theksua dhe u analizua gjatë periudhës para dhe pas Luftërave Napoleonike në fillim të shekullit të 19-të. Gjatë kësaj periudhe, politikanë dhe teoricienë europianë si Metternich¹⁴ dhe Castlereagh¹⁵ e vlerësuan si prioritet themelor të krijonin dhe ruanin një balancë të fuqisë midis fuqive të mëdha evropiane për të parandaluar hegjemoninë dhe për të ruajtur stabilitetin midis tyre. Në kohët më moderne, koncepti i balancës së fuqisë u ringjall në formën më të ashpër të tij pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, sidomos me gjallërimin e teorive realiste në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ai u bë një aspekt kyç për të kuptuar politikën e fuqive të mëdha gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, me studiues si Kenneth Waltz që e përmirësuan dhe e sistemuan konceptin në mes të shekullit të 20-të. Pra, edhe pse koncepti i balancës së fuqisë ka rrënjë më të hershme historike, ai fitoi një rëndësi dhe zhvillim teorik në shekullin e 19-të dhe 20-të, sidomos gjatë periudhave të ndërlikuara të konkurrencës dhe konflikteve gjeopolitike. Dilema e sigurisë, nga ana tjetër, u theksua më shumë si një koncept teorik i sigurisë në mes të shekullit të 20-të, kur studiuesit përballeshin me kompleksitetet e sigurisë ndërkombëtare dhe eskalimin e konflikteve.

Edhe në Ballkanin Perëndimor, dilema e sigurisë dhe balanca e fuqisë ndjehen si faktorë të rëndësishëm në çështjet e sigurisë rajonale. Rajoni ka një histori komplekse të tej-mbushur nga tensionet etnike, konfliktet dhe mosmarrëveshjet territoriale. Shqetësimet për sigurinë shpesh shkaktohen nga dilemat historike, si ato që u krijuan nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe garat e fuqive rajonale e

¹³ John Herz (1951). *Political Realism and Political Idealism*. "University of Chicago Press".

¹⁴ Klemens von Metternich, politikan dhe diplomat austriak, i cili u bë një nga figurat kryesore në Konferencën e Vjenës në 1814-1815.

¹⁵ Viscount Castlereagh, politikan dhe diplomat britanik i shekullit të 19-të, i cili luajti një rol kryesor në ngjarjet e pas-Luftës së Napoleonit.

ekstra rajonale për ndikim në këtë hapësirë rajonale. Në këtë kontekst, balanca e fuqisë vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në formimin e dinamikave brenda rajonit ku shtete dhe grupe etnike të ndryshme garojnë për ndikim, jo rrallë, duke u lidhur dhe inspiruar me aktorë të jashtëm shpesh agresivë për të përforcuar pozicionet e tyre. Kjo konkurrencë mund të përkeqësojë tensionet dhe të kontribuojë në instabilitet. Për më tepër, vendndodhja gjeopolitike e Ballkanit Perëndimor e bën atë një pikë kryqëzimi për interesa të kundërta. Aktorë ndërkombëtarë të ndryshëm, përfshirë Bashkimi Evropian, NATO, Rusia dhe Turqia, ndikojnë në rajon për arsye strategjike, ekonomike ose politike. Kjo i komplikon më tej përpjekjet për të arritur stabilitet dhe për të zgjidhur çështje të vjetra.

Adresimi i dilemës së sigurisë dhe krijimi i një balancë të qëndrueshme të fuqisë janë të rëndësishme për të promovuar paqen, stabilitetin dhe prosperitetin në Ballkanin Perëndimor. Kjo kërkon rol të elementeve të ‘hard’ dhe ‘soft power’, diplomaci efektive, mekanizma zgjidhjeje konflikti dhe iniciativa për bashkëpunim rajonal që synojnë adresimin e shqetësimeve themelore dhe ndërtimin e besimit midis palëve të interesuara. Tashmë që balanca e fuqisë dhe dilema e sigurisë kanë ndryshuar mjaft në mjedisin e ri të sigurisë me një numër kërcënimesh sa tradicionale e sa të ndryshme, sa konvencionale e sa asimetrike e hibride dhe me balanca fuqie që ndryshojnë po aq shumë duket se një paradigmë e re po i zë vendin asaj të mëparshmes. Kjo vjen si një paradigmë që do të reflektojë në nevojën e një reforme të re, në strategji, kapacitete fuqie, infrastrukture, në koncepte e në veprime.

4. Koncepti i ‘fuqisë së fortë’ në kapacitetet e mbrojtjes.

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe sigurisë kombëtare, koncepti i ‘fuqisë së fortë’ luan një rol kritik në formimin e strategjisë së mbrojtjes së një kombi. ‘Fuqia e fortë’ përfshin përdorimin e kapaciteteve kërcënuese dhe ushtarake për të arritur objektivat e një shteti, shpesh përdorur përmes forcës ushtarake ose kërcënimit me të. ‘Fuqia e fortë’ është një koncept themelor në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, i njohur nga shkencëtari politik Joseph Nye. Ajo përfshin kapacitetet ushtarake të një shteti, duke përfshirë ushtrinë, marinën, forcën ajrore dhe arsenalin bërthamor, si dhe fuqinë ekonomike dhe avancimet teknologjike në sistemet e mbrojtjes. Efektshmëria e fuqisë së fortë qëndron në aftësinë e saj për të parandaluar kundërshtarët, për të projektuar forcën ushtarake dhe për të mbrojtur interesat kombëtare përmes mjeteve kërcënuese. Siç theksoi Mearsheimer, “...ajo përfshin kapacitetet ushtarake të një shteti, duke përfshirë ushtrinë, marinën, forcën ajrore dhe arsenalin bërthamor...”¹⁶

¹⁶ John Mearsheimer (2011). *The Tragedy of Great Power Politics*.

Komponentët e Fuqisë së Fortë. Sipas Morgenthau, një nga komponentët kryesorë të fuqisë së fortë është teknologjia e avancuar. “Avancimet në teknologji, si lufta kibernetike dhe pajisjet ajrore, ‘dronë’, kanë bërë gjithnjë e më të rëndësishme në luftën moderne dhe janë pjesë e kapaciteteve që fuqia e një vendi duhet të përmbajë për të mbrojtur interesat e saj...”¹⁷. Fuqia e fortë përfshin disa komponentë kyç që kontribuojnë në kapacitetet e mbrojtjes së një kombi. Fuqia e fortë mbetet një themel i strategjive të mbrojtjes kombëtare për shkak të efektshmërisë së saj në parandalimin e agresionit, mbrojtjen e sovranitetit kombëtar dhe ruajtjen e interesave jetësore. Aftësia për të përdorur forcat ushtarake dhe për të projektuar fuqinë shërben si një parandalim kundër kundërshtarëve potencialë, duke i penguar ata nga sfidimi i sigurisë dhe integritetit territorial të një kombi. Siç e shpjegon Ualtz, “...fuqia e fortë mbetet një themel i strategjive të mbrojtjes kombëtare për shkak të efektshmërisë së saj në parandalimin e agresionit dhe mbrojtjen e sovranitetit kombëtar...”¹⁸

Gjithashtu, kërcënimi i besueshëm i veprimeve ushtarake mund të detyrojë kundërshtarët të kërkojnë zgjidhje diplomatike për konflikte, duke parandaluar eskalimin dhe duke ruajtur stabilitetin rajonal. Në rastet kur diplomacia dështon ose kur interesat kombëtare tërheqin, përdorimi i fuqisë së fortë mund të jetë i nevojshëm për të mbrojtur kundër agresionit dhe për të mbrojtur ligjin dhe normat ndërkombëtare. Megjithatë, ndërsa fuqia e fortë është e domosdoshme në mbrojtjen kombëtare, ajo nuk është pa kufizime. Mbështetja e tepërt në forcën ushtarake mund të çojë në pasoja të papritura, duke përfshirë viktimat civile, krizat humanitare dhe instabilitetin afatgjatë. Gjithashtu, përhapja e sistemeve të armëve të avancuara dhe kërcënimet emergjente si lufta kibernetike sjellin sfida të reja për konceptet tradicionale të fuqisë së fortë.

5. Për një analizë në mjedisin rajonal përmes Indeksit të Fuqisë

Përmes Indeksit Global të Fuqisë së Fortë, mund të kalojmë në një analizë të balancës së fuqisë e më tej ‘dilemës së sigurisë’ në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në një botë të ngjyrosur nga konkurrenca gjeopolitike dhe sfidat e sigurisë, vendet kërkojnë të përmirësojnë forcën e tyre ushtarake për të mbrojtur sovranitetin e tyre, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të afirmuar ndikimin në çështjet rajonale dhe globale. Indeksi Global i Fuqisë jep një pasqyrë interesante të balancës së fuqisë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Platforma

¹⁷ Hans Morgenthau (1948). *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*. Alfred A. Knopf.

¹⁸ Kenneth Waltz, *Theory of International Politics*.

"Global Fire Power"¹⁹, e cila vlerëson fuqinë ushtarake të 145 vendeve në botë, ka prezantuar renditjen e vendeve të këtij rajoni në krahasim me vendet e tjera. Kosova, për shembull, ka një rënie në renditje për vitin 2024 krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa, Shqipëria, Serbia dhe Kroacia kanë ndryshime në forcat e tyre të armatosura duke shënuar rritje në renditjen e kësaj platforme *online*.

Edhe pse në vitin 2024, Forcat e Sigurisë së Kosovës janë angazhuar në investimet në armë të reja dhe të sofistikuara, duke rritur buxhetin dhe numrin e ushtarëve aktivë, përsëri ajo është në rënie në renditjen e fuqisë ushtarake sipas "Global Fire Power". Kosova aktualisht renditet e 135-ta, nga 140 vende. Sipas këtij vlerësimi, buxheti i mbrojtjes së Republikës së Kosovës shkon në shumë 399 milionë dollarë për vitin 2024. Sipas të dhënave, 7,500 persona janë personel ushtarak, duke përfshirë edhe ushtarët rezervistë. Kosova nuk posedon asnjë mjet luftarak ajror, asnjë tank, por ka në inventar 922 mjete transportuese ushtarake dhe mjete të blinduara. Nuk janë përfshirë në këtë vlerësim dronët e sapo blerë Bajraktar nga Turqia, raketat Javelin kundër tankeve dhe pajisjet e tjera ushtarake.

Ndërsa, Shqipëria ka përjetuar një rritje në fuqinë ushtarake për dy vitet e fundit. Ajo ka përforcuar kapacitetet e saj ushtarake dhe ka rritur pozicionin në renditjen e fuqisë së fortë globale. Në vitin 2024, Shqipëria renditet e 90-ta me një buxhet për mbrojtjen prej 386 milionë dollarëve dhe një numër të modest të ushtarëve aktivë. Shqipëria, për të dytin vit radhazi, është përmirësuar në terma të fuqisë ushtarake. Vitin e kaluar ajo ishte e renditur e 91-ta, duke ngritur 24 vende krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, për 2024 është ngritur në një pozicion më të lartë të fuqisë ushtarake, në vendin e 90-të. Buxheti që Shqipëria shpenzon për mbrojtjen sipas "Global Fire Power" shkon në shumë 386 milionë dollarë. Sipas të dhënave, Shqipëria ka 2335 ushtarë aktivë; 660 anëtarë në Forcën Ajrore dhe 1000 në Forcën Detare. Ndërkohë, ajo zotëron 19 aeroplanë, të gjithë helikopterë. Shtohet këtu fakti se dy helikopterë nga kontingjenti i helikopterëve amerikanë UH-60 Black Hawk arritën në tokën shqiptare së fundmi.

Lider në terma të fuqisë ushtarake në Ballkanin Perëndimor mbetet Serbia, shteti që trashëgoi shumicën e armatimeve pas shkatërrimit të Jugosllavisë. Në anën tjetër, Serbia mbetet lider në fuqinë ushtarake në rajon, duke rritur pozicionin në renditje për dy vjet radhazi. Me një buxhet për mbrojtjen prej 1.5 miliardë dollarëve për vitin 2024, Serbia zotëron një gamë të gjerë pajisjesh ushtarake dhe një numër të madh të ushtarëve aktivë. Krahasuar me vitin e kaluar, Serbia është ngritur dy vende më lart, duke u renditur e 56-ta, me mbi

¹⁹ Global Fire Power (2024).

13,000 ushtarë aktivë dhe 3,000 trupa në forcën ajrore. Serbia zotëron 122 mjete ajrore, mes tyre 44 helikopterë, 11 avionë luftarakë, 17 avionë sulmues dhe 2 për transportimin e peshës, gjithashtu ajo zotëron 262 tanke, 3954 mjete ushtarake dhe 82 mbushje raketore ose bateri për të lëshuar raketat.

Vendi fqinj, Kroacia me të cilin Serbia humbi luftën në vitet '91-'95, është i vetmi që i rezistoi atij në terma të fuqisë ushtarake. Kroacia po ashtu ka shënuar një rritje në fuqinë ushtarake për vitin 2024, duke u ngritur në renditje për tre pozicione krahasuar me vitin e kaluar. Me një buxhet për mbrojtjen prej afërsisht 1.2 miliardë dollarëve, Kroacia ka një numër të konsiderueshëm të ushtarëve aktivë dhe një arsenal të pajisjeve ushtarake. Kroacia renditet e 66-ta për 2024, duke u ngritur tre pozicione krahasuar me vitin e kaluar. Buxheti i mbrojtjes kroate shkon në afërsi të 1.2 miliardë dollarëve, me mbi shtatë mijë trupa ushtarake aktive, 1,260 personel në forcën ajrore dhe 1,365 në forcën detare. Kroacia zotëron 52 helikopterë, 11 avionë luftarakë dhe 26 aeroplanë trajnues. Ndërkohë në tokë, nëse sulmon shtetin kroat, ballafaqohesh me 72 tanke, mbi 3000 mjete ushtarake, 18 mjetet kundërsulmuese të vetë-përhapura, 163 mjetet luftarakë të ngarkuara nga mjetet e tjera, si dhe 105 mbushje raketore, MLRS, prodhim amerikan si dhe 32 mjetet që përdoren në ujë. Ndërkohë, Maqedonia e Veriut është e 110-ta në listën e renditjeve, me 295 milionë euro dollarë për mbrojtjen, ndërsa Mali i Zi është i 129-ti në listën e renditjeve, me 115 milionë dollarë për mbrojtjen. Gjithashtu, vende si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi gjithashtu kanë një prezencë të vlefshme në renditjet e fuqisë ushtarake, edhe pse me buxhete më të vogla krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

"Indeksi i Fuqisë së Fortë Globale" është një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar kapacitetet ushtarake të vendeve dhe ndikimin e tyre në skenën globale. Në një kontekst të sigurisë dhe stabilitetit rajonal, ky vlerësim është thelbësor për të kuptuar dinamikën e fuqisë ushtarake dhe ndikimin e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ngritja e kapaciteteve ushtarake të vendeve të rajonit nuk duhet të shihet vetëm si një garë për fuqinë, por edhe si një mundësi për të ndërtuar marrëdhënie të sigurta dhe të qëndrueshme në rajon. Përmes vlerësimeve të tilla, mund të krijohet një përfaqësim i përgjithshëm i nivelit të fuqisë së fortë të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe faktorëve që ndikojnë në pozicionin e tyre në skenën globale të sigurisë. Është e rëndësishme të kuptohet se ky është një shkurtim i mundësive dhe se një analizë më e hollësishme do të kërkonte një vlerësim të detajuar të çdo faktori dhe kontekstit të gjerë rajonal dhe ndërkombëtar.

6. Nga 'hard power' në 'soft power', një paradigmë që thellohet

Koncepti i 'soft power' ose i fuqisë së butë shpreh ka të bëjë me influencën ndërkombëtare të një vendi, pra sa aftësi ka një vend për të prodhuar efekt

te vendet e tjera. Kjo vlerësohet përmes perceptimeve shtetet apo individët për kombet e tjera në mbarë botën²⁰. ‘Fuqia e butë’ për një vend është mjaft e rëndësishme pasi liderët shpeshherë marrin vendime për politikën e jashtme bazuar mbi perceptimet e tyre për vendet e tjera. Në këtë kontekst vjen në ndihmë Indeksi Global i Fuqisë së Butë.

Në Indeks Global të Fuqisë së Butë për vitin 2022, renditet për herë të parë dhe vendi ynë. Ne renditemi në vend të 104-t nga 120 vende në total dhe vlerësohemi me 29.1 pikë nga 100 në total. Ky indeks bazohet në shtatë shtylla kryesore, të cilat janë: Biznesi dhe Tregtia, Qeverisja, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Kultura dhe Trashëgimia, Media dhe Komunikimi, Arsimi dhe Shkenca, si dhe Njerëzit dhe Vlerat. Në këtë edicion të këtij indeksi është përfshirë dhe pyetja mbi opinionin publik sa i përket trajtimit të pandemisë Covid-19 nga vendet. Për këtë indikator, vendi ynë është vlerësuar me 3.6 pikë. Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria renditet në fund të tyre. Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi po ashtu janë hyrje të reja në këtë indeks. Bosnje-Hercegovina renditet e para në rajon sa i përket fuqisë së butë, duke u pozicionuar në renditjen e përgjithshme në vend të 72-të. Ndjek Serbia në vend të 78-të dhe Mali i Zi në vend të 97-të. Këtë indeks e kryesojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vend të dytë është renditur Mbretëria e Bashkuar. Raporti thekson mes të tjerave edhe sulmet e Rusisë ndaj Ukrainës, duke thënë se do të duhet një moment i dytë për të matur saktë perceptimet mbi fuqinë e butë të këtyre dy vendeve. Megjithatë, Ukraina është duke përdorur mediat konvencionale dhe sociale në funksion të fuqisë së butë, por edhe për të fituar argumentin. Nga ana tjetër, ekspertët politikë thonë se i vetmi komb me aftësinë për të ndaluar konfliktin është Kina, duke përdorur fuqinë e saj të butë ndaj Rusisë.²¹

Krijuesi i konceptit të ‘soft power’ është Joseph Nye, një akademik dhe politikan amerikan, i cili paraqiti këtë ide në vitin 1990, menjëherë pas Luftës së Ftohtë. Ai argumentoi se fuqia nuk është vetëm një çështje e forcës së armëve dhe ekonomisë, por edhe e aftësisë për të bindur dhe për të ndikuar në opinionin publik dhe në sjelljen e tjerëve përmes vlerave, kulturës dhe diplomacisë²². ‘Soft power’ është një koncept i përdorur për të përshkruar aftësinë e një subjekti (si një shtet, organizatë apo individ) për të ndikuar në sjelljen e tjerëve duke përdorur metoda jo-fizike dhe jo-kërcënuese. Në thelb, ‘soft power’ është një formë e fuqisë që nuk përfshin përdorimin e forcës fizike ose sanksioneve ekonomike për të arritur qëllimet e saj, por përdor ndikimin e

²⁰ “Brand Finance” (2022) (Global Soft Power Index, 2022).

²¹ scan intelligence unit/

²² Joseph Nye (2011). *The Future of Power*.

vlerave, kulturës, diplomacisë dhe resurseve të tjera për të bindur dhe për të përmbushur objektivat e saj.

Koncepti i 'soft power' mund të aplikohet në disa mënyra edhe në forcat e armatosura për të përmbushur qëllime të tyre strategjike dhe për të forcuar efektivitetin e tyre në mbrojtjen kombëtare. Disa mënyra se si 'soft power' mund të përdoret në forcat e armatosura përfshijnë *diplomacinë ushtarake*. Forcat e armatosura mund të përdorin diplomacinë ushtarake për të forcuar marrëdhëniet me forcat e tjera ushtarake në nivel ndërkombëtar dhe për të ndërtuar partneritete strategjike në mënyrë të ngushtë. Kjo mund të përfshijë shkëmbimin e trajnimeve ushtarake, ushtrime të përbashkëta dhe në bashkëpunim në operacione të përbashkëta paqësore.

7. Integrimi i 'hard power' me 'soft power' si mundësi për 'smart power'

Koncepti "smart defense" si derivat i 'smart power' u prezantua për herë të parë në Samitin e NATO-s në Chicago në vitin 2012. Kjo erdhi në një kohë kur aleatët filluan të ndjenin presionin e kufizimeve buxhetore dhe kërkonin mënyra të reja për të mbrojtur interesat e tyre të përbashkëta në mënyrë më efikase. Nga ajo kohë, ky koncept ka ndërruar dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme për të përmbushur nevojat e ndryshme të sigurisë në një mjedis të ndryshuar. Në fillim, lindja e konceptit të "smart defense" ka qenë një reagim ndaj kufizimeve buxhetore të vendeve anëtare të NATO-s. Në një kohë kur shpenzimet për mbrojtjen po zvogëloheshin, aleatët filluan të kërkonin mënyra për të ndarë më mirë barrën e mbrojtjes dhe për të përdorur më frutshmëri burimet e disponueshme.

NATO ka vazhduar të eksplorojë konceptin e "smart defense" edhe në vitet e fundit si përgjigje ndaj sfidave të reja të sigurisë dhe mjedisit ndërkombëtar. Ky zhvillim është një përpjekje për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e aleancës duke përdorur më mirë burimet dhe kapacitetet ekzistuese. Përmes "smart defense", NATO synon të inkurajojë bashkëpunimin dhe ndarjes e përgjegjësisë në mes të vendeve anëtare. Kjo përfshin ndarjen e burimeve për zhvillimin e teknologjive të reja, ndarjen e specializimeve të ushtrive, dhe përdorimin e mbrojtjes kolektive për të mbrojtur interesat e përbashkëta. Kjo shkon përtej thjesht një ndarjeje të shpenzimeve, duke inkurajuar një përjasje strategjike më të koordinuar dhe efikase ndaj sfidave të sigurisë të bashkëkohore. Në evoluimin e konceptit të "smart defense", NATO ka filluar të eksperimentojë me modele të reja të bashkëpunimit, duke përdorur teknologjinë dhe inovacionin për të përmirësuar aftësinë e saj për të përballuar sfidat e reja të sigurisë. Kjo përfshin investime në teknologji të reja si inteligjenca artificiale, robotikën dhe kibernetikën për të përmbushur objektivat e mbrojtjes kolektive në një mjedis të

ndryshuar në mënyrë efikase dhe efektive.

Në një peizazh sigurie global, që ndryshon vazhdimisht, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) vazhdimisht ka kërkuar qasje inovative për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë kolektive të shteteve anëtare. Një qasje e tillë, ‘smart defense’ ose ‘mbrojtja e mençur’, ka dalë si një iniciativë strategjike që synon optimizimin e burimeve, përmirësimin e ndërveprimit dhe nxitjen e bashkëpunimit midis aleatëve të NATO-s. Koncepti i mbrojtjes së mençur përfshin një gamë principesh dhe iniciativash të dizajnuara për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë ndërsa ndeshemi përherë në burime të kufizuara. Në qendër të saj, mbrojtja e mençur vë theksin në grupimin dhe përgjegjësinë e kapaciteteve të mbrojtjes midis shteteve anëtare të NATO-s. Kjo përfshin përpjekjet për të prokuruar pajisje ushtarake, zhvilluar aftësi të specializuara dhe kryer ushtrime trajnimi të përbashkëta. Duke shfrytëzuar burimet kolektive, NATO synon të arrijë më shumë efikasitet dhe efektivitet në adresimin e kërcënimeve të sigurisë.

Përveç kësaj, NATO ka nxitur ushtrime dhe trajnime të përbashkëta si një mjet për të përmirësuar ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë mes forcave aleate²³ (NATO, 2020). Këto ushtrime ofrojnë mundësi të çmuara për shtetet anëtare të NATO-s për të praktikuar koordinimin dhe bashkëpunimin në skenarë të realistë, duke forcuar aftësitë e përgjithshme të aleancës. Ushtrimet më të fundit theksojnë angazhimin e NATO-s për të ruajtur një pozicion të besueshëm parandalues dhe për të siguruar gatishmërinë e angazhimit të forcave të saj. Përballë sfidave të emergjente të sigurisë, mbrojtja e mençur mbetet një shtyllë e NATO-s për sigurinë kolektive. Koncepti lejon shtetet anëtare të NATO-s të maksimizojnë aftësitë e tyre të mbrojtjes ndërsa përballen ndaj kërcënimeve dhe kufizimeve të burimeve. Duke promovuar bashkëpunimin, efikasitetin dhe interoperabilitetin, mbrojtja e mençur forcon aftësitë e aleancës për të parandaluar agresionin, mbrojtur anëtarët e saj dhe për të mbajtur parimet e mbrojtjes së kolektivitetit. Pra, mbrojtja e mençur përfaqëson një qasje bashkëkohore për të përmirësuar sigurinë kolektive të NATO-s dhe individuale në një botë të pasigurtë. Duke pranuar parimet e ‘smart defense’, aleatët e NATO-s mund të përballen më efektivisht me sfidat e përbashkëta të sigurisë. Ndërsa aleanca vazhdon të evoluojë, mbrojtja e mençur do të mbetet një angazhim mjaft i rëndësishëm për të ruajtur sigurinë dhe mirëqenien e anëtare të saj.

A është ‘smart defense’ një thellim në paradigmen e mbrojtjes... midis Shqipërisë dhe Kosovës?

Në një botë të ndryshueshme ku kërcënime të reja sigurie shfaqen çdo ditë,

²³ NATO. (2020). Ushtrime dhe trajnime. Marrë nga <https://www.nato.int/cps/en/natohq/>

bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes bëhet gjithnjë e më domethënës. Në këtë kontekst, koncepti i mbrojtjes së mençur mund të dalë si një paradigmë e re për çështje të mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Kosovës. Në qendër të konceptit të 'mbrojtjes së mençur' është pjesëmarrja e shteteve për të ndarë burime dhe për të zhvilluar kapacitete të specializuara të mbrojtjes²⁴. Në kontekstin e Shqipërisë dhe Kosovës, kjo mund të përfshijë bashkëpunimin në fusha të tilla si: trajnimi ushtarak, shkëmbimi i inteligjencës dhe ndarja e teknologjisë së mbrojtjes. Duke përdorur një qasje të mençur në mbrojtje, Shqipëria dhe Kosova mund të përmirësojnë aftësinë e tyre për të përballuar kërcënime të përbashkëta, duke përdorur më së miri burimet e kufizuara.

Çështja shtrohet nëse ka kufizime për një projekt të 'smart defense' midis Shqipërisë një vend anëtar i NATO-s dhe Kosovës që, megjithëse ndjek të njëjtat principe, ende nuk është anëtar i aleancës? - Përgjigja vjen pozitive dhe është e mundur për një vend anëtar i NATO-s të zhvillojë aspekte të "smart defense" me një vend që nuk është anëtar i NATO-s, megjithatë ka disa konsiderata dhe kufizime. Së pari, NATO vepron në bazën e mbrojtjes kolektive mes anëtarëve të saj, çka do të thotë se fokusi kryesor i bashkëpunimit dhe marrëveshjeve për mbrojtje është brenda aleancës vetë. Megjithatë, NATO ka ngritur partneritete me disa vende jo anëtare përmes programeve të ndryshme si Partneriteti për Paqen (PfP), Dialogu Mesdhetar dhe Iniciativa për Bashkëpunim të Stambollit. Këto partneritete synojnë të ndërtojnë besim, të përmirësojnë interoperabilitetin dhe të promovojnë sigurinë rajonale. Brenda kësaj kornize të partneriteteve, vendet anëtare të NATO-s mund të angazhohen në iniciativa bashkëpunimi për mbrojtje me vende që nuk janë anëtare, duke përfshirë aspekte të "smart defense." Kjo mund të përfshijë ushtrime të përbashkëta, shkëmbim të informacionit, ndërtimin e kapaciteteve dhe transferimin e teknologjisë për të përmirësuar sigurinë dhe kapacitetet e mbrojtjes për të dyja palët. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se çdo bashkëpunim mes vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve që nuk janë anëtare duhet të jenë në përputhje me parimet, objektivat dhe interesat e sigurisë të NATO-s.

Përveç kësaj, niveli dhe shkalla e bashkëpunimit mund të ndryshojnë në varësi të marrëveshjeve dhe organizimeve specifike mes palëve të përfshira. Në përgjithësi, ndërsa iniciativat e "smart defense" mes vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve që nuk janë anëtare janë të mundshme, ato duhet të realizohen brenda kornizës së partneriteteve të vendosura dhe në një mënyrë që respekton parimet dhe shqetësimet e sigurisë të NATO-s.

²⁴NATO. (2012). Smart Defense: A New Culture of Cooperation. Marrë nga https://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_2012_03/20120302_120302-smart-defense.pdf

Duhet pasur në konsideratë fakti që ndërveprimi është një faktor, i cili përshkruan aftësinë e forcave të mbrojtjes për të punuar së bashku dhe për të komunikuar në mënyrë efektive gjatë operacioneve të përbashkëta²⁵. Në kontekstin e Shqipërisë dhe Kosovës, përmirësimi i ndërveprimit mund të sigurojë një bazë të fortë për bashkëpunim ushtarak dhe për përgatitjen e forcave të tyre për të kryer misione të përbashkëta pa vonesa dhe pa probleme të koordinimit. Një pikë tjetër e rëndësishme është specializimi i aftësive. Në vend që të përpjekin të mbulojnë të gjitha nevojat e mbrojtjes vetëm me burimet e tyre, Shqipëria dhe Kosova mund të specializohen në disa fusha të caktuara, duke përdorur më së miri kapacitetet dhe resurset që kanë në dispozicion. Kjo do të lejojë më shumë efikasitet dhe efektivitet në përgjigjen ndaj kërcënimeve të sigurisë.

Në vijim të këtij arsyetimi, Shqipëria dhe Kosova mund të zhvillojnë projekte të përbashkëta të mbrojtjes, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, si dhe bashkëpunimin në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë së avancuar të mbrojtjes²⁶. Një përqendrim i tillë në bashkëpunim të thelluar dhe përmirësim të mbrojtjes së përbashkët do të ndihmojë në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit të të dy vendeve, si dhe në kontributin e tyre në sigurinë e përgjithshme të rajonit. Pra, mbrojtja e mençur paraqet një paradigma të re në marrëdhëniet e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Kosovës. Në një mjedis të ndryshueshëm të sigurisë, bashkëpunimi i thelluar dhe përmirësimi i mbrojtjes së përbashkët janë thelbësore për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë dhe për të promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon.

Pjesëmarrja në iniciativat e mbrojtjes së mençur në kuadër të NATO-s mund të ndikojë në bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës në disa mënyra, por kjo nuk do të thotë që pjesëmarrja në vetvete është një pengesë absolute për bashkëpunimin midis tyre. Në rastin e Shqipërisë, si anëtare e NATO-s, dhe Kosovës si partner i përshkallëzuar, ndonjëherë mund të ketë sfida të cilat duhet adresuar për të përmirësuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, por fakti që këto partneritete janë vetëm për mbrojtje dhe aspak të adresuara kundër një shtetit tjetër, ato janë plotësisht të mundshme. Pra, aq sa pjesëmarrja në NATO mund të sjellë disa sfida në një projekt të 'smart defense' midis Shqipërisë dhe Kosovës, po aq afrohen edhe mundësi për të thelluar bashkëpunimin dhe për të përballuar sfidat e përbashkëta të sigurisë.

Përvoja dhe burimet e NATO-s apo çdo vendi anëtar të tij mund të përdoren për të ndihmuar Kosovën në zhvillimin e kapaciteteve të saj të sigurisë, duke

²⁵NATO. (2018). Capability Development. Marrë nga <https://www.nato.int/cps/en/natohq/>

²⁶Shala, A. (2017). *NATO and Kosovo: From Crisis Management to Cooperative Security*. Southeast European and Black Sea Studies, 17(2), 297-314.

krijuar një ambient më të sigurt dhe të qëndrueshëm në rajon. Sigurisht që për elementë specifikë të një projekti të përbashkët të ‘smart defense’ midis dy vendeve tona do të duhet një studim i detajuar me pjesëmarrje të ekspertëve, të cilët të kenë në konsideratë jo vetëm mjedisin aktual të sigurisë e mbrojtjes, por edhe sfidat e ardhshme të cilat shfaqen e rishfaqen me një dinamikë mjaft të ndryshme se më parë dhe se planet e burokratëve.

Përfundime

Mbrojtja e mençur, ‘smart defense’, vjen si një thellim në paradigmen e re të politikave të mbrojtjes, e cila ka shumë potencial për të përmirësuar sigurinë kolektive të NATO-s në një kontekst të ndryshueshëm të sigurisë globale. Kjo përqendrohet në përdorimin më efikas dhe efektiv të burimeve të kufizuara për të përballuar sfidat e përbashkëta të sigurisë. Me specifikimin e aftësive, përmirësimin e ndërveprimit dhe promovimin e bashkëpunimit, NATO synon të arrijë një nivel më të lartë të gatishmërisë dhe efikasitetit për të reaguar ndaj kërcënimeve emergjente.

Në kontekstin e Shqipërisë dhe të Kosovës, përdorimi i konceptit të ‘mbrojtjes së mençur’ mund të sjellë avantazhe të konsiderueshme në përgjigjen ndaj sfidave të sigurisë. Përveç ndarjes së burimeve dhe zhvillimit të aftësive të specializuara, theksimi në ndërveprim dhe bashkëpunim do të ndihmojë në rritjen e gatishmërisë së forcave të tyre për të përballet me kërcënime të ndryshme. Në fund, për të përfituar maksimumin nga ky koncept, Shqipëria dhe Kosova duhet të vazhdojnë të thellojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e mbrojtjes, duke përfshirë projekte të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave. Kjo do të forcojë sigurinë dhe stabilitetin e tyre, duke kontribuar në paqen dhe sigurinë e rajonit në tërësi.

Bibliografia:

1. Buzan, B. (1991). *People, States, and Fear: An Agenda for International Security Studies*. ECPR Press.
2. Booth, K. (2007). *Theory of World Security*. Cambridge University Press.
3. Enloe, C. (2014). *Bananas, Beaches and Bases: Making Feminist Sense of International Politics*. University of California Press.
4. Galeotti, Mark (2013). *Small States: Insecurity and Strategic Culture*. *Journal of Strategic Studies*, 36(2), 1.
5. Harkavy, Robert E. (2009). *The International Relations of Small States: An Overview*. In "The International Relations of Small States: Persistent

- and Emerging Issues." University of British Columbia Press.
6. Hoffman, Frank G. (2008). *Conflict in the 21st Century*. Praeger USA.
 7. Kuhn, Thomas (1962). *The Structure of Scientific Revolutions*. University of Chicago Press.
 8. Mearsheimer, John (2001). *The Tragedy of Great Power Politics*. W.W. Norton & Company.
 9. Metternich, Klemens (1814-1815). Figura kryesore në Konferencën e Vjenës.
 10. Morgenthau, Hans (1948). *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*. Alfred A. Knopf.
 11. Shala, A. (2017). *NATO and Kosovo: From Crisis Management to Cooperative Security*. Southeast European and Black Sea Studies, 17(2), 297-314.
 12. Viscount Castlereagh. Figura kryesore në ngjarjet e pas-Luftës së Napoleonit.
 13. Waltz, Kenneth (1979). *Theory of International Politics*. McGraw-Hill, New York.
 14. NATO. (2012). "Smart Defense: A New Culture of Cooperation." Marrë nga https://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_2012_03/20120302_120302-smart-defense.pdf.
 15. NATO. (2014). "Interoperabiliteti." Marrë nga <https://www.nato.int/cps/en/natolive/>.
 16. NATO. (2018). "Capability Development." Marrë nga <https://www.nato.int/cps/en/natohq/>.
 17. NATO. (2020). "Ushtrime dhe trajnime." Marrë nga <https://www.nato.int/cps/en/natohq/>.

Strategjia ushtarake, në një realitet gjeopolitik që ndryshon me shpejtësi

Kolonel Arben DHULI

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit dhe dy dokumentet themelore “Strategjia e Sigurisë Kombëtare” dhe “Strategjia Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”, në këtë punim, jam përpjekur të trajtoj, sipas këndvështrimit tim, strategji të disa shteteve partnere, por edhe strategjinë e vendeve që e trajtojnë ndryshe nga pikëpamja dhe rëndësia, por edhe nga situata gjeopolitike.

Gjithashtu, në këtë shkrim trajtohet rëndësia e Strategjisë të Sigurisë Kombëtare dhe asaj Ushtarake, të cilat për nga përmbajtja e tyre, kanë specifike çështje të cilat vlerësojnë aspekte specifike dhe japin orientime për marrjen e masave për përballimin e situatave kritike si ato të brendshme, si dhe për kërcënimet reale dhe ato të pritshme në momentin e përgatitjes, kjo duke përfshirë shtetet e aleancës por edhe kundërshtarët e saj.

Por le të shohim se si trajtohen këto strategji në nivelin e përgjithshëm. Në nivel kombëtar, kultura strategjike reflekton një sërë vlerash të shoqërisë, të cilat i detyrohen përdorimit të forcës. Në nivelin ushtarak, kultura strategjike ose “mënyra e luftës” e një kombi është shprehje se si ushtria e një kombi do t'i luftojë luftërat.

Realiteti gjeopolitik dhe përdorimi i forcës ushtarake, si agresioni i padrejtë dhe i pajustificuar Rus kundër Ukrainës, ka ndryshuar dukshëm paradigmen e sigurisë. Strategjia drejton veprimtarinë e të gjitha institucioneve publike me autoritete dhe përgjegjësi në fushat kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes.

Në tërësinë e vet, Strategjia Ushtarake është dokument themelor nëpërmjet të cilit përcaktohen synimet, objektivat dhe konceptet kryesore për funksionimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Kjo e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK), e hartuar me ekspertizë gjithëpërfshirëse.

Si strategji e një vendi anëtar të NATO-s, është në harmoni me dokumentet, konceptet dhe proceset e Aleancës ku siguria dhe mbrojtja është pjesë e mbrojtjes kolektive. Zhvillimet në mjedisin strategjik të sigurisë kanë nxjerrë në pah sfida dhe rreze të reja të natyrës gjeopolitike, hibride dhe ushtarake, të cilat po i mbivendosen rrezeve dhe kërcënimeve si: terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm, krimi i organizuar, sulmet kibernetike, emigracioni i paligjshëm dhe siguria shëndetësore.

Rajoni i Detit të Zi është me interes strategjik jo vetëm për Rumaninë, të cilin unë e kam marrë si rast studimi në këtë punim, por është jetike për një zonë të sigurtë, për sigurinë evropiane dhe transatlantike.

Fjalë kyçe: Strategji, koncept, gjeopolitikë, kulturë strategjike, NATO, plan afatgjatë i zhvillimit.

1. Kultura strategjike e një kombi dhe Strategjia Ushtarake

Kultura strategjike e një kombi rrjedh nga gjeografia dhe burimet, historia dhe eksperiencia nga shoqëria dhe struktura e saj politike. Ajo përfaqëson një qasje ku një shtet i dhënë e ka themeluar suksesshëm në të shkuarën edhe pse jo e pandryshueshme ajo ka tendencën të zhvillohet ngadalë. Nuk është koincidence, për shembull, që Britania historikisht ka favorizuar fuqinë e detit dhe strategjitë indirekte ose që tradicionalisht i është larguar mbajtjes së një ushtrie të madhe. Gjithashtu mungesa e thellësisë gjeografike të Izraelit, popullsia e tij e vogël por e edukuar dhe njohja teknologjike kanë prodhuar një kulturë strategjike që thekson zhvillimin strategjik, operacionet e ndryshme, iniciativat dhe një teknologji në rritje dhe në zhvillim.¹ Statusi minimal gjeopolitik i Australisë, identiteti kontinental në vend të atij detar,

¹ Michael I. Handel, *The Evolution of Israeli Strategy: The Psychology of Insecurity and the Quest for Absolute Security*, in Williamson Murray, MacGregor Knox, and Alvin Bernstein, eds., *The Making of Strategy: Rulers, States, and War* (Cambridge: Cambridge University Press, 1994).

dhe eksperiencia formative e ushtrisë e kanë formuar rrugën e saj të luftës.²

Në një përkufizim thuhet se “Strategjia Ushtarake është një grup idesh të zbatuara nga strukturat ushtarake për të ndjekur qëllimet e dëshiruara strategjike. Prejardhja e fjalës “strategji” vjen nga gjuha greke “strategos” dhe ky term u përdor për herë të parë gjatë shekullit të 18-të, në kuptimin e tij të ngushtë si “arti i gjeneralit” ose “arti i rregullimit” të trupave, pasi ajo merret me planifikimin dhe zhvillimin e fushatave, lëvizjen dhe disponimin e forcave dhe mashtrimin e armikut.

Për më tej, babai i studimeve moderne strategjike perëndimore, Carl von Clausewitz, e përkufizoi strategjinë ushtarake si “përdorimi i betejave për të fituar fundin e luftës”. Gjithashtu përkufizimi i B. H. Liddell Hart vuri më pak theks te betejat, duke përcaktuar strategjinë si “artin e shpërndarjes dhe aplikimit të mjeteve ushtarake për të përmbushur qëllimet e politikës”, duke i dhënë përparësi synimeve politike mbi qëllimet ushtarake.

Edhe strategu ushtarak Sun Tzu, i cili shpesh konsiderohet si babai i strategjisë ushtarake lindore, ndikoi shumë në taktikat historike dhe moderne të luftës kineze, japoneze, koreane dhe asaj vietnameze. Libri i tij “Arti i Luftës” u rrit në popullaritet dhe pa përdorim praktik edhe në shoqërinë perëndimore. Ai vazhdon të ndikojë në shumë përpjekje konkurruese si në Azi, Evropë dhe Amerikë, duke përfshirë kulturën, politikën dhe biznesin, si dhe luftën moderne.

Operacionet dhe taktikat janë arti i organizimit të forcave në ose pranë fushëbetes për të siguruar objektiva si pjesë e strategjisë më të gjerë ushtarake.

Shtetet e Bashkuara janë kombi më i fuqishëm në botë dhe do të jenë për një të ardhme të parashikuar. Mënyra se si Shtetet e Bashkuara sillen, ndikon jo vetëm te qytetarët, por edhe rreth botës. Të kuptosh kulturën strategjike të Shteteve të Bashkuara është e rëndësishme për shoqërinë, armiqët dhe ata që janë neutral. Si komb, kultura strategjike e Amerikës është formuar nga siguria e lirë dhe mbushur me urrejtje kundrejt eksepcionalizmit (veçantisë).

Kultura strategjike është ai set i besimeve të ndara, përmbledhjeve dhe mënyrave të sjelljes, të derivuara nga eksperiencia të përbashkëta dhe tregime të pranuar (gojëdhëna dhe të shkruara), që i japin formë identitetit kolektiv dhe marrëdhënieve të grupeve të tjera, që përkufizojnë definicionet e duhura dhe mjetet për të arritur objektivat e sigurimit.

Në përcaktimin e Kolin S. Grei thuhet se: “....kultura i referohet mënyrave të të menduarit dhe veprimit në respekt për forcën, e derivuar nga perceptimi i

² Michael Evans, *The Tyranny of Dissonance: Australia's Strategic Culture and Way of War*, 1901 2005 (Canberra: Land Warfare Studies Center, 2005).

eksperiencës historike nacionale, aspirimit për vetë karakterizim... dhe nga të gjitha eksperiencat e dalluara të Amerikës (nga gjeografia, politika filozofike, kultura qytetare dhe “mënyra e jetesës”) që karakterizojnë një qytetar amerikan³.

Kultura strategjike kombëtare, si ajo gjeografike dhe historike, i kanë dhënë formë kulturës strategjike kombëtare të Amerikës. Gjatë pjesës më të madhe të historisë së Amerikës, pozita ishullore e Amerikës Veriore dhe fqinjët e dobët të veriut dhe jugut u kombinuan për të arritur sigurinë e lirë të Shteteve të Bashkuara. E mbrojtur nga Oqeani Atlantik dhe Paqësor dhe Marina Mbretërore, Shtetet e Bashkuara u rritën deri në maturim në një mjedis beninj (të pasigurtë). Fakti se Shtetet e Bashkuara nuk kishin se pse të lodhnin veten për t’u përgatitur për ndërmarrjen e luftërave kundër fqinjëve i ndau ato nga shtetet e tjera, veçanërisht nga fuqitë e mëdha të Europës. Pozita ishullore e Amerikës dhe ekzistenca e sigurisë së lirë edukuan pikëpamjen se lufta është një derivim nga normat e paqes.

Kultura strategjike e Amerikës e mori formën nga periudhat e gjata të paqes të ndërprera nga konfliktet e gjeneratave - lufta e vitit 1812, Lufta Civile, Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore – të përcaktuara si një kryqëzatë e të mirës kundër të keqes. Siguria e lirë, në anën tjetër, afektoi këndvështrimin e Amerikës mbi botën. Ashtu siç C. Vann Woodward shkroi më shumë se katër dekada më parë se “Ankthi për siguri e ka mbajtur rritjen e optimizmit brenda caqeve në mesin e njerëzve të tjerë. Mungesa relative e anktheve të tilla në të shkuarën ka ndihmuar, së bashku me faktorët e tjerë, ta krijojë optimizmin si një filozofi kombëtare në Amerikë”.⁴ Kultura strategjike e Amerikës në mënyrë të qartë refuzon traditën Europiane të fuqive politike. Kjo kulturë në mënyrë të qartë shijon fuqinë e traditës dhe fuqinë politike. Përkundrazi, që nga themelimi, amerikanët e kanë parë veten si të pazakonshëm.

Eksepcionalizmi (Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, përjashtimi amerikan i referohet besimit se Shtetet e Bashkuara zotërojnë cilësi unike ose një fat të veçantë që e dallon atë nga kombet e tjera). ka influencuar mënyrën se si Shtetet e Bashkuara bënë marrëveshje me të tjerët. Siç Walter Lippmann ka vërtetuar se kultura strategjike e Amerikës “nuk njeh se Amerika është një komb mes gjithë kombeve të tjera me të cilën duhet të merren si rivale, si aleate, si partnere.” Më tepër, “një agresion është një rebelim i armatosur

³ Colin S. Gray, *National Style in Strategy: The American Example*, International Security 6, no. 2 (Fall 1981), 22.

⁴ C. Vann Woodward, *The Age of Reinterpretation*, American Historical Review 66 (October 1960), 6.

kundër principeve universale dhe të përjetshme të shoqërisë botërore. Asnjë luftë nuk mund të përfundojë në mënyrë të drejtë, prandaj, përveç nënshtrimit të pakufizuar të sulmuesve dhe nga rrëzimi dhe transformimi i regjimit politik.”⁵ Impulsi për të transformuar sistemin ndërkombëtar në shërbim të idealeve të demokracisë liberale formon fije që kalon nëpërmjet historisë së Amerikës. Strategjia e sigurisë kombëtare e administratës së Klintonit dhe zgjerimi i angazhimit të administratës së Xhorxh W. Bush për përhapjen e demokracisë, të shprehura me ndikime afatgjata me efekte të paparashikueshme dhe pas Ukrainës nuk përjashtohet mundësia e një sulmi konvencional kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të aleatëve.

Gorge Kennan, në shkrimet e tij për diplomacinë e Amerikës, dorëzuar në vitin 1950, diskutoi se afrimi i Amerikës në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte karakterizuar nga “moralizmi dhe legalizmi” i tepruar që çojnë në një tendencë për të shpallur kryqëzata kundër të këqijve. Siç Kennan shkroi “Një luftë e luftuar në emër të principit të lartë të moralit gjen jo shpejt një formë të dominimit total”. Amerikanët shpesh i kanë ndërmarrë luftërat jo si vazhdimësi e politikës, por si një simptomë e dobësisë së tyre. J.C. Wylie ishte duke reflektuar mbi një pamje të pasqyruar amerikane kur ai shkroi: Është lufta në fakt vazhdimësi e një politike? Për ne, besoj se jo. Lufta për një komb jo agresor është në fakt përafërsisht një kolaps komplet i politikës. Pasi lufta vjen, atëherë të gjitha politikat e paraluftës bëhen të pavlefshme, sepse vendosja në të cilën janë projektuar për të funksionuar jo për shumë kohë korrespondon me faktet e realitetit. Kur lufta vjen, ne menjëherë lëvizim në botë radikalisht të ndryshme.

Në mënyrë të ngjashme, tekstet e vitit 1936 të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara mbi strategjinë përmbanin se “Politika dhe strategjia janë radikalisht dhe fundamentalisht gjëra të ndryshme.

Strategjia fillon aty ku politika mbaron. Ajo që ushtarët kërkojnë, është se në momentin që politika vendoset, strategjia dhe komandat duhet të konsiderohen si një sferë e ndarë nga politika.”⁶ Në fjalë të tjera, amerikanët kanë tendencën të mendojnë në mënyrë strategjike.⁷ Kështu Shtetet e Bashkuara kanë shfaqur një preferencë të gjatë dhe të qëndrueshme për fillimin e luftërave për arsye të

⁵ Walter Lippmann, *Public Opinion and Foreign Policy in the United States*, (London: Allen and Unwin, 1952), 25-26.

⁶ The Principles of Strategy for an Independent Corps or Army in a Theater of Operations, (Ft. Leavenworth, KS: Command and General Staff School Press, 1936).

⁷ Samuel P. Huntington, *The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations*, (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957), 151.

pakufizuar politike.⁸ Gjatë Luftës Civile, Presidenti Abraham Lincoln. Në Luftën e Dytë Botërore Franklin D. Rusevelt dhe komandantët e tij ishin të një mendje se lufta duhet të merrte drejtim në përmbysjen e qeverive Gjermane, Japoneze dhe Italiane të cilat kishin filluar luftën. Në luftën e tanishme kundër ekstremistëve xhihadistë nuk ka asnjë ndjenjë që mund të çojë në vendosjen e negociatave.⁹ Amerikanët kanë pasur tendencë t'i quanin luftërat e tyre si kryqëzata kundër të këqijve.

Ashtu siç Samuel Huntington është shprehur: “Për amerikanin, një luftë nuk është luftë, nëse nuk është një kryqëzatë.”¹⁰ Patjetër, një sjellje e tillë i ka rrënjët të forta politike, gjatë shekullit të njëzetë. Shtetet e Bashkuara luftuan një sërë regjimesh despotike, nga Gjermania e Hitlerit dhe Koreja e Veriut e Kim Sung II, deri tek Iraku i Sadam Husein-it dhe Serbia e Slobodan Miloseviç. Gjithsesi, ka ekzistuar gjithmonë një tension i qartë mes nevojës për të çuar publikun në një tubim në mbështetje të përdorimit të forcës dhe nevojës për të ndjekur qëllime të limituara. Liderët politikë, të cilët demonizuan kundërshtarët e Amerikës, shpesh u përballën me një reagim të ashpër kur Shtetet e Bashkuara nuk e vazhduan luftën deri në fund. Këshilltarët e Presidentit George. W. Bush, për shembull, u tërbuan nga krahasimet e Sadam Husein-it të Adolf Hitler, duke u frikësuar se kjo do të komplikonte sjelljen e Luftës së Gjirit në 1991.¹¹

Weigley flet se për një vlerësim më kritik të “Mënyrës së luftës Amerikane “duhet të shohim se kur Ushtria e Forcave të Armatosura kanë pasur një arritje unike në luftim, në luftërat ku asgjësimi bëhej nëpërmjet përdorimit të tepërt të fuqisë së zjarrit? Në formulimin e tij, karakteristikat kryesore të “Mënyrave të luftës Amerikane” përfshijnë agresivitetin në çdo nivel të betejës, një çështje për luftërat vendimtare dhe një dëshirë për të bërë rezistencë maksimale. Ushtria e Shteteve të Bashkuara ka parë “përmbysjen komplete të armiqeve,

⁸ As Clausewitz wrote, “War can be of two kinds, in the sense that either the objective is to overthrow the enemy— to render him politically helpless or militarily impotent, thus forcing him to sign whatever peace we please; or merely to occupy some of his frontier districts so that we can annex them or use them for bargaining at the peace negotiations. Transitions from one type to the other will of course recur in my treatment; but the fact that the aims of the two types are quite different must be clear at all times, and their points of irreconcilability brought out [emphasis in original].” Carl von Clausewitz, *On War*, ed. and trans. Michael Howard and Peter Paret (Princeton: Princeton University Press, 1976), 69

⁹ For alternative views, see Eliot A. Cohen, *Supreme Command: Soldiers, Statesmen, and Leadership in Wartime* (New York: Free Press, 2002), 175-184; Andrew Krepinovich, *The Army and Vietnam* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1986).

¹⁰ Samuel P. Huntington, *The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations* (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957), 152.

¹¹ George Bush and Brent Scowcroft, *A World Transformed* (New York: Knopf, 1998), 389.

shkatërrimin e forcave ushtarake, (si) objekt të luftës”¹²

Gjithashtu Weigley argumenton se “Amerikanët veçanërisht ushtarët Amerikan“, kanë mbajtur një përkufizim të ngushtë të strategjisë që prirej të “jepnin pak konsideratë konsekuencave të jo ushtarëve në lidhje me atë që ata po bënin”. Gjithashtu kultura strategjike kombëtare, ushtarake dhe e shërbimit ka afektuar mënyrën se si Shtetet e Bashkuara ia afruan armës bërthamore. Kultura Strategjike Kombëtare e armëve bërthamore ka forcuar idenë e vjetër në Shtetet e Bashkuara se ekziston një ndarje në dy pjesë mes paqes dhe luftës. Qysh në fillimin e Luftës së Ftohtë, këndvështrimi dominant i shprehur nga strategët civil dhe oficerët ushtarak ka qenë se armët bërthamore janë armët e para dhe me kryesore të parandalimit. Siç George Kennan shkroi në vitin 1961 se: Atomi thjesht ka shërbyer për ta bërë pashmangshmërisht të qartë çfarë ka qenë vërtet gjatë gjithë kësaj kohe që nga dita e fillimit të mitralozit dhe motorit me djetje të brendshme në teknikat e luftës.

Në kontekstin e saj, Strategjia Ushtarake orienton funksionimin e mbrojtjes e cila mund të shërbejë deri në dekadën e ardhshme. Ashtu edhe siç është theksuar më lart nga disa mendimtarë ushtarakë, Strategjia Ushtarake është dokumenti kryesor i planifikimit të instrumentit ushtarak të fuqisë kombëtare në nivel strategjik. Siguria dhe mbrojtja e vendit mbështetet në zhvillimin dhe përdorimin e integruar të elementëve të fuqisë kombëtare nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale, orientohet nga sfidat e mjedisit të paqëndrueshëm gjeopolitik.

2. Strategjitë ushtarake e disa shteteve të aleancës, rasti i Rumanisë

Rumania është një vend i fuqishëm i përkushtuar ndaj vlerave evropiane dhe luan një rol të rëndësishëm në NATO dhe BE, në garantimin e sigurisë për kufijtë e tyre të jashtëm, si dhe në rajonin e Detit të Zi. Ajo është gjithashtu është një partner solid për SHBA-në dhe aleatët si një shtyllë për sigurinë rajonale. Politika e sigurisë kombëtare nuk mund të jetë shprehje e vullnetit të një personi të vetëm, ndonëse është rezultat i një procesi që bie nën detyrat e Presidentit. Ajo duhet të ndërtohet, të paktën në parim, mbi vlerat dhe udhëzimet themelore, pasi është shprehje e konsensusit dhe përpjekjes së përbashkët kombëtare. Në lidhje me sfidat e sigurisë në kufirin lindor të NATO-s dhe BE-së, Rumania do të veprojë drejt vendosjes së një ankorimi më të fortë të dy organizatave në rajon, drejt një bashkëpunimi të aplikuar me aleatët rajonalë, por edhe për të mbështetur shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe fqinjësinë lindore, në proceset e tyre transformuese përsa i përket institucioneve të brendshme, demokracisë dhe lidhjes me flukset ekonomike evropiane.

¹² Weigley, American Wy of War, xxi

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes e Rumanisë për vitet 2020-2024 jep përgjigje për pyetjet kryesore në lidhje me objektivat kryesorë kombëtare rumune për garantimin e sigurisë së saj dhe qytetarëve dhe nënvizon hapat e nevojshëm për t'i arritur ato. Në strategjinë e mbrojtjes të Rumanisë 2020-2024 janë përcaktuar qartë masat që duhen marrë nga ndonjë kërcënim i mundshëm pasi si Polonia edhe Rumania janë vende kufitare me zonën e konfliktit në Ukrainë.

Gjatë 30 viteve të fundit, Rumania ka evoluar ndjeshëm falë veprimit individual dhe të përbashkët të qytetarëve të saj. Rumania ka përmbushur objektivat kombëtarë që kanë qenë jetikë për zhvillimin e saj të brendshëm, si dhe për pozitën e saj të forcuar jashtë vendit: anëtarësimin në NATO dhe Bashkimin Evropian. Për sa i përket sigurisë së Rumanisë, në një kontekst dinamik gjeopolitik, të turbullt dhe të paparashikueshëm si ai aktual, duhet të kemi një përgjigje të përshtatur dhe efikase ndaj rreziqeve, kërcënimeve dhe dobësive me të cilat po përballemi, bazuar kjo në: vazhdimësinë, përshtatshmërinë, fleksibilitet, elasticitet dhe parashikueshmëri. Brenda NATO-s, do të vazhdojë të veprojë me vendosmëri, si në të kaluarën, për të rritur rëndësinë e Rumanisë brenda Aleancës, në mënyrë që kjo e fundit të vazhdojë të jetë organizata e mbrojtjes kolektive më e fortë dhe më efikase në histori.

Zbatimi me vendosmëri i angazhimit të Rumanisë për të siguruar të paktën 2% të financimit të PBB-së për mbrojtjen, përveç vlerësimit të aleatëve, ka sjellë edhe përfitime të prekshme në drejtim të sigurisë së vendit. Pa forca të armatosura të forta, një shtet nuk përfiton nga besueshmëria ndërkombëtare dhe strategjike. Arkitektura e re e mbrojtjes kërkon burime njerëzore të trajnuara dhe të pajisura shumë mirë, si dhe aftësi të ndërveprueshme në sistemin e mbrojtjes kolektive të NATO-s. Ekzistenca e burimeve të rëndësishme që synojnë dhurimin e Forcave të Armatosura Rumune dhe garantimi i shpërndarjes së tyre afatgjatë është gjithashtu një nxitje e nevojshme për rigjallërimin e industrisë kombëtare të mbrojtjes.

Zhvillimet teknologjike gjenerojnë një kompleksitet të larmishëm dhe të shtuar të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, si sulmet kibernetike, aktivitetet e lidhura me informacionin (veprimet armiqësore/ndikuese të kryera në hapësirën publike, dezinformimi, përhapja e lajmeve të rreme ose të rreme, etj.), si dhe efektet e mundshme të dëmshme dhe destabilizuese të shkaktuara nga sjellja e disa teknologjive të përdorura civile brenda veprimeve asimetrike dhe hibride, duke sjellë kështu sfida të reja sigurie.

Në fushën sociale, mjedisi i sigurisë ndikohet nga zhvillimi demografik asimetrik, nga urbanizimi i shpejtë, polarizimi i shoqërive, nga rritja e moshës të popullsisë, rritja e individualizmit dhe izolimi në hapësirën virtuale, rritja e cënueshmërisë së mediave sociale online ndaj luftës së informacionit, veprimet, si dhe nga zhvillimi i fenomenit të migracionit. Në të njëjtën kohë,

urbanizimi po i kthen qytetet më vulnerabël, veçanërisht nga këndvështrimi i ndryshimeve klimatike dhe siguri i standardeve minimale për kushtet e jetesës. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes përfaqëson, natyrshëm dhe legjitimisht, një koleksion sintetik të aspiratave, dëshirave, vizioneve dhe ideve të lirisë, dinjitetit dhe prosperitetit që synojnë të ndërtojnë një Rumani normale, një Rumani të shekullit të 21-të. Strategjia pasqyron nevojën për të siguruar një ekuilibër natyror midis sigurisë kombëtare dhe fushave të tjera jetike si ekonomia, shëndetësia apo arsimi.

Në të njëjtën kohë, Partneriteti Strategjik me SHBA-të, veçanërisht pas kontakteve të nivelit më të lartë të ndodhur gjatë viteve të fundit, ka premisa më të mira se kurrë për të thelluar dhe zgjeruar rolin e tij si spirancë strategjike e qëndrimit euroatlantik dhe rolin e saj si pikë referimi për objektivat dhe përpjekjet e tjera të bëra për të garantuar sigurinë kombëtare të Rumanisë. Zhvillimi i Partneritetit Strategjik me SHBA-të, veçanërisht në aspektin ekonomik, me fokus në fushën e teknologjive të fundit, do t'i japë edhe më shumë konsistencë marrëdhënieve dypalëshe, si dhe do të rrisë rëndësinë strategjike të Rumanisë. Rumania synon të forcojë bashkëpunimin e saj ushtarak me SHBA-të jo vetëm si një linjë veprimi që synon përgjithësisht në formatin aleat, por veçanërisht si një objektiv operacional për t'u zbatuar në territorin kombëtar. Më pas, përpjekjet e shtetit rumun drejtohen drejt vendosjes në territorin rumun të disa zgjidhjeve që synojnë të forcojnë praninë e përparuar të NATO-s dhe, në mënyrë implicite, të pengojnë veprimet e mundshme agresive të kryera nga disa aktorë shtetërorë. Bashkëpunimi ushtarak brenda formateve të vendosura në rajon, zhvillimi dhe zgjerimi i disa koncepteve të gjera novatore me aleatët dhe partnerët evropianë dhe rajonalë, duke i bërë operacionale iniciativat kombëtare të miratuara në nivel aleat, mund të kontribuojnë në zbatimin në praktikë të objektivit për të ruajtur sigurinë rajonale dhe atë evropiane.

Koncepti i qëndrueshmërisë së Rumanisë trajtohet nga një këndvështrim i dyfishtë: kapaciteti i natyrshëm i entiteteve – individëve, komuniteteve, rajoneve, shtetit – për t'i rezistuar dhe përshtatur në mënyrë artikulative ngjarjeve të dhunshme që shkaktojnë stres, tronditjeve, fatkeqësive, pandemie ose konflikteve, nga njëra anë dhe aftësinë e këtyre subjekteve për t'u kthyer sa më shpejt në një gjendje funksionale, normale, nga ana tjetër. Forcimi i qëndrueshmërisë dhe reduktimi i dobësive kërkojnë një strategji fleksibël shumëdimensionale, si dhe një perspektivë të gjerë për të gjitha sistemet, në mënyrë që të kufizohen rreziqet që lidhen me një krizë, por edhe të përmirësohet kapaciteti për të menaxhuar shpejt mekanizmat e rregullimit në nivel lokal, nivel kombëtar dhe rajonal.

Por krahas analizës për strategjitë ushtarake të disa shteteve partnere duhet të

sjellim në vëmendje dhe strategjinë apo doktrinën ushtarake të fqinjëve tanë dhe kryesisht asaj të Serbisë. Nga dokumenti i publikuar Serbia ka shpallur doktrinën e re ushtarake. *Sipas strategjisë, forca ushtarake e Serbisë duhet të jetë më e madhe se të gjitha forcat e armatosura të vendeve potencialisht kundërshtarë të rajonit së bashku.* Nga analiza e bërë dhe krahasimi i fuqisë ushtarake për momentin Serbia arrin në nivelin 65-70 % të fuqisë së forcave të armatosura të Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës, Shqipërisë dhe “shtetit të panjohur të Kosovës”. Por sipas analizës kjo nuk është e mjaftueshme, prandaj synohet të arrihet së paku 110% e fuqisë së përbashkët ushtarake të katër vendeve të përmendura. Vetëm nëse ushtria serbe është në gjendje të ndalë sulmin dhe të neutralizojë në mënyrë efikase kërcënimet e të gjitha vendeve potencialisht kundërshtarë të rajonit, mund të ketë një garanci afatgjatë të paqes dhe stabilitetit. Vetëm nëse këto vende e dinë se përplasja ushtarake me Serbinë do t’i shkaktojë humbje proporcionalisht më të mëdha, Serbia mund ta planifikojë zhvillimin e vet shtetëror dhe shoqëror afatgjatë. Në frymën e kësaj strategjie, Serbia ka bërë investime të mëdha në blerjen e armatimit dhe në zhvillimin e marrëdhënieve ushtarake me Rusinë, sado që në atë strategji e ka të proklamuar neutralitetin ushtarak. Gjithashtu aty thuhet se Kreu i shtetit as nuk ka autorizim ligjor për të miratuar strategji të re, sepse atë autorizim e ka Kuvendi i Serbisë. Kreu i shtetit mund t’i bëjë propozim Kuvendit për strategji të re ose përditësim të strategjisë ekzistuese. Gjithashtu, qasja që duhet të bëhet me ato përcaktime të cilat janë shtyllat kryesore ku do të bëhet zbatimi konkret i saj.

Në përfundim, do doja të trajtoja shkurtimisht edhe diçka për projekt-Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës për vitin 2022-2027. Ky projekt është miratuar nga Komisioni Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si një ndër sfidat kryesore për sigurinë e vendit që është “pretendimi territorial i Serbisë ndaj Kosovës”. Rreziku nga Serbia përmendet për herë të parë në mënyrë eksplicite në një dokument të tillë. Projekt-Strategjia e Sigurisë e Kosovës është një dokument që përfshin të gjitha aspektet e sfidave të sigurisë në Kosovë “...sidomos të rreziqeve që burojnë nga shteti fqinj, Serbia. Në këtë projekt identifikohet saktë rreziku kryesor që i kanoset shtetit për adresimin e rreziqeve të identifikuara që përfshijnë edhe ndryshimet klimatike, katastrofat e mundshme natyrore e njerëzore, ekstremizmin e dhunshëm politik apo religjioz. Gjithashtu në këtë projekt-strategji është folur edhe për “Migrimin e të rinjve si një ndër rreziqet potenciale. Por ndër elementet që parashikohen me risk është pjesa e ruajtjes të vitalitetit të institucioneve të sigurisë, që ato të ripërtërihen, në mënyrë që të sigurohet një vazhdimësi e funksionimit me rekrutimin e të rinjve në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës, policisë, agjencive dhe shërbimeve të ndryshme”. Gjithashtu thuhet se “FSK-ja vazhdimisht do të rishikojë strukturën organizative të saj, për t’iu përshtatur

kohës dhe detyrave që dalin në funksion të realizimit dhe ruajtjes së interesave vitalë shtetërorë”.

Mendoj se projekti ka qenë ndoshta më i avancuari prej strategjive që janë prezantuar në faza të hershme nga ana e Qeverisë. Nga analizat dhe komentet bëhet fjalë për një projekt të mirë të strategjive, sidomos kur krahasohet me projektet e mëparshme apo edhe me Strategjinë e mëparshme të Sigurisë Kombëtare”. Ndërkohë që nuk duhet harruar që raportet me Serbinë kanë qenë jo të mira ku qysh në vitet 1998-99, në Kosovë është zhvilluar një luftë e iniciuar nga regjimi i atëhershëm serb, e cila ka lënë të vrarë mbi 13.000 civilë dhe të zhdukur mijëra të tjerë. Mbi 1.600 persona vazhdojnë të jenë të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë atë si pjesë të territorit të saj. Ndërkohë që Kosova dhe Serbia vazhdojnë bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011, me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, por procesi dialogu është duke shkuar ngadalë.

Përfundime

1. Strategjia ushtarake lindore ndryshon nga ajo perëndimore duke u fokusuar më shumë në luftën asimetrike dhe mashtrimin. Strategjia ndryshon nga operacionet dhe taktikat, pasi strategjia i referohet përdorimit të të gjitha kapaciteteve ushtarake të një kombi nëpërmjet planifikimit, zhvillimit të nivelit të lartë dhe afatgjatë, për të garantuar sigurinë ose fitoren.
2. Bazuar mbi konceptet dhe elementët e mbrojtjes, përcaktimet e zbatimit kryesisht në forcimin e mbrojtjes nga sulmet e mundshme, si dhe pjesëmarrja në detyra të ndryshme në interes të NATO-s, BE-së, OKB-së, duhet të bëhet një planifikim i përcaktuar qartë me qëllim që edhe buxheti i miratuar për mbrojtjen të jetë sa më efektiv.
3. Sjellja agresive e Federatës Ruse, veprimet për militarizimin e rajonit të Detit të Zi, si dhe veprimet e tyre hibride të kryera me qëllim ruajtjen e një klime të tensionuar pasigurie në afërsi të rajonit tonë kërkojnë vendosmëri për vazhdimin e procesit të përditësimit të dokumenteve strategjike të vendit tonë.
4. Për sa u trajtua më lart, është e rëndësishme që në dokumentet strategjike për çdo lloj strategjie por sidomos të asaj ushtarake, duhet të përcaktohen qartë elementet thelbësore dhe mbi këto elemente të bashkëlidhen edhe dokumentet e tjera mbështetëse si p.sh., Plani Afatgjatë i Zhvillimit etj.

Bibliografia

1. Koncepti i ri Strategjik i Aleancës, Madrid 2022.
2. Strategjia Ushtarake e NATO-s e miratuar në 2019.
3. NATO's Concept for Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area (DDA).
4. The NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC).
5. Weigley, American Wy of War, xxi
6. The Principles of Strategy for An Independent Corps or Army in a Theater of Operations (Ft. Leavenwrth, KS: Command and General Staff School Press, 1936).
7. Samuel P. Huntington, The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957), 151
8. Michael Howard and Peter Paret (Princeton: Princeton University Press, 1976), 69.
9. For alternative views, see Eliot A. Cohen, Supreme Command: Soldiers, Statesmen, and Leadership in Wartime (New York: Free Press, 2002), 175-184; Andreë Krepinevich, The Army and Vietnam (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1986).
10. Samuel P. Huntington, The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957), 152.
11. George Bush and Brent Scoëcroft, A World Transformed (New York: Knopf, 1998), 389.
12. C. Vann Woodward, "The Age of Reinterpretation," American Historical Review 66 (October 1960), 6.
13. Walter Lippmann, Public Opinion and Foreign Policy in the United States (London: Allen and Unwin, 1952), 25-26.
14. Colin S. Gray, "National Style in Strategy: The American Example," International Security 6, no. 2 (Fall 1981), 22.
15. Michael I. Handel, "The Evolution of Israeli Strategy: The Psychology of Insecurity and the Quest for Absolute Security" in Williamson Murray, MacGregor Knox, and Alvin Bernstein, eds.
16. The Making of Strategy: Rulers, States, and War (Cambridge: Cambridge University Press, 1994).
17. Michael Evans, The Tyranny of Dissonance: Australia's Strategic Culture and Why of War, 1901-2005 (Canberra: Land Warfare Studies Center, 2005).

Strategjia globale e Kinës dhe angazhimi i saj ndaj rendit multilateral ekzistues

Kapiten Msc. Hekuran Budani,
Msc. Orgest Xhangoli
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Qëndrimi dhe sjellja e Kinës ndaj rendit multilateral ekzistues ka ndryshuar në kohë, duke pasqyruar një portret kompleks për angazhimin saj ndaj këtij rendi. Megjithëse në Kinë ka një pakënaqësi të qartë me natyrën e rendit aktual global, ai i ka shërbyer Kinës në tranzicionin e saj drejt një fuqie globale. Në të vërtetë, qëndrimi i Kinës ndaj këtij rendi nuk mund të cilësohet as si armiqësor dhe as si mbështetës, ai është diku në mes.¹ Prandaj, në disa raste Kina shfaqet si faktori kryesor për reforma dhe ndryshim, ndërsa në raste të tjera ajo sillet si një palë e përgjegjshme dhe e interesuar në mbështetje të rendit ekzistues.²

Duke analizuar në mënyrë kritike sjelljen kontradiktore të Kinës, ky artikull argumenton se strategjia globale e Kinës pasqyron një angazhim të paqartë dhe jokohërent ndaj rendit multilateral ekzistues. Gjithashtu vihet në dukje se rritja ekonomike e ka bërë Republikën Popullore të Kinës një konkurrent afatgjatë të Perëndimit,³ prandaj dhe ekziston rreziku që Pekini të bëhet “në

¹ Astrid Cevallos, Michael Mazarr and Timothy Heath, *China and the International Order*, 2018, p. 33-39, 99, 119.

² Shaun Breslin, *China and the global order: signaling threat or friendship?*, 2013

³ John J. Mearsheimer, *The Future of the American Pacifier*, *Foreign Affairs*, 2001.

mënyrë të fshehtë” përcaktues i agjendës perëndimore, duke përdorur investimet ekonomike si një mjet për të ndërtuar hegjemoninë “nga brenda” rendit ekzistues.⁴

Ndërkohë që “kriza e hegjemonisë së SHBA-ve” po konkretizohet gjithnjë e më shumë, Kina ende mbetet larg nga realizimi i marrëdhënieve hegjemonike, qoftë edhe në nivel rajonal.⁵ Megjithatë, ndikimi aktual dhe potencial i Kinës në nivel rajonal dhe global nëpërmjet institucioneve multilaterale ekzistuese ose të krijuara prej saj dhe nëpërmjet fuqisë shtetërore ekonomike (economic statecraft), veçanërisht në disa demokraci në rritje apo rajone ekonomikisht dhe politikisht të brishta nuk duhet të injorohet.

Ky artikull është i organizuar në katër çështje. Çështja e parë përmbledh shkurtimisht rritjen e Kinës dhe vlerëson në mënyrë kritike angazhimin e saj ndaj rendit multilateral ekzistues. Çështja e dytë analizon qasjen e Kinës përmes Iniciativës “Brez dhe Rrugë” (Belt and Road Initiative -BRI). Ndërsa çështja e tretë analizon se si Kina po e përdor fuqinë shtetërore ekonomike (economic statecraft) dhe tregon disa nga përpjekjet e Kinës për të krijuar një rend paralel. Së fundmi, çështja e katërt paraqet një perspektivë tjetër përmes “Sindromës së Kolombit” (Columbus Syndrome), në lidhje me qasjen analitike që i bëhet rritjes së Kinës dhe angazhimit të saj ndaj rendit ekzistues.

Fjalë kyçe: Kina, strategji, rend multilateral, multilateralizëm, rend paralel, iniciativa brez dhe rrugë, fuqi ekonomike, hegjemoni, reforma

1. Rritja e Kinës dhe angazhimi i saj ndaj rendit multilateral

Tridhjetë vjet më parë, roli i Kinës në çështjet globale përtej periferisë së Azisë Lindore ishte padyshim i vogël dhe kishte pak fuqi gjeostrategjike.⁶ Ajo ndiqte një “strategji reaktive minimaliste të diplomacisë simbolike”, në arenën ndërkombëtare.⁷ Rritja ekonomike e Kinës hodhi bazën për një zgjerim të pranisë së saj në arenën ndërkombëtare. Sipas “Këshillit mbi Marrëdhëniet me Jashtë” ajo e rriti fuqinë e saj në katër mënyra, më konkretisht: ajo mori një rol më të madh në institucionet ndërkombëtare, promovoi ndikimin e saj në rritje, hodhi bazat dhe krijoi disa nga organizatat e veta.⁸

⁴ O. Stuenkel, *Post-Western World: How Emerging Powers Are Remaking the Global Order*, Cambridge, 2016.

⁵ Lorenzo Fusaro, *Why China is Different: Hegemony, Revolutions and the Rise of Contender States*, 2017, p.1.

⁶ D. Shambaugh, *U.S.-China Rivalry in Southeast Asia: Power Shift or Competitive Coexistence?* International Security, 2018, Vol. 42, No. 4, p. 85-127.

⁷ David Shambaugh, *China and the World* (Oxford University Press), 2020, pp.358-361.

⁸ Council on Foreign Relations (CFR), <https://www.cfr.org/china-global-governance/>

Në dekadën e parë të shekullit të njëzet e një, Kina shpesh u tregua e gatshme të luante sipas rregullave dhe normave ndërkombëtare por sjellja e Kinës ka ndryshuar me kalimin e kohës. Ndërkohë që ekonomia e saj po rritej, Pekini mori një rol më aktiv në qeverisjen globale, duke sinjalizuar potencialin e tij për të udhëhequr dhe për të sfiduar institucionet dhe normat ekzistuese. Dekadën e fundit, Kina ka ndërmarrë një sërë nismash të gjera rajonale dhe globale jo vetëm në fushën diplomatike, por edhe në sferën e sigurisë, kulturore dhe veçanërisht atë ekonomike.

Kina është tashmë një fuqi e madhe, me ekonominë e dytë më të madhe në botë dhe një ushtri të klasit botëror. Ajo po imponohet gjithnjë e më shumë, në sistemin ndërkombëtar dhe mbi institucionet e qeverisjes globale. Fuqia ekonomike në zgjerim e Kinës e ka lejuar atë të shtrijë ndikimin e saj kudo në glob, nga minierat e mineraleve në Afrikë, në tregjet e monedhës në Perëndim, në fushat e naftës në Lindjen e Mesme, tek fabrikat e Azisë Lindore dhe deri tek agrobiznesi në Amerikën Latine.⁹ Në përgjithësi, kur autoritetet kineze këmbëngulin që vendi mbështet “rendin ndërkombëtar”, ato zakonisht i referohen pjesëmarrjes së Kinës në organizatat dhe institucione të tilla si: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Organizata Botërore e Tregtisë si dhe mbështetjen e saj për shumë ligje dhe traktate ndërkombëtare.¹⁰ Në të kundërt, udhëheqësit dhe mendimtarët kinezë kritikojnë normat dhe vlerat liberale që mbështesin rendin ndërkombëtar si një “ideologji politike” vetëm perëndimore.¹¹

Në një sesion studimi të Byrosë Politike mbi qeverisjen globale më 12 tetor 2015, presidenti kinez Xi Jinping deklaroi se: “qëllimi themelor i pjesëmarrjes së Kinës në qeverisjen globale është t'i shërbyer arritjes së ëndrrës së madhe kineze të përtëritjes së kombit. Ëndrra kineze, këmbënguli Xi, mund të realizohet vetëm në një mjedis ndërkombëtar paqësor dhe nën një rend ndërkombëtar të qëndrueshëm.” Në këtë fjalim Xi Jinping argumenton se interesat e Kinës janë në përputhje me rendin ndërkombëtar.

Por në një fjalim tjetër në Kongresin e 19-të të Partisë në 2017, Xi Jinping theksoi se: “rruga e Kinës ofron një shembull dhe mundësi për vendet e tjera në zhvillim” - duke nënkuptuar se Pekini synon të ofrojë një rrugë unike kineze drejt rendit dhe zhvillimit socio-ekonomik, i cili mund të konkurrojë me modelin liberal që ka qenë baza për rendin e pasluftës.”¹²

⁹ David Shambaugh, *China Goes Global: The Partial Power* (New York: Oxford University Press), 2013.

¹⁰ Xinhua News Agency, *China Supports, Contributes to Postwar International Order*, July 30, 2015.

¹¹ Astrid Cevallos, Michael Mazarr, and Timothy Heath, *China and the International Order*, 2018, p. 33-39, 99.

¹² Report of the 19th Congress of the Chinese Communist Party, 2017.

Sipas studiuesit Chien-peng Chung, qëndrimi i autoriteteve kineze ndaj sigurisë rajonale dhe organizatave ekonomike shumëpalëshe ndryshoi nga “dyshimi” para 1996, në “kujdes” midis viteve 1996 - 2000 dhe më pas në “mbështetje” viti 2000 - e në vazhdim. Chung gjithashtu vëren se, në forume dhe institucione të ndryshme shumëpalëshe, Kina është shumë më e etur për të promovuar institucionalizimin e mëtejshëm në rastet kur shpërndarja e pushtetit të organizatës favorizon Kinën dhe kur çështjet me të cilat merret organizata janë të rëndësishme për Kinën.¹³

Për më tepër, në disa fusha si ndryshimet klimatike, Kina nuk përpiket të imponojë vizionin dhe rregullat e veta, ndërsa në fushat e të drejtave të njeriut dhe të qeverisjes së internetit (Internet governance), Pekini përpiket të promovojë normat e veta më autoritare. Në këtë kuadër, në maj 2020, Pekini miratoi një legjislacion të ri i cili i jepte Kinës kompetenca të gjera për të shtypur disidencën në Hong Kong, duke kërcënuar seriozisht autonominë e rajonit të posaçëm administrativ. Gjithashtu, Kina po punon me fuqi të tjera autoritare si Rusia për të krijuar standarde që pasqyrojnë interesat e tyre edhe në hapësirën digjitale të qeverisjes së internetit (Internet governance).

Sipas Këshillit mbi Marrëdhëniet me Jashtë, për çështjet në të cilat Pekini ka qëndrim të ndryshëm nga normat e sistemit aktual, ai kërkon të krijojë institucione dhe modele alternative. Ky model zhvillimi pasqyron një kontroll më të gjerë shtetëror mbi politikën dhe shoqërinë, si dhe një përzierje të praktikave të bazuara në tregun e lirë dhe kontrollin shtetëror në sektorët kryesorë të ekonomisë.

2. Iniciativa “Brez dhe Rrugë” (BRI) dhe implikimet e saj

Ideja e formimit të një “Brezi Ekonomik të Rrugës së Mëndafshit” (SREB) dhe Iniciativën e Rrugës Detare të Mëndafshit (*Maritime Silk Road Initiative-MSRI*), e njohur gjerësisht si Iniciativa Brez dhe Rrugë (*Belt and Road Initiative-BRI*), frymëzuar nga Rrugat e lashtë të Mëndafshit, u propozua nga presidenti kinez Xi Jinping dhe u prezantua për herë të parë gjatë fjalimit të tij në Astana të Kazakistanit, në shtator 2013, si një platformë e re për bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar. Forumi i parë i BRI-së u mbajt në vitin 2017, i dyti në vitin 2019, ndërsa forumi i tretë “Brez dhe Rrugë për Bashkëpunim Ndërkombëtar” u zhvillua në datat 17-18 tetor të vitit të kaluar, duke demonstruar rëndësinë dhe hapjen e vazhdueshme të BRI-së. Ky forum kurorëzoi përvjetorin e dhjetë të nismës dhe sukseset në dekadën e saj të parë. BRI konsiderohet si një pjesë qendrore e politikës së jashtme të liderit kinez

¹³ Chien-peng Chung, *China's Multilateral Co-operation in Asia and the Pacific* (Abingdon, Oxon and New York: Routledge), 2010, p. 2.

Xi Jinping dhe shpesh është krahasuar me Planin Marshall. BRI formon një komponent qendror të strategjisë së "Diplomacisë së Madhe të Vendit", e cila i bën thirrje Kinës të marrë një rol më të madh udhëheqës për çështjet globale në përputhje me fuqinë dhe statusin e saj në rritje.¹⁴ Që nga gushti 2023, 155 vende u renditën si të regjistruara në BRI. Vendet pjesëmarrëse përfshijnë pothuajse 75% të popullsisë së botës dhe përbëjnë më shumë se gjysmën e PBB-së botërore.¹⁵ Administrata Xi Jinping e përshkruan nismën si "një përpjekje për të përmirësuar lidhjen rajonale dhe për të përqafuar një të ardhme më të ndritur". Projekti ka një datë të synuar të përfundimit të vitit 2049, e cila do të përkohë me 100-vjetorin e themelimit të Republikës Popullore të Kinës (PRC).

Strategjia e Kinës "Brez dhe Rrugë" (Belt and Road) njihet si nisma më ambicioze gjeopolitike e kohës. Ajo synon të ndikojë në çdo element të shoqërisë globale, nga transporti në bujqësi, nga ekonomia në politikë dhe deri te hapësira digjitale, turizmi dhe kultura, duke e futur Kinën në një fazë të re të ambicieve të saj si superfuqi, me synim "rindërtimin" e ekonomisë botërore dhe kurorëzimin e Pekinit si qendra e re e globalizmit.¹⁶

Plani parashikon një gamë të gjerë projektsh infrastrukturore që do të lidhin Azinë me Evropën përmes një rruge tokësore përtej Euroazisë ("Rripi Ekonomik i Rrugës së Mëndafshit") dhe një rrugë të dytë që përfshin Detin e Kinës Jugore përmes Oqeanit Indian dhe Detit të Kuq në Mesdhe, e pagëzuar si "Ruga Detare e Mëndafshit e Shekullit e 21-të". Projekte të shumta tregtare, duke përfshirë ndërtimin e porteve, termocentraleve, rrjeteve të energjisë elektrike, hekurudhave, autostradave, parqeve industriale, qendrave tregtare dhe financiare, objekteve të telekomunikacionit, banesave rezidenciale si dhe shumë projekte të tjera që tashmë janë duke u zhvilluar dhe zbatuar. Duke pasur parasysh nevojën urgjente për këtë lloj infrastrukture në vendet përgjatë këtyre korridoreve, BRI është mirëpritur përgjithësisht nga shumica e vendeve.¹⁷

Në planin e veprimit të kësaj nisme thuhet se: "Iniciativa Brez dhe Rrugë" (Belt and Road Initiative), synon të promovojë lidhjen e kontinentit Aziatik, Europian dhe atij Afrikan dhe deteve të tyre, të krijojë dhe të forcojë partneritetet midis vendeve përgjatë kësaj hapësire, të krijojë rrjete dhe lidhje shumëdimensionale, zhvillim të pavarur, të balancuar dhe të qëndrueshëm.

¹⁴ Smith, Stephen, *China's Major Country Diplomacy*, Foreign Policy Analysis, 16 shkurt 2021.

¹⁵ Giorgio Caridi, *BRI's Digital Silk Road and the EU: China and Eurasian Powers in a Multipolar World Order*, 2023.

¹⁶ B. Maçães, *Belt and Road: A Chinese World Order*, (London: Hurst), 2018.

¹⁷ David Shambaugh, *China and the World* (Oxford University Press), 2020, pp.358-361.

Projektet e lidhura me nismën do të ndihmojnë në harmonizimin dhe koordinimin e strategjive të zhvillimit të vendeve, shfrytëzimin e potencialit të tregut, promovimin e investimeve dhe konsumit, krijimin e kërkesave dhe mundësive të punës, rritjen e shkëmbimeve njerëzore dhe kulturore, dhe të mësuarit reciprok midis popujve të vendeve përkatëse, dhe t'u mundësojë atyre të kuptojnë, të besojnë, të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jetojnë në harmoni, paqe dhe prosperitet."¹⁸

Gjuha e përdorur në planin e veprimit është transparente dhe në përputhje me rendin liberal botëror, multilateralizmin, idenë e hapjes dhe bashkëpunimit. Përtej përshkrimit teorik, praktikisht BRI është tregues i aktivitetit të ri të Kinës në periferinë e saj aziatike dhe më gjerë. Prej 2017, Pekini ka arritur të joshë shumicën e shteteve të Azisë Juglindore, në përpjekje për t'i sjellë këto vende më afër orbitës gjeo-ekonomike, gjeopolitike dhe gjeostrategjike të Kinës.

Kur Kina njoftoi për herë të parë BRI-në, ajo ishte e paqartë për qëllimin e saj; për disa, ajo lindi nga nevojat e brendshme ekonomike të Kinës, të cilat përfshijnë nevojën për tregje më të mëdha dhe më shumë mundësi për korporatat shumëkombëshe kineze (MNC)¹⁹, ndërsa për të tjerët ajo përfaqëson një përpjekje të Republikës Popullore Kineze për të dominuar Euroazinë dhe për të rritur fuqinë e saj në rendin global. Ka edhe rryma të tjera që mendojnë se ajo është një përpjekje e fuqisë së butë, duke vënë në dukje vlerën e saj politike të brendshme, ose ndërtimin e trashëgimisë së Xi, dhe dëshirën e një lideri për të siguruar pozicionin e tij politik të brendshëm, për të shmangur presionet e jashtme dhe për të gjetur aleatë të rinj sigurie.²⁰ Me kalimin e kohës, etiketimi i duhur për këtë iniciativë është bërë gjithnjë e më i vështirë.²¹

Mbështetësit e vlerësojnë BRI-në për potencialin e saj për të rritur PBB-në globale, veçanërisht në vendet në zhvillim. Studime të shumta të kryera nga Banka Botërore kanë vlerësuar se BRI mund të rrisë flukset tregtare në 155 vende pjesëmarrëse me 4.1%, si dhe të ulë koston e tregtisë globale me 1.1 % në 2.2 % dhe të rrisë PBB-në e vendeve në zhvillim të Azisë Lindore dhe Paqësorit, me një mesatare prej 2.6 deri në 3.9 %. Sipas Qendrës për Kërkime Ekonomike dhe Biznesi (CEBR), në Londër, BRI ka të ngjarë të rrisë GDP-në botërore me 7.1 trilion dollarë në vit deri në vitin 2040 dhe se përfitimet do të jenë "të përhapura" pasi infrastruktura e përmirësuar redukton "fërkimet që

¹⁸ Action Plan on the Belt and Road Initiative, State Council of PRC, 2015.

¹⁹ David Shambaugh, *China and the World* (Oxford University Press), 2020, pp.358-361.

²⁰ Po aty.

²¹ Jean-Marc F. Blanchard, *Belt and Road Initiative (BRI) Blues: Powering BRI Research Back on Track to Avoid Choppy Seas*, (2020).

pengojnë tregtinë botërore". Kjo qendër gjithashtu, arrin në përfundimin se projekti ka të ngjarë të tërheqë vende të tjera për t'u bashkuar, nëse nisma globale e infrastrukturës përparon dhe fiton vull.²²

Megjithatë, kjo nisme ka pasur gjithashtu kritika mbi shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ndikimin mjedisor, si dhe shqetësimet e diplomacisë së kurthit të borxhit që rezulton në neokolonializëm dhe imperializëm ekonomik. Këto këndvështrime të ndryshme janë objekt i debatit aktiv.²³

3. Fuqia shtetërore ekonomike (Economic Statecraft) e Kinës dhe rendi paralel

Në mekanizma dhe organizata të ndryshme shumëpalëshe ku Kina merr pjesë, peshë e saj ekonomike është ndoshta asemi i saj më i rëndësishëm.²⁴ Kina dhe fuqitë e tjera në rritje po zgjerojnë marrëveshjet e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, në mënyrë që të angazhojnë vendet që janë të pakënaqur me marrëveshjet aktuale globale.²⁵ Ajo favorizon një sistem multipolar që redukton mbizotërimin e SHBA-ve, dhe gjithashtu pret të fitojë shkallën e vet të mbizotërimit rajonal, të paktën brenda Azisë.²⁶

Presioni ekonomik i Kinës dhe synimi për mbizotërim rajonal përforcohet nga qëndrimi i saj ndonjëherë me një posturë diplomatike kërkuese. Siç e përshkruan një zyrtar i lartë nga Singapori, "Kinezët do t'ju thonë të qëndroni në këmbë, pastaj ju thonë të uleni. Pasi t'i bëni të dyja, pastaj ata do t'ju thonë të gjunjëzoheni. Nuk do të ndalen kurrë." Në mënyrë të ngjashme, një zyrtar i lartë tajlandez e përshkroi në këtë mënyrë: "Tridhjetë e pesë vjet më parë, kur ministrat kinezë erdhën këtu, ata ishin mjaft të përlurur, në ditët e sotme nuk është më kështu. Kina tani ka fuqi, dhe ata po sillen sikur vijnë këtu dhe na thonë të bëjmë këtë dhe të bëjmë atë. Kinezët kanë një thënie: "Qielli është i lartë dhe perandori është larg." Por perandori nuk është më aq larg tani. Perandori tani e ka aftësinë për të zbatuar vullnetin e tij."²⁷

Kina është tashmë investitori më i madh i huaj në Kamboxhia, Laos, Malajzi,

²² CEBR, *Belt and Road Initiative to boost world GDP by over \$7 trillion per annum by 2040*, 2019.

²³ Deborah Brautigam, *A critical look at Chinese 'debt-trap diplomacy': the rise of a meme*, (2020-01-02).

²⁴ Jean-Marc F. Blanchard *Belt and Road Initiative (BRI) Blues: Powering BRI Research Back on Track to Avoid Choppy Seas*, (2020).

²⁵ O. Stuenkel, *Post-Western World: How Emerging Powers Are Remaking the Global Order*, Cambridge, 2016.

²⁶ Ann Kent, China's International Socialization: The Role of International Organizations, *Global Governance*, Vol. 8, No. 3, July-September 2002, pp. 343–344, 349, 358.

²⁷ Shambaugh, D. (2018) "U.S.-China Rivalry in Southeast Asia: Power Shift or Competitive Coexistence?" *International Security*, Vol. 42, No. 4, pp. 85–127

Myanmar dhe e dyta më e madhe në Singapor dhe Vietnam.²⁸ Kina po ndërton gjithashtu koalicione ndërkombëtare për të mbështetur reformat e saj të organizatave dhe institucioneve ekzistuese dhe krijimin e të rejave. Në veçanti, Kina ka zhvilluar marrëdhëniet e saj me botën në zhvillim, veçanërisht me vendet e mëdha në zhvillim si Brazili, Rusia, India, Indonezia dhe Afrika e Jugut. Në të vërtetë, Kina dhe Rusia kanë lëshuar deklaratat e tyre për nevojën për të reformuar rendin ndërkombëtar.²⁹

Ndërsa Kina është e përgatitur të marrë një rol më aktiv në çështjet e Botës së Tretë në bashkëpunim me vendet kryesore të saj, ajo po rrit gjithashtu koordinimin diplomatik me vendet kryesore të Amerikës Latine siç tregohet nga aktivitetet e grupit BRICS dhe bashkëpunimi për ndryshimet klimatike në OKB.³⁰ Udhëheqësit kinezë priren të konsiderojnë se lidhjet në zhvillim të Kinës me Amerikën Latine demonstrojnë një shtrirje globale që korrespondon me fuqinë ekonomike, statusin dhe ndikimin ndërkombëtar të saj.³¹

Kina kërkon të bëjë dallimin midis rendit aktual të cilin e konsideron kryesisht si "unipolar" dhe që privilegjon Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj dhe një rendi "multipolar", në të cilin vendet joperëndimore të kenë mundësi më të barabarta në përcaktimin e normave dhe marrjen e vendimeve brenda institucioneve ndërkombëtare.³² Një nga arsyet e kërkesës së Kinës për reformimin e përfaqësimit brenda institucioneve ekzistuese ndërkombëtare është besimi i tyre se shpërndarja e fuqisë globale po ndryshon ndërsa tregjet dhe vendet në zhvillim po rriten.

Aty ku reforma institucionale nuk ka ardhur ose është dukur me pak gjasa që të ndodhin, Kina ka filluar të ndërtojë institucione dhe organizata alternative më të përshtatshme për ushtrimin e pushtetit kinez në një rol udhëheqës. Kjo prirje është bërë veçanërisht e dukshme nën Xi, i cili ka mbikëqyrur krijimin ose zgjerimin e Bankës Aziatike të Investimeve në Infrastrukturë (AIIB), Organizatën e Bashkëpunimit të Shangait (SCO), Konferencën për Ndërveprimin dhe Ndërtimin e Besimit (CICA) dhe Bankën e Re të Zhvillimit për BRICS.³³

²⁸ Po aty.

²⁹ People's Republic of China Ministry of Foreign Affairs, "China's African Policy", January 12, 2006.

³⁰ Joseph Yu-Shek Cheng 2017, Multilateral Approach in China's Foreign Policy, p.2-49, Chpt I.

³¹ Po aty.

³² Shambaugh, D. (2018) "U.S.-China Rivalry in Southeast Asia: Power Shift or Competitive Coexistence?" International Security, Vol. 42, No. 4, pp. 85–127

³³ Sebastian Heilmann, Moritz Rudolph, Mikko Huotari, and Johannes Buckow, "China's Shadow Foreign Policy," Mercator Institute for China Studies, No. 18, October 2014.

Perceptimi i Kinës për tre kërcënimet e sigurisë në Azinë Qendrore; terrorizmin, separatizmin dhe ekstremizmin, nxitën iniciativën e saj për të krijuar SCO-në në qershor 2001, simotra e NATO-s në Azinë Qendrore.³⁴ Udhëheqësit kinezë kanë qenë të aftë në zhvillimin e kuadrit institucional të SCO-së dhe duket se po marrin kompensimin e burimeve të shpenzuara. Ata treguan durim të konsiderueshëm kur zhvillimi i SCO-së hasi në pengesa. Gjithashtu, autoritetet kineze kanë promovuar ndërkombëtarizimin e monedhës së tyre, yuanit. Pjesëmarrja e saj në mekanizma multilaterale si BRICS e kanë lehtësuar këtë proces.³⁵ Pavarësisht pasivitetit relativ historik të Kinës iniciativat e mësipërme paraqesin një shembull të suksesshëm të zhvillimit të Kinës dhe të rritjes së rolit të saj rajonal dhe më gjerë.³⁶

4. Analiza e rritjes kineze dhe “Sindroma e Kolombit”

Perceptimi i rritjes së Kinës si diçka rutinë pasqyron ndoshta një problem më të gjerë në rrymat kryesore të teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke u krahasuar ndonjëherë edhe me “Sindromën e Kolombit”.³⁷ Në udhëtimin e tij në vitin 1492, Kristofor Kolombi dështoi të njohte “risitë” e Botës së Re me të cilën ai u përball; ai gjithashtu refuzoi të pranonte se amerikanët indianët flisnin një gjuhë të ndryshme nga ai. Në vend të kësaj, ai thjesht supozoi se popullatat indigjene nuk ishin në gjendje të flisnin. Kështu, dështimi i Kolombit për të njohur diversitetin e gjuhëve, i lejoi atij vetëm dy forma të mundshme të sjelljes: ta pranojë atë si gjuhë, por të refuzojë të pranojë se është një gjuhë ndryshe; ose të pranojë dallimin e saj, por të refuzojë të pranojë se është një gjuhë.³⁸ Nisur nga ky model perceptimi, Kolombi “e di paraprakisht se çfarë do të gjejë”³⁹ dhe pranon vetëm gjërat që i përshtaten modelit të tij konjektiv, duke injoruar të gjitha aspektet që nuk janë në përputhje me të.

Implikimet që shfaq “Sindroma e Kolombit” ndaj analizës që i bëhet qasjes së Kinës ndaj rendit multilateral global është nëse ne po kërkojmë elementët e gabuar në formën e gabuar në një gjendje të ngjashme me atë të Kolombit duke reduktuar realitetin, kompleksitetin dhe dinamizmin e sistemit global për t’ia përshtatur atë historive apo trajektoreve të parashkruara të fuqive ekzistuese.⁴⁰ Ndoshta lloji i hegjemonisë dhe lidhshëritë që Kina po përpiqet të ndërtojë në

³⁴ Joseph Y. S. Cheng, The Shanghai Co-operation Organization: China’s Initiative in Regional Institutional Building”, Journal of Contemporary Asia, Vol. 41, No. 4, 2011, pp. 632–656

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

³⁷ Kavalski, E. (2018). “The Guanxi of Relational International Theory. London: Routledge.”

³⁸ Todorov, T. (1982). “The Conquest of America: The Question of the Other. New York: Harper.”

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Kavalski, E. (2018). “The Guanxi of Relational International Theory. London: Routledge.”

shekullin e 21-të nuk është ai që njihet prej analistëve apo studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare të cilët janë më shumë të familjarizuar me një perceptim apo model perëndimor të shfaqjes dhe evoluimit të fuqive. Ky perceptim vërehet sidomos në përpjekjen për të kërkuar një hegjemoni identike me atë të Shteteve të Bashkuara, ku gjuha, kultura, dollari amerikan, modeli prodhimit identifikonin atë se çfarë ishte hegjemonia amerikane. Ndoshta, rritja dhe zhvillimi që po shfaq Kina është diçka krejtësisht e ndryshme dhe ka vërtet karakteristika të vërteta dalluese kineze.⁴¹

Përfundime

Ky punim shqyrtoi angazhimin e Kinës ndaj rendit multilateral ekzistues pasi rritja ekonomike e saj hodhi bazat për një prani më të shtuar globale. Analiza evidenton se sjellja multilaterale e Kinës ka ndryshuar në kohë dhe për çështjet, të cilat Pekini divergjon nga normat e sistemit aktual, siç janë për shembull të drejtat e njeriut, kërkon të krijojë institucione dhe modele alternative.

Nga ana tjetër, iniciativa “Brez dhe Rugë”, nisma më ambicioze gjeopolitike e kohës, po synon të ndikojë në çdo element të shoqërisë globale, nga transporti në bujqësi, nga ekonomia në politikë dhe deri te hapësira digjitale, turizmi dhe kultura, duke e futur Kinën në një fazë të re të ambicieve të saj si superfuqi, me synim “rindërtimin” e ekonomisë botërore dhe kurorëzimin e Pekinit si qendra e re e globalizmit.

Gjithashtu, artikulli hulumtoi se si Kina po e përdor fuqinë ekonomike të shtetit në mekanizma dhe organizata të ndryshme multilaterale në të cilat Kina merr pjesë, ku pesha e saj ekonomike ka qenë ndoshta asemi më i rëndësishëm i saj, duke favorizuar një sistem multipolar që redukton mbizotërimin e SHBA-ve, dhe përpjekjet e Kinës për të krijuar një rend paralel përmes organizatave alternative më të përshtatshme për ushtrimin e pushtetit kinez.

Për më tepër, artikulli lë një debat të hapur përmes "Sindromës së Kolombit" mbi interpretimin që i bëhet rritjes së Kinës dhe angazhimit të saj ndaj rendit ekzistues, duke ngritur shqetësimin nëse po kërkojnë elementët e gabuar në formën e gabuar në një gjendje të ngjashme me atë të Kolombit.

Si konkluzion kryesor mund të themi se: ndonëse "kriza e hegjemonisë së SHBA-ve" po konkretizohet gjithnjë e më shumë, Kina ende mbetet larg nga realizimi i marrëdhënieve hegjemonike, qoftë edhe në nivel rajonal. Megjithatë, ndikimi aktual dhe potencial i Kinës në nivel rajonal dhe global nëpërmjet institucioneve multilaterale ekzistuese ose të krijuara prej saj dhe nëpërmjet fuqisë shtetërore ekonomike (economic statecraft), veçanërisht në

⁴¹ Alex Colas 2021. “Geopolitics and Geo-Economics in the 21st Century.”

disa demokraci në rritje, apo rajone ekonomikisht dhe politikisht të brishta nuk duhet të injorohet.

Bibliografia:

1. Caridi, Giorgio (2023). "BRI's Digital Silk Road and the EU: China and Eurasian Powers in a Multipolar World Order.
2. Alex Colas 2021. "Geopolitics and Geo-Economics in the 21st Century."
3. Maçaes, B. (2018). "Belt and Road: A Chinese World Order (London: Hurst)."
4. David Shambaugh, 2020. "China and the World (Oxford University Press), pp.358-361".
5. O. Stuenkel, 2016. "Post-Western World: How Emerging Powers Are Remaking the Global Order." Cambridge.
6. Oliver Stuenkel, 2014. "China's parallel global order."
7. Lorenzo Fusaro, 2017. "Why China is Different: Hegemony, Revolutions and the Rise of Contender States, p.1."
8. Astrid Stuth Cevallos, Michael Mazarr, and Timothy R. Heath, 2018. "China and the International Order. pp. 33-39, 99, 119."
9. Shambaugh, D. (2018) "U.S.-China Rivalry in Southeast Asia: Power Shift or Competitive Coexistence?" International Security, Vol. 42, No. 4, pp. 85–127
10. David Shambaugh, 2013. "China Goes Global: The Partial Power "(New York: Oxford University Press).
11. David Shambaugh, 2020. "China and the World (Oxford University Press), pp.358-361".
12. John J. Mearsheimer (2001). "The Future of the American Pacifier', Foreign Affairs."
13. Blanchard, J-F. & C. Flint (2017). "The Geopolitics of China's Maritime Silk Road Initiative", Geopolitics, Vol. 22, No, 2, pp. 223-245.
14. Council on Foreign Relations (CFR), <https://www.cfr.org/china-global-governance/>
15. Jean-Marc F. Blanchard (2020). "Belt and Road Initiative (BRI) Blues: Powering BRI Research Back on Track to Avoid Choppy Seas."
16. Xinhua News Agency, July 30, 2015 "China Supports, Contributes to Postwar International Order".
17. Shaun Breslin, 2013. "China and the global order: signaling threat or friendship?"

18. Maçães, B. (2018). "Belt and Road: A Chinese World Order (London: HHurst)."
19. Robert O. Keohane, "Multilateralism: An Agenda for Research", *International Journal*, Vol. 45, No. 4 (January 1990), pp. 731–764.
20. Arthur A. Stein, 2008. "Incentive Compatibility and Global Governance: Existential Multilateralism, a Weakly Confederal World, and Hegemony", in A. S. Alexandroff (ed.), *Can the World be Governed? Possibilities for Effective Multilateralism* (Waterloo, Canada: Wilfrid Laurier University Press), pp. 47–49.
21. Chien-peng Chung, 2010. "China's Multilateral Co-operation in Asia and the Pacific (Abingdon, Oxon and New York: Routledge), p. 2.
22. Action Plan on the Belt and Road Initiative, State Council of PRC, 2015
23. Joseph Y. S. Cheng, 2011. "The Shanghai Co-operation Organization: China's Initiative in Regional Institutional Building", *Journal of Contemporary Asia*, Vol. 41, No. 4, pp. 632–656.
24. Joseph Yu-Shek Cheng 2017, *Multilateral Approach in China's Foreign Policy*, p.2-49, Chpt I.
25. Ann Kent, July–September 2002. "China's International Socialization: The Role of International Organizations," *Global Governance*, Vol. 8, No. 3, , pp. 343–344, 349, 358.
26. Latin American Research Group, China Institute of Contemporary International Relations, "Zhongguo dui Lading Meizhou Zhengce Yanjiu Baogao" (Research Report on China's Policy towards Latin America), *Xiandai Guoji Guanxi*, Vol. 4 (2004), p. 5.
27. People's Republic of China Ministry of Foreign Affairs, "China's African Policy", January 12, 2006.
28. Y. W. Zhang and R. W. Huang, 2006. *Zhongguo Guoji Diwei Baogao* (China's International Status Report 2006) (Beijing: Renmin Chubanshe, 2006), p. 284.
29. Sebastian Heilmann, Moritz Rudolph, Mikko Huotari, and Johannes Buckow, "China's Shadow Foreign Policy," *Mercator Institute for China Studies*, No. 18, October 2014.
30. Daniel McDowell, "New Order: China's Challenge to the Global Financial System" *World Politics Review*, April 14, 2015.
31. Kavalski, E. (2018). "The Guanxi of Relational International Theory. London: Routledge."
32. Todorov, T. (1982). "The Conquest of America: The Question of the Other. New York: Harper

RUBRIKA E DYTË

ARSIMIMI DHE STËRVITJA

Disa këndvështrime mbi drejtuesin toksik

Prof. Asoc. Dr. Edmond BRANESHI
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Lidershipi toksik është një dukuri e pashmangshme në veprimtaritë e organizatave. Në zinxhirin drejtues të strukturave të ndryshme jo të gjithë drejtuesit janë të përsosur, pavarësisht angazhimeve të tyre serioze. Drejtimi është i lidhur ngushtë me burimet njerëzore, të cilat konsiderohen një faktor kyç i suksesit të çdo organizate. Për këtë arsye, organizata kërkon drejtues të aftë për të nxitur veprimtarinë e njerëzve, duke inkurajuar e motivuar në mënyrë të vijueshme angazhimin e vartësve. Të drejtosh është përgjegjësi jo vetëm profesionale por edhe njerëzore.

Shpesh vëmendja përqendrohet tek lidershipi i mirë, fryma pozitive që përçon në motivimin e vartësve, por në jo pak raste vihen re edhe sjellje apo veprime jo të hijshme që ulin vlerat ose imazhin e tyre. Te disa drejtues, këto sjellje janë të rastit ose vijnë si rezultat i mosmenaxhimit të emocioneve të çastit, por ka edhe drejtues që vazhdimisht prodhojnë klimë toksike, ankth, frikë apo pasiguri te vartësit dhe ky stil drejtimi iu jep atyre kënaqësi. Për këto dukuri

janë kryer hulumtime nga njerëz apo institucione të ndryshme, sondazhe dhe intervista të shumta për të dhënë një pamje sa më të qartë të drejtuesve që “vuajnë nga sëmundjet helmatisëse”.

Në këtë shkrim do të ndalemi te këndvështrimet mbi lidershipin toksik, dëmet që i shkaktojnë organizatës dhe karakteristikat më tipike të tij. Kjo do të qartësojë qasjet se si drejtuesit duhet të reflektojnë në të tilla raste për të zvogëluar “viruset toksike”.

Fjalët kyçe: lidership toksik, drejtues i keq, ndjekës, vartës, dukuri, sjellje, efekt negativ, ndikim negativ, organizatë, motivim, marrëdhënie.

Hyrje

Të qenët prind është një detyrë e vështirë dhe e lodhshme pasi duhet të zotërosh aftësi që fëmijët e tu të të binden. Hamendësoni të drejtoni një organizatë, të japësh urdhra për të realizuar detyrimet ditore apo për të arritur objektivat e muajit dhe për këtë, do të duhet që të ndjekin të gjithë njerëzit me të cilët mund të mos kesh punuar ndonjëherë. Apo mund të promovohesh në një detyrë më të lartë dhe të jesh drejtues i shokëve apo kolegëve të tu. Dhe ju mendoni i dyzuar: “A do ta kryej detyrën sipas standardeve të përcaktuara?”, “A do të jem një drejtues i mirë?”, “A do të më ndjekin pas të tjerët?”...

Drejtuasi duhet të jetë njerëzor, largpamës, frymëzues, efektiv, i sigurtë në vetvete dhe të ndërtojë marrëdhënie sa më të ngrohta me vartësit e tij. E rëndësishme është të mos i rëndoje pa të drejtë njerëzit që punojnë për të. Mendje të ndritura të lashtësisë, si Platoni, Aristoteli, Buda, Konfuci etj., na kanë përcaktuar tiparet thelbësore të drejtuesit të mirë. Megjithatë, lidershipi është kompleks dhe shpesh është vështirë të gesh të mesmen e artë ose përcaktimin përfundimtar për një drejtues. Pavarësisht studimeve të ndryshme mbi lidershipin e mirë, kur bie fjala të flasësh për drejtuesit e këqij, interesi bëhet edhe më i madh. Gjatë jetës, pothuajse të gjithë jemi ndeshur me drejtues negativë apo edhe me forma të ndryshme të shfaqjes së tij.

Ka studime, shkrime apo libra që trajtojnë dukurinë “drejtues i keq”, “drejtues negativ”, “drejtues shkatërrues”, “drejtues i dëmshëm”, “drejtues mistrec” e emërtime të përafërta të përdorura, por që nënkuptojnë drejtuesin toksik ose helmues. Termi “drejtues toksik” (helmues) ka marrë qytetarinë e një përdorimi të gjerë në këtë shekull. Në këtë kuadër, synimi i këtij shkrimi është të nxjerrë në pah karakteristikat më dalluese të lidershipit toksik, duke zgjeruar panoramën mbi pasojat shkatërruese që mund t’i sjellin organizatës, drejtuesit që vuajnë nga kjo “sëmundje”.

1. Çfarë është lidershipi toksik?

“Nëse njeriu i gabuar merr në dorë mjetet e duhura, mjetet e duhura funksionojnë në mënyrën e gabuar”.

Thomas Jefferson

Hulumtimet shkencore tregojnë se dallimi thelbësor midis një lidershipi të mirë dhe një lidershipi të keq ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kënaqësinë e kryerjes së detyrave, masën dhe llojin e motivimit, performancën në punë, në mirëqenie, te niveli i stresit, në punën ekipore si dhe te rezultatet e përditshme apo ato që kanë të bëjnë me detyra të caktuara.

Janë kryer shumë hulumtime në funksion të studimit të një lidershipi të mirë. Në këto studime, së fundmi, është shtuar dhe interesi për të studiuar lidershpin e keq apo shkatërrues. Drejtues të këqij ka pasur në të gjitha kohërat, por nuk i është kushtuar vëmendja e duhur studimit të tyre, të paktën jo në një masë të madhe apo sistematike. Megjithatë, rritja e hulumtimeve shkencore për lidershpin toksik ka treguar se ndikimi negativ i këtij lloji lidershipi mbi ndjekësit e tij është po aq i madh sa ndikimi pozitiv i një lidershipi të mirë në përmbushjen e suksesshme të detyrave të ndjekësve. Në lidhje me këtë dukuri, në librin e P. Smith “Përgjegjësia” thuhet: *“Udhëheqja dhe drejtimi janë më shumë një përvojë dhënëse se sa marrëse. Qëndrimi i drejtuesit në veprimtarinë e përditshme është shumë i rëndësishëm dhe ka një ndikim të madh në moralin e organizatës. Nëse drejtuesi është njeri negativ ka të ngjarë që vartësit t’i përshtaten gjithashtu karakterit negativ. Nga ana tjetër, nëse drejtuesi është i gëzueshëm dhe i gjallë, gëzimi dhe gjallërimi do të përhapet anembanë njësisë. Njerëzit duan të dëgjojnë fjalë të mira dhe të ndjejnë kënaqësi për veten, për organizatën e tyre dhe për punën që bëjnë”*¹. Ndoshta, për këtë arsye, S. Soderfjalli thekson se parapëlqehet më shumë përpjekja që drejtuesit e këqij t’i shndërrosh në drejtues mesatarisht të mirë (apo në rastin më të keq t’i largosh tërësisht), sesa të shndërrosh në drejtues të shkëlqyer ata që janë mesatarisht të mirë².

Është vështirë që të mos gjesh një njeri, që nuk i ka takuar të dy llojet e drejtuesve: njërin me të cilin ka punuar me gëzim dhe tjetrin me të cilin, bezia ishte vazhdimisht e pranishme. Alessio Roberti, sociolog, ekspert i lidershipit dhe komunikimit, flet për ekzistencën e dy tipeve drejtuesish, bazuar mbi llojet e pushtetit që ata përdorin: drejtuesi toksik, që përdor pushtetin hierarkik ose rolin (pozicionin) dhe drejtuesi pozitiv, që përdor pushtetin vetjak. Ndër të tjera, ai shpjegon: “Drejtesia toksik, për të arritur diçka nga ekipi i tij, përdor

¹ Perri Smith, *Përgjegjësia*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, faqe 167.

² Stefan Söderfjäll, *Libri i vogël i Lidershipit*, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2019, ISBN: 978-9951-721-85-1, faqe 34.

tre lloj komunikimi: *urdhëron* (unë jam bosi/drejtori dhe do të bësh këtë), *kërcënon* (nëse nuk e bën këtë do të të ndëshkoj, do të të pushoj nga puna) dhe *përdor forcën* (nëse kundërshton, të shmang ose ia kërkon dikujt tjetër ta bëjë dhe të heq)”. Ndërsa për drejtuesin e mirë ai vijon se, “...ka aftësinë, që me sjelljen e tij, t’i bëjë të tjerët që t’i bëjnë gjërat sepse duan dhe jo thjesht sepse duhet, duke i bindur për mirësinë e ideve të tij”³. Pikërisht ky kompleksitet përcakton dhe vetë fatin e lidershit, duke e kthyer atë në profesionin më të vështirë, pasi përgjegjshmëria duhet të jetë e pranishme në çdo kohë.

Drejtesit më të mirë janë njerëz të besueshëm, empatikë dhe të lidhur, të cilët i qetësojnë, i shpërblejnë dhe i frymëzojnë vartësit e tyre. Drejtuesit më të këqij janë njerëz të largët, të vështirë dhe arrogantë, të cilët në rastin më të mirë i bëjnë vartësit e tyre të mos ndihen rehat dhe në rastin më të keq i përçmojnë dhe i lëndojnë. George Kohlrieser-i, psikolog dhe profesor në Institutin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Administrimit të Biznesit në Zvicër, vëren se një vend pune i sigurt është çelësi i performancës së lartë. Duke u ndier i sigurt, argumenton Kohlrieser-i, i lejon një punonjësi të përqendrohet më mirë në punën e tij, të arrijë qëllimet dhe t’i shohë pengesat si sfida, jo si kërcënime. Përkundrazi, ata që janë në ankth, shqetësohen lehtësisht me fantazmën e dështimit, nga frika se mos të vepruarit keq do të thotë se do të refuzohen ose do të braktisen (nënkupto: do të pushohen nga puna) dhe kështu nuk rrezikojnë asgjë⁴. Prandaj, anëtarët e organizatave që udhëhiqen nga drejtues të mirë, janë vërtet fatlumë në të gjitha aspektet, pasi ata janë të motivuar, të frymëzuar dhe vazhdimisht të prirur për të punuar me përkushtim.

Drejtesit toksik, sipas emrit përcaktohet si “drejtues i cili ka efektin e helmit”, me ndikim negativ në klimë e efektivitet dhe dëm të konsiderueshëm dhe afatgjatë për organizatën.⁵ Në këtë kuadër, lidershi toksik është një bashkim i qëndrimeve egoiste, motiveve dhe sjelljeve me efekt negativ në motivimin e vartësve, performancën e organizatës dhe përmbushjen e misionit. Ky drejtues nuk shqetësohet për të tjerët dhe as për klimën e organizatës, e cila çon në efekte negative afatshkurtra dhe afatgjata. Drejtuesi toksik sillet me kapadaillëk, vetëvlerësim të tepruar dhe orientohet nga interesi vetjak. Ai përdor vazhdimisht sjellje të dyshimta për të mashtruar, frikësuar, shtrënguar ose ndëshkuar padrejtësisht të tjerët për të arritur synimet e tyre. Këta drejtues krijojnë një klimë negative që përmbush kërkesat afatshkurtra, duke operuar në

³ <https://bota.al/nga-cbrume-formohet-nje-lider-nje-manual-per-udheheqes-moderne/>

⁴ Daniel Goleman, *Inteligjenca Sociale*, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2022, ISBN: 978-9951-817-46-2, faqe 328.

⁵ Jean Lipman-Blumen, *The Allure of Toxic Leaders: Why We Follow Destructive Bosses and Corrupt Politicians – and How We Can Survive Them*, New York: Oxford University Press, (2005), faqe 17-18.

nivelet fundore të vazhdimësisë së angazhimit, ku vartësit i përgjigjen pushtetit të pozitës së drejtuesit të tyre për të përmbushur kërkesat. Këta drejtues mund të arrijnë rezultate për një kohë të shkurtër, por ata nuk i përfillin kompetencat e tjera në fushat e drejtimit dhe zhvillimit⁶. Klima negative për një kohë të gjatë do të ndikojë duke minuar vullnetin, iniciativën dhe potencialin e vartësve dhe do të shkatërrojë moralin e njësisë.

Pavarësisht perceptimit të drejtuesit toksik, ndikimi i tyre është negativ. Studimet kanë treguar se njerëzit që punojnë nën varësinë drejtuesve toksikë shprehen për nivel të ulët kënaqësie në punë dhe një demotivim të tejskajshëm.

2. Karakteristikat dalluese të lidërshit toksik

“Kujdesi për njerëzit është problemi kryesor i drejtuesit, në qoftë se do t’i neglizhohë ata, me siguri ai do të dështojë”⁷.

Në kulturat e dobëta, njerëzit gjejnë siguri të rregullat. Kjo është arsyeja pse kemi burokratë. Ata besojnë se respektimi i rreptë i rregullave u jep atyre siguri në punë. Gjatë procesit, ata dëmtojnë besimin brenda dhe jashtë organizatës. Në kulturat e forta, njerëzit gjejnë siguri te marrëdhëniet. Marrëdhëniet e forta janë themeli i ekipeve me performancë të lartë. Dhe të gjitha ekipet me performancë të lartë fillojnë me besimin⁸. Nëse punonjësve (vartësve) nuk u pëlqejnë drejtuesit e tyre, atyre u ka humbur besimi dhe për pasojë, ata do të largohen edhe sikur të paguhen mirë, të marrin vlerësime, të kenë mundësi që të mësojnë më shumë apo të ecin më tej. Në fakt, antipatia për drejtuesin është një nga shkaqet kryesore për humbjen e njerëzve të përkushtuar. Le ta ilustrojmë me një intervistë, e cila është bërë përpara largimit të një punonjësi nga puna:

Intervistuesi: Methju, pse vendosët që të largoheni nga organizata? Mesa di unë, ju paguajmë po aq mirë ose më mirë nga ç’paguajnë të tjerët. Madje ju sapo keni marrë një shtesë rroge.

Methju: Mund të kem besim tek ju?

Intervistuesi: Absolutisht po.

Methju: Paga është e mirë, po kështu edhe puna. Por **drejtori im është i vështirë**. Është e pamundur që të punosh me të. I dhashë drejtim, pasi jeta është tepër e shkurtër dhe nuk mund ta kaloj duke punuar për një plehrë.

Tabela nr. 1⁹

⁶ US Army Doctrinal Publication 6-22. Army Leadership, August 2012, faqe 3.

⁷ John G. Meyer, *Komandimi i kompanisë*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 113.

⁸ Simon Sinek, *Loja e pafundme*, Shtëpia Botuese “Minerva”, viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5, f. 142.

⁹ Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, *Duajini punonjësit, që të mos i humbisni*, botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3, faqe 150.

Ky dialog domethënës nxjerr në pah rolin shkatërrues të një drejtuesi toksik në organizatë. Gjithashtu, ndër vite janë zhvilluar sondazhe, intervista apo studime të ndryshme për të vënë në dukje dëmin që shkakton drejtuesi toksik në organizatën që drejton. Kështu, nga një sondazh i zhvilluar me 50 000 persona, një në tre të intervistuar e përshkruan drejtuesin e tyre si një “makth”, ndërsa 11% të tjerë, me shumë mirësjellje, u shprehën për drejtuesin e tyre se ishte “njeri i vështirë në punë”. Një studim tjetër ka treguar se pas 20 vjet kërkimesh dhe 60 000 intervistash përpara largimit nga puna, 80% e ndërrimit të plotë të stafit lidhet me marrëdhëniet e pakënaqshme me drejtuesin.¹⁰

Në vitin 2009, u zhvillua një studim mbi vrazhdësinë në vendin e punës me disa mijëra menaxherë dhe punonjës të anketuar nga një gamë e gjerë kompanish amerikane. Ata që shërbenin në një klimë negative apo drejtim toksik shprehnin zemërimin, zhgënjimin, dhe nganjëherë dëshirë për hakmarrje. Studimi tregoi se: 48 % kishin ulur përpjekjet në punë, 47 % zvogëluan kohën e punës, 38 % ulën cilësinë e punës, 66 % pohuan se kishte rënë performanca e tyre, 80 % humbnin kohë me shqetësimet, 63 % humbnin kohë për të shmangur gabimet, 78 % pohonin se përkushtimi për organizatën kishte rënë.¹¹ Po kështu, një studim i para disa viteve i Gallup-it arriti në përfundimin se drejtuesit përbëjnë 70% të ndryshimeve në rezultatet e angazhimit të vartësve dhe vetëm 13% e vartësve janë gjithmonë njëloj të angazhuar.¹²

Nga autorët e librit “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” janë pyetur dhjetëra vetë se si veprojnë drejtuesit e bezdisshëm dhe përgjigjet për sjelljet e tyre janë nga më të ndryshmet. Disa nga sjelljet e tyre¹³ më tipike në marrëdhënie me vartësit janë: poshtërojnë, veprojnë me arrogancë, nuk bëjnë lëvdata, përplasnin dyert e godasin fort tryezat, sillen pa edukatë, zhvlerësojnë vartësit përpara të tjerëve, punojnë që t’ua bëjnë qejfin eprorëve, nuk interesohen për punën bazë, bëjnë komente negative, çirren me zë të lartë ndaj vartësve, veprojnë kundër rregullave, tregojnë mungesë respekti, sillen sikur janë më të mirë apo më të zgjuar se gjithë të tjerët, mbajnë për vete informacion me rëndësi vendimtare, e nisin çdo fjali me “unë”, ua rrëmbejnë meritën ose qendrën e vëmendjes të tjerëve, nuk u besojnë shumicës së punonjësve, tregohen të anshëm, i vënë të tjerët në pozitë të vështirë, e përdorin ironinë me

¹⁰ Saratoga Institute, Santa Clara, Calif, 2000.

¹¹ Christine Porath and Christine Pearson, *How Toxic Colleagues Corrode Performance*, Harvard Business Review, April 2009. Shih: <http://kaplanmarketing.com/wp-content/uploads/2010/10/toxic-colleagues1.pdf>. (Ardian Lilo, leksion, “Klima e komandimit dhe etika e udhëheqjes”, Tiranë, dhjetor 2015, faqe 22).

¹² Randall Beck and Jim Harter, *Why Great Managers Are So Rare*, Gallup Business Journal, 25 March 2014. Shih: <http://gallup.com/businessjournal/167975/why-great-managers-rare.aspx>

¹³ Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, *Duajini punonjësit, që të mos i humbisni*, botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3, faqe 153-154.

tepri, vendosin objektiva ose afate të pamundura, asnjëherë nuk e pranojnë fajin, i lënë të tjerët të marrin goditjen, tregojnë mungesë interesimi për vartësit, kanë “humor të paqëndrueshëm” (kur ndihen keq ua shkarkojnë të tjerëve), janë hakmarrës, nuk ua vënë veshin të tjerëve, kërkojnë përsosmëri, ndërpresin vazhdimisht, bëjnë vërejtje “të hidhura”, i shkelin premtimet etj., etj. Jo më kot Xhon Kigani citon se studimet mbi sjelljet shqyrtojnë rolin që luan një drejtues për të nxitur të tjerët që të ndryshojnë bindjet dhe për t’i detyruar ata të veprojnë ashtu siç dëshiron ai.¹⁴ Sigurisht ndryshimet mund të jenë për mirë (drejtues pozitiv) apo për keq (drejtues negativ).

Gjithashtu, janë paraqitur një sërë modelesh për të kategorizuar mënyrat e ndryshme të lidrshipit të keq, që nga veprimet aktivisht shkatërruese, deri tek mënyrat më pasive. Në vijim do të paraqesim shembuj të ndryshëm të disa sjelljeve¹⁵ që i kanë orientuar studiuesit të përkufizojnë një drejtues toksik. Secila nga këto sjellje, zakonisht ka efekte negativë tek veprimtaritë dhe individët, por këto efekte negativë mund të ndryshojnë në formë dhe në masë. Gjithsesi, rezultati i përbashkët përfundimtar i këtyre efekteve është ndikimi negativ në plotësimin e nevojave për kompetencë, autonomi dhe përkatësi, krahas pasojave të tjera negative si pasiguria, stresi apo madje dhe lëndimi fizik. Ju mund të vlerësoni vetë se si do ta përfjetonit të punuarit nën udhëheqjen e një personi, që shfaq një nga modelet e sjelljeve të paraqitura më poshtë.

- Lidrshipi artificial i referohet mospërrputhjes midis fjalëve dhe veprave, mosmbajtja e premtimeve, trajtimi i të tjerëve në mënyrë të padrejtë, mbajtja për vete e informacionit, marrja e meritave nga puna e të tjerëve, përparësi kanë nevojat e veta përpara të të tjerëve. Efekti negativ që lidrshipi artificial ka te ndjekësit është që dëmton besimin te drejtuesi.
- Lidrshipi despotik vepron për të shtypur dhe ulur të tjerët, është ekstremisht autoritar dhe mund të bëjë sulme personale apo të tallet me të tjerët me qëllim që të forcojë pozitën e vet shoqërore.
- Lidrshipi shfrytëzues krijon dhunë ndaj të tjerëve, duke u bërë presion vartësve dhe duke u parashtruar kërkesa të paarsyeshme. Stresi i fortë dhe dyshimi në aftësitë individuale janë pasojat e arsyeshme të kësaj lloji sjelljeje të këtij drejtuesi.
- Lidrshipi kontrollues nuk i përfshin vartësit e tij, por i mbyty, duke i detyruar të kryejnë detyra, nuk u jep aspak hapësirë, komandon në detaje, mbikëqyr dhe u rri mbi kokë të tjerëve, për t’i kontrolluar nëse po e kryejnë punën siç duhet.

¹⁴ Xhon Kigann, *Maska e komandimit*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1996, faqe 5.

¹⁵ Stefan Söderfjäll, *Libri i vogël i Lidrshipit*, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2019, ISBN: 978-9951-721-85-1, faqe 35-41.

- Lidershipi konsumues energjish, kjo ndodh në rastet kur ai e përdor kohën e vartësve në mënyrë joproduktive, duke i konsumuar kështu aftësitë dhe energjitë e tyre në mënyrë të papërshtatshme, kjo sjellje ndikon në dëmtimin e veprimtarisë, për shkak se aftësitë dhe energjitë nuk shfrytëzohen në mënyrë efektive.
- Lidershipi i paafët beson se zotëron njohuri të cilat në të vërtetë nuk i ka, merr vendime jo të mençura, ndërhyr dhe jep udhëzime të papërshtatshme në lidhje me situatën.
- Lidershipi i paqartë (i pastrukturuar) flet pa një kornizë të caktuar, kalon nga njëra temë në tjetrën dhe bën veprime të hutuara, priret të japë udhëzime të paqarta dhe informacione të cunguara dhe e ka të vështirë t'i përmbahet çështjes në fjalë dhe shpesh përdor një gjuhë të ndërlikuar. Rezultati: ndjekësit kanë interpretime të ndryshme për mesazhet e tij.
- Lidershipi shmangës kurrë nuk mban qëndrim, por pajtohet për gjithçka dhe e kthen gëzofin nga fryn era, është kontradiktor, u shmanget përgjegjësi, konflikteve dhe nuk ka guxim të përballët me të tjerët kur është e nevojshme. Nuk i qartëson pritshmëritë, objektivat dhe rolet, nuk është frymëzues për veprime të frytshme. Shumë hulumtime tregojnë se sjellja shmangëse e lidershipit ndikon shumë negativisht në motivim, bashkëpunim, mirëqenie dhe në performancën e vartësve.

Ndërsa Barbara Kellerman-i, në librin e saj “Lidershipi i keq: çfarë është, si ndodh, pse ka rëndësi”, ofron dy pika të favorshme për t’u marrë parasysh në ndërtimin e përkufizimit të lidershipit të keq. Njëra është se drejtuesit e këqij janë të paefektshëm. Drejtuesi joefektiv, sipas Kellerman-it, është thjesht ai që nuk prodhon ndryshimet e dëshiruara nga ndjekësit. E dyta është se drejtuesit e këqij janë jo etikë. Ajo e përkufizon drejtuesin jo etik si atë që “... nuk arrin të dallojë të drejtën nga e gabuara”¹⁶. Në këtë logjikë, Kellerman-i “ndalet” në përcaktimin (tipizimin) e llojeve të drejtuesve negativë, duke i cilësuar me emërtimet: drejtues të paafët; drejtues të ngurtë dhe jo elastikë; drejtues të papërmbytur; drejtues të pashpirt, pa empati dhe ndjenja; drejtues të korruptuar; drejtues izolacionistë, që nuk shkojnë përtej interesave të grupit që përfaqësojnë; drejtues diktatorë¹⁷. Sikur edhe njëra nga këto cilësi të jetë e pranishme, shfaqja e lidershipit quhet negative. Megjithatë, të gjitha pikat konsiderohen negative, katër të fundit (drejtues të pashpirt, të korruptuar, izolacionistë, diktatorë) mbeten shumë më të rrezikshme dhe kanë të bëjnë

¹⁶ Barbara Kellerman, *Bad Leadership: What It Is, How It Happens, Why It Matters*, (2004), f. 34.

¹⁷ Iris Halili, *Lideri nuk lind... bëhet*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-292-67-4, faqe 71.

drejtpërsëdrejti me mungesën e etikës tek drejtuesit. Drejtuesit negativë nuk do të thotë se kanë qenë të tillë gjatë gjithë kohës. Përkundrazi, historia na rrëfen se shpesh ata janë kthyer të tillë me kalimin e kohës dhe kjo ka ndodhur kur ata kanë humbur orientimin e drejtë dhe kanë marrë vendime të gabuara apo i kanë marrë këto vendime jo në çastin e duhur. Ka shumë mënyra për të qenë “drejtues i keq” dhe është e vështirë të llogaritet kostoja e “drejtimit toksik”, gjë që nuk duhet injoruar, por duhet mësuar që ta “eliminojmë dhe trajtojmë atë si ndonjë sëmundje që dëmton, dobëson dhe ndonjëherë edhe vret”¹⁸.

3. Modele dhe shembuj

Ekziston një dallim shumë i madh midis një drejtuesi që vepron në mënyrë të dëmshme në ndonjë rast të veçantë dhe një tjetri që paraqet një model të drejtuesit të dëmshëm si strategji parësore në ushtrimin e atij funksioni. Përpjekja për t’i kënaqur të gjithë dhe nevoja për t’u pëlqyer janë diametralisht të kundërta me drejtimin e mirë. Për këtë arsye, Robert Sutton-i shprehet se dikush që mban një pozitë drejtuese do të ketë raste të vlerësohet dhe përfytyrohet si një njeri “jonormal”.¹⁹ Megjithatë, drejtuesit e mirë nuk do të lejojnë që ky vlerësim për ta, të jetë i paracaktuar dhe pranuar gjithmonë. Vetëm për shkak se eprori ka një ditë të keqe dhe i bërtet një vartësi nuk do të thotë se ai është një drejtues toksik, pasi koha, bazuar në modelin e sjelljes, perceptimin prej vartësve dhe ndikimin e tij në klimën dhe efektivitetin e organizatës do të tregojë se çfarë drejtuesi është. Le të shkojmë më tej, ka raste kur një drejtues mund të jetë i papërmbytur (cilësi negative), por mund të ketë shumë empati, duke përmbytur kështu një nga cilësitë negative. Shtrohet pyetja: Si do ta cilësonim një drejtues që shfaq një apo dy pika të aspekteve negative, por në pikat e tjera është pozitiv?

Ne shohim drejtues me shumë personalitet të cilët janë, pa dyshim, shumë të efektshëm, por edhe problematikë në marrëdhëniet ndërvetjake. Është e vështirë që të diskutosh bëmat e ish-trajnerit të basketbollit Bob Knight. Ai fitoi shumë kampionate dhe kishte një rekord të lakmueshëm fitoresh, pavarësisht nga shpërthimet e tërbimit kur iu hidhte edhe karriget apo në publik kritikonte dhe poshtëronte lojtarët e tij²⁰. Të tjerë shembuj janë gjeneralët e famshëm si Patton ose MacArthur, të cilët shfaqnin prirje për një prototip unik drejtimi të identifikueshëm, të sigurt në vetvete, pa marrëzi, autokratë, autoritarë, nuk mbajnë peng, që nuk duan t’ia dinë për mendimin e të tjerëve, por mbi të gjitha stili i tyre ishte jashtëzakonisht efektiv.

¹⁸ Ardian Lilo, leksion, “Klima e komandimit dhe etika e udhëheqjes”, Tiranë, dhjetor 2015, f. 8.

¹⁹ Robert I. Sutton, *The No Ashole Rule: Building a Civilized Workforce and Surviving One that Isn't*, New York: Warner Business Books (2007), faqe 9.

²⁰ Ardian Lilo, leksion, “Klima e komandimit dhe etika e udhëheqjes”, Tiranë, dhjetor 2015, f. 28.

Le të sjellim në vëmendje një tjetër personalitet, Stiv Jobs-i, themelues i kompanisë gjigante “Apple”. Ndonëse një gjeni dhe krijues i pakonkurrueshëm në llojin e vet, Jobs-i njihej si një karakter narcisist, i papërmbajtur dhe me një sjellje arrogante, që tregonte mungesë të tejskajshme empatie. Përveç këtyre tipareve negative në lidhshpirtin e tij, Jobs-i ka pasur veti të pamata të lidhshpirtit efektiv, sikurse qenë ato të drejtuesit transformues, inovator, mendjehapur dhe me vizion e largpamësi të pakrahasueshme. Falë gjithë këtyre meritave në lidhshpirtin, ai arriti të krijojë një gjigant si “Apple” dhe ta kthejë atë në modelin më unik të teknologjisë botërore, në vetë simbolin e teknologjisë moderne. Drejtpeshimi mes vlerave dhe anti-vlerave na ndihmon të bëjmë edhe përcaktimet përfundimtare për drejtuesit negativë apo shkallën e toksicitetit të tyre.

Ndonëse rastet më tipike janë ato që tregojnë se si drejtuesit nga shumë të admirueshëm janë kthyer në negativë, ka edhe raste të tjera kur drejtuesit më pak të vlerësuar për njëfarë kohe, në një çast historik apo vendimtar kanë ndërmarrë akte historike. Për shembull, Rudi Xhuliani, ish-kryetari i bashkisë së Nju Jorkut ishte në kuotat e tij më të pavlerësuar kur ndodhi tragjedia e rënies së kullave binjake, më 11 shtator 2002. Menaxhimi i kujdesshëm dhe shpirti kurajoz e solidar që ai përcolli në popull e ktheu Xhulianin në një mit dhe drejtues të dashur për të gjithë²¹. Kjo do të thotë se gjykimi i ndjekësve nuk mbetet i pandryshuar, ata vlerësojnë në bazë të asaj që shohin dhe i japin notën drejtuesit në gjithë dinamikën e ngjarjeve dhe veprimtarisë së tij.

Lidhshpirti nuk ka formulë, por mbetet vital si vetë natyra dhe jeta njerëzore. Vendimtare në fatin e lidhshpirtit janë sa personaliteti, karakteri, dijet dhe vendimmarrja, aq edhe rrethanat historike apo situatat e çastit që i japin drejtuesit mundësinë të marrë vendimet më të drejta dhe më të mençura.

4. Drejtuesit duhet të reflektojnë

Do të ishte gabim të sugjerohej se elimini i drejtimit toksik është politikisht korrekt që do të siguronte mënyrën e duhur të drejtimit, ku të gjithë vartësit do të jenë të lumtur dhe të kënaqur dhe misioni nuk do të cenohej. Qasja e duhur e drejtimit është ajo e cila plotëson nevojat e vartësve dhe kërkesat e detyrës sipas situatës. Drejtuesi duhet të ndërgjegjësohet për rëndësinë e aftësive të vetëkontrollit ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, me qëllim që të menaxhojë sa më mirë ngarkesat emocionale. Kontrolli i vetvetes është një virtyt që ka një rëndësi të dyfishtë, praktike dhe morale. Si virtyt praktik, e shpëton nga veprime të pamenduara (të dëmshme) e nga iniciativa të padobishme e të

²¹ Iris Halili, Lideri nuk lind... bëhet, Shtëpia Botuese “Dituria”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-292-67-4, faqe 74.

qortueshme; si virtyt moral, e mëson të veprojë sipas parimeve që i ka vendosur vetes. Njeriu që nuk kontrollon veten me rreptësi bie në një sërë gabimesh. Ai duhet të ushtrojë një kontroll të vazhdueshëm mbi veprimet e veta. Harry Box thekson: “...Pa një kontroll të përpiktë, jeta bie nën pushtetin e ngjarjeve të papritura. Mbrohu nga e papritura. Paralizojë rastin...Duhet të dominosh përmes një kontrolli sistematik e vigjilent të gjithë elementet që hyjnë në jetën tënde. Ti duhet ta mbikëqyrësh veten: bëhu një mendje e kthjellët, një vetëdije aktive, një vullnet gjithmonë e në rritje, të dish se çfarë do të bësh e cilin qëllim do të arrish; Ngjarjet nuk do të befasojnë më”²². Është e natyrshme që do të ketë çaste kur drejtuesi do të ngrëjë edhe zërin, pasi zemërimi me masë është i justifikuar, por duhet të mbajë parasysh këshillën e Aristotelit: “Të gjithë mund të zemërohem. Kjo nuk është e vështirë. E vështirë është të zemëroresh me njeriun e duhur, në masën e duhur, në kohën e duhur, për qëllimin e duhur dhe në mënyrën e duhur”²³. Gjithashtu, drejtuesi jo rrallëherë duhet të kërkojë prej vartësve gjëra të vështira, sfida apo zbatimin e projekteve të reja dhe të adresojë problemet e performancës së tyre, pa pasur mundësinë dhe luksin për t’i kënaqur të tërë gjatë gjithë kohës. Drejtuesit nuk duhet t’i hamendësojmë si “perëndi” apo të pagabueshëm, por njerëz, të cilët kanë anët e tyre të dobëta që në çaste të caktuara dhe mund t’i “nxjerrin jashtë vetes” me dashje ose pa dashje. Pyetja është: “Sa herë mund të ndodhë kjo dukuri?”, “Çfarë efekti ka sjellja e tij tek vartësit që punojnë për të?”. Mirëpo sjelljet prej njeriu “mistrec”, shpeshherë bëjnë që drejtuesi të rrezikojë shumë që t’i “ulen pikët” në përballje me vartësit dhe të zhvlerësojë të gjitha anët e tjera të forta, që zotëron ose edhe më keq, të humbasë njerëzit e talentuar e të përkushtuar për të cilët organizata dhe misioni i saj ka nevojë.

Është mirë që drejtuesi, në periudha të caktuara duhet të bëjë “kontrollin 360-gradësh” që nënkupton marrjen e vlerësimeve dhe komenteve të plota në të gjitha drejtimet (drejtuesi epror, kolegët/bashkëpunëtorët, vartësit). Është e mira që komentet nga vartësit e bashkëpunëtorët të jenë anonimë. Ato duhet të përdoren për ta vënë në dijeni për sjelljet jo të mira (toksike), me qëllim që të marrë masa për të ndryshuar. Mike Mears në librin e tij “Elementet e Lidershipit” shprehet se pranimi i gabimeve është hapi i parë i marrjes së përgjegjësisë dhe i shmangies së gabimeve të njëjta në të ardhmen. Mospranimi i tyre të çon në mohimin apo refuzimin e gabimeve të dukshme e komplekse dhe në humbjen e besueshmërisë.²⁴

²² Harry Box, Arti i imponimit, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999, faqe 97-98.

²³ Daniel Goleman, *Inteligjenca emocionale*, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, faqe 9.

²⁴ Mike Mears, *Leadership Elements, a guide to building trust*, iUniverse, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 92.

Nëse drejtuesi pranon gabimet, nëse ai vlerëson vërejtjet e kolegëve dhe të vartësve, ai rrit autoritetin dhe respektin e tij. Është e mira që ai të marrë sa më shumë mendime nga vartësit e tij. Parësore për një drejtues është që të vlerësojë mendimet e të tjerëve dhe të besojë se ato janë me vlerë. Nëse nuk e beson këtë, i ka duart e lidhura. Është mirë që drejtuesi t'i bëjë vetes këto pyetje:

A jam i qëndrueshëm emocionalisht? Njerëzit që kanë mungesë besimi dhe merakosen për statusin, pozitën apo fuqinë e tyre, kanë prirje të mos pranojnë mendimet apo vlerësimet e të tjerëve, të mbrojnë “terrenin” e tyre dhe t'i mbajnë larg njerëzit. Duhet të jesh një njeri i sigurt që të marrësh parasysh idetë e të tjerëve.

A i vlerësoj njerëzit? Nuk ke se si të vlerësosh idetë apo vlerësimet e dikujt nëse së pari nuk e vlerëson atë vetë si person. A e ke analizuar ndonjëherë sjelljen tënde kur je me njerëz që i vlerëson dhe kur je me ata që nuk i vlerëson? Le të shohim dallimet e mëposhtme:

Nëse i vlerësoj njerëzit	Nëse nuk i vlerësoj njerëzit
o Dua të kaloj kohë me ta	- Nuk dua të rri me ta
o I dëgjoj	- Refuzoj t'i dëgjoj
o Dua t'i ndihmoj	- Nuk u jap ndihmë
o Ndikohem prej tyre	- I shpërfill
o I respektoj	- Jam indiferent

Tabela nr. 2²⁵

E rëndësishme është që drejtuesi të vlerësojë procesin. Botuesi Malcolm Forbes pohoi: “T’i vësh veshin një këshille shpesh të ndihmon më shumë se vetëm ta dëgjosh”. Duhet të jesh i hapur ndaj vlerësimeve apo komenteve në adresën tënde. Përveç kësaj, drejtuesi duhet të praktikojë një mënyrë analize dhe të menduari jo egoiste, pasi kjo mund të ndryshojë qasjen se si e përcakton suksesin. Mënyra e të menduarit jo egoiste²⁶ sjell vetëm të mira për drejtuesin: e plotëson si person; bën që të vlerësojë të tjerët; inkurajon virtytet e tij; e bën pjesë të diçkaje më të madhe se vetja etj.

Në të njëjtën kohë, drejtuesit eprorë duhet të jenë vigjilentë për prirjet toksike të drejtuesve vartës dhe duhet të ndërhyjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke ju

²⁵John C. Maxwell, *Si mendojnë njerëzit e suksesshëm*, Shtëpia Botuese “Bota shqiptare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0, faqe 179.

²⁶ Po aty, faqe 187.

thënë: “Vartësit tuaj urrejnë të punojnë për ju; ju perceptoheni prej tyre si njeri i vogël, abuzues dhe i fokusuar vetëm në promovimin e vetes” dhe të kërkojnë ndryshimin duke ofruar njëkohësisht mbështetje.

Opinionet e shumta do të japin një pasqyrë më të qartë për të bërë dallimin midis asaj që je dhe se si duhet të jesh. Nëse është dëshira e mirë për reflektim, “sëmundja” do të shërohet. Në të kundërtën, ju do të mbeteni “i sëmurë” dhe sjellja juaj, do të vijojë jo vetëm të lëndojë vartësit e bashkëpunëtorët tuaj, do të shkatërrojë organizatën, por gjithashtu do t’ju dëmtojë edhe më tepër juve si drejtues. Në këtë kuadër, P. Smith këshillon: *“Drejtuesit duhet të jenë të aftë të shikojnë me objektivitet brenda vetes dhe të analizojnë ku kanë bërë gabime, ku u kanë mbyllur rrugën njerëzve dhe ku i kanë çuar në rrugë të gabuar. Ata duhet të jenë të vendosur “të shihen në pasqyrë” dhe të përcaktojnë çfarë kanë bërë drejt e çfarë kanë bërë gabim sot, cilit vendim duhet t’i rikthehen, sa të afrueshëm kanë qenë me njerëzit etj... Shpirti i vogël nuk krijon drejtues të mëdhenj”*²⁷.

Reflektimi është një terapi e domosdoshme pasi shërben si një lloj “feedback-u” që i shërben përmirësimit vetjak dhe që duhet të kthehet në një zakon pune për çdo drejtues. Gjetja dhe pranimi i elementeve toksike te vetja kërkon jo vetëm një karakter të fortë, por edhe guxim e vullnet. Pranimi i gabimeve apo i ekzistencës së “qelizave helmuese në trup” nuk ia ul vlerat një drejtuesi, por përkundrazi e lartëson para vartësve dhe i ngre “stekën” e përvojës, duke pakësuar rrugët që të çojnë në drejtim të gabuar.

Në vend të mbylljes

Ka shumë drejtues të talentuar të aftë që menaxhojnë operacione, por aftësitë e shkëlqyera drejtuese nuk bazohen vetëm tek aftësitë e shkëlqyera operacionale. Drejtimi nuk është e njëjta gjë me të qenit drejtues. Të qenit drejtues do të thotë që postin më të lartë e mbani ose në sajë të meritave, fatit të mirë, ose nga drejtimi i politikave të brendshme. Megjithatë të drejtosh do të thotë që të tjerët të ndjekin vullnetarisht – jo sepse u duhet ta bëjnë këtë, jo se paguhet për këtë, por sepse duan²⁸. Vetëm ata që udhëheqin janë në gjendje ta bëjnë këtë gjë, pasi ata që ndjekin besojnë se vendimet e marra në nivelet e larta kanë për zemër interesat më të mira të grupit. Për rrjedhojë, ata që kanë besim punojnë shumë, pasi kanë ndjesinë se po punojnë për diçka më të madhe se vetvetja.

²⁷ Perri Smith, *Përgjegjësia*, Shtëpia Botuese e Ushtisë, Tiranë 1994, faqe 30-31.

²⁸ Simon Sinek, *Fillo me pse, si liderët e mëdhenj frymëzojnë këdo që të veprojë*, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2019, ISBN: 978-9928-261-16-1, faqe 101.

Përfundime

Studimi i lidershipit toksik merr një rëndësi të veçantë sepse i bën qartësisht të dallueshëm sjelljet e tyre, duke përcaktuar modelet tipike të drejtuesve të tillë. Prandaj angazhimet apo hulumtimet e studiuesve në këtë fushë janë njëlloj analize për të kurrar “sëmundjet toksike” nga më të lehtat deri tek më të rëndat.

Drejtuesit e këqij shfaqen në forma të ndryshme, por pasojat e zbatimit të tyre kanë të përbashkët faktin që ndikojnë negativisht në motivim, performancë dhe në mirëqenien e vartësve. Ky lloj drejtuesi mund të jetë shumë aktiv (modeli diktator, shfrytëzues) ose pasiv (modeli shmangës). Por gjithsesi, ajo që i tipizon ata është se kanë një mungesë e dukshme shqetësimi ndaj vartësve, paraqesin një personalitet që ndikon negativisht në klimën e organizatës dhe tek vartësit krijohet një bindje për ta se në çdo kohë, parësor kanë interesin vetjak. Të tillë drejtues janë të përqendruar në arritje të vogla afatshkurtra.

Është e rëndësishme që strukturat përkatëse në organizata t’u kushtojnë rëndësi procedurave të rekrutimit, në mënyrë që të zvogëlojnë rrezikun e marrjes të drejtuesve toksikë. Gjithashtu, ata duhet t’i identifikojnë drejtuesit e këqij ekzistues, në mënyrë që t’i ndihmojnë të veprojnë në mënyrë konstruktive ose t’i largojnë nga pozicioni i drejtuesit sa më parë. Ndjekësit duhet ta shqyrtojnë mirë nëse ia vlen të sakrifikohesh për një drejtues të keq, ndërsa drejtuesit e këqij duhet të kenë aftësinë dhe të gjejnë brenda vetes forcën për të ndryshuar sjelljet e tyre.

Bibliografia

1. Jean Lipman-Blumen, “The Allure of Toxic Leaders: Why We Follow Destructive Bosses and Corrupt Politicians – and How We Can Survive Them”, New York: Oxford University Press, (2005).
2. Harry Box, “Arti i imponimit”, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999.
3. Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7.
4. Daniel Goleman, “Inteligjenca sociale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2022, ISBN: 978-9951-817-46-2.
5. Iris Halili, “Lideri nuk lind... bëhet”, Shtëpia Botuese “Dituria”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-292-67-4.
6. Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni”, botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3.

7. Xhon Kigann, “Maska e komandimit”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1996.
8. Ardian Lilo, Leksion, “Klima e komandimit dhe etika e udhëheqjes”, Tiranë, dhjetor 2015.
9. John C. Maxwell, “Si mendojnë njerëzit e suksesshëm” Shtëpia Botuese “Bota shqiptare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0
10. Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, iUniverse, Inc. New York Bloomington 2009.
11. John G. Meyer, “Komandimi i kompanisë”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.
12. Simon Sinek, “Fillo me pse, si liderët e mëdhenj frymëzojnë këdo që të veprojë”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2019, ISBN: 978-9928-261-16-1.
13. Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5.
14. Perri Smith, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë , Tiranë 1994.
15. Stefan Söderfjäll, “Libri i vogël i Lidershit” Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2019, ISBN: 978-9951-721-85-1.
16. Robert I. Sutton, “The No Ashole Rule: Building a Civilized Workforce and Surviving One that Isn’t”, New York: Warner Business Books (2007).
17. US Army Doctrinal Publication 6-22. Army Leadership, August 2012.
18. <https://bota.al/nga-cbrume-formohet-nje-lider-nje-manual-per-udheheqes-moderne/>

Forca e armatosur si formë e dhunës institucionale.

Një qasje teorike me bazë vende të demokracive liberal-demokrate

Nënkolonel Latif SHURDHI

Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Në këtë punim trajtohet forca e armatosur si një formë e dhunës institucionale që mund të përdoret për të forcuar autoritetin, për të fuqizuar sigurinë kombëtare ose për të qetësuar apo vendosur nën kontroll shpërthime të brendshme të dhunshme. Natyrisht që përdorimi i saj mund të ketë edhe pasoja negative në shoqëri, duke përfshirë shkeljen e të drejtave të njeriut dhe eskalimin e konflikteve. Është e rëndësishme që institucioni i përdorimit të dhunës dhe individët mbartës së detyrave funksionale të institucioneve të tilla të jenë të kujdesshëm në ushtrimin e këtij funksioni duke respektuar ligshmërinë kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Për të krijuar qartësi për lexuesin duhet të sjellim një përkufizim se çfarë janë forcat e armatosura. Forcat e armatosura duke i parë në kuptimin social të konceptit nga pikëpamja numerike e anëtarëve të saj janë një organizatë dhe nga pikëpamja e normave dhe vlerave që ata përfaqësojnë, janë një institucion. (...) Institucioni është një vendosje e normave të ndërlidhura dhe roleve që rregullojnë një fushë të jetës shoqërore¹.

¹ Latif Shurdhi, *Forcat e Armatosura dhe familja si "greedy institutions"*. Revista Ushtarake, nr. 2/2014, Tiranë, gusht 2014, fq.130.

Sa i përket përkufizimit të konceptit “dhunë” dhe ndërlidhjes së këtij koncepti me institucionin e forcës së armatosur, i cili po ashtu nënrenditet në formën e një instrumenti në raport me shtetin, do të njihemi më poshtë gjatë trajtimit në fjalë. Po ashtu do të shikojmë ndërlidhjen e një sërë konceptesh me forcën e armatosur; si dhe veçori e karakteristika të saj, të cilat në sociologji kanë rëndësi për bërjen e dallimeve mes koncepteve dhe përkufizimeve të tyre.

Në mënyrë tepër të përmbledhur në këtë artikull do të gjeni të shpjelluar forcën e armatosur si formë të dhunës institucionale; dhunës shtetërore dhe praktikës shoqërore; praktikën shoqërore në forcë të armatosur; hierarkinë dhe rëndësinë e saj për këtë institucion; kolektivin ushtarak me karakteristikat e tij; si dhe disa përfundime dhe perspektiva në lidhje me forcën e armatosur.

Fjalët kyçe: forca e armatosur, *homo militaris*, kolektiv ushtarak, dhunë institucionale, hierarkia, etj.

1. Homo militaris, formë e dhunës institucionale

Forca e armatosur është një fushë sociale dhe institucion politike², e cila organizon dhunën (ushtrimin e dhunës) ndaj vendeve të tjera, mbron vendin nga dhuna që ushtrohet nga jashtë dhe mban mjete të gatshme për mbrojtjen e rendit të brendshëm sipas nevojës dhe gjendjes juridike. Në këtë institucion ndodh një integrim i raportit të tensionit të racionalitetit burokratik vertikal dhe të gjithë komunitetit profesional horizontal. Karakteri korporativ ushtarak përbëhet nga mekanizmat e logjikës burokratike dhe referencat e nënkuptuara të vlerave dhe virtyteve aristokrate-luftarake.

Për shkak të shkrirjes specifike të organizimit dominues dhe profesionit të ushtarakut, forca e armatosur mund të karakterizohet si një korporatë dhune. Dhuna ushtarake është një e “mirë kolektive” e ofruar nga forca e armatosur, e cila për këtë arsye, ndryshon nga shoqëria civile. Veçoritë e skicuara këtu përshkruajnë kushtet kornizë, brenda të cilave formohen format e praktikës shoqërore të fushës ushtarake, në të cilën prodhohet dhe riprodhohet dhuna (sipas Max Weber) dhe kultura ushtarake në kuptimin e praktikës sociale (sipas Pierre Bourdieu). Prandaj korniza e analizës sociologjike e kësaj shkon përtej forcës së armatosur si organizatë dhe përfshin gjithë shoqërinë, sepse organizmat dhe organizatat shoqërore kuptohen në të njëjtën mënyrë si forca e armatosur, si instrumente racionale-qëllimore për vënien në jetë të objektivave funksionale, ndërkohë që ata prezantojnë të paktën sisteme simbolesh apo

² Grhard Goehler, *Institutionenlehre und Institutionentheorie in der deutschen Politikwissenschaft nach 1945: Grundfragen der Theorie politischer Institutionen. Forschungsstand, Probleme, Perspektiven*, Opladen 1987.

domethëniesh³.

2. Dhuna shtetërore dhe praktika shoqërore.

Që nga vitet 1960, Renate Mayntz ka vënë në dukje se modeli racional organizativ i sociologjisë klasike ka injoruar kontekstin *Maxweberian* të sociologjisë së pushtetit të trajtimit burokratik, dhe në këtë mënyrë nuk ka dalluar që *Max Weber*, burokracinë dhe pushtetin i kupton si dy parime, që qëndrojnë gjithmonë të tensionuara me njëra-tjetrën⁴. Prej këtej bëhet e qartë që fillimisht organizatat duhet të kuptohen si fusha të forcave shoqërore, në të cilat konkurrohet për realizimin e qëllimeve të ndryshme e nga një herë të kundërta. Strukturat organizative formohen nga rregullat e drejtpërdrejta dhe të nënkuptuara, si dhe nga shpërndarja e kapitalit ekonomik, social, kulturor e simbolik në kuptimin e trajtimeve të *Bourdieu*. Këto lloj kapitalesh përfaqësojnë një instancë të pushtetit shoqëror dhe shërbejnë si bazë për legjitimimin e pushtetit.

Forca e armatosur, si mjet i vetë ekspozimit të shtetit në botën e jashtme, por edhe të brendshme, është institucion politik nga njëra anë dhe formë e qartë e dhunës së institucionalizuar nga ana tjetër. Poseduesi i organizatës së forcës së armatosur është shteti, të cilin *Weber*-i e kupton si organizatë që ka pushtetin, sepse çdo shtet si institucion shtrëngues (detyrues) bazohet tek dhuna, dhe dhuna fizike si mjet specifik është monopol i tij⁵. Forca e armatosur dhe parimet e saj lidhen ngushtësisht me shtetin. Pyetja kryesore që shtrohet këtu është se, cilat struktura e lejojnë atë që urdhrat e drejtuesit të ekzekutohen me humbjet më të vogla të mundshme të shkaktuara nga fërkimet e aparatit?! Kësaj kërkesë, sipas *Weber*-it, do t'i përshtatej vetëm burokracia moderne rationale, e cila në tipin e pastër të saj përfaqëson një sistem të veprimeve qëllimore-racionale të ndërlidhura me njëra-tjetrën, për lindjen dhe shpalosjen e të cilave ndër të tjera paraqet një kusht, atë të përqendrimit të burimeve materiale në duart e punëdhënësit.

Kështu burokratizimi historik i forcës së armatosur është themelor për kuptimin e saj si instrument politik i dhunës shtetërore. Koncepti i dhunës institucionale integron dhunën aktuale dhe eventuale (sipas *Weber*-it), si dhe dhunën simbolike (sipas *Bourdieu*) dhe përkufizohet nga sociologu *Peter Waldman* si më poshtë: “Koncepti i dhunës institucionale (...) në këtë kuptim

³ Ulrich vom Hagen, *Homo Militaris. Perspektiven einer kritischen Militärsoziologie*, Bielefeld 2011.

⁴ Renate Mayntz, *Soziologie der Organisationen*, Reinbek, fq. 32.

⁵ Max Weber, *Wirtschaft und Gesellschaft. Grundriss der verstehenden Soziologie*, Tübingen, 1972 (1921).

shkon përtej kuptimit personal të drejtpërdrejtë të dhunës. Ai nuk fokusohet vetëm në modalitetet specifike të veprimtarisë shoqërore, por edhe në raporte të vazhdueshme varësie dhe bindjeje. Dhuna mund të përkufizohet si një pushtet që disponohet përmes sanksioneve fizike, e cila i është dhënë poseduesit të pozicioneve hierarkike ndaj vartësve të tij. (...) Prototip i dhunës institucionale në kohët moderne është kërkesa për njohje e bindje me të cilën shteti përballet me individin”⁶.

Prandaj mund të pohojmë se dhuna institucionale përmbledh dhunën shtetërore. Kështu që karakteristikat e monopolit të dhunës dhe dhunës shtetërore, si ato të forcës së armatosur, janë forma e dhunës institucionale dhe e kulturës së saj.

3. Praktika shoqërore në forcën e armatosur

Për të përcaktuar kulturën e forcës së armatosur është e domosdoshme të shkëputemi nga homogjeniteti i supozuar shpesh për atë dhe të shtrojmë pyetjen se për çfarë bëhet fjalë në të vërtetë në fushën e saj. Pra shtrohet pyetja për përkufizimin e thelbit të forcës së armatosur të një vendi, dhe në varësi të pranimi të këtij përfytyrimi për shanset në karrierën ushtarake. Në frymën e korpusit shprehet njëkohësisht kohezioni, por edhe konformizmi i atyre që kanë arritur tashmë të gjejnë pranim në botën shoqërore të forcës së armatosur. Këto mekanizma përbëjnë karakterin “korporativ” të forcës së armatosur. Po ashtu në forcën e armatosur gjenden nënkultura, veçanërisht tek forcat përbërëse kryesore (forcë tokësore, detare dhe ajrore), tek specialitetet e veçanta të forcës tokësore, ose në formën e grup-gradave (oficer, nënoficer, ushtar), si dhe me anë të dallimit mes trupave në atdhe dhe në mision jashtë vendit.

Konfliktet që lindin mes aktorëve dhe grupeve të veçanta në fushën shoqërore mbështeten në antagonizmin specifik të fushës në lidhje me mundësitë e shfrytëzimit të kapitalit shoqëror, kulturor, simbolik dhe ekonomik. Prandaj, është ndihmuese që forca e armatosur, ashtu si fushat e tjera, të shikohet si një fushë loje, në të cilën garohet për fuqi interpretimi dhe kjo gjeneron një habitus të caktuar, i cili lejon përshtatje të vetëkuptueshme e të natyrshme me rregullat e lojës së fushës specifike.

Si pjesë e aparatit shtetëror, forca e armatosur posedon domethënie të tejskajshme për sferën politike, sepse aparati shtetëror stabilizon raportet shoqërore të pushtetit. Bazuar në përkufizimin e njohur të *Max Weber*-it shteti zotëron monopolin e pushtetit simbolik legjitim mbi individët që jetojnë në

⁶ Peter Waldmann, *Politik und Gewalt: Dietr Nohlen/Reiner-Olaf Schulze (Hrsg), Lexikon der Politik, Bd. 1: Politische Theorien*, München, 1995, fq. 430.

këtë territor. Legjitimimi i monopolit të pushtetit si në botën jashtë edhe brenda vendit arrihet përmes forcës së armatosur. Forca e armatosur integron përfytyrimin politik të unitetit të popullit, territorit dhe shtetit në një mënyrë unike, saqë asaj i jepet një rol i veçantë rregullvënës dhe ruajtës⁷. Përmes përfaqësimit të kësaj trinomi, forca e armatosur legjitimon shtetin dhe në fund edhe veten e saj.

Logjika burokratike nga njëra anë, ashtu sikundër njëkohësisht referenca tek virtytet dhe udhëheqja ushtarake nga ana tjetër, formojnë modelin e rendit ushtarak. Nga këto krijohet në forcën e armatosur një tension i vazhdueshëm mes realitetit modern, i cili shprehet në disiplinën burokratike që synon sjellje konform rregullave pa marrë parasysh personalitetin e drejtuesit, dhe përfytyrimeve para moderne për figurën e drejtuesit ushtarak, e cila korrespondon me figurën e personalitetit karizmatik me veçoritë individuale specifike të saj. Baza e çdo kulture ushtarake formon këtu “historical model of the Prussian corps”⁸, të cilit i referohen botërisht. Përtej kësaj, strategjia dhe taktika, teknika, vlera, norma dhe virtyti ushtarak bëhet traditë dhe trashëgohet më tej. Të gjithë organizatat ushtarake kanë të përbashkët arsimimin bazë dhe kurset përmes të cilëve individëve u injektohet kultura ushtarake në formën e një procesi social dhe u mësohet atyre mënyra e jetesës ushtarake. Gjatë këtij procesi ushtarakët, ndër të tjera, instruktohen për hierarkinë, burokracinë, rregullat, ligjet, shoqërinë ushtarake, besimin, besnikërinë, simbolet ushtarake, ritualet, si dhe fjalorët specifike ushtarakë dhe kështu përthithet dhe adaptohet kultura e disiplinës ushtarake, e cila gjendet në të gjitha organizatat ushtarake⁹. Përmes misionëve ushtarake të përbashkëta shumëkombëshe jashtë vendit dhe takimit me ushtarakë të forcave të armatosura të vendeve të ndryshme, garantohet më mirë se kurrë vazhdimësia historike e bazës së kulturës ushtarake.

Kultura ushtarake pasqyrohet në veprimtarinë e ushtarakëve, e cila rigjendet në rregullat dhe rregullsinë e kësaj fushe sociologjike. Ushtarakët instruktohen gjatë formimit bazë dhe gjatë shërbimit të tyre ushtarak për parimet specifike ushtarake, të cilat përmbledhin ndër të tjera bindjen dhe teknikat e plagosjes dhe vrasjes. Ata gjatë procesit formues edukohen me vlerat ushtarake si p.sh. disiplina, besnikëria, guximi, sakrifica dhe vetëmohim. Përveç kësaj një rol

⁷ Klaus Ender, *Multikulturalität als Dilemma* në: Remi Hess/Christoph Wulf (Hrsg) *Grengänge. Über den Eigenen und dem Fremden*, Frankfurt am Mai, New York 1999, fq. 44.

⁸ Eyal Ben-Ari/Efrat Elron, *Blue Helmets and White Armor: Multi-nationalism and Multiculturalism among UN Peacekeeping Forces*. Armed Forces & Society, 2 (2001) fq. 284.

⁹ Joseph Soeters/Donna Winslow/Alise Weibull, *Military Culture*. Guiseppe Caforio (Hrsg) *Handbook of the Sociology of the Military*, London 2003, fq. 250.

një rol qendror luajnë burëria, ndjenja e përkatësisë së përbashkët, si dhe sjellja konform rregullave. Në këtë mënyrë ushtarakët bashkohen rreth një interesi të veçantë në luftën e tyre për objektin e interesit, tek i cili ata besojnë dhe e zotërojnë¹⁰. Hierarkia dhe ndjenja kolektive kristalizohen si elementët kryesorë të përbashkët, të cilët kanë një rëndësi qendrore për përcaktimin e forcës së armatosur dhe kulturës së tyre të veçantë. Brenda harkut të tensionit të këtyre dy elementëve ka forma të tjera, të cilat janë të rëndësishme për praktikën shoqërore dhe ushtarake. Format praktike të fushës ushtarake ndahen në dy dimensione bazë (hierarki dhe kolektiv) me nga tre elemente secila (disiplinë, formalizëm dhe konservatorizëm; segregacion (grupim), maskulinitet (burëri), tradition dhe konvencion).

4. Hierarkia

Forca e armatosur si organizatë shoqërore në themel përbëhet pak a shumë nga një numër i madh luftëtarësh, por fillimisht përmes integritit të fortë të saj në një shtet në shekujt XVII dhe XVIII, lindi kushti i hierarkisë për kalimin nga çeta (grupime) tokësore në forcë të armatosur formale të gatshme. Në vijim të shekullit XIX, forca e armatosur u zhvillua duke u shndërruar më shumë në një organizatë të madhe formale shtetërore. Dhuna apo forca shtetërore mishërohet ndër të tjera përmes forcës së armatosur dhe mund të përdoret jo vetëm në marrëdhëniet e jashtme, por edhe për luftimin e turbullirave të brendshme në varësi të situatës ligjore. Për arsye se forca e armatosur, si rezultat i mbartësit të monopolit të dhunës shtetërore, paraqet vazhdimisht një rrezik për lidhshirësinë politik, ekzekutivi i jep një rëndësi të madhe absorbimit dhe zbatimit me konsekuencë të parimit të primarit të politikës brenda forcës së armatosur. Ky ndodh duke instaluar parimin e urdhrit dhe bindjes në të gjitha nivelet e forcës së armatosur. Urdhri dhe bindja janë pjesë qendrore e hierarkisë së forcës së armatosur, e cila nga disiplina dhe burokracia shtetërore mëson një formë, që do të thotë, një përcaktim formal të praktikave dhe kompetencave.

Si një grup i madh burokratik forca e armatosur formon një hierarki të dallueshme, e cila është shprehje e strukturave autoritare që prodhon një zinxhir të qartë komandim-kontrolli. Njëkohësisht sistemi i statuseve dhe gradave shkakton një distancim shoqëror mes gradave ushtarake, të cilët nuk korrespondojnë vetëm me kompetencat, por edhe me mënyrën e sjelljes që i përshtatet secilit rang.

Ana burokratike e profesionit të ushtarakut i korrespondon tipit ideal të planëzuesit ushtarak (*managerial leader*), i cili ushtron pushtetin në kuptimin

¹⁰ P. Bourdieu, *Sozialer Sinn. Kritik der theoretischen Vernunft* Frankfurt am Main, 1987, f. 124.

e Weber-it kryesisht përmes legjitimitetit racional¹¹. Kësaj i qëndron përballë tipi ideal i drejtuesit ushtarak si luftëtar (*heroic leader*), i cili pushtetin e tij e legjitimon përmes karizmës dhe traditës. Duke pasur para sysh këto dy tipe drejtuesish, procesi i drejtimit në forcën e armatosur sipas grupeve restauruese kuptohet para së gjithash si një koncept i përqendruar tek personi.

Këtu vlen primati i veprave (i realizimit të punëve). Forca e armatosur, si simbol i bashkimit të një populli, territori dhe shteti, zotëron lirisht edhe forcë tërheqëse për të rinjtë me orientime konservative-kombëtare dhe politike të djathta radikale, sepse si rezultat i parimit të urdhrit dhe bindjes, diskutimet dhe liria e ndërgjegjes vlejné si joushtarake. Kurse hierarkia dhe parimet e ndërlidhura me të, si varësia dhe radhitja në strukturën ushtarake, vlejné si të përshtatshme. Qëndrimi dhe tipi i *homo militaris* i përkojnë luftëtarit ushtarak ashtu siç ai mund të gjendet në forcën e armatosur. Rrethanat për të cilat ushtarakët duhet të jenë të përgatitur, që detyrën e tyre ta përmbushin edhe nën kushtet e luftës, kanë për pasojë që pamja ideale e ushtarakut të ndikohet nga detyra e tij për të luftuar. Kështu, ky tip ideal vlen njëlloj për të gjitha ushtritë, pavarësisht nga epoka apo sistemi politik dhe pavarësisht se çfarë mund të thotë imazhi zyrtar i profesionit të ushtarakut të një force të armatosur.

Në një koncept, i cili konsideron drejtuesin ushtarak si gjeneralist dhe ky është imazhi mbisundues për oficerin, takohen së bashku kërkesa të ndryshme për “idetë dhe veprat”. Këtu ekziston tensioni mes racionalitetit modern, disiplinës funksionale dhe rregullshmërisë burokratike nga njëra anë, dhe nga ana tjetër totaliteti i dhunshëm i institucioneve të luftës, si dhe imazhi i ushtarakut si luftëtar. Etosi ushtarak që përbëhet nga përfytyrimi tradicional i imazhit të ushtarakut, i cili buron nga spektri i mendimit konservativ dhe nga virtytet ushtarake të bindjes, besnikërisë, disiplinës, mirësjelljes, drejtësisë, nderit dhe gatishmërisë për sakrifikim, kushtëzojnë karakterin ushtarak. Pikërisht këto orientime ndaj vlerave ushtarake, parimeve dhe virtyteve të gatishmërisë për sakrifikim dhe vetëmohim paraqesin modelin e përfytyruar të veprimit, perceptimit dhe mendimit që mishëron karakterin ushtarak në lidhje me veprimin e përshtatshëm dhe të suksesshëm në forcën e armatosur. Kështu që hierarkia në ushtri është përcaktuar si nga *funksioni* edhe nga *drejtimi*.

Kolektivi ushtarak.

Parimisht në forcën e armatosur vlen motoja që sukcesi i kolektivit qëndron para suksesit të individit. Historikisht në drejtimin e luftës vihet në plan të parë superioriteti numerik i forcave nga njëra anë, dhe nga ana tjetër kolektivi ka rëndësi të madhe për ushtarin sepse ai ofron siguri gjatë luftës. Në këtë

¹¹ Morris Janowitz, *The professional Soldier. A social and political portrait*. New York 1960.

kontekst ideja e shpirtit të kolektivit mund t'i referohet si repartit, apo nënrepartit të drejtpërdrejtë të ushtarit (p.sh kompanisë), por mund të kërkojë vlefshmëri edhe brenda grupit të të njëjtit rang ushtarak. Veçanërisht korpusi i oficerëve dhe nënoficerëve, përtej secilës pjesë të përkatësisë së forcës, kuptohen si bashkësi të së njëjtës pikëpamje në mendim dhe veprim, sepse të dyja janë, të paktën deri më tani, për dy shtresa të ndryshme sociale dhe pozicione të ndryshme brenda hierarkisë. Korpusi i oficerëve në Gjermani dhe shoqëritë e tjera perëndimore nuk rekruton pothuajse aspak nga shtresa e dëshiruar¹² më parë. Ato përbëheshin në Gjermani që nga koha e perandorisë nga shtresat e familjeve të oficerëve, pronarëve të tokave, si dhe nga “grupet e dëshiruara” të borgjezisë së arsimuar (nga familje të nëpunësve të lartë, si dhe të profesioneve akademike e profesioneve të lira).

Për arsye se forca e armatosur, pavarësisht përpjekjeve për integrimin e gjinisë femërore këtu, është një bastion i gjinisë mashkullore dhe vend shoqëror i riprodhimit të maskilitetit, përfytyrimet për imazhin e ushtarakut “të vërtetë” janë të karakterit burrëror¹³. Socializimi njerëzor i ushtarakut është i dukshëm, sepse ushtria është e ndarë ambjentalisht nga shoqëria civile¹⁴.

Në idenë qendrore, që ka forca e armatosur për përkatësinë në kolektivin ushtarak, shprehet në formë simbolike orientimi për shoqërinë e gjinisë mashkullore. Në ambientet, që deri para pak kohësh ishin të rezervuara vetëm për gjininë mashkullore, zhvillohen aktivitete serioze të garave sipas rregullave të koduar mashkullorë. Shoqëria kolektive e një grupimi mashkullor zotëron aftësinë për të siguruar ruajtjen e unitetit të nevojshëm gjatë rasteve konkrete serioze (p.sh gjatë luftimeve). Shoqëria kolektive shërben gjithashtu edhe për formimin e diferencës gjinore.

Përfytyrimet specifike të sjelljes së përshtatshme shoqërohen së bashku me qëndrimin e drejtë. Këto shprehen, ndër të tjera, në etiketa dhe norma të këtij kolektivi, prej të cilave buron përkatësia në një fraksion, ose në një nëngrup brenda një grupi të një rangu. Legjitimimi tradicional i pushtetit sipas Weber-it shprehet përmes zotërimit të stileve dhe formave të sjelljes përkatëse. Këto ngjashmëri me kontekstet e situatave civile ndihmojnë për të mposhtur ose fshehur pasigurinë. Përtej kësaj, rregullat e detyrueshme të sjelljes nën kushtet potenciale të ndarjes nga jeta dhe përdorimit në operacione luftarake marrin

¹² Detlef Bald, *Deutsche Offizier. Sozial- und Bildungsgeschichte der deutschen Offizierkorps im 20. Jahrhundert*. München 1982, fq. 41.

¹³ Ruth Seifert, *Männlichkeitskonstruktionen: Das Militär als discursive Macht. Das Argument*, 196,(1992), fq.859-872.

¹⁴ Jean Lipman-Blumen, *Toward a Homosocial Theory of Sex Roles. An Explanation of the Sex Segregation in Social Institutions*. Signs, 3 (1976), fq. 15-31.

një rëndësi funksionale. Në këtë kontekst, besimi fetar ruan akoma një rol të madh në shumë forca të armatosura të vendeve të ndryshme. Ai vihet në përdorim sidomos kur ndodh një vdekje. Përkujdesja tradicionale fetare në jetën e përditshme të trupës ushtarake nuk ka ndonjë vlerë të madhe, por gjithsesi shërben në trashëgimin e mëtejshëm të virtyteve specifike ushtarake.

Vetë-detyrimi i një trupe profesionale ndaj vlerave dhe normave specifike të përfytyruara për një shërbëtor të shtetit konkretizohet përmes objektivave dhe qëllimeve shtetërore. Etosi i shërbimit ushtarak shprehet jo vetëm në vetë-detyrimin kolektiv profesional për sjellje të moralshme për të mirën e atdheut, por edhe në betimin ushtarak, ku është sanksionuar detyrimi për bindje dhe sjellje të virtytshme. Mbetet për t'u konstatuar nëse në forcën e armatosur disa virtyte kanë ose u jepet një rëndësi më e madhe. Lidhur me profilin e kërkesave të profesionit të ushtarakut, *trimëria* mund të vlejë si *virtut primar* ushtarak, sepse ajo në vetvete reflekton gatishmërinë për luftim dhe vetëmohim në rast se kërkohet¹⁵. Trimëria duhet të kuptohet në një farë mase si guxim i qëndrueshëm, si dhe përballim i patundur i kërcënimeve dhe ngarkesave. *Virtytet sekondare* ushtarake rrjedhin nga kushte të mëtejshme, të cilat janë të lidhura me detyrën e ushtarakut. Në varësi të pozicionit në hierarkinë ushtarake *virtyteve sekondare funksionale* si disiplina, vendosmëria, bindja, qëndrueshmëria, uniteti, sakrifica, guximi dhe forca e gjykimit, u jepet një rëndësi tjetër. Ato në thelb pasqyrojnë kërkesat specifike të detyrave ushtarake. *Virtytet sekondare karakteriale* si sinqeriteti, këmbëngulja, thjeshtësia, urtësia, matura, ndershmëria, qetësia, vetëmohimi, besnikëria, vullneti dhe dinjiteti, zotërojnë ose kanë kërkesa morale të larta. Virtytet sekondare karakteriale formojnë etosin e profesionit të ushtarakut. Këtu bëhet fjalë për një kod sjelljeje të caktuar, i cili mundëson një identifikim të përbashkët mbi vlera të njëjta. Theksimi i veçantë i këtyre virtyteve në ushtri nuk shërben vetëm për vetë-përshkrimin kolektiv, por ndihmon gjithashtu për ta krijuar dhe ruajtur kolektivin. Ato ofrojnë gjithashtu mundësinë për t'i shërbyer ushtarakëve për t'i veçuar nga të tjerët në mënyrë të ndërgjegjshme, ose të pandërgjegjshme.

Në zonat operacionale janë zhvilluar modele sjelljeje e mendimi social-kulturor, si dhe identitete operacionale specifike që kanë ndikuar te forca e armatosur jo vetëm strukturalisht, por edhe socio-kulturalisht¹⁶. Ndarja e ambienteve shoqërore, që për ushtarakët po bëhet gjithnjë e më shumë në operacionet jashtë vendit, po merr një dimension të ri, sepse vendstrehimi

¹⁵ Carl Amery, *Die Kapitulation oder Deutscher Katholizismus heute.*, Reinbek 1963, fq. 12.

¹⁶ Ulrich vom Hagen/Maren Tomforde, *Militärische Kultur*: Nina Leonhardt/Ines-Jacqueline Werkner (Hrsg) "Militärische Soziologie—Eine Einführung", Wiesbaden 2012.

fushor në zonën e operacionit është si një organizatë formale e ushtarakëve, po ashtu edhe një vendbanim për ata. Kufiri mes tre aktiviteteve fjetje, kohë e lirë dhe punë turbullohen dhe shpesh shkrihen në një të vetme. Njëkohësisht ekzistojnë kufij të qartë ndaj shoqërisë civile në kuptimin social dhe gjeografik¹⁷. Në mision ndodh jo vetëm një ndarje e gjithanshme e vendfushimit nga popullsia e zonës së operacionit, por për çdo ushtarak mision do të thotë edhe ndarje nga familja dhe ambienti privat i tij.

Përfundime

Fusha ushtarake zotëron elementë specifike, ku me ndihmën e karakteristikave të saj mund të kristalizojë një kulturë të forcës së armatosur. Këto elementë janë formuar pjesërisht nga kushtet funksionale dhe pjesërisht nga zhvillimet historike. Një perspektivë që dallohet si rezultat i të qenurit i mbyllur dhe siç duket i të qenurit në unitet kolektiv, lejon kuptimin dhe interpretimin e forcës së armatosur si kolektiv heterogjen brenda një shoqërie.

Qasja teorike e propozuar këtu për kulturën ushtarake përqendrohet tek praktikat shoqërore dominuese në ushtri. Për përfytyrimet e vlefshme ndaj thelbit “të vërtetë” të forcës së armatosur nuk përpiqen vetëm grupe të ndryshme ushtarakësh, por vazhdimisht edhe gjeneratat e formuara dhe të përthithura aty. Në varësi se nga cila shtresë shoqërore vijnë të rekrutuarit në forcën e armatosur dhe se sa konstante qëndron detyra e saj, ndryshon më ngadalë ose më shpejt praktika shoqërore në të. Këto kushte shoqërore formohen në kulturën ushtarake në mënyrë të përqendruar.

Përmes kërkesave të larta morale, shpeshherë të mbartura dhe jashtë shoqërisë ushtarake, të cilat i vendosin ushtarakët për profesionin e tyre, forca e armatosur shfaqet dukshëm si “organizatë morale” në kuptimin sociologjik. Vlerat “*pa interes*” të shoqërisë ushtarake me bosht kryesor nderin, që konstatohen nga tradita e kësaj fushe, dhe vlerat “*me interes*” të shoqërisë civile me karakter konkurrues përplasen në këtë fushë sociale dhe çojnë në kundërshtime të vazhdueshme mes kulturës ushtarake dhe asaj civile qytetare.

Në forcën e armatosur burokratike të një shoqërie moderne me shtresa vështirë se dikush mund të veprojë pa interesa ose me nder sipas ideve të “aristokracisë ushtarake”. Kjo e bën më të rëndësishme kultivimin e formave formale të praktikës së nderit. Pavarësisht hierarkisë në forcën e armatosur në aspektin profesional e kolegjal, aty flitet për “përkatësi kolektive”. Aty shprehet njëkohësisht hierarkia dhe ndjenja kolektive.

¹⁷ Donna Winslow, *The Canadian Airborne Regiment in Somalia: A Socio-cultural Inquiry*. Ottawa 1997.

Tipi ideal i ushtarakut tregon një farë ndryshimi nga epoka në epokë dhe nga vendi në vend, por në themel është konstant dhe i shërben forcës së armatosur për të ruajtur parimet ushtarake të qëndrueshmërisë, gatishmërisë për sakrifikim dhe për ndjenjën e përkatësisë kolektive gjatë rutinës së përditshme në kohë paqeje.

Forca e armatosur, si pjesës e dhunës shtetërore dhe si lokacioni qendror i dhunës institucionale, integron raportin e kushteve të pushtetit, forcës dhe dhunës si asnjë institucion tjetër politik. Me forcën e armatosur mundësohet ekzistenca e një organizate të dhunshme që për të eksperiencia elementare e luftimit, vrasjes dhe vdekjes janë të vetëkuptueshme. Edhe gjatë rutinës së përditshme në organizatën ushtarake burokratike vetë kuptueshmëria e orientimit për luftë ruhet përmes eksperiencës së operacioneve në misionet jashtë vendit, përmes stërvitjeve, përmes kërkesave normative direkte, si dhe përmes kultivimit të traditës luftarake të forcës së armatosur. Si institucion politik i shtetit dhe i shoqërisë forca e armatosur formon si ushtarakun edhe civilin dhe prodhon kështu *homo militaris, pra njeriun ushtarak*.

Bibliografia:

1. Revista Ushtarake. Organ teoriko-shkencor i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Nr.2/2014. Tiranë. Gusht. 2014.
2. Hantington, Samuel P., Ushtaraku dhe Shteti. Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë. 1995.
3. Lufta, morali dhe profesioni ushtarak. Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë. 1998.
4. Moskos, Charles C., From Institution to Occupation, "Military and Society". Washington DC. 1974.
5. Janowitz, Morris. The professional Soldier. A social and political portrait. New York. 1960.
6. Goehler, Gerhard. Institutionslehre und Institutionentheorie in der deutschen Politikwissenschaft nach 1945. Grundfragen der Theorie politischer Institutionen. Forschungsstand, Probleme, Perspektiven. Opladen. 1987.
7. Von Hagen, Ulrich. Homo Militaris. Perspektiven einer kritischen Militärsoziologie. Bielefeld 2011.
8. Mayntz, Renate. Soziologie der Organisationen. Reinbek. 1963.
9. Weber, Max. Wirtschaft und Gesellschaft. Grundriss der verstehenden Soziologie. Tübingen. 1972.

10. Waldmann, Peter. Politik und Gewalt. Lexikon der Politik. Bd.1. Politische Theorien. München. 1995.
11. Bourdieu, Pierre. Sozialer Sinn. Kritik der theoretischen Vernunft. Frankfurt am Main. 1987.
12. Bald, Detlef. Deutsche Offizier. Sozial und Bildungsgeschichte der deutschen Offizierkorps im 20. Jahrhundert. München. 1982.
13. Seifert, Ruth. Männlichkeitskonstruktionen: Das Militär als destruktiver Macht. Das Argument. 1992.
14. Lipman-Blumen, Jean. Toward a Homosocial Theory of Sex Roles. An Explanation of the Sex Segregation in Social Institutions. Signs,3 (1976).
15. Amery, Carl. Die Kapitulation oder Deutscher Katholizismus heute. Reinbek. 1963.
16. Winslow, Donna. The Canadian Airborne Regiment in Somalia: A Socio-cultural Inquiry. Ottawa. 1997.
17. Von Hagen, Ulrich/Tomforde, Maren. Militärischer Kultur. Militärische Soziologie – Eine Einführung. Wiesbaden 2012.

Kontrolli demokratik i Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë

Major. Msc. Kujtim ZEKA

Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar.

Nëpërmjet këtij punimi janë pasqyruar normat dhe parimet bazë kushtetuese për kontrollin civil të forcave të armatosura në Republikën e Shqipërisë. Institucionet shtetërore të cilat kanë si mision mbikëqyrjen dhe kontrollin demokratik të forcave të armatosura, synojnë të harmonizojnë dhe të vendosin në ekuilibër institucional dhe kushtetues marrëdhëniet civilo-ushtarake sipas normave dhe standardeve të një shoqërie demokratike. Objekti kryesor i këtij punimi është të pasqyrojë rolin dhe detyrat kryesore që kanë institucionet shtetërore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë në kohë paqeje dhe lufte.

Ndër të tjera në këtë punim, janë evidentuar gjithashtu edhe disa norma evropiane të cilat shprehin standardet bazë të kontrollit demokratik ndaj veprimtarisë së forcave të armatosura. Mendoj se lexuesi mund të konceptojë në mënyrë më të qartë raportin kushtetues dhe ligjor që kanë forcat e armatosura me institucionet shtetërore, shoqërinë civile si dhe mekanizmat ligjorë që shërbejnë për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së FA konform ligjeve, normave demokratike dhe parimeve themelore të shtetit të së drejtës.

Nisur nga ndjeshmëria e lartë dhe mungesa e njohurive që ka një pjesë e madhe e shoqërisë shqiptare për forcat e armatosura në përgjithësi, mendoj se nëpërmjet punimit të kësaj teme do të pasqyrohen të dhëna thelbësore sa i takon bazës ligjore dhe procedurave që udhëheqin mbikëqyrjen dhe kontrollin demokratik të veprimtarisë së forcave të armatosura.

Në këtë punim janë trajtuar gjithashtu edhe parimet bazë kushtetuese të kontrollit demokratik ndaj forcave të armatosura, rregullat dhe standardet të cilat në tërësi përbëjnë sistemin demokratik efektiv për një kontroll efikas dhe të drejtë të forcave të armatosura. Synohet gjithashtu që të evidentohen sa më qartë parimet dhe procedurat ligjore që zbatojnë institucionet shtetërore për mbikëqyrjen dhe kontrollin demokratik të veprimtarisë së forcave të armatosura në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim të këtij punimi mendoj se do të jetë me interes të konceptohet në mënyrë më të qartë funksionimi në tërësi i sistemit të kontrollit demokratik ndaj forcave të armatosura, si dhe rolin që kanë ato në një shoqëri demokratike, duke përfshirë edhe raportet e tyre ligjore dhe kushtetuese me organizmat shtetërorë dhe ato të shoqërisë civile.

Fjalët kyçe: Kontrolli civil demokratik i FARSH, mekanizmat parlamentarë, institucionet e kontrollit demokratik, marrëdhëniet civilo-ushtarake.

Hyrje

Qëllimi i politikës së sigurisë kombëtare është të garantojë sigurinë shoqërore, ekonomike dhe politike të shtetit dhe të institucioneve të tij¹. Me kontroll demokratik të forcave të armatosura nënkuptojmë tërësinë e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, e përgjegjësive dhe procedurave për ushtrimin e pushtetit të popullit drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij mbi institucionin e forcave të armatosura. Në çdo shoqëri demokratike, populli ka të drejtën legjitime të informohet dhe të kontrollojë se si qeveria, në emër të tyre, ndërton, reformon dhe përdor forcat e armatosura. Marrëdhëniet civilo-ushtarake janë patjetër një aspekt kryesor i politikës së sigurisë kombëtare². Kontrolli demokratik i forcave të armatosura është parakusht për sigurimin dhe respektimin e autoriteteve civile, mbrojtjen e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Nëse i referohemi marrëdhënieve civilo-ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore, vërejmë se aspekti më i dukshëm i lidhjeve civilo-ushtarake në dekadën e pasluftës ishte tensioni i ashpër e i lartë midis imperativëve ushtarake dhe shoqërisë liberale amerikane.

¹ Samuel Hantington, *Ushtaraku dhe Shteti*. Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1995, faqe 5.

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ky tension ishte produkt i dominimit të vazhdueshëm të liberalizmit në mendësinë amerikane dhe pranimi i përgjithshëm i pikëpamjes liberale për lidhjet civilo-ushtarake, nga njëra anë dhe i kërcënimeve intensive ndaj sigurisë ushtarake amerikane, të cilat theksonin nevojën e rritjes së kërkesave ushtarake dhe përshtatjen e etikës ushtarake ndaj politikës kombëtare.³

Objekti kryesor i kontrollit demokratik të forcave të armatosura është garantimi që interesat, aspiratat dhe objektivat kombëtarë të popullit të pasqyrohen në mënyre të plotë dhe të saktë në politikat e mbrojtjes ku të ketë një sistem efektiv në fushën e mbrojtjes. Kontrolli demokratik i forcave të armatosura mund të shihet gjithashtu dhe si një garanci që fuqia ushtarake e krijuar nga ana e shtetit është e përligjur plotësisht në popull dhe se ajo nuk do të drejtohet kurrë kundër popullit ose të përdoret kundër vullnetit të popullit.

Kontrolli demokratik i forcave të armatosura është një karakteristikë e rëndësishme e shtetit demokratik dhe mbulon të gjitha aspektet e ndërtimit dhe përdorimit të fuqisë ushtarake. Fusha kryesore e kontrollit demokratik është të sigurojë që forcat e armatosura janë duke i shërbyer vetëm popullit dhe duke pasqyruar vlerat, objektivat dhe interesat jetikë kombëtarë⁴.

1. Normat kryesore ndërkombëtare për kontrollin demokratik të Forcave të Armatosura

Ushtarakët duhet të bashkëpunojnë me institucionet e shoqërisë civile, me mediat dhe me çdo organizëm civil që do të mund të kontribuonte për ndërtimin e një imazhi civil për forcat e armatosura, për shkak së çështjet e sigurisë nuk janë thjesht vetëm ushtarake, por janë më gjithëpërfshirëse dhe kanë nevojë edhe për ekspertizë në të gjitha fushat. Nga ana tjetër Forcat tona të Armatosura duhet të afrohen më shumë me komunitetin lokal, ku përfaqësuesit e forcave të armatosura duhet të jenë më shumë prezentë në problemet komunitare dhe ushtarakët nuk duhet të konsiderohen si të ndryshëm përkundrejt civilëve, por si një pjesë thelbësore që kryejnë funksione të rëndësishme për shoqërinë shqiptare⁵.

Marrëdhëniet civilo-ushtarake përfshijnë shumë më tepër se thjesht kontrollin kushtetues civilo-politik mbi forcat e armatosura. Ato përfshijnë gjithashtu nevojën për të pasur një hapje dhe transparencë të plotë mbi veprimtarinë e forcave të armatosura, ku në këtë proces nuk marrin pjesë vetëm institucionet

³ Samuel Huntington, *Ushtaraku dhe Shteti*. Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1995, faqe 341.

⁴ Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare i Republikës së Shqipërisë.

⁵ *Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civile-Ushtarake: Një Çështje e Papërfunduar*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ISBN 97899956-831-0-8, Tiranë: nëntor 2009, faqe 13.

qeveritare, por edhe ato të shoqërinë civile⁶. Forcat e Armatosura janë një instrument kryesor i politikës së sigurimit. Ata nuk janë një aktor politik i ndarë. Carl von Clausewitz, rreth 200 vjet më parë, e shprehu në këtë mënyrë lidhjen midis tyre: “Lufta nuk është gjë tjetër veçse vazhdim i politikës me mjete të tjera”. Në botën e sotme, parapëlqimi kryesor është që të përdoren mjete të tjera të ndryshme nga lufta, për të arritur objektivat politike. Pavarësisht kësaj, pika kryesore e Clausewitz ngelet e vërtetë: Përdorimi i forcave të armatosura u shërben objektivave politike edhe në veprimet paqeruajtëse apo në situatat e tjera, ku armët lejohen vetëm për vetëmbrojtje. Objektivat politike të një vendi përcaktohen nga qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me parlamentin dhe jo direkt me Forcat e Armatosura⁷.

Parlamenti përfaqëson vullnetin e popullit dhe i kërkon llogari ekzekutivit për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes⁸. Ai ka një rol të vetëm kushtetues për të autorizuar dhe për të shqyrtuar shpenzimet e mbrojtjes dhe sigurisë ku luan një rol vendimtar në lidhje me shpalljen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së luftës. Kërkesa e parë për çdo sistem të kontrollit civil të forcave të armatosura, është ulja në maksimum e pushtetit ushtarak. Kontrolli civil e arrin këtë objektiv duke rritur profesionalizmin e ushtarakëve në mënyrë që ata të bëhen asnjans në lidhje me politikën⁹.

Organizimet parlamentare. Në vendet demokratike, parlamentet janë organet më të larta mbikëqyrëse dhe institucionet kryesore për kryerjen e kontrollit demokratik të sektorit të forcave të armatosura. Pushtetet dhe të drejtat e parlamenteve në kontrollin demokratik të forcave të armatosura janë specifike për çdo vend¹⁰. Në terma të përgjithshëm, ka dy grupe të pushteteve të tilla: pushtetet dhe të drejta të zbatueshme në gjithë sferat e shtetit: pushtetin legjislativ për miratimin e ligjeve që drejtojnë dhe rregullojnë gjithë aspektet e mbrojtjes, të cilat zakonisht propozohen nga qeveria. Në shumicën e vendeve, anëtarët e parlamentit kanë gjithashtu të drejtën të iniciojnë ose amendojnë ligje të tilla¹¹. Përmbledhja më e zakonshme e legjislacionit në fushën e mbrojtjes përfshin ligjet për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e vendit, gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme, mobilizimin e popullsisë, shërbimin e detyrueshëm ushtarak, shërbimin vullnetar dhe statutet e personelit

⁶ Po aty, faqe 17.

⁷ Po aty, faqe 117.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

⁹ Guidë për Politikën dhe Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (Vëllimi II), fq.25.

¹⁰ Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civile-Ushtarake: Një Çështje e Papërfunduar”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ISBN 97899956-831-0-8, Tiranë: Nëntor 2009, f. 31.

¹¹ Po aty, fq 39.

ushtarak dhe civil. Në legjislacionet bazë të shumë shteteve demokratike, përfshihen gjithashtu politikat e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe strategjitë e propozuara nga kryetari i shtetit dhe/ose qeverisë, siç janë: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia ose koncepti i Mbrojtjes Kombëtare, Rishikimi i Mbrojtjes Strategjike dhe Strategjia Ushtarake.

Pushtetin për të vendosur për shpenzimin e parave të publikut (taksapaguesve), e kanë parlamentet të cilat debatojnë, amendojnë dhe miratojnë ligje për shpenzimet e mbrojtjes. Parlamentet kanë të drejtën për të monitoruar dhe kontrolluar se si janë zbatuar ligjet dhe vendimet nga pushteti ekzekutiv. Ato kanë të drejtë gjithashtu të formulojnë pyetje të ndryshme në lidhje me çështjet e mbrojtjes, si dhe të thërrasin anëtarët e ekzekutivit dhe stafet e tyre për të dëshmuar, aksesin e tyre në informacionin e klasifikuar, zhvillimin e seancave pyetëse, dëgjimore dhe informuese për fushën e mbrojtjes.

Pushtetin për të miratuar apo amenduar vendime në lidhje me përdorimin e forcës ushtarake, e kanë parlamentet të cilat kanë të drejtë të marrin vendimet përfundimtare në raste lufte, ose të gjendjeve të jashtëzakonshme. Parlamentet kanë gjithashtu të drejtën për të autorizuar shpenzime të veçanta për mbrojtjen, siç janë programet e pajisjeve dhe armatimit, shpenzimet për misionet jashtë vendit. Në shumë vende demokratike, parlamentet përfshihen gjerësisht në vendimet për kontratat e mbrojtjes, ose për të vendosur në përdorimin e trupave në mision jashtë vendit, ku në përgjithësi këto vendime ndërmjet të tjerave përfshijnë deklarin e misionit, mandatin politik, nivelin e angazhimit, numrin e trupave, kohëzgjatjen e misioneve, rregullat e angazhimit, si dhe delegimin ose mbajtjen e komandim - kontrollit.

Parimet e mirëqeverisjes dhe sundimi i ligjit vlejné për të gjitha degët e qeverisë dhe si pasojë, edhe për fushën e sigurisë. Anëtarët e personelit të angazhuar në fushën e sigurisë japin llogari individualisht para trupit gjyqësor për shkelje të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare (për faje civile ose penale). Organizimet në fushën e sigurisë janë asnjëse nga pikëpamja politike.

Ekzistojné disa parime e norma të pranuar në përgjithësi, si vijon: ruajtja e kontrollit të popullit ndaj pushteteve si: legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit; kontrolli nga organet legjislative të vendimeve kyçe në lidhje me emërimin e oficerëve të nivelit të lartë; kontrolli mbi qarkullimin e burimeve të mbrojtjes, përfshi buxhetet e mbrojtjes, politikat e mbrojtjes, si dhe misionet që duhet të përmbushin forcat e armatosura¹².

¹² *Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civile-Ushtarake: Një Çështje e Papërfunduar*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ISBN 97899956-831-0-8, Tiranë: Nëntor 2009, faqe 27

Normat evropiane: Nevoja për respektimin e normave dhe standardeve të kontrollit demokratik është artikuluar në kontekste të ndryshme. Normat e përfshira në Kodin e Sjelljes në Aspektet Politiko - Ushtarake të Sigurisë të OSBE-së janë deri tani ndër më të arrirat.

Përveç këtyre, normat e kontrollit demokratik janë paraqitur në raportet dhe rezolutat e KB, në ndihmat e zhvillimit dhe politikat e anëtarësimit në BE, rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe drafti i Kodit të Sjelljes për Forcat e Armatosura dhe të Sigurisë ECOWA. Shtetet pjesëmarrëse në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) e konsiderojnë kontrollin politik demokratik të forcave të armatosura “një element të domosdoshëm të stabilitetit dhe sigurisë” dhe ata janë të angazhuar “të mbështesin integrimin e forcave të armatosura me shoqërinë civile si një shprehje e rëndësishme e demokracisë¹³.

Krijimi i këtyre tavolinave, që sipas rastit mund të jenë për të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, krijon hapësirat e nevojshme për realizimin e transparencës për mënyrën e hapjes e daljes bindshëm në shoqëri, për mënyrën e trajtimit e të konceptimit të problemeve të brendshme e të perspektivës së forcave të armatosura, por edhe lartëson figurën dhe personalitetin e vetë forcave të armatosura në opinionin publik¹⁴.

¹³ Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).

¹⁴ “*Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civile-Ushtarake: Një Çështje e Papërfunduar*”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ISBN 97899956-831-0-8, Tiranë: Nëntor 2009, faqe 108.

Kodi i sjelljes (drejtimit) të OSBE-së në aspektet politiko-ushtarake të sigurisë (1994)	
Normat ndërkombëtare	Normat brenda shtetit
Pranimi i solidaritetit (në qoftë se dhunohen normat dhe parimet)	Kontrolli demokratik politik i forcave ushtarake, të sigurisë së brendshme, shërbimeve inteligjente dhe policisë.
	Integrimi i forcave të armatosura me shoqërinë civile
	Udhëheqje dhe kontroll efektiv i forcave ushtarake, paramilitare, dhe të sigurisë nga autoritetet e vendosura në mënyrë kushtetuese të veshur me legjimitetin demokratik.
Mbrojtja efektive ushtarake në raport të drejtë me nevojat e sigurisë individuale dhe kolektive.	Miratim ligjor i shpenzimeve të mbrojtjes
	Përmbytje në shpenzimet ushtarake
	Transparencë dhe akses publik në informacionin që lidhet me forcat e armatosura
Përcaktimi i aftësive ushtarake mbi bazën e procedurave demokratike	Asnjësi politike të forcave të armatosura
	Masa për ruajtje kundër përdorimit aksidental ose të paautorizuar të mjeteve ushtarake
	Jo tolerancë ose mbështetje për forcat që nuk janë përgjegjshme ose nuk kontrollohen nga autoritetet e vendosura në mënyrë kushtetuese
Mos imponim i dominimit ushtarak mbi shtetet e tjera të OSBE-së	Mos lejimi i forcave paramilitare për të shtënë në dorë kapacitete luftarake më tepër nga ato për të cilat ato janë krijuar
	Rekrutimi ose thirrja në shërbim ushtarak të jetë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore
	Reflektim në ligjet ose dokumentet e tjera përkatëse të të drejtave dhe detyrave të personelit ushtarak
Vendosja e forcave ushtarake në territorin e një shteti tjetër në përputhje me marrëveshjet e negociuara në mënyrë të lirë dhe me ligjet ndërkombëtare	Pajtueshmëria e forcave të armatosura me dispozitat e ligjit humanitar ndërkombëtar
	Përgjegjshmëria vetjake e personelit të forcave të armatosura në ligjin humanitar ndërkombëtar
	Mbrojtja e të drejtave të personelit që shërben në forcat e armatosura

Forcat paramilitare nuk duhet të lejohen të marrin aftësi luftarake në tejkalim të misionit për të cilat ato janë krijuar. Rekrutimi apo thirrja e këtyre forcave duhet të jetë në përputhje me kushtetutën, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të shtetasve. Misioni dhe detyrat e forcave paramilitare duhet të reflektohen në mënyrë të qartë në ligjet ose dokumentet e tjera përkatëse, ku të pasqyrohen qartë të drejtat dhe detyrat e këtyre forcave, në kuadrin e përfshirjes së tyre me forcat e rregullta të armatosura. Pajtueshmëria e forcave të armatosura me dispozitat e ligjit humanitar ndërkombëtar dhe mbrojtja e të drejtave të personelit që shërben në forcat e armatosura, duhet të jetë e sanksionuar me ligj. Ndër të tjera, duhet përcaktuar edhe përgjegjësia personale e personelit të forcave të armatosura në ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar¹⁵.

Parimet e kontrollit demokratik zbatohen nëpërmjet një numri mekanizmash, të cilat janë:

a. Kuadri ligjor i pastër që përmban parimet kryesore të kontrollit demokratik të cilat mund të shprehen qartë në kushtetutën e vendit, si për shembull në kushtetutën e SHBA-ve (1787) dhe atë të Polonisë (1997). Gjithashtu, parlamentet kombëtare mund të adoptojnë ligje të veçanta që paraqesin ose fuqizojnë parimet e kontrollit demokratik; shembujt e kohëve të fundit përfshijnë ligjin për kontrollin civil demokratik të forcave të armatosura të shtetit dhe organizatave të zbatimit të ligjit në Ukrainë (2003) dhe aktin e marrëveshjes së paqes, Sierra Leone (1999) i cili përcakton që Forcat e Armatosura duhet të jenë të përgjegjshme ndaj lidershipit civil.

b. Krijimi i mekanizmave institucionalë që garantojnë respektimin e ligjit në të gjitha rangjet me ndihmën e institucioneve siç është ombudsmani ushtarak apo inspektori i përgjithshëm, kështu për shembull në Kanada krijimi i institucionit të Ombudsmanit është nxitur nga përfshirja e paqeruajtësve kanadezë në abuzimin me të drejtat e njeriut në Somali. Kryerja e kontrollit financiar për të parandaluar korrupsionin dhe mashtrimin që ndryshe mund të mbetej i fshehur nga publiku për shkak të natyrës së klasifikuar të disa informacioneve ushtarake; këto kontrolle financiare kryhen nga hetime të pavarura parlamentare dhe të medias.

c. Zhvillimi të masave edukative që përpiqen të rrënjosin një kulturë të re të sigurisë në komunitetet civile dhe ushtarake nëpërmjet fokusimit në çështje të tilla si bashkëpunimi civilo-ushtarak dhe integrimi më i mirë i forcave të armatosura brenda shoqërisë, për shembull, Gjermania pas Luftës së Dytë Botërore adoptoi konceptin e ushtarëve “qytetarë në uniformë” për të siguruar që personeli ushtarak vepron si pjesë e popullsisë civile dhe jo veçmas saj.

¹⁵ Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), faqe 32.

Përfshirja e trajnimit të personelit të sigurisë në çështje të tilla si vlerat demokratike, të drejtat e njeriut, ligji humanitar ndërkombëtar dhe normat e kontrollit demokratik të forcave të armatosura të zhvilluara nga organizatat ndërkombëtare; për shembull ushtria zvicerane zhvillon kurse për ligjin humanitar ndërkombëtar si për personelin e tij ashtu dhe pjesëtarët e forcave të armatosura të vendeve të tjera. Ushtarakët duhet të përfshihen në procesin e planifikimit të mbrojtjes, por lidërshipi civil i informuar në mënyrën e duhur duhet të ketë fjalën e fundit në të gjitha çështjet.

Hendeku civilo-ushtarak: Forcat e armatosura priren të jenë një institucion ishullor i izoluar, për shkak të dëshirës së tyre për të ruajtur karakteristikat që ato shpesh i perceptojnë si vendimtare për efikasitetin e tyre, siç është shpirti i repartit, etika dhe morali i fortë dhe në disa raste, vlera konservatore shoqërore. Në rastin kur përbërja kulturore, politike dhe etnike e forcave të armatosura ndryshon nga ajo e shoqërisë në tërësi, atëherë mund të shfaqet “hendeku civilo-ushtarak”. Për shembull, në qoftë se ushtarakët nuk përfshihen në mendimin e supermacisë së civilëve ndaj çështjeve ushtarake, këtu ekziston një rrezik në rritje i përfshirjes së papërshtatshme të ushtarakëve dhe forcave të armatosura në jetën politike të vendit. Një hendek civilo-ushtarak mund të zvogëlojë gjithashtu pranimin dhe pëlqimin e ushtrisë nga shoqëria, çfarë mund të shkaktojë një izolim të mëtejshëm.

Në mënyrë të veçantë, forcat e armatosura nuk duhet të përjashtojnë individët duke u bazuar në karakteristika të tilla si raca, etniciteti, klasa shoqërore, feja, gjinia apo orientimi seksual. Në rastin kur grupe të caktuara diferencohen në shoqëri, atëherë mund të jenë të nevojshme masa të veçanta me qëllim që të rritin përfaqësimin e tyre në forcat e armatosura.

Modelet e kontrollit demokratik. Ekzistojnë dy modele kryesore të kontrollit demokratik. Njëri model bazohet në mënyrën se si ushtrohet kontrolli demokratik, ku veçohen kontrolli vertikal, horizontal dhe vetëkontrolli. *Kontrolli vertikal* është ushtrimi i ndikimit mbi forcat e armatosura nga lart-poshtë. *Kontrolli horizontal* detyron shpjegimin ose ndryshe ndikon në mënyrë jo zyrtare në çështjet e politikës së mbrojtjes dhe kjo ndodh nëpërmjet medias dhe shoqërisë civile. *Vetëkontrolli* i referohet veprimeve që kryejnë vetë forcat e armatosura për t’u siguruar që rregullat e ndryshme respektohen me korrektesë prej tyre.

Një klasifikim tjetër bazohet në fazën e kryerjes së kontrollit, ku përfshihen kontrolli paraveprues, reagues dhe operacional. *Kontrolli paraveprues* përbëhet nga hapat që kanë për qëllim të adresojnë problemet e ardhshme. *Kontrolli reagues* ndodh pasi janë marrë vendimet dhe përfshin rishikimin e politikave të mbrojtjes ose kontrollin e shpenzimeve të kryera. *Kontrolli*

operacional ndodh gjatë operacioneve ushtarake dhe përfshin ndërhyrjen politike në vendimet e zinxhirit të komandimit¹⁶.

2. Institucionet e Kontrollit Demokratik të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë.

Kontrolli demokratik mund të funksionojë në mënyrë të efektshme vetëm atëherë kur ai të institucionalizohet plotësisht. Në një kuptim më të gjerë institucioni i kontrollit demokratik të sektorit të mbrojtjes përfshin institucionet zyrtare të përfshira në procesin e formulimit, miratimit dhe zbatimit të politikave të strategjive të mbrojtjes dhe të vendimmarrjes në çështjet e mbrojtjes. Institucionet më të zakonshme të përfshira në kontrollin e sektorit të mbrojtjes janë:

- ✓ Institucionet e përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, kryesisht parlamenti dhe në disa raste, Kryetari i Shtetit (Presidenti).
- ✓ Institucionet e caktuara nga parlamenti në emër të popullit: Kryetari i Shtetit (Presidenti) kur ai nuk është i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli; Këshilli i Ministrave (Kabineti) dhe Ministria e Mbrojtjes¹⁷.
- ✓ Përmbledhja e legjislacionit që rregullon se cilat institucione duhet të përfshihen në këto procese, përgjegjësitë e tyre dhe si duhet të përmbushen këto përgjegjësi nga këto institucione. Në çdo demokraci, sistemi kushtetues dhe ligjor përfshin ligjet që specifikojnë mekanizmat dhe përgjegjësitë për ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes në kohë paqe dhe lufte dhe caktimin e nivelit të autorizimit (mandatit, kompetencave) për pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.
- ✓ Procedurat e ndërvarësisë (marrëdhënieve) ndërmjet institucioneve dhe brenda çdo institucioni të përfshirë në funksionin e kontrollit demokratik të sektorit të mbrojtjes.

Në mënyrë të përgjithshme, procedurat e kontrollit demokratik të FA përfshijnë:

- ✓ Formulimet e politikave të mbrojtjes dhe strategjive, zakonisht në nivelin e pushtetit ekzekutiv, që përfshijnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe kreun e pushtetit ekzekutiv (Kryeministrin dhe/ose Presidentin), me institucionet e tjera përkatëse ekzekutive në rolin mbështetës. Në disa raste, në rol këshillues në nivelin e Kryetarit të Shtetit vepron një institucion i ngritur veçmas, i emërtuar Këshilli i Sigurimit Kombëtar, ose Këshilli i Mbrojtjes Kombëtare apo një emërtim i ngjashëm me të.

¹⁶ Guidë Për Politikën dhe Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (Vëllimi II-të), faqe 39.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

- ✓ Miratimin e politikave dhe strategjive të mbrojtjes, që zakonisht kryhen nga Parlamenti. Kryetari i Shtetit mund të përfshihet gjithashtu në procesin e miratimit, por ai nuk duhet të zëvendësojë pushtetin (kompetencat) e Parlamentit¹⁸.
- ✓ Kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të mbrojtjes. Parim bazë është që institucionet që miratojnë këto politika dhe strategji, duhet gjithashtu edhe të kontrollojnë zbatimin e tyre me anë të autorizimit të buxheteve të mbrojtjes, nivelit të forcës, misioneve, emërimit të drejtuesve civil dhe ushtarak, kontraktimit të pajisjeve kryesore etj., dhe nëpërmjet raportimeve (pyetje, interpelanca, hetime, dëgjime, inspektime)¹⁹.

Në Republikën e Shqipërisë, Kryetari i Shtetit ka dy role të dallueshme në kontrollin demokratik të forcave të armatosura: Si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të vendit, ai është nën kontrollin e popullit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet parlamentit. Si përfaqësues i popullit, ai ushtron kontrollin ndaj ekzekutivit dhe strukturave ushtarake për çështje të mbrojtjes nën autoritetin e tyre²⁰.

Presidenti ka pozicione të ndryshme ndërmjet pushteteve shtetërore, që shtrihen nga ato përfaqësuese deri tek ato të veshura me pushtet ekzekutiv. Në shumë vende, presidenti është autoriteti më i lartë në çështjet e mbrojtjes, dhe e ushtron autoritetin e tij nëpërmjet pushtetit ekzekutiv. Pushtetet e presidentit renditen nga deklarimi i luftës mbi bazën e vendimit të parlamentit, deri në formulimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes dhe vendimet përkatëse për zbatimin e tyre.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar në RSH. Në shumë raste, veprimtaria e presidentit në çështjet e mbrojtjes, në përgjithësi mbështetet nga këshilli i sigurimit/mbrojtjes, si dhe nga puna e stafëve të tyre. Këshilli i Sigurimit (mbrojtjes) vepron në përputhje me ligjet përkatëse që përcaktojnë përbërjen dhe përgjegjësitë e tyre. Ata bashkëpunojnë me ministrinë dhe institucionet përkatëse për të garantuar sigurinë e vendit. Ministrat kryesorë në përgjithësi janë anëtarë të këtyre këshillave. Në disa raste, edhe anëtarë të parlamentit mund të kenë gjithashtu vend në këshillin e sigurimit²¹.

Pushteti i ekzekutivit. Në çdo sistem demokratik, pushteti ekzekutiv buron nga populli, qoftë në mënyrë direkte, si në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose nëpërmjet përfaqësuesve të popullit, pra të parlamenteve që

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

²⁰ Po aty.

²¹ Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare i Republikës së Shqipërisë.

zgjedhin pushtetin ekzekutiv. Përpjekja kryesore për ndërtimin e një mbrojtje të efektshme, të përballueshme dhe të përligjur përqendrohet kryesisht tek ekzekutivi, ku ministri i Mbrojtjes është në rolin drejtues për pjesën më të madhe të kohës.

Pushteti ekzekutiv është iniciuesi kryesor i hartimit të ligjeve dhe ka të drejtën të propozojë për mënyrën si duhet të institucionalizohet dhe drejtohet sektori i mbrojtjes. Ka të drejtën e botimit të dokumenteve të politikave dhe programeve për aspekte të veçanta të mbrojtjes.

Kontrolli demokratik nënkupton që këto të drejta të ekzekutivit të kontrollohen nga parlamenti nëpërmjet pushtetit (kompetencës) të tyre për të nxjerrë ligje, miratuar dhe autorizuar veprimtari të caktuara.

Përgjegjësitë kryesore të pushtetit ekzekutiv në lidhje me kontrollin demokratik të forcave të armatosura janë si për kontrollin e zbatimit të politikave të mbrojtjes dhe vendimeve, ashtu dhe për raportimin e rezultateve. Faza e raportimit të procesit demokratik ndodh njëherazi si për parlamentin dhe publikun.

Ministria e Mbrojtjes. Roli i ministrisë të mbrojtjes në formulimin, miratimin dhe zbatimin e vendimeve të politikës së mbrojtjes është i shprehur qartë në ligjet e nxjerra në fushën e mbrojtjes. Në lidhje me kontrollin demokratik të forcave të armatosura, ministria është si subjekt ashtu dhe objekt, pasi ajo është përgjegjëse për kontrollin e drejtpërdrejtë të forcave të armatosura dhe njëherazi janë përgjegjëse ndaj titullarëve më të lartë ekzekutivë (kryeministrit dhe/ose presidentit) dhe ndaj parlamentit.

Ministria e Mbrojtjes është autoriteti publik kryesor i specializuar për zhvillimin e forcave të armatosura, të cilat organizojnë, koordinojnë, zhvillojnë dhe drejojnë veprimtaritë për mbrojtjen e vendit. Në lidhje me formulimin dhe zbatimin e politikës, Ministria e Mbrojtjes vlerëson mjedisin politiko-ushtarak; identifikon kërcënimet dhe rreziqet me dimension ushtarak; përpunon kërkesat e autoriteteve të tjera publike që do të plotësohen me mjete ushtarake; kontribuon në përgatitjen e draftit të politikës së sigurisë dhe përcaktimin e drejtimeve kryesore për zbatimin e saj²².

Si pjesë e pushtetit ekzekutiv, Ministria e Mbrojtjes ka të drejtën e iniciativës legjislative të propozimit të ligjeve dhe rregulloreve të nevojshme për çështjet e mbrojtjes si dhe përfshihet në përgatitjen e propozimeve të projekt-buxhetit. Gjithashtu, ajo është përgjegjëse për organizimin e kërkimeve shkencore në fushën ushtarake dhe për zbatimin e rezultateve të kërkimeve që kanë lidhje

²² Dokumenti i Strategjisë Ushtarake i Republikës së Shqipërisë.

me forcat e armatosura të vendit. Ministria e Mbrojtjes miraton dokumentet e mbrojtjes të dala nga Shtabi i Përgjithshëm dhe drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes, në përputhje me dispozitat ligjore²³.

3. Kontrolli parlamentar i Forcave të Armatosura

Në përgjithësi të gjitha sistemet qeverisëse u krijojnë parlamentarëve mundësi të shumta për të kontrolluar dhe ushtruar politika të caktuara në lidhje me veprimtarinë e forcave të armatosura dhe institucioneve të sigurisë. Në përgjithësi këto realizohen përmes:

- debateve parlamentare;
- pyetjeve dhe interpelancave;
- hetimeve parlamentare.

Debatet parlamentare për çështjet e sigurisë. Debatet parlamentare për çështjet e sigurisë kanë një rëndësi të madhe për të shkëmbyer mendime dhe informacione. Në përgjithësi ato zhvillohen pas paraqitjes së buxhetit nga ana e qeverisë, pas deklaratave zyrtare dhe jo zyrtare të ministrit të Mbrojtjes apo titullarëve të tjerë, që kanë lidhje me politikat e sigurimit në lidhje me paraqitjen e dokumenteve kryesore të mbrojtjes dhe të sigurisë, në lidhje me programin e qeverisë për këtë fushë apo dhe ndonjë problemi tjetër që lidhet me çështjet në fjalë.

Pyetjet dhe interpelancat parlamentare për sigurinë. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të detyrës së parlamentit dhe vlerësohen si një nga procedurat parlamentare më të rëndësishme për të mbikëqyrur veprimet e qeverisë. Pyetjet dhe interpelancat mund të bëhen me kërkesën e çdo parlamenti, grup parlamentarësh apo dhe grupi politik, por në përgjithësi ato zhvillohen nga ana e opozitës. Interpelancat u drejtohen përfaqësuesve të ekzekutivit, siç është Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes dhe tematika e tyre është shumë e gjerë dhe mund të përfshirë gjithë veprimtarinë e Forcave të Armatosura²⁴.

Qëllimi i procedurës së pyetjeve është që të merret informacion konkret nga administrata, të kërkohet ndërhyrje e saj dhe sipas rastit të denoncohen shpërdorimet dhe të kërkohen korrigjime. Kjo procedurë përdoret gjithashtu për të marrë fakte të hollësishme që do t'i ndihmonin deputetët të kuptonin subjektet e ndërlikuara të projektligjeve dhe të dokumenteve ligjore që vijnë në parlament dhe nga ana tjetër, kjo procedurë i krijon opozitës një mjet për të zbuluar pikat e dobëta të qeverisë. Interpelanca ka dy tipare thelbësore: së pari, ajo çon në debate të përgjithshme; së dyti, ajo mbart në vetvete një masë

²³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

politike sepse debati arrin kulmin me votën për mocion, që shpreh pakënaqësinë e parlamentit për shpjegimet e dhëna nga qeveria. Ajo nuk është thjesht një mjet për të marrë informacion, por është një formë e drejtpërdrejtë kontrolli, e cila duhet kuptuar si e tillë²⁵.

Hetimet parlamentare për sigurinë. Komisionet e përkohshme hetimore për çështjet e sigurisë kanë rëndësi të veçantë, sepse në përgjithësi ato shihen nga publiku si sinjale pozitive politike. Është mekanizëm që mund të shqyrtojë në mënyrë të hollësishme probleme të ndjeshme në fushën e sigurisë.

Komisionet hetimore përdoren gjerësisht për të studiuar çështje të veçanta. E drejta për të filluar një hetim është rrjedhim logjik dhe i natyrshëm i parimit se parlamenti duhet të jetë plotësisht i informuar për çdo çështje për të cilën ekzekutivi ndërmerr veprim. Pavarësisht nga kuadri ligjor që funksionon, komisioni i ngritur për të kryer një hetim nuk është asgjë më tepër se sa një organ hetimor dhe fakt-mbledhës, detyra e vetme e të cilit është t'i paraqesë një raport parlamentit që e ka ngritur atë. I takon vetë parlamentit që të nxjerrë përfundimet e nevojshme nga hetimi dhe të dhënat e nxjerra prej tij²⁶.

Pavarësisht se kompetencat e këtyre komisioneve ndryshojnë nga një parlament te tjetri, në thelb ato përfshijnë këto të drejta:

- zgjedhjen e temës dhe objektit të hetimit;
- vizita në baza të ushtrisë dhe zyrat e tjera të sigurisë;
- grumbullimin e informacionit përkatës;
- marrjen e dëshmive të ndryshme;
- organizimin ose jo të seancës me dyer të mbyllura.

Komisionet parlamentare. Komisionet parlamentare janë një nga elementet më të rëndësishme të mbikëqyrjes parlamentare në fushën e sigurisë. Mbikëqyrja parlamentare nuk përfshin thjesht një komision, por disa komisione, emërtimi i të cilëve ndryshon nga një parlament te tjetri.

Të tilla mund të përmendim:

- Komisionin e Mbrojtjes ose Komisionin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë Kombëtare dhe në përgjithësi merret me të gjitha çështjet që lidhen me çështjet e sigurisë.
- Komisionin e Punëve të Jashtme, që trajton vendimet për pjesëmarrjen në misionet e paqes ose pranimin e tyre në territorin kombëtar, traktatet, marrëveshjet etj.

²⁵ Po aty.

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, komisioni që lidhet direkt me veprimtarinë e Forcave të Armatosura të RSH, quhet Komisioni i Sigurisë Kombëtare. Më parë ka pasur emërtimin Komisioni i Mbrojtjes, por tani mbulon edhe Rendin Publik dhe Shërbimin Informativ Shtetëror, i cili funksionon si nënkomision²⁷.

Detyrat kryesore të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Në fushën e politikave të sigurisë në përgjithësi ka për detyrë: të verifikojë dhe raportojë çdo nismë të rëndësishme që shpall Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror në lidhje me politikën e sigurisë dhe mbrojtjes; të marrë në shqyrtim në mënyrë periodike veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të gjitha organizmave dhe agjencive të tjera, për përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre në lidhje me politikën e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit; të mbajë nën vëzhgim përputhshmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes me legjislacionin për lirinë e informacionit dhe cilësinë e dhënies së informacionit për parlamentin; të verifikojë kërkesat dhe ankesat e personelit ushtarak dhe civil në lidhje me fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes²⁸.

Përfundime

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë i shërbejnë interesave të popullit dhe gëzojnë legjitimitet dhe mbështetje popullore. Politikën dhe aftësitë e forcave ushtarake duhet të jenë në një linjë me objektivat politikë të vendit dhe në përpjesëtim të drejtë me burimet e tij. Kontrolli demokratik i forcave të armatosura është një proces i vazhdueshëm nën autoritetin e drejtpërdrejtë të popullit, ku publiku në tërësi dhe individët kanë të drejtë të paraqesin opinionet dhe alternativat e tyre për çështje të rëndësishme të demokracisë, sa i takon kontrollit demokratik të forcave të armatosura.

Kontrolli demokratik i forcave të armatosura është parakusht për të siguruar që të respektohet epërsia politike e autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të mbrojtë sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Forcat e armatosura nuk mund të përdoren për qëllime politike, për t'u shërbyer partive të ndryshme politike. Aktualisht nuk ekzistojnë metoda të pranueshme të shkallë të gjerë që të shërbejnë për përcaktimin e saktë të nivelit të kënaqjes së publikut ose të pajtueshmërisë (pranimit) me parimet, normat ose praktikën ndërkombëtare për kontrollin demokratik të forcave të armatosura.

²⁷ Po aty.

²⁸ Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare i RSH.

Me qëllim që kontrolli demokratik i forcave të armatosura të jetë i efektshëm dhe eficient, ai duhet të institucionalizohet në të gjitha nivelet e shtetit. Institucionalizimi i kontrollit demokratik të forcave të armatosura nënkupton rregullimet efektive dhe transparente, përfshi legjislacionin dhe procedurat e përshtatshme që tregojnë rolin dhe përgjegjësitë ligjore dhe operacionale të institucioneve kryesore shtetërore të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv të vendit.

Bibliografia:

1. Guidë për Politikën dhe Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (Vëllimi i II-të).
2. Hantington. S. *“Ushtaraku dhe Shteti”*. Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1995.
3. Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
5. Dokumenti i Strategjisë Ushtarake i Republikës së Shqipërisë.
6. Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare i Republikës së Shqipërisë.
7. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ISBN 97899956-831-0-8, Tiranë: nëntor 2009, *“Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civile-Ushtarake: Një Çështje e Papërfunduar”*.

RUBRIKA E TRETË

**INTELIGJENCA ARTIFICIALE
DHE ZHVILLIMET INOVATIVE**

Zhvillimet e inteligjencës artificiale në SHBA, vendet e BE-së dhe NATO-s dhe efektet e saj në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë globale

Kolonel Dilaver HOXHA
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Industria e Inteligjencës Artificiale (IA) po zhvillohet me ritme të shpejta në disa sfera kryesore të veprimtarisë njerëzore. Një nga kompanitë e para që depërtoi në këtë hapësirë ishte kompania motër e Google, DeepMind, por investime kanë bërë dhe po bëjnë gjigantët e teknologjisë kompjuterike siç janë: Microsoft; Alfabet; Amazon; Meta dhe Apple. “Sidoqoftë, aplikacioni që ka bërë ndikimin më të madh në mbarë botën deri më sot është ChatGPT, AI i sofistikuar i stilit chatbot nga OpenAI që ju mundëson të bëni pyetje komplekse dhe të merrni përgjigje bazuar në të dhënat e tij të disponueshme globalisht...”¹. IA është një fushë e informatikës që fokusohet në sisteme të cilat mund të kryejnë detyra që zakonisht, ose më parë, kërkonin inteligjencën njerëzore për të përfunduar, siç janë: të mësuarit, zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen, perceptimin, kreativitetin dhe angazhimin social. Kjo industri po mbështetet edhe nga shumë kompani të tjera të fuqishme teknologjike, të cilat e shtrijnë veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme, si: të edukimit, meteorologjisë, bujqësisë, transportit, mbrojtjes, sigurisë, sferës ndërhapësinore, etj.

¹ QinetiQ: A do të komandojë Inteligjenca Artificiale ushtrinë e së ardhmes?. 19.10.2023.

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një pasqyrë mbi potencialet e aplikimit të IA nga SHBA-të, vendet e BE-së dhe strategjia e NATO-s në këtë drejtim, duke u fokusuar në ndikimin e saj në fushën e mbrojtjes. Nga këndvështrimi i përgjithshëm, IA është një fushë shkencore, e ndërlidhur me shumë fusha të tjera, e cila mund të konsiderohet si një ndër ndikuesit kryesorë strategjikë me efekt global në dekadat e ardhshme. Mbi këtë bazë nxirren në pah trendi i kësaj shkençe, fushat kryesore të zhvillimit të saj, vlerësimi i avantazheve dhe dizavantazheve, kryesisht në sistemet e simulimit, planifikimin e mbrojtjes, industrinë ushtarake dhe zhvillimin e operacionet ushtarake.

Fjalët kyçe: Inteligjencë Artificiale (IA), Mësimi i Makinerisë (Machine Learning), Mësimi në Thellësi (Deep Learning- DL), vizioni kompjuterik (CV).

Hyrje

Zhvillimet teknologjike, me faktorët mbështetës dhe kufizues të tyre janë rrrjedhojë e ambicieve njerëzore për të plotësuar kërkesat dhe nevojat për modernizimin e veprimtarive të tyre jetike. Në epoka të ndryshme, ka pasur zhvillime në fusha specifike, ku së fundmi një vend të rëndësishëm ka zënë evoluimi kompjuterik, pjesë e të cilit është edhe Inteligjenca Artificiale. Nga mesi e viteve 1900 dhe në vijim, fusha e IA kaloi nëpër periudha të zhvillimit intensiv e shoqëruar me sfida dhe problematika të cilat kanë qenë objekt për zgjidhje. Në vitin 1956, John McCarthy ishte i pari që përdori termin “inteligjencë artificiale” duke e përcaktuar atë si shkencën dhe inxhinierinë e krijimit të makinave inteligjente². Gjatë dy dekadave të fundit të këtij fillimshkulli, mund të perceptohet një rritje e konsiderueshme dhe e vazhdueshme në kërkimin, zhvillimin dhe aplikimin e IA, duke marrë një zgjerim dhe depërtuar në ekonominë globale, përmes prodhimit, si dhe në shërbimet e konsumatorëve³.

1. Inteligjenca Artificiale dhe evoluimi i saj.

Zhvillimet e vrullshme globale të IA përbëjnë ndër temat më të rëndësishme aktuale, që janë diskutuar në filozofi dhe fanta-shkencë për dekada, por tashmë është një realitet, duke e bërë atë një emër të njohur dhe objekt investimi nga shumë kompani të fuqishme në mbarë globin. IA, ende nuk ka një përkufizim të pranuar përgjithësisht sot, megjithatë ajo nuk mund të interpretohet si një aplikacion i pavarur, por si një teknologji që mbështet aplikacionet funksionale ekzistuese.

² Toneo.ai.

³ Raporti Vjetor Presidencial 2019, i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i publikuar më 23 mars 2020.

Përgjithësisht, IA bazohet në të dhëna të projektuara për të zgjidhur probleme specifike, e cila mund të përmblihet me përkufizimin vijues “IA është një nga disiplinat e shkencës kompjuterike që siguron kombinimin e teorisë dhe të zhvillimit të sistemit kompjuterik, me qëllim që të jetë e aftë të kryejë funksione që kërkojnë ngjashmëri me inteligjencën njerëzore në lidhje me perceptimin vizual, njohjen e të folurit e të modeleve në gjuhë të ndryshme, marrjen e vendimeve dhe gjykimin, ashtu si dhe njerëzit”.

Në aspektin praktik, IA është simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nga makinat, veçanërisht sistemet kompjuterike, të cilat kryejnë funksione që lidhen me marrjen, regjistrimin, përshtatjen, transferimin dhe modifikimin e të dhënave. E thënë më thjeshtë, IA përbën pajisjen kompjuterike, e cila simulon procese të inteligjencës njerëzore për të menduar si njerëzit dhe për të bërë gjëra edhe më të “të zgjuara” se ata vetë.

Aplikacionet specifike të IA përfshijnë sistemet e ekspertëve, përpunimin e gjuhës natyrore, njohjen e të folurit dhe vizionin e makinës⁴. Programimi i saj fokusohet në aftësitë njohëse që përfshijnë: (1) Të mësuarit - marrja e të dhënave dhe shndërrimi i tyre në informacione vepruese); (2) Arsytimi - zgjedhja e algoritmit të duhur për të arritur një rezultat të dëshiruar; (3) Vetëkorrigjimi - rregulli i vazhdueshëm i algoritmeve⁵ që ato të ofrojnë rezultatet më të sakta të mundshme; (4) Kreativiteti - përdorimi i rrjeteve memoriale, sisteme të bazuara në rregulla, metoda statistikore dhe teknika të tjera për të vlerësuar dhe gjeneruar imazhe, vepra dhe ide të reja.

2. Disa përkufizime të tjera kyçe që lidhen me IA⁶

IA nuk mund të funksionojë e vetme apo e pavarur, ajo është e ndërlidhur me fusha të tjera, në varësi të saj ose të ndërveprueshme, disa prej të cilave janë:

Inteligjenca e Përgjithshme Artificiale (AGI): Një term i përdorur për të përshkruar makinat e ardhshme që mund të përputhen dhe më pas të tejkalojnë gamën e plotë të aftësisë njohëse njerëzore në të gjitha detyrat me vlerë ekonomike.

IA gjeneruese: Një familje sistemesh të IA që janë të afta të gjenerojnë përmbajtje të re (p.sh., tekst, imazhe, audio ose asete 3D) bazuar në kërkesa.

⁴ Nga Nicole Laskowski: sipas drejtoreshës së lajmeve, redaktore për Industrinë, Linda Tucci CIO/IT Strategy.

⁵ Algoritëm: Një proces ose grup rregullash që duhen ndjekur në llogaritjet e zgjidhjes së problemeve, veçanërisht nga një kompjuter.

⁶ Përkufizimet e marra nga raporti i gjendjes së IA 2023, ChatGTP France, Entreprisedna.co, Futura-Sciences.com.

Modeli i gjuhës së zgjeruar (Large Language Model- LM): Një sasi e madhe të dhënash tekstuale të përdorura për të gjeneruar përgjigje të ngjashme me ato të një qenieje njerëzore dhe/ose për të parashikuar fjalën tjetër në një mënyrë të vetëmbikëqyrrur.

Përpunimi i gjuhës natyrore (Natural Language Processing -NLP): Aftësia e një programi për të kuptuar gjuhën njerëzore, ashtu siç flitet dhe shkruhet.

Agjenti i IA: Programe ose sisteme softuerësh që janë krijuar për të perceptuar mjedisin e tyre, për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë veprime në mënyrë autonome për arritjen e qëllimeve specifike. Agjenti IA përdor informacion nga rrethina e tij, mëson nga përvojat e tij dhe vepron për të përmbushur detyrat pa ndërhyrjen njerëzore.

Vizioni kompjuterik (Computer Vision - CV): Aftësia e një programi për të analizuar dhe kuptuar imazhet dhe videot.

Mësimi i Makinerisë (Machine Learning-ML): Është një shkencë për t'i bërë kompjuterët të mësojnë dhe të veprojnë ashtu si dhe njerëzit.

Mësimi në Thellësi (Deep Learning-DL): Rrjedh nga ML, i cili imiton punën e trurit njerëzor dhe mund të përpunojë, interpretojë dhe të përdorë grupe të dhënash, për të kryer detyra shumë më komplekse se njerëzit.

Sipas shkallës së efekteve, IA mund të klasifikohet në tre grupimet e mëposhtme:

- **IA e dobët (weak)**, është një sistem i dobët kompjuterik që mund të kryejë një detyrë të përcaktuar në mënyrë më efikase sesa njeriu, i cili ka gjetur zbatim në shumicën e aplikacioneve.
- **IA e fortë (strong)**, mund të tejkalojë arritjet njerëzore në çdo detyrë intelektuale. Për shembull, ne mund të shohim robotë me këtë lloj të inteligjencës artificiale, p.sh., robotët e çminimit, ku ata veprojnë sipas qëllimeve të tyre bazuar në mendimet e ndërgjegjshme.
- **Super IA (ASI)**, pritet të jetë në gjendje të tejkalojë njerëzit në pothuajse të gjitha fushat, por veçanërisht në krijimtarinë shkencore, logjikën dhe mençurinë, si dhe në aftësitë sociale. Gjithsesi sipas shkencëtarëve, kontributi njerëzor në procesin e aplikimit të IA në një moment mbetet i domosdoshëm, pasi motivet dhe aftësitë etike, intuitat dhe veçanërisht ato shpirtërore janë ekskluzivisht karakteristika njerëzore edhe nëse, në një farë mase, makinat mund t'i imitojnë ato.

3. Disa nga kompanitë në vendet e BE-së që po zhvillojnë IA.

BE-ja dhe vendet anëtare të saj i kanë kushtuar rëndësi të veçantë IA-së, e

cila vihet re në financimin për startup-et e specializuara në këtë teknologji me kërkesa të larta që ishte më shumë se 1.8 miliardë dollarë për vitit 2023. Shumë nga kompanitë kryesore të Evropës janë liderë në eksplorimin dhe aplikimin e IA-së, me zhvillimet që në përgjithësi janë përpara mesatares globale. Sipas të dhënave, në përgjithësi BE-ja nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë në IA-të ushtarake, por në mënyrë indirekte ajo ka një sërë mjetesh që mund të ndikojnë në këtë sektor, ku industria e mbrojtjes është njëra prej tyre. Disa kompani evropiane të IA, të cilat janë në kërkim të zonave të tregut dhe burimeve të financimit për të konkurruar në nivel global janë: Mistral AI, Aleph Alpha AI, Owkin AI, Helsing AI, etj. Vlen të theksohet se vetëm njëra prej tyre, përkatësisht Helsing AI ka aplikuar IA në fushën e mbrojtjes.

Megjithatë, për t'u zhvilluar më tej, kompanitë evropiane të teknologjisë të cilat planifikojnë aplikimin e IA në fushën ushtarake, nuk kanë nevojë vetëm për buxhetim, por edhe për infrastrukturë, kryesisht për qendrat e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave.

4. Strategjia e NATO-s për Inteligjencën Artificiale.

IA po ndryshon mjedisin global të mbrojtjes dhe të sigurisë, e cila ofron një mundësi të paprecedentë për të forcuar avantazhin teknologjik të vendeve të NATO-s, për të përballuar kërcënimet aktuale dhe së ardhmes në përmbushje të detyrave themelore të Aleancës, përkatësisht: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe siguria bashkëpunuese. Në këtë aspekt, NATO dhe vendet anëtare të saj janë angazhuar për bashkëpunim për çdo çështje që lidhet me IA për mbrojtjen dhe sigurinë transatlantike, e cila është e përcaktuar në Strategjinë e NATO-s për IA.

Në politikat dhe strategjinë e saj, NATO-ja udhëheq dhe inkurajon zhvillimin dhe përdorimin e IA në një mënyrë të përgjegjshme për qëllimet e mbrojtjes dhe të sigurisë së aleatëve. Rastet e përdorimit të IA, krijimi i strukturave dhe programeve të reja për funksionimin e saj, do të rrisin ndërveprimin brenda Aleancës, në drejtim të mbrojtjes dhe monitorimit të teknologjisë së IA. Gjithashtu, NATO synon rritjen e aftësive për të rinovuar atë në mënyrë periodike, duke adresuar konsideratat e politikave të sigurisë për funksionalizimin efektiv dhe mbrojtjen kundër kërcënimeve të mundshme.

Mbajtja e ritmeve të zhvillimit të IA, është e orientuar nëpërmjet një bashkëpunimi midis strukturave të Aleancës, vendeve anëtare dhe partnere të saj, sektorit privat dhe institucioneve shkencore. NATO-ja ka të përcaktuar në politikat e saj sigurimin e ekspertizës së talenteve të IA, ndërtimin e një infrastrukture të fuqishme dhe të sigurtë si dhe mbrojtjet e duhura kibernetike.

Mbi bazën e politikave të NATO-s për inovacionin, qendrat kombëtare të anëtarëve të saj për testimin e IA mund të mbështesin ambicien për zhvillimin

e kësaj shkence. NATO dhe aleatët janë të angazhuara me kompani të fuqishme teknologjike për të ndihmuar në formimin e zhvillimit të teknologjive në fushën e IA, duke krijuar një kuptim të përbashkët të mundësive dhe rreziqeve që dalin nga IA.

Në krye të kësaj strategjie qëndrojnë parimet e NATO-s të përdorimit të IA në fushën e mbrojtjes, në përputhje me vlerat, normat dhe të drejtën ndërkombëtare. Këto parime bazohen në angazhimet ekzistuese dhe të pranuara gjerësisht nga vendet e Aleancës. Parimet themelore të NATO-s për përdorimin e IA në fushën e mbrojtjes janë: ligjshmëria, përgjegjësia dhe llogaridhënia, shpjegimi dhe gjurmimi, besueshmëria, drejtimi, si dhe zbutja e paragjytimeve⁷.

NATO po punon për përcaktimin e standardeve ndërkombëtare të IA për të siguruar koherencë të plotë gjatë gjithë ciklit jetësor të funksionimit të saj. Një vëmendje e veçantë i kushtohet sektorit privat, ku përfshihen Big Tech, bizneset e reja, sipërmarrësit dhe ekspertët e kësaj fushe etj.

5. Aplikacionet aktuale më të dobishme ushtarake të IA në SHBA.

Globalisht, ka një prirje të dukshme drejt adoptimit të teknologjive të drejtuara nga IA në aplikimet ushtarake, me vendet e zhvilluara si SHBA-ja, Kina dhe Rusia që kryesojnë integrimin e IA në operacionet e mbrojtjes. Këto vende po investojnë shumë në kërkimin dhe zhvillimin e IA, me një theks të veçantë në zhvillimin e sistemeve autonome, analitikës parashikuese dhe mjeteve të zgjuara të mbështetjes së vendimeve që rrisin efikasitetin dhe efektivitetin e aftësive ushtarake.

Ushtria amerikane ka përdorur IA për shumë vite, madje edhe para se ajo të bëhej e zakonshme në jetën civile. Me kalimin e kohës, ajo është zhvilluar për të qenë në gjendje të kryejë punë më komplekse dhe në shumë drejtime, duke shmangur në maksimum kontributin e njeriut, por gjithnjë nën mbikëqyrjen tij. Aktualisht përdorimi i IA ka bërë hapa të jashtëzakonshëm në rritjen e aftësive të ushtrisë amerikane dhe në mbështetjen e realizimit me sukses të misioneve ushtarake.

Në nëntor 2023, Departamenti Amerikan i Mbrojtjes ka publikuar strategjinë e adaptimit të aftësive të avancuara të IA, me qëllim që të ruhet epërsia e vendimeve në fushën e betejës. Një strategji e tillë ka ndikuar në zhvillimin e IA dhe forcimin e avantazhin konkurrues të SHBA-ve në fushën e zhvillimit global teknologjik. “Ndërsa jemi fokusuar në integrimin e IA në operacionet tona me përgjegjësi dhe shpejtësi, arsyeja jonë kryesore për ta bërë këtë ka

⁷ Organizata e Atlantikut të Veriut, Strategjia e parë për Inteligjencën Artificiale, publikuar më 22 tetor 2021.

qenë e drejtpërdrejtë, sepse përmirëson avantazhin tonë të vendimmarrjes..... Ndërkohë, ndërsa kompanitë komerciale të teknologjisë dhe të tjerët vazhdojnë të shtyjnë përpara kufijtë e IA, ne po sigurohemi që të qëndrojmë në avantazh me largpamësi, përgjegjësi dhe një kuptim të thellë të implikimeve më të gjera për kombin tonë.”⁸

Po kështu, shefi i Departamentit të Shtetit për Mbrojtjen Digjitale dhe IA, Craig Martell ka theksuar se “Teknologjitë evoluojnë, gjërat do të ndryshojnë javën e ardhshme, vitin e ardhshëm, dekadën e ardhshme. Dhe ajo që fiton sot mund të mos fitojë nesër...”.

IA po zbatohet në shumë fusha të veprimtarisë ushtarake, siç janë: Grumbullimi, përpunimi, analizimi i të dhënave; Zhvillimi i simulimeve dhe veprimet konkrete luftarake; Planifikimi i operacioneve, marrja e vendimeve dhe ndjekja e zbatimit të tyre; Mbështetja logjistike dhe mjekësore, mirëmbajtja e sistemeve dhe transportimi i trupave; trajnimi i personelit dhe programet e arsimimit, etj. Megjithatë, për të qenë të dobishëm, sistemet duhet të zbatohen sipas praktikave më të mira dhe në mënyra sa më të përshtatshme.

Disa nga fushat kryesore që po përdoret teknologjia e IA-së në ushtrinë amerikane janë:

Sistemet Autonome të Armëve: Këto sisteme, të fuqizuara nga IA, mund të identifikojnë, gjurmojnë dhe angazhojnë në mënyrë autonome objektiva me përfshirje minimale njerëzore për të minimizuar rreziqet e dëmtimit njerëzor dhe material, duke përmirësuar efikasitetin e operacioneve ushtarake. Disa prej këtyre sistemeve janë: armët, sensorët, navigimi, mbështetja e aviacionit dhe mbikëqyrja e tyre, etj. Synimi kryesor është që t’i bëjnë operacionet më efikase dhe më pak të varura nga kontributi njerëzor.

Vendimmarrja strategjike: Përbën kombinimin e të kuptuarit etik të njerëzve me aftësitë e shpejta analitike të IA, e cila mund të përshpejtojë procesin e vendimmarrjes. IA është në gjendje të mbledhë, përpunojë e analizojë, me shpejtësi të madhe dhe saktësi të lartë, të dhëna nga burime të shumta për të ndihmuar drejtuesit në planifikim dhe vendimmarrje, sidomos në situata kritike. Ajo gjithashtu mund të krijojë simulime për të testuar skenarë të mundshëm, duke lejuar marrjen e vendimeve sa më të drejta, gjithnjë me mbikëqyrjen e ngushtë njerëzore.

Mjetet ajrore pa pilot UAV: Janë mjete, në të cilat ka gjetur përdorim të gjerë teknologjia e IA, duke sjellë në transformim rrënjësor në efikasitetin e tyre.

⁸ Zëvendëssekretare e Mbrojtjes Kathleen Hicks, gjatë ceremonisë së publikimit të strategjisë në Pentagon, 2 nëntor 2023.

Ndërsa për UAV-të e mëparshme operatorët njerëzorë të merrnin vendime thelbësore, përparimet në AI tani mundësojnë gjeneratën e fundit të UAV-ve, të operojnë në mënyrë autonome me ndërhyrje minimale nga operatori. Aplikimi i IA ka dhënë efikasitet edhe në grupet e UAV-ve ose të cilësuar si “tufa dronësh”, të cilët mund të përdoren në simulime, si dhe në operacione stërvitore aktuale.

Kërkimi dhe përpunimi i të dhënave: Është i dobishëm për filtrimin e shpejtë të të dhënave, zgjedhjen e informacionit më të vlefshëm, eliminimin e informacionit të përsëritur dhe reduktimin e gabimeve njerëzore. Kjo mund të lejojë personelin ushtarak të identifikojë modelet në mënyrë më efikase, të nxjerrë përfundime më të sakta dhe të krijojë plane veprimi bazuar në një pamje më të plotë të situatës. Mbi bazën e këtyre zhvillimeve, drejtuesit ushtarakë mund të formulojnë strategjinë e bazuar në një kuptim më të thellë të kushteve të krijuara dhe parashikimeve për të ardhmen.

Parashikimi, monitorimi i kërcënimeve dhe vlerësimi i situatës: Ky proces përdor operacione që sigurojnë dhe analizojnë informacione për të ndihmuar në shumë aktivitete të ndryshme ushtarake. Në lidhje me monitorimin e kërcënimeve ka sisteme pa pilot (përfshi dronët) që mund të kontrollohen nga distanca ose të dërgohen në një rrugë të llogaritur paraprakisht. Këto sisteme përdorin IA për të ndihmuar personelin në monitorimin e kërcënimeve dhe, në këtë mënyrë, për të shfrytëzuar ndërgjegjësimin e tyre për situatën. Dronët mund të monitorojnë zonat kufitare, të njohin kërcënimet dhe të alarmojnë ekipet e reagimit. Për më tepër, ato mund të forcojnë sigurinë e bazave ushtarake, si dhe të rrisin sigurinë e ushtarëve në luftime.

Lufta Elektronike: IA mund të analizojë sinjalet e radios dhe format e tjera të komunikimit elektronik për të lokalizuar pozicionet e armikut, për të ndërprerë rrjetet e komunikimit të tij dhe për të fituar një avantazh taktik kundër forcave kundërshtare.

Simulimi i stërvitjeve luftarake: Softuerët e simulimit të stërvitjes ushtarake kanë gjetur përdorim të gjerë në FA. Nëpërmjet aplikimit të IA ndërtohen modele të digjitalizuara që përgatisin ushtarët për përdorimin e sistemeve luftarake gjatë stërvitjeve dhe operacioneve. Me fjalë më të thjeshta, simulimi i stërvitjes ushtarake është në thelb një “luftë” virtuale që përdoret për të trajnuar ushtarët. Ato janë në gjendje të ofrojnë misione dhe detyra reale për ushtarët, për të siguruar që ata të fitojnë përvojën më të madhe të mundshme, përpara se të aplikojnë aftësitë e tyre në situata të jetës reale.

Edukimi ushtarak dhe programet arsimore: IA mund të përmirësojë trajnimin ushtarak dhe programet arsimore, nëpërmjet përdorimit të modeleve të gjuhëve të fuqizuara nga ana e saj, për të mundësuar futjen në përdorim të

materialeve të reja të trajnimit. Ajo gjithashtu mund të ndihmojë në vlerësimin e aftësive aktuale të studentëve dhe përshtatjen e trajnimit për nevojat e tyre specifike. IA bashkëbiseduese mund të ofrojë gjithashtu reagime të personalizuar për t'i ndihmuar studentët të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të ndihmojnë oficerët komandues të dinë se ku mund të ketë vështirësi një student i caktuar.

Ndërsa IA ka shumë potencial për aplikimet e trajnimit ushtarak, ajo kurrë nuk duhet të zëvendësojë tërësisht instruktorin/mësimdhënësin. Ky i fundit përcakton plan-programin e përgjithshëm, ndërsa IA mund të krijojë mësimet të individualizuara që instruktorët njerëzorë mund t'i shqyrtojnë më pas për saktësinë dhe çështje të tjera. Megjithatë, me ndihmën e IA, instruktori mund të krijojë dhe administrojë programe trajnimi më efektive, për shkak të vëmendjes së individualizuar ndaj studentëve që ai mund të mos jenë në gjendje t'i prodhojë, si nga shpejtësia dhe nga cilësia e tyre.

Njohja dhe klasifikimi i objektivave: IA mund të ndihmojë njohjen më të saktë të objektivave në mjedise luftarake, si: automjetet, avionët, anijet, sistemet luftarake, bazat e furnizimit, personeli, etj. Ajo mund të lejojë forcat e mbrojtjes të fitojnë një kuptim të detajuar të një zone operacioni, duke grumbulluar, ekzaminuar dhe analizuar raportet, dokumentet, lajmet dhe format e tjera të informacionit, shumë më shpejt se sa njerëzit. Sistemet e IA kanë aftësinë të parashikojnë sjelljen e armikut, të parashikojnë dobësitë, kushtet e motit dhe mjedisin, të vlerësojnë strategjitë e misionit dhe të sugjerojnë planet për zbatim. Kjo mund të kursejë kohë dhe burime njerëzore, duke i vendosur ushtarët një hap përpara objektivave të tyre, por si gjithmonë kërkon që njerëzit të marrin vendimin përfundimtar.

Siguria kibernetike: Edhe sistemet ushtarake shumë të sigurta mund të jenë të prekshme ndaj sulmeve kibernetike, ku IA mund të japë një ndihmë e madhe. Sulmet mund të vënë në rrezik informacionin e klasifikuar apo të dëmtojnë një sistem krejtësisht, gjë që mund të rrezikojë personelin ushtarak dhe të rrezikojë realizimin e misionit. IA ka aftësinë për të mbrojtur programet, të dhënat, rrjetet dhe kompjuterët nga personat që nuk janë të autorizuar për t'iu qasur atyre. Ajo ka gjithashtu aftësi për të studiuar modelet e sulmeve kibernetike dhe për të formuar strategji mbrojtëse për të luftuar kundër tyre. Këto sisteme mund të njohin sjelljet më të vogla të sulmeve, shumë përpara se të hyjnë në një rrjet. Gjenerimi i skenarëve dhe aftësitë e komunikimit mund të përmirësojnë gjithashtu sigurinë kibernetike në mjediset ushtarake. Me aftësinë për të analizuar sasi të mëdha të dhënash dhe për të gjetur modele, IA mund të zbulojë dhe neutralizojë kërcënimet e mundshme dhe të përdorë analitikë parashikuese për të ndihmuar në parashikimin e sulmeve të ardhshme.

Menaxhimi i logjistikës, furnizimi dhe transporti: IA mund të ndihmojë

operacionet logjistike duke optimizuar planifikimin e rrugës, kontrollin e inventarit, shpërndarjen e burimeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe ulur kostot. Logjistika dhe transporti është padyshim jetik për suksesin e operacioneve ushtarake. IA është në gjendje të luajë një rol në transportin e municioneve, mallrave, armatimeve dhe trupave. Ajo mund të ulë kostot e transportit dhe të zvogëlojë nevojën për kontributin e njeriut, për shembull, duke përcaktuar rrugën më efikase për të udhëtuar në kushtet aktuale. IA gjithashtu mund të identifikojë paraprakisht problemet për flotat ushtarake në mënyrë që të rritet efikasiteti i performancës së tyre.

Diagnostikimi dhe trajtimi mjekësor: Mjekët ashtu si dhe të gjithë ushtarakët e tjerë që marrin pjesë në luftime, duhet të marrin vendime në situata të vështira. IA mund të ndihmojë personelin mjekësor në diagnostikimin e lëndimeve, përshkrimin e trajtimeve dhe ofrimin e kujdesit të përshtatur në mjediset luftarake. Ky proces mundëson aksesin e të dhënave që përmbajnë raste të traumave mjekësore, të cilat përfshijnë diagnoza, grupe shenjash vitale, medikamente, të dhëna, trajtime dhe rezultate. Më pas këto të dhëna kombinohen për të dhënë indikacione, paralajmërime dhe sugjerime për trajtim. IA nuk është e kualifikuar për të marrë vendime mjekësore, por mund të sigurojë analiza të shpejta për t'u dhënë mjekëve më shumë informacion mbi të cilin mund të bazojnë vendimet e tyre.

6. Kompanitë që kanë aplikuar inteligjencën artificiale në sektorin e mbrojtjes.⁹

Disa nga kompanitë më të fuqishme amerikane, të cilat po përdorin teknologjinë e inteligjencës artificiale në fushën e mbrojtjes janë:

- 1) **Anduril**, e cila prodhon pajisje mbrojtëse, duke përfshirë dronët dhe kullat e vëzhgimit që lidhen me një platformë të përbashkët softuerësh të emërtuar “Lattice OS”.
- 2) **Rafael**, është kompani izraelite e cilësuar si Laborator Kombëtar i Mbrojtjes për zhvillimin e armëve dhe teknologjisë ushtarake brenda Ministrisë së Mbrojtjes të Izraelit.
- 3) **L3Harris**, është një lider në aviacionin ushtarak e përshtatur me pajisjet elektronike për të ofruar zgjidhje të besueshme për sfidat ushtarake për SHBA-të dhe aleatët.
- 4) **Palantir**, ndihmon ushtrinë amerikane të përdorë njohuritë e IA për të marrë vendime të shpejta në fusha të shumta në përmbushje të misionit.

⁹ Marcus Law, Revista për Teknologjinë, 7 mars 2023.

Kjo siguron që të dhënat të jenë të aksesueshme në të gjitha nivelet për vendimmarrje të shpejtë dhe të sa më të sigurtë.

- 5) **Grupi Thales**, është një kompani shumëkombëshe e mbrojtjes dhe e hapësirës ajrore që ofron zgjidhje të avancuara teknologjike në fushat e IA, sigurisë kibernetike dhe sistemeve autonome.
- 6) **IBM**, është një korporatë teknologjike shumëkombëshe amerikane me seli në Armonk, Nju Jork dhe e pranishme në mbi 175 vende. Ajo mund të ndihmojë departamentet qeveritare dhe korporatat të kalojnë në një mjedis të avancuar hibrid të bazuar në renë kompjuterike të ndërtuar mbi teknologjinë që është krijuar për përmbushje të misionit të saj.
- 7) **Raytheon Technologies**, është një kompani shumëkombëshe e mbrojtjes dhe e hapësirës ajrore që ofron zgjidhje të avancuara teknologjike në fushat e sigurisë kibernetike dhe luftës elektronike.
- 8) **Northrop Grumman**, është një kompani amerikane shumëkombëshe e teknologjisë ajrore, e cila projekton, zhvillon, ndërton dhe mbështet produktet më të avancuara në botë, si: avionët të avancuar, anijet kozmike, sistemet e sigurisë kibernetike, radarët, etj.
- 9) **Lockheed Martin**, është një korporatë amerikane e hapësirës ajrore, armëve, mbrojtjes, sigurisë së informacionit dhe teknologjisë me interesa mbarëbotërore. Ajo u formua nga bashkimi i Lockheed Corporation me Martin Marietta në mars 1995. Ajo ka selinë në North Bethesda, Maryland, D.C. Vitin e kaluar kompania njoftoi versionin e parë të fabrikës së saj të IA, një ekosistem i brendshëm për zhvillimin dhe prodhimin e zgjidhjeve të IA.
- 10) **Sistemet BAE**, është një kompani shumëkombëshe e mbrojtjes, sigurisë dhe hapësirës ajrore, e cila punon në teknologjitë e avancuara në IA, sigurinë kibernetike dhe luftën elektronike.

7. Avantazhet dhe dizavantazhet.

Avantazhet dhe dizavantazhet e aplikimit të IA-së në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore:

Avantazhet:

- Përpunon të dhëna dhe bën parashikime më të sakta sesa njerëzit dhe lehtëson punën e studiuesve.
- Zgjidh të dhëna të vështira, bën punë të orientuar dhe mjaft të detajuar, krahasuar me njerëzit.
- Jep rezultate të qëndrueshme dhe rrit produktivitetin.

- Rrit transparencën dhe ndikon në marrjen e vendimeve.
- Kursen fuqinë punëtore.
- Agjentët virtualë të IA janë të disponueshëm gjatë gjithë kohës (24/7).

Disavantazhet:

- Ofron shërbim të shtrenjtë, pasi kanë kosto të lartë të mjeteve kompjuterike.
- Kërkon ekspertizë të thellë teknike, e cila jepet nga një numër i kufizuar personeli të kualifikuar.
- Reflekton paragjykime në menaxhimin e të dhënave, duke rritur shkallën e manipulimit të tyre.
- Nuk ka kreativitet, duke të kufizuar në mendim dhe veprim në spektrin e gjerë të jetës, duke rritur shkallën e pasivitetit në veprimtarinë e përditshme.
- Eliminon vendet e punës, duke rritur shkallën e papunësisë.

Avantazhet dhe dizavantazhet e aplikimit të IA-së në fushën e mbrojtjes:

Avantazhet:

- IA ka potencialin për të revolucionarizuar çështjet ushtarake globale, e cila përbën një revolucion teknologjik me efekt ndikues në ekuilibrin strategjik ndërkombëtar, duke e bërë atë objekt i debatit intensiv.
- Aplikimi me përpikëri i IA-së mund të përmirësojë funksionimin e shumë aspekteve të operacioneve ushtarake, duke rritur produktivitetin dhe zvogëluar kontribut njerëzor.
- IA përdor metodat e mbledhjes dhe analizës së informacionit për të ofruar udhëzime dhe drejtime që ndihmojnë drejtuesit ushtarakë të përmirësojnë të kuptuarit e mjedisit operacional, të zvogëlojnë ngarkesën njohëse të situatës dhe të mbështesin në marrjen e vendimeve të drejta për realizimin me sukses të misionit.
- Përdorimi i AI i jep mundësi njerëzve për të deleguar detyra me rrezikshmëri të lartë tek agjentët jo njerëzor, e cila rrit shkallën e sigurisë për mbrojtjen e tyre.

Dizavantazhet:

- Rreziqet që lidhen me përdorimin e IA në aplikimet ushtarake janë të shumanshme dhe kërkojnë shqyrtim të kujdesshëm dhe zgjidhje gjithëpërfshirëse.
- Duke qenë se IA kërkon një sasi të madhe të dhënash për menaxhim, mund të krijohen hapësira për manipulim të tyre. Mbi këtë bazë kërkohen masa shtesë për mbrojtje në përballimin e kërcënimeve.

- Aplikimi i IA ngre shqetësime për zvogëlimin e rolit kritik të gjykimit apo humbjen e kontrollit njerëzor mbi përdorimin e pajisjeve luftarake, që çojnë në nxitjen e konflikteve, kryerjen e veprimeve të pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare humanitare, si dhe shmang llogaridhënien për veprimet e papërgjegjshme.
- Përhapja e teknologjisë ushtarake së AI, ngre shqetësime serioze për përhapjen e saj tek aktorët joshitetërorë dhe kombet mashtruese, të cilët janë vështirë për t'u menaxhuar.

Përfundime

Inteligjenca artificiale po hap padyshim perspektiva të reja në teknologjitë e mbrojtjes, ku synohen pritshmëri të mëdha, në lidhje me aplikimin e teknikave të kësaj shkence në disa fusha ushtarake. Nga ana tjetër, ka ende faktorë pengues dhe çështje të pazgjidhura për kërkime të mëtejshme në mënyrë që të përmbushen këto pritshmëri. Nga analiza e bërë, konstatohet se kjo situatë nuk do të thotë se duhet të jemi skeptikë në lidhje me zbatueshmërinë e përhapur të IA por përkundrazi, të kuptojmë se për kërkim dhe zhvillim duhet më shumë përpjekje intelektuale dhe burime financiare. Zhvillimet e fundit në IA po ndryshojnë rrënjësisht fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë globale për vendet e BE-së dhe NATO-s. Për të përfutur plotësisht nga këto teknologji, është thelbësore të krijohen korniza të përshtatshme rregullatore dhe etike, të rriten investimet në kërkim dhe zhvillim dhe të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, inteligjenca artificiale mund të përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive për të përmirësuar sigurinë dhe mbrojtjen globale.

Disa rekomandime për zhvillimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në Forcat e Armatosura.

Menaxhimi i burimeve njerëzore: Nëpërmjet zbatimit të IA mund të arrihet modernizimi i menaxhimit të sistemit të burimeve njerëzore, duke përfshirë gjithë ciklin jetësor të tyre: rekrutim, caktim në detyrë, trajnim, mbështetje sociale, promovim dhe nxjerrje në lirim ose në pension.

Arsimimi dhe trajnimi: Organizimi i programeve të arsimimit dhe të trajnimit për personelin ushtarak në përdorimin dhe mirëmbajtjen e teknologjive të avancuara të IA, duke synuar automatizimin e gjuhës së komunikimit, si dhe të procesit të mësimdhënies e të vlerësimit. Inkurajimi i edukimit të vazhdueshëm për të mbajtur stafin të përditësuar me zhvillimet e fundit teknologjike dhe taktikat e reja në aspektin e ndërtimit të kurrikulave, mësimdhënie dhe kontrollit të njohurive.

Zhvillimi i politikave, strategjive dhe doktrinë ushtarake: Përshtatja e

teknologjisë së inteligjencës artificiale në FA, duke adresuar çështjet që lidhen me përdorimin me efikasitet të tyre, në përputhje me procedurat etike dhe të sigurisë së informacionit. Integrimi i kapaciteteve të IA në strategjitë dhe doktrinat ushtarake si dhe në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, do të ndikojë në rritjen e efektivitetit dhe gatishmërisë së Forcave të Armatosura.

Integrimi i teknologjive të inteligjencës artificiale: Përshtatja i sistemeve të IA për përmirësimin e zbulimit dhe mbikëqyrjes, duke përdorur dronë të pajisur me teknologji të avancuar, është e nevojshme për të monitoruar mjedisin dhe për të identifikuar kërcënimet në kohë reale. Përdorimi i algoritmeve të IA do të shërbejë për analizimin e të dhënave të zbulimit dhe të inteligjencës, për të identifikuar modelet e kërcënimeve dhe për të parashikuar veprimet e mundshme të kundërshtarëve.

Mbrojtja kibernetike: Investimi në infrastrukturën kibernetike nevojitet për të mbrojtur sistemet ushtarake dhe rrjetet e informacionit nga sulmet kibernetike. Përdorimi i saj vlen për të zbuluar në kohë reale anomalitë dhe kërcënimet kibernetike, duke përmirësuar mbrojtjen ndaj sulmeve të sofistikuar.

Përmirësimi i logjistikës dhe i mbështetjes: Përdorimi i IA për të synuar optimizimin e zinxhirit të furnizimit dhe logjistikës ushtarake, duke siguruar që burimet të jenë në dispozicion në vendin dhe në kohën e duhur. Implementimi i sistemeve të IA për menaxhimin e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve ushtarake, përbën hapa të rëndësishëm për të parashikuar dhe parandaluar defektet dhe për të siguruar gatishmërinë operacionale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar: Zgjerimi i bashkëpunimit me vendet aleate të NATO-s do t'i shërbejë shkëmbimit të njohurive mbi burimet dhe praktikat më të mira në fushën e IA dhe mbrojtjes kibernetike. Angazhimi në projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore me vendet e NATO-s dhe BE-së për të përfutur nga teknologjitë më të fundit dhe inovacionet, për të siguruar një ndërveprim në masat e përbashkëta për këtë qëllim.

Implementimi i rekomandimeve të mësipërme mund të ndihmojë Forcat e Armatosura Shqiptare të përmirësojnë procesin e planifikimit të operacioneve, kapacitetet operacionale për t'u përshtatur me sfidat e reja të zhvillimit teknologjik, sigurisë globale, si dhe për të kontribuar në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në rajon e më gjerë. Këto përmirësime teknologjike do të jenë mjaft të vlefshme në forcimin e mbrojtjes kombëtare, rritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar brenda NATO-s dhe me vendet e BE-së.

Bibliografia:

1. U.S. DOD, *Summary of the 2018 Department of Defense Artificial Intelligence Strategy: Harnessing AI to Advance our Security and Prosperity* (Washington, DC: U.S. DOD, 2018), 5. Shih: <https://media.defense.gov/2019/Feb/12/2002088963/-1/-1/1/SUMMARY-OF-DOD-AI-STRATEGY.PDF>.
2. “Deputy Secretary of Defense Kathleen Hicks’ Remarks: ‘Unpacking the Replicator Initiative’ at the Defense News Conference (As Delivered),” U.S. DOD, 6 September 2023. Shih: <https://www.defense.gov/News/Speeches/Speech/Article/3517213/deputy-secretary-of-defense-kathleen-hicks-remarks-unpacking-the-replicator-ini/>.
3. “DOD Adopts Ethical Principles for Artificial Intelligence”, U.S. DOD, 24 February 2020. Shih: <https://www.defense.gov/News/Releases/Release/Article/2091996/dod-adopts-ethical-principles-for-artificial-intelligence/>.
4. James Johnson, *Artificial Intelligence and Future Warfare: Implications for International Security*, Defense and Security Analysis 35, no. 2 (2019): 158. Shih: <https://doi.org/10.1080/14751798.2019.1600800>.
5. STAND-TO, Divizioni i Mediave Online dhe Sociale (The management of the Online and Social Media Division - OSMD, Zyra e Shefit të Çështjeve Publike (The Office of the Chief of Public Affairs (OCPA). U.S. Army STAND-TO! | Army Organic Industrial Base Modernization Implementation Plan
6. M. L. Cummings, *Artificial Intelligence and the Future of Warfare*, Institute of International Affairs London, London, UK, 2017.
7. C.H. Heller, *The future navy-near-term applications of artificial intelligence*, Naval War College Review, vol. 72, 2019. View at: Google Scholar
8. J. Dalzochio, R. Kunst, J. L. V. Barbosa et al., *Predictive maintenance in the military domain: a systematic review of the literature*, ACM Computing Surveys, vol. 55, 2023. View at: Publisher Site | Google Scholar.

Inteligjenca Artificiale dhe Siguria Kombëtare

Kolonel (R) Shyqyri DEKAVELLI

Ish-drejtor i DSIK

Trajtesë e shkurtuar.

Siguria kombëtare ose mbrojtja kombëtare është siguria dhe mbrojtja e një shteti sovran, duke përfshirë qytetarët, ekonominë dhe institucionet e tij, e cila konsiderohet si detyrë e qeverisë. E konceptuar fillimisht si mbrojtje kundër sulmeve ushtarake, siguria kombëtare kuptohet gjerësisht se përfshin edhe dimensione joushtarake, të tilla si: siguria nga terrorizmi, minimizimi i krimit, siguria ekonomike, siguria e energjisë, siguria mjedisore, siguria ushqimore dhe siguria kibernetike.

Kohët e fundit siguria kombëtare po ndikohet gjerësisht nga aplikimi i inteligjencës artificiale.

Ndikimi i inteligjencës artificiale në sigurinë kombëtare është i gjerë, duke paraqitur një sërë avantazhesh që mund të forcojnë ndjeshëm kapacitetet mbrojtëse të një vendi. Aftësia e tij për të përpunuar dhe analizuar sasi të mëdha të dhënash me shpejtësi të paarrtshme nga analistët njerëzorë është një nga avantazhet e tij kryesore. Inteligjenca artificiale luan një rol kyç në përpunimin e sasive të mëdha të të dhënave, duke u mundësuar profesionistëve të sigurisë kombëtare të fitojnë njohuri dhe të marrin vendime të sakta në një

shkallë dhe shpejtësi të jashtëzakonshme. Aftësia e saj për të analizuar burime të ndryshme të të dhënave në të njëjtën kohë ka revolucionarizuar mbledhjen e informacionit.

Përdorimi i inteligjencës artificiale në teknologjitë e sigurisë mund të ofrojë përfitime të rëndësishme për sigurinë operacionale, të tilla si rritja e probabilitetit dhe shpejtësisë së zbulimit, zvogëlimi i ngarkesës dhe lodhjes së operatorit, si dhe ndihmon për të përqendruar vëmendjen e personelit të sigurisë atje ku është më e nevojshme. Inteligjenca artificiale mund të monitorojë aktivitetin e rrjetit, të identifikojë anomalitë dhe t'i japë përparësi sinjalizimeve. Mund të analizojë vëllime të mëdha të dhënash, të identifikojë përmbajtje mashtruese ose të dyshimta dhe të izolojë kërcënimet.

Duke automatizuar detyrat rutinë manuale, inteligjenca artificiale mund të luajë një rol kryesor në parandalimin e rrjedhjeve aksidentale të të dhënave dhe gabimeve të tjera të paqëllimshme që mund të rrezikojnë sigurinë. Inteligjenca artificiale gjithashtu pajis ekipet e sigurisë kibernetike me mjete dhe njohuri të fuqishme që përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e tyre.

Fjalët kyçe: Inteligjenca artificiale, siguria kombëtare, policimi parashikues, shërbimet inteligjente, siguria kibernetike.

1. Aplikimi i inteligjencës së ngushtë artificiale, inteligjencës së përgjithshme artificiale dhe super-inteligjencës artificiale në ushtri.

Inteligjenca artificiale pranohet gjerësisht se është një nga krijeset më dramatike të lojërave teknologjike të epokës sonë. Ajo tashmë ka filluar dhe pritet të vazhdojë për të pasur një ndikim të madh në shumicën e sferave të jetës private dhe publike. Mbrojtja dhe siguria nuk do të bëjnë përjashtim. Por, si saktësisht do të ndikohen këto? Mendimi më aktual se si inteligjenca artificiale do të ndikojë në mbrojtje dhe siguri është se inteligjenca artificiale do të rrisë shumë aplikimet e saj në mbrojtje. Inteligjenca artificiale mund të ketë një ndikim më të thellë transformues në mbrojtje dhe siguri, pra do të bëhen gjëra të ndryshme në mënyra të reja.

Përparimet e mëdha të inteligjencës artificiale, veçanërisht në dy vitet e fundit me krijimin e mjeteve të ndryshme të të mësuarit të thellë, tashmë janë duke fshirë shumë praktika tradicionale në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Shembujt përfshijnë zbulimin shkencor, përkthimin makinerik, asistentët dixhitale, kërkimin, lëvizshmërinë, shëndetin, etj. Në sfondin e këtyre zhvillimeve të stuhishme, vlerësohen tre hapa të rëndësishëm në zbatimin e inteligjencës artificiale në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë: vlerësohet se *inteligjenca e ngushtë artificiale* (Artificial Narrow Intelligence) barazohet ose tejkalon inteligjencën njerëzore për detyra specifike, *inteligjenca e*

përgjithshme artificiale plotëson gamën e plotë të performancës njerëzore për çdo detyrë, ndërsa super-inteligjenca artificiale e tejkalon 13 herë inteligjencën artificiale.

Mbrojtja tani është fokusuar në aplikimet e inteligjencës së ngushtë artificiale, e cila ndihmon operatorët aktualë dhe luftëtarët të kryejnë (në thelb) detyrat e tyre aktuale brenda paradigëmës aktuale. Vihet re se si disa nga lojtarët kryesorë në fushën e mbrojtjes si Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Rusia janë duke u përqendruar në aplikimet e inteligjencës së ngushtë artificiale. Përdorimi i inteligjencës së ngushtë artificiale, inteligjencës së përgjithshme artificiale dhe super inteligjencës artificiale do të bëjë të mundur, monitorimin e përparësive në fushën e mbrojtjes, rishikimin e fuqisë së strukturës aktuale të mbrojtjes, identifikimin e sfidave dhe mundësive afatshkurtra, identifikimin e sfidave dhe mundësive afatgjata. Inteligjenca artificiale është duke luajtur një rol gjithnjë e më të fuqishëm në këtë transformim përmes një kombinimi të të mësuarit të thellë, përpunimit të dhënave të shumta me performancë të lartë. Studiues të shquar të inteligjencës artificiale theksojnë se duhet të monitorojmë e të shqyrtojmë me kujdes të madh implikimet e përparimeve të inteligjencës artificiale për mbrojtjen dhe sigurinë sepse, super-inteligjenca artificiale, d.m.th., inteligjenca që është më e lartë se ajo e njerëzve, ka të ngjarë të paraqesë sfida mjaft unike për planifikuesit e mbrojtjes dhe sigurisë. Shfaqja e inteligjencës super-njerëzore është sigurisht një tranzicion që kërkon një konsideratë jashtëzakonisht të kujdesshme njerëzore.

Ky informacion mund të kontribuojë në një rishikim më themelor të mënyrës se si inteligjenca artificiale mund të ndikojë në të ardhmen e mbrojtjes dhe sigurisë dhe se si mund të shfrytëzohen me përgjegjësi zhvillimet në këtë fushë për të arritur zgjidhje më të qëndrueshme të mbrojtjes dhe sigurisë. Sistemet ushtarake, përfshirë armët, do të jenë inteligjente, shumë të shpejta, shumë të vegjël dhe do të krijojnë një mjedis e mundësi komplekse që njerëzit t'i monitorojnë, kontrollojnë dhe drejtojnë ato. Sistemet e bazuara në informacion do të çojnë në një mbingarkesë të të dhënave që do të jenë një sfidë për njerëzit që të kenë mundësi të kalojnë drejtpërdrejt në vendimmarrje. Armët dhe sistemet e tjera ushtarake tashmë nën zhvillim do të funksionojnë në nivele gjithnjë e më të larta të kompleksitetit dhe përgjegjësisë, pa ndërhyrje dhe kontroll domethënës njerëzor. Në konfliktet e ardhshme ushtarake, parimi do të jetë të veprosh me shpejtësi. Arkitekturat ushtarake të nesërme do të përbëhen nga një grup i ri i sensorëve të bazuar në det, tokë dhe hapësirë, mjete ajrore luftarake pa pilot dhe teknologji të mbrojtjes nga raketat. Forcat ushtarake do të jenë edhe më të shpejta edhe të manovrueshme.

Forcat ushtarake kështu do të jenë në gjendje për të krijuar një mbrojtje të fortë dhe një sulm efektiv për të shkatërruar aftësinë e një kundërshtari. Për të

ekzekutuar procesin, “vëzhgoni, orientoni, vendosni dhe veproni” më shpejt se armiku është në konceptin thelbësor të luftës digjitale dhe informacionit në të ardhmen. Sistemet e automatizuara, të ndihmuara nga inteligjenca artificiale në një formë apo tjetër, mund të jenë një rrugëdalje për këtë problem.

Përparimet e fituara në fushën e teknologjisë së inteligjencës artificiale mund të përdoren nga sistemet pa pilot, për të qenë në gjendje të vlerësojnë situatat operacionale dhe taktike dhe të vendosin për një veprim të duhur. Informacioni do të drejtojë suksesin e komandimit dhe kontrollit. Këto sisteme do të mbledhin të dhëna, do të kenë aftësinë për të analizuar të dhënat dhe për të dhënë rekomandime komandantëve.

Metodologjitë e inteligjencës artificiale po zbatohen për të mbështetur vendimmarrjen në të gjitha nivelet e operacioneve ushtarake siç janë vlerësimi i gatishmërisë së forcës, besueshmëria dhe aftësia, planifikimi i misioneve komplekse dhe integrimi i të dhënave nga burime të shumta.

Kërkimet në fushën e inteligjencës artificiale po adresojnë gjithashtu sfidat e paraqitura, duke mbështetur vendimmarrjen e tillë në mjedise që ndryshojnë me shpejtësi. Përdorimi i një teknologjie të tillë hap mundësi të pafundme në ushtri. Inteligjenca artificiale sistemon dhe automatizon detyrat intelektuale dhe prandaj është potencialisht e rëndësishme për çdo sferë të aktivitetit intelektual njerëzor. Në një kuptim, është një fushë me të vërtetë universale. Qeveritë dhe në veçanti ushtarakët, gjithashtu kanë një interes masiv në shpejtësinë dhe saktësinë e ofruar nga inteligjenca artificiale. Ritmi i shpejtë me të cilin po zhvillohen kërcënimet globale kërkon qasje të reja dhe mendime të reja për mënyrën se si të zhvillohen idetë dhe teknologjia. Financimet në teknologji do të kërkojnë projekte pioniere se si inteligjenca artificiale dhe automatizimi mund të mbështesin forcat e armatosura në punën e tyre thelbësore të përditshme. Këto projekte do të shikojnë se si katër konceptet si: automatizimi, autonomia, mësimi makinerik dhe inteligjenca artificiale mund të integrohen në sistemet ushtarake dhe se si ato mund të shfrytëzohen për të rritur reagimin ndaj kërcënimeve të mundshme dhe aktuale.

Kjo do të sigurojë që mbrojtja të mbetet një forcë efektive, e aftë në një peizazh teknologjik që ndryshon me shpejtësi. Një përshtatje e tillë është një përgjigje e nevojshme për natyrën gjithnjë në ndryshim të konfliktit ndërshtetëror. Ky shpërthim i ngjarjeve të shumta më të vogla kërkon që forcat e mbrojtjes të jenë shumë më të vetëdijshme për atë që po ndodh në botën përreth tyre. Strukturat ushtarake tashmë po përballen me mbingarkesë informacioni me mijëra burime të të dhënave dhe informacionit të inteligjencës. Duke shfrytëzuar automatizmin dhe inteligjencën artificiale me aftësitë dhe përvojën e jetës reale mund të revolucionarizohet koordinimi dhe bashkëveprimi midis strukturave të ndryshme ushtarake në interes të mbrojtjes së vendit.

Shqetësimi i ushtarakëve në përgjithësi për përdorimin inteligjencës artificiale është në rritje. Qeveritë e vendeve të ndryshme po rrisin investimet e tyre në inteligjencën artificiale ushtarake, Pra, përveç se është e ardhmja e gjithçkaje tjetër, inteligjenca artificiale ka të ngjarë të jetë e ardhmja e luftës. Ajo do të përpunojë gjithnjë e më shumë informacione të lidhura me mbrojtjen, do të filtrojë të dhëna të tilla për kërcënimet më të mëdha, do të marrë vendime mbrojtëse bazuar në algoritmet e saj të programuara dhe ndoshta edhe robotë të drejtpërdrejtë luftarakë. Dronët dhe robotët mund të zëvendësojnë deri në një të katërtën e trupave në luftime deri në vitin 2030. Kjo ka shumë të ngjarë të bëjë ushtarakët “më të fortë” dhe “më të aftë”, por mund të shkaktojë edhe humbjen e jetëve të pafajshme dhe ndoshta edhe përshkallëzimin në luftë të hapur. Skeptikë të përdorimit të inteligjencës artificiale shprehen se sistemeve të automatizuara të mbrojtjes nuk mund t’u besohet gjithmonë.

2. Zbatimi i inteligjencës artificiale në polici.

Agjencitë e zbatimit të ligjit janë përgjegjëse për sigurinë publike dhe duhet të trajtojnë të gjitha sfidat duke shfrytëzuar inteligjencën artificiale. Për fat të mirë, oficerët e policisë janë në gjendje të mbështeten në teknologji për shumë pjesë të punës së tyre. Vitet e fundit, inteligjenca artificiale është bërë një aspekt i rëndësishëm i punës së policisë në të gjithë botën. Ndërsa teknologjia e bazuar në inteligjencën artificiale bëhet gjithnjë e më thelbësore për strukturat e zbatimit të ligjit, fusha si parandalimi dhe parashikimi i krimit po kalojnë ndryshime të mëdha. Agjencitë e zbatimit të ligjit tashmë po shfrytëzojnë potencialin e inteligjencës artificiale në disa mënyra të rëndësishme.

Teknologjia e njohjes së fytyrës është thelbësore për forcat e policisë. Oficerët e policisë përdorin njohjen e fytyrës për të identifikuar kriminelët në arrati dhe personat e zhdukur duke përdorur të dhëna të imazhit. Nëse keni parë ndonjëherë pamje nga një kamerë rruge, ju e dini se sa me cilësi të ulët janë këto imazhe. Siç mund ta imagjinoni, vlerësimi i këtyre imazheve për informacionin kryesor është i vështirë dhe kërkon shumë punë. Shumë departamente policie nuk kanë as njerëz ose specialistë të mjaftueshëm për të trajtuar vëllimin e analizës së imazhit të nevojshëm për të zgjidhur të gjitha rastet e tyre.

Inteligjenca artificiale premton saktësi më të madhe veprimi, nuk mjaftohet vetëm me përputhjen e fytyrave të njerëzve por kursen edhe kohën e oficerëve të policisë. Disa teknologji të inteligjencës artificiale sot janë madje mjaft të përparuara për të gjetur një fytyrë të vetme në një turmë në një stadium, diçka që kohët e fundit e ndihmoi Kinën të kapte një kriminel në një event sportiv të mbushur plot me njerëz.

Në shumicën e qyteteve kamerat janë kudo në rrugë dhe në biznese. Agjencitë

e zbatimit të ligjit shpesh mbështeten në këto pamje për të analizuar ngjarjen që ka ndodhur dhe për të kapur kriminelët. Inteligjenca artificiale mund të bëjë jo vetëm njohjen e fytyrës në këto imazhe, por gjithashtu identifikon objekte dhe aktivitete komplekse si aksidentet automobilistike që ndodhin. Identifikimi i objekteve është veçanërisht i rëndësishëm për oficerët e policisë që përpiqen të monitorojnë ngjarje të mëdha, të tilla si festivalet e muzikës, aktivitetet sportive, maratona, etj. Për shkak se ata nuk mund të jenë në shumë vende në të njëjtën kohë, oficerët e policisë mund të mbështeten në inteligjencën artificiale për të marrë një sinjal nëse dikush në zonë ka një armë ose po vepron në mënyrë të pazakontë dhe mund të jetë një kërcënim për njerëzit.

Përmes analizimit të filmimeve në rrugë, intelijenca artificiale mund të identifikojë automjetet bazuar në karakteristikat e përcaktuara. Kjo bëhet e dobishme kur oficerët kërkojnë një automjet të vjedhur ose një kriminel në arrati dhe kanë nevojë për rezultate të shpejta. Agjencitë e zbatimit të ligjit po punojnë gjithashtu me kamera dronesh, të cilat u lejojnë atyre të eksplorojnë më shumë zona dhe të përfshihen në përpjekje më të shpejta për kërkim-shpëtim. Këta dronë janë të pajisur natyrshëm me pajisjet e inteligjencës artificiale të afta për njohjen e fytyrës dhe objektit.

Policimi parashikues i inteligjencës artificiale i referohet aftësisë për të parashikuar se ku do të ndodhin krimet, individët që do t'i kryejnë ato, llojet e krimit dhe cilët do të jenë viktimat. Departamentet e policisë sapo kanë filluar të testojnë sistemet parashikuese të policisë. Këto sisteme janë mjaft të rëndësishëm në parashikimin dhe parandalimin ideal të krimeve. Kur bëhet fjalë për të parashikuar vendet e krimit, algoritmet mund të analizojnë nivelet e krimit në zona të ndryshme dhe të zhvillojnë një hartë të pikave të nxehta të krimit. Kjo i thotë policisë të synojë këto zona për patrullim dhe mbikëqyrje shitesë.

Inteligjenca artificiale është gjithashtu në gjendje të përshkruajë një pamje më të mirë se kush rrezikon të kryejë një krim dhe kush ka të ngjarë të ri veprojë pasi të lirohet nga burgu bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizat e modeleve historike. Natyrisht në lidhje me këtë informacion debatohet shumë ndërkohë që përdorimi i kësaj praktike rritet vazhdimisht. Policimi parashikues mund të jetë më i dobishëm në identifikimin e viktimave të mundshme të krimeve në të ardhmen.

Të gjitha forcat e policisë nuk mund të zëvendësohen me robotë, por fakt është që departamentet e policisë po i drejtohen robotëve për të trajtuar detyra që variojnë nga më të zakonshmet deri te më të rrezikshmet. Disa vende vërtet po testojnë robotë që veprojnë si zëvendësues të oficerëve të policisë. Dubai po eksperimenton me robotë rrugësh që mund të transmetojnë të dhëna përsëri në zyrat qendrore për t'u vlerësuar nga njerëzit atje. Ata janë gjithashtu të

pajisur me ekran prekës për raportimin e krimeve dhe mund të komunikojnë në gjashtë gjuhë të ndryshme. Robotët gjithashtu mund të kryejnë detyra më komplekse në emër të oficerëve të policisë. Ata mund të hyjnë në vende të rrezikshme dhe të identifikojnë njerëz dhe objekte që paraqesin kërcënime të mundshme, një alternativë më e sigurt për të shpëtuar jetën e policëve. Ka robotë që janë gjithashtu të pajisur me aftësinë për të shpërthyer bomba, duke përmirësuar sigurinë publike pa i vënë oficerët në rrezik.

Inteligjenca artificiale është i aftë të dallojë anomali në modele dhe kjo bën të mundur mirë zbulimin e krimeve jo të dhunshme si mashtrimi dhe pastrimi i parave. Bankat tashmë po aplikojnë inteligjencën artificiale si pjesë integrale e sigurisë së tyre dhe agjencitë e zbatimit të ligjit po bashkëpunojnë me këto subjekte për të kapur këto lloj krimesh. Përmes analizimit të imazheve, inteligjenca artificiale mund të zbulojë mallra të falsifikuara dhe fatura të falsifikuara me një probabilitet të lartë saktësie, duke zbuluar detaje që syri i njeriut mund t'ei humbasë.

Inteligjenca artificiale mund të jetë e re për agjencitë e zbatimit të ligjit, kështu që aplikimet e saj nuk janë realizuar ende plotësisht. Sidoqoftë, tashmë ajo ka një ndikim në fushat kryesore si mbikëqyrja, parandalimi i krimit dhe zgjidhja e krimit. Me teknologjitë e përforcuara të imazhit dhe njohjen e objektit dhe fytyrës, inteligjenca artificiale zvogëlon nevojën angazhimit të oficerëve të policisë me detyra të ndryshme, duke bërë të mundur që oficerët të trajtojnë veprimtari më komplekse. Inteligjenca artificiale gjithashtu mund të ndihmojë në kapjen e kriminelëve që mund të lihen të lirë dhe mund të zbulojë krime që mund të mbeten të pazbuluara.

Policimi parashikues është gjithashtu një fushë për t'u parë, pasi mund të ketë implikime të mëdha për mënyrën se si kapen kriminelët dhe si identifikohen viktimat. Në mënyrë ideale policimi parashikues do të mbrojë publikun edhe më shumë se më parë, por ka ende vështirësi për t'u përpunuar pasi sistemet bëhen më të avancuara. Nuk mund të thuhet se si këto ndryshime do të transformojnë rolin e oficerit të policisë por një gjë është e sigurt, që rezultatet do të kenë një ndikim të madh të gjithë. Teknologjia po përparon me hapa shume të shpejta, por e rëndësishme është që edhe mendimi e mentaliteti i drejtuesve të policisë së shtetit të ndryshojë e të ndjekë në zhvillimin e teknologjisë. Kjo gjë do t'i bëjë ata të vetëdijshëm për zbatimin e përdorimin e teknologjisë e sidomos inteligjencës artificiale si shkenca e së ardhmes.

3. Zbatimi i inteligjencës artificiale në shërbimet inteligjente.

Shërbimet inteligjente po përdorin inteligjencën artificiale për të ndihmuar në menaxhimin e rritjes eksponenciale të të dhënave. Inteligjenca artificiale është e gatshme të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si agjencitë plotësojnë misionet

e tyre, veçanërisht për departamentet e të dhënave të mëdha si ato në Shërbimet e inteligjencës. Menaxherët e programeve, që kërkojnë zgjidhje nëpërmjet inteligjencës artificiale në agjencitë e ndryshme, janë duke iu përmbajtur konceptit të zgjerimit të inteligjencës duke përdorur inteligjencën artificiale. Ato po auditojnë funksionet rutinë që analistët, kuratorët, koleksionistët kanë bërë manualisht në të kaluarën për t'i liruar ata nga kjo punë dhe për të kryer më shumë inteligjencë.

Mbledhja e informacionit është pjesë e punës së strukturave të ndryshme të shërbimeve sekrete, informacione që natyrisht janë të shumta. Një analizë e shpejtë dhe e saktë e të dhënave të shumta ka nevojë për inteligjencën artificiale që të ndihmojnë në leximin e shpejtë dhe seleksionimin e atyre informacioneve me vlerë informative. Tashmë dihet se sasia e të dhënave të mbledhura nga shërbimet sekrete po rriten në mënyrë eksponenciale.

Shërbimet sekrete po përcaktojnë drejtimit dhe strukturat që mund të bashkëpunojnë me inteligjencën artificiale. Shërbimet sekrete po rimodelojnë procesin për të integruar inteligjencën artificiale në të gjithë bordin, duke ndryshuar mënyrën e kryerjes së rrjedhës së punës dhe po krijojnë një grup trajnimi të vazhdueshëm për inteligjencën artificiale. Shërbimet sekrete po përdorin mjetet e inteligjencës artificiale për të renditur sasi të mëdha të imazheve dhe për të përcaktuar objekte specifike, të tilla si vendstrehimet e armikut dhe fushat ajrore, punë që është bërë manualisht nga analistët në të kaluarën. Mjetet e reja u mundësojnë analistëve që të punojnë më shumë në analizën e të dhënave.

Sigurisht që një kompjuter mund të na tregojë se një fushë ajrore është bosh, por nuk mund të na tregojë arsyen se përse është bosh. Këtë detyrë e kryejnë analistët. Shërbimet sekrete po përdorin inteligjencën artificiale për të gjetur bërthamat e informacionit të dobishëm në të dhënat e shumta që agjencitë mbledhin çdo ditë. Shumica e këtyre të dhënave të mbledhura është në interesin më të mirë të analistëve për të siguruar inteligjencën (informacionin) më të mirë për vendimmarrësit. Shërbimet sekrete duhet të përdorin inteligjencën artificiale për të parashikuar e zbuluar një sërë kërcënimesh.

Kundërshtarët ka të ngjarë të përdorin teknologjinë për sulme në hapësirën kibernetike dhe në sistemin politik dhe intelijenca artificiale do të nevojitet për t'i zbuluar dhe ndaluar ato. Kërcënimet në të ardhmen mund të përfshijnë përdorimin e inteligjencës artificiale për të krijuar falsifikime të thella, ku një kompjuter mund të mësojë të gjenerojë video bindëse të falsifikuara të një personi real, në mënyrë që të manipulojë opinionin publik. Mund të përdoret gjithashtu për të krijuar viruse nga me të ndryshmet që të kryejnë të sigurt sulme kibernetike, duke e bërë më të vështirë për sistemet normale për të zbuluar këto sulme.

Në këto raste, intelijenca artificiale do të jetë e nevojshme të zhvillojë e të krijojë një algoritëm kundërvënies mbrojtës ndaj atij të inteligjencës artificiale të përdorur nga kundërshtari. Shërbimet sekrete e kanë bërë përdorimin e teknologjisë në studimin e të dhënave një përparësi për të ardhmen. Sidoqoftë, besohet se intelijenca artificiale do të ketë vetëm “vlerë të kufizuar” në “inteligjencën parashikuese” në fusha të tilla si kundër-terrorizmi. Akte të tilla si terrorizmi janë shumë të rralla për të siguruar grupe të dhënash historike mjaft të mëdha për të kërkuar modele sepse ato ndodhin shumë më rrallë se aktet e tjera kriminale, të tilla si vjedhjet. Do të jetë thelbësore për të siguruar që operatorët njerëzorë të mbeten të përgjegjshëm për vendimet dhe që intelijenca artificiale të mos veprojë si një “kuti e zezë”, nga e cila njerëzit nuk e kuptojnë bazën mbi të cilën merren vendimet. Megjithatë, përdorimi i inteligjencës artificiale me efikasitet bën të mundur që informacionet e shërbimeve sekrete të paralajmërojnë rrezikun shumë shpejt dhe kështu të merren masa të shpejta mbrojtëse.

Inteligjenca artificiale po revolucionarizon investigimin në ndihmë të strukturave të zbatimit të ligjit.

Informacioni ka një funksion qendror për strukturat e zbatimit të ligjit dhe është një burim i rëndësishëm për të mundësuar hetime efektive dhe efikase. Në shoqërinë e sotme teknologjia siguron gjithnjë e më shumë burime informacioni për të mbështetur mbledhjen e provave. Përmbajtja e të dhënave dixhitale po bëhet një burim kryesor i hetimeve të policisë dhe inteligjencës. Strukturat e zbatimit të ligjit do të vlerësohen nga përdorimi i teknologjisë së inteligjencës artificiale për të analizuar dhe përpunuar burimet e të dhënave digjitale, të tilla si celularët, profilet e mediave sociale dhe pamjet e mbikëqyrjes video, për të avancuar hetimet dhe për të shtuar informacionin e tyre.

Kur bëhet fjalë për hetim, është e rëndësishme të siguroni sa më shumë informacion të detajuar. Nuk mund të keni gjithmonë informacione të dobishme nëse nuk ka asnjë mënyrë për të shqyrtuar dhe interpretuar në mënyrë efikase të dhënat. Në fillim të çdo hetimi, agjentët dhe oficerët duhet të përcaktojnë përparësitë për vlerësimin dhe mbledhjen e informacionit. Teknologjia e inteligjencës artificiale mundëson strukturat dhe zbatimin e ligjit për përshpejtimin dhe përpunimin e informacionit. Me teknikat e inteligjencës artificiale, hetuesit mund të përdorin zgjidhje të përcaktuara nga intelijenca artificiale, të cilat përpunojnë të dhëna të papërpunuara dhe i strukturon ato në indekse dhe vizualizime për analizë dhe interpretim më të lehtë. Kur të dhënat nxirren, identifikohen dhe klasifikohen, bëhet më e lehtë që të vlerësosh provat dhe të përdorësh gjetjet e inteligjencës artificiale për të zgjidhur një çështje.

Për shembull, një pajisje e inteligjencës artificiale mund të përdoret për të analizuar telefonin celular të një viktime. Duke tërhequr të dhëna nga pajisja

mobile, inteligjenca artificiale mund të nxjerrë në pah modelet e komunikimit dhe të indeksojë objektet e kapura në imazhet e viktimës, duke e bërë mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave më të menaxhueshme për identifikimin e të dyshuarve dhe kuptimin e ngjarjeve.

Me teknologjinë e inteligjencës artificiale që vlerëson përmbajtjen dixhitale, hetuesit kursejnë kohë në nxjerrjen e provave. Nëse hetuesit kanë një objektiv të njohur, ai mund të zbulohet, identifikohet dhe gjurmohet lehtësisht në të dhënat dixhitale. Kur nuk ka një të dyshuar të njohur ose prova mbështetëse është e pakët, hetuesit mund të zbulojnë detaje duke vlerësuar të dhënat e strukturuara nga inteligjenca artificiale.

Pamjet e mbikëqyrjes se videos janë një burim i rëndësishëm i të dhënave dixhitale dhe një burim kryesor i hetimeve. Tani teknologjia e analizave të përmbajtjes se videos po ndihmon strukturat e zbatimit të ligjit të kuptojnë vlerën e plotë të investimeve të tyre të mbikëqyrjes me video. Kur kamera të shumta mbulojnë hapësirën e një vendi të krimit, duke regjistruar zonën nga çdo kënd, hetuesit mund të përpunojnë të gjithë videot dhe të kërkojnë prova. Me teknologjinë e Inteligjencës Artificiale oficerët mund të përdorin të gjitha të dhënat në dispozicion të tyre pa pasur nevojë për personel të madh. Duke shfrytëzuar pamjet e videove nga burime të shumta lokale, të kapura gjatë ditëve para incidentit ose ngjarjes, oficerët dhe hetuesit e zbatimit të ligjit mund të gjurmojnë në mënyrë efektive lëvizjet e të dyshuarve në dhe rreth vendit të ngjarjes, t'i identifikojnë ato dhe të ndihmojnë në përqendrimin e përpjekjeve të hetimit në synimet përkatëse.

Mbështetur në teknologjinë e inteligjencës artificiale, që mundëson përpunim efikas dhe efektiv të të dhënave, agjencitë e zbatimit të ligjit mund të përdorin burimet e tyre ekzistuese të të dhënave për njohuri më të thella vepruese, duke promovuar rritjen e sigurisë dhe efikasitetin operacional.

4. Zbatimi i inteligjencës artificiale në sigurinë kibernetike.

Inteligjenca artificiale (IA) po merr një zhvillim të madh dhe po aplikohet pothuajse në të gjitha fushat e ndryshme. Një zbatim të gjerë e të suksesshëm IA ka në fushën e sigurisë kombëtare të vendeve të ndryshme. Mbrojtja kibernetike (Cyber Defense), e cila është një nga fushat e sigurisë me zhvillim të shpejtë, po e aplikon gjerësisht inteligjencën artificiale, madje po drejtohet nga ajo. Aplikimi i IA për zgjidhjet e sigurisë kibernetike do të ndihmojë në mbrojtjen e institucioneve nga kërcënimet ekzistuese kibernetike dhe identifikimin e llojeve të reja të *malware*-ve. Përveç kësaj, sistemet e sigurisë kibernetike të bazuar në inteligjencën artificiale mund të sigurojnë standarde efektive të sigurisë dhe të ndihmojnë në zhvillimin e strategjive më të mira të parandalimit të rrezikut. Sot përdoren teknologjitë më të fundit për zbatimin

praktik të inteligjencës artificiale në sigurinë kibernetike. Inteligjenca artificiale ofron një potencial të madh për të ndihmuar institucionet dhe kompanitë të përmirësojnë qëndrimet e tyre në sigurinë kibernetike përmes analizës inteligjente të kodit dhe analizës së konfigurimit dhe monitorimit të aktivitetit. Megjithatë inteligjenca artificiale përdoret në shumë fusha, siguria kibernetike është njëra prej tyre që ka marrë vëmendje të veçantë për shkak të shkallës me të cilën po zhvillohen kërcënimet dhe numrit të sulmeve. Zgjidhjet e sigurisë kibernetike të bazuara në inteligjencën artificiale mund të zbulojnë modelet e sjelljes keqdashëse në trafikun e rrjetit dhe skedarët dhe faqet e internetit që futen në rrjet. Inteligjenca artificiale e integruar në një bankë ose në një sistem biznesi mund të paralajmërojë mashtrimin njerëzor dhe të analizojë rrezikun, duke shpejtuar kështu proceset e zbulimit të mashtrimit. Bankat gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme që përpjekje të tilla nga inteligjenca artificiale synojnë kryesisht në mbledhjen dhe organizimin e të dhënave, duke siguruar kështu që të dhënat në lidhje me sigurinë dhe sistemet e parandalimit të ndërhyrjeve, të mblidhen në një format të ngjashëm. Siguria kibernetike i referohet teknologjisë dhe praktikave që synojnë mbrojtjen e rrjeteve dhe informacionit nga dëmtimi ose aksesit i paautorizuar. Siguria kibernetike është jetike sepse qeveritë, kompanitë dhe strukturat ushtarake mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë shumë informacione në kompjuter.

Përdorimi i rrjeteve nervore të Inteligjencës Artificiale ka lejuar zhvilluesit të përshtaten me vektorët e rinj të sulmit dhe të parashikojnë më mirë hapat e ardhshëm të kriminelëve kibernetikë. Përdorimi i saj mund të stimulojë më tej sulme të ngjashme dhe të çojë në një epokë të re sulmet e sponsorizuara nga shteti dhe spiunazhi kibernetik. Shumë drejtues e specialistë të sigurisë deklarojnë se ata tani janë “plotësisht të varur” nga teknologjia e inteligjencës artificiale për të mbrojtur rrjetet dhe të dhënat e tyre të ndjeshme.

Shumica e agjencive të inteligjencës të vendeve të ndryshme e kanë identifikuar luftën kibernetike si një nga kërcënimet potenciale e më serioze ndaj sigurisë kombëtare gjatë dekadës së ardhshme.

Ka pasur ndryshime dramatike në mjedisin e sigurisë në të kaluarën e afërt dhe situata ka të ngjarë të bëhet më e paqëndrueshme dhe e rrezikshme në vitet në vijim. Një nga aplikacionet e mundshme të inteligjencës artificiale në mbrojtjen kibernetike është mundësia i ngritjes së rrjeteve vetë-konfigurorese. Inteligjenca artificiale mund të kapërcejë kështu mangësitë e mjeteve tradicionale të sigurisë kibernetike. Inteligjenca artificiale është gjithashtu një mekanizëm i fuqishëm në gjendje të përmirësojë nivelet e zbulimit të viruseve duke përdorur një bazë të të dhënave të inteligjencës kibernetike.

Inteligjenca artificiale është trajnuar duke konsumuar miliarda artikuj të të dhënave nga dy burime të strukturuar dhe të pa strukturuar, të tilla si blogje

dhe histori lajmesh. Përmes makinerive dhe teknikave të mësimit të thellë, inteligjenca artificiale përmirëson njohuritë e saj për të “kuptuar” kërcënimet e sigurisë në internet dhe rrezikun në internet.

Sot me Inteligjencën Artificiale, çdo gjë që është një proces mund të automatizohet. IA do të ndryshojë në mënyrë drastike llojet e punës që bëjnë inxhinierët kibernetikë. Inteligjenca artificiale është në gjendje të përpunojë sasi të mëdha të të dhënave ose zëvendësimin e detyrave autonome manuale, por nuk mund të jetë në gjendje të zëvendësojë vlerësimet e një analisti të sigurisë ose të kuptuarit e fushës. Siguria e inteligjencës artificiale i referohet aftësisë së saj për të kryer siç kërkohet procese të ndryshme dhe të jetë e kuptueshme për njerëzit. Këto karakteristika janë të dallueshme nga siguria tradicionale në internet, e cila përqendrohet më gjerësisht në kriptimin dhe mbrojtjen e të dhënave. Ndërsa të dhënat mund të përdoren për t'i shërbyer më mirë nevojave përkatëse të biznesit, ato gjithashtu paraqesin sfida të mëdha për sigurinë në internet dhe mbrojtjen e fshehtësisë. Mbrojtja kibernetike duhet t'i përgjigjet këtyre sfidave duke përdorur teknologji të bazuara në inteligjencën artificiale.

Analiza e sigurisë kibernetike e drejtuar nga Inteligjenca Artificiale tashmë ka zgjeruar aplikimet në përdorimin e sistemit automatik të zbulimit të ndërhyrjeve, klasifikimin e trafikut të koduar, klasifikimin e programeve me qëllim të keq, etj. Ndërtimi i një algoritmi automatik enkriptimi bën të mundur një zgjidhje inteligjente mbrojtëse pa ndërhyrjen e përpjekjes njerëzore. Nga ana tjetër, rritja e sulmeve kibernetike të kundërshtarit të ndihmuara nga inteligjenca artificiale pritet të shkaktojë një shpërthim të depërtimeve në rrjet, vjedhjeve të të dhënave personale dhe një përhapje të niveleve epidemike të viruseve inteligjente në sistemet e komunikimit. Kështu që kjo kërkon të mbrohesh nga sulmet kibernetike të kundërshtarit të drejtuar nga inteligjenca artificiale duke përdorur teknika të drejtura nga inteligjenca artificiale, të cilat ndoshta do të çojnë në një garë të armëve të inteligjencës artificiale. Industria ka përparuar shumë në kërkimet e saj, me një theks të veçantë në mjetet, teknikat, konceptet dhe aplikacionet e reja në lidhje me analizën e sigurisë kibernetike të drejtuar nga inteligjenca artificiale.

BE-ja i ka kërkuar të gjitha vendeve që të hartojnë Strategjinë Kombëtare të Inteligjencës Artificiale. Sigurisht që shumë vende, për të mos thënë të gjitha vendet, e kanë hartuar dhe e kanë azhurnuar këtë Strategji, përveç Shqipërisë. BE-ja e konsideron inteligjencën artificiale një nga teknologjitë më strategjike të shekullit XX. Vendet e ndryshme në botë po e formësojnë të ardhmen e inteligjencës artificiale. Qeveritë në mbarë botën po lëvizin shpejt për të rregulluar zhvillimin, implementimin dhe për të zbutur rreziqet e mundshme të inteligjencës artificiale.

Rekomandime.

1. Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Inteligjencës Artificiale, ligjit dhe i rregullores për funksionimin e inteligjencës artificiale nga këndvështrimi i objektivave të mbrojtjes dhe sigurisë që duam të arrijmë në mënyrë të qëndrueshme.
2. Identifikimi i një liste me përparësi të aplikacioneve të inteligjencës artificiale që mund të zbatohen me shpejtësi në kuadrin e strukturave dhe proceseve të tjera të mbrojtjes dhe veçanërisht ato që përqendrohen më shumë në aftësitë parandaluese dhe të rezistencës.
3. Dialogu me subjekte të ndryshme në të gjithë ekosistemin e mbrojtjes dhe të sigurisë në lidhje me mundësitë premtuese dhe sfidat kritike në zbatimin e inteligjencës artificiale në të gjithë hapësirën e opsioneve.
4. Të qenët të vetëdijshëm për situatën se çfarë po ndodh në këtë fushë jashtëzakonisht dinamike. Ky zbatim i inteligjencës artificiale kërkon përfshirjen e gjithë ekosistemit të mbrojtjes dhe sigurisë.

Bibliografia

1. Artificial Intelligence and National Security G-Reference.
2. J. Cimbala Information and Interdisciplinary Subjects Series Author Stephen
3. Hamid Jahankhani, Babak Akhgar, Peter Cochrane, Mohammad Dastbaz. Policing in the Era of AI and Smart Societies 2020.
4. Mark Stamp, Corrado Aaron Visaggio, Francesco Mercaldo, Fabio Di Troia. Artificial Intelligence for Cybersecurity 2022.
5. Reza Montasari Artificial Intelligence and National Security 2022.
6. Fei Hu, Xiali Hei. AI. Machine Learning and Deep Learning: A Security Perspective 2023.
7. The Quantum Evolution Application of AI and Robotics in the Future of Quantum Technology. A comprehensive literature review of the applications of AI techniques through the lifecycle of industrial equipment, Volume 3, article number 43.
8. Mahboob Elahi, Samuel Olaiya Afolaranmi, Jose Antonio Perez Garcia. Discover Artificial Intelligence.
9. Melanie Mitchell. Artificial Intelligence, Foundations and Trends in Machine Synthesis Lectures on Artificial Intelligence and Machine Learning International Journal of Computer Vision.

Metodologji dhe Strategji për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike

Nënkolonel Msc. Dashnor BETA
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike (MIK) në nivel kombëtar nuk është një detyrë e lehtë dhe e parëndësishme. Në të përfshihen hapa të ndryshëm si: përcaktimi, priorizimi dhe mbrojtja e atyre infrastrukturave dhe shërbimeve që janë jetike për mirëqenien e shoqërisë. Megjithëse disa sektorë, nënsektorë dhe shërbimet që lidhen me to duken të jenë shumë të rëndësishëm për të gjitha vendet, disa sektorë të tjerë mund të ndryshojnë rëndësinë e tyre bazuar në karakteristikat specifike ekonomike, mjedisore dhe sociale të secilit vend.

Në këtë shkrim do të shqyrtojmë disa metodologji ekzistuese dhe strategji kombëtare për mbrojtjen e infrastrukturave kritike (IK). Ekzaminimi i metodologjive për identifikimin dhe vlerësimin e sektorëve dhe shërbimeve kritike, bëhet duke u mbështetur në qasjet administrative nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart. Për të identifikuar IK-të dhe për të krijuar plane kombëtare të mbrojtjes shqyrtohen praktikat e zakonshme që janë aplikuar në vende të ndryshme. Në këtë shkrim gjithashtu përshkruhen dhe një grup qëllimesh që gjenden zakonisht në metodologji të ndryshme dhe në praktikat më të mira për mbrojtjen e IK-ve.

Fjalët kyçe: Infrastrukturë Kritike (IK), Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike/ të Informacionit (MIK/I), IK e Informacionit (IKI), kritere vlerësimi të IK, Strategji e Mbrojtjes së IK-ve.

Hyrje

Termi “IK”, sipas Këshillit të Evropës, nënkupton një aset, sistem ose pjesë të një sistemi që është thelbësor për funksionimin e duhur të veprimtarive jetësore të shoqërisë, të lidhura me shëndetin, sigurinë, sigurinë, mirëqenien ekonomike ose sociale. Dështimi për të mbajtur një nivel funksionimi të tolerueshëm, ose më keq, kolapsi i plotë i një IK-je do të kishte një ndikim të rëndësishëm në nivelet njerëzore, sociale, ekonomike dhe kombëtare. Për funksionet e tyre jetike, biznesi dhe industria si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik varen kryesisht nga IK-të. Shembuj tipik të IK-ve përfshijnë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), energjinë, transportin, ekonominë (sektori financiar), shëndetësinë, mbrojtjen, ushqimin, furnizimin me ujë, shërbimet qeveritare etj.

Shumica e IK-ve mund të modelohen si sisteme kiber-fizike, ku pjesa e informacionit (kibernetike) kontrollon komponentët fizikë dhe strukturat themelore, për të menaxhuar, kontrolluar e optimizuar qëllimet dhe funksionalitetin e IK-ve. P.sh., kontrolli i komponentëve fizikë të një termocentrali (gjeneratorët ose elementët shpërndarës) mund të kryhet nëpërmjet sensorëve dhe aktivizuesve interaktivë, të cilët kontrollojnë periodikisht statusin, transmetojnë informacion në sistemet qendrore të kontrollit të informacionit dhe pranojnë komandat e rrjetit për të modifikuar statusin e komponentëve fizikë në përputhje me rrethanat.

Identifikimi dhe vlerësimi i IK-ve është një detyrë sfiduese, ndërkohë që procesi dhe metodologjitë e përdorura për të identifikuar dhe vlerësuar IK-të, veçanërisht ato që mund të prekin njerëzit dhe sistemet në nivel kombëtar, mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Këtu trajtohen metodologjitë për identifikimin dhe vlerësimin e IK, shqyrtohen kritere të ndryshme që janë përdorur në metodologjitë ekzistuese, përshkruhen praktikat më të mira nga vendet të ndryshme si dhe jepen disa metodologji të ndryshme dhe praktikamë të mira për mbrojtjen e IK.

Mekë të trajtesë gjithashtu synohet udhëzimi i palëve të interesuara të ekosistemit të IKI, (përfshi ndoshta autoritetet koordinuese të MIKI, rregullatorët e TIK, ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve, të shërbimit të internetit), që të kuptojnë më mirë aspektet e mbrojtjes së sektorëve dhe shërbimeve të IKI dhe aspektet rregullatore, si identifikimi i modeleve rregullatore të kësaj infrastrukture, rolin e koordinatorit të IKI dhe disa kërkesa sigurie e detyrime ligjore që duhen zbatuar apo që janë duke u zbatuar në disa vende.

1. Metodologji për identifikimin dhe vlerësimin e IK

Identifikimi i IK-ve kombëtare përcaktohet në rregullore të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. Brenda kuadrit të një programi kombëtar mbrojtjeje, çdo shtet anëtar i BE-së duhet të identifikojë “zonat/sectorët kombëtarë kritikë”, të regjistrojë dhe vlerësojë sistemet ose komponentët e tyre¹, si dhe ndërvlerësitë (e mundshme) ndërmjet IK-ve të identifikuara. Çdo vend gjithashtu duhet të zhvillojë dhe/ose të përditësojë një *Plan Sigurie Operatori* (PSO) dhe një *Plan Emergjence* (PE) në funksion të mbrojtjes së IK-ve kombëtare. Meqë, në shumicën e rasteve, pronarët dhe/



ose operatorët e IK-ve janë subjekte private, çdo proces për identifikimin e IK-ve kombëtare dhe çdo proces tjetër nën një program kombëtar mbrojtjeje, shtrun si nevojë dhe kërkon shkëmbimin e informacionit mes palëve të përfshira, në përputhje me parimin e palëve të interesuara për bashkëpunim, në mënyrë të veçantë *Partneriteti Publik Privat* (PPP)².

Figura nr.1 Përbërësit e një programi kombëtar të mbrojtjes

Kuadri për zbatimin e çdo programi kombëtar të mbrojtjes është paraqitur në fig 1. Këshilli i BE-së³ jep udhëzime të mëtijshme në identifikimin dhe përcaktimin e IK-ve kombëtare për çdo vend anëtar, dhe tregon detyrimin e tyre për identifikimin e çdo Infrastruktura Kritike Evropiane të mundshme (IKE) (European Critical Infrastructure - ECI) në territorin e tyre, d.m.th., ato IK, ndërprerja ose shkatërrimi i të cilave do të kishte ndikime të rëndësishme ndërkufitare -përtej kufijve të një vendi.

Në fakt, shpeshherë, dëmtimi ose shkatërrimi/humbja e një IK në një shtet mund të ketë efekte negative në disa shtete të tjera⁴. Direktiva përqendrohet në sektorët e energjisë dhe transportit ndërkohë që, objekti i

¹ Burimi: <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/PPD-21-Critical-Infrastructure-and-Resilience-508.pdf>

² Burimi: Partneritetet Publike Private (PPP) – Modelet e bashkëpunimit (2017) ENISA. <https://www.enisa.europa.eu/publications/public-private-partnerships-ppp-cooperative-models>

³ Burimi: <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/PPD-21-Critical-Infrastructure-and-Resilience-508.pdf>

⁴ Burimi: Komisioni Evropian (2007) Programi Evropian për mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Off J 9. Komisioni Evropian (2005) Letra e gjelbër mbi një program evropian për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, Bruksel, COM, f. 576.

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0576>

saj lë të hapur përfshirjen e sektorëve të tjerë, duke i dhënë prioritet sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Kushti i domosdoshëm i çdo vend anëtar për zbatimin e Direktivës është identifikimi i IK-ve nga secili, në mënyrë që nga kjo listë⁵ të mund të nxirret çdo Infrastrukturë Kritike Evropiane (IKE) potenciale. Për çdo IK kombëtare, të identifikuar si IKE, çdo vend anëtar, mes të tjerash, është përgjegjës për mbledhjen e informacionit mbi rreziqet e sigurisë, kërcënimet dhe dobësitë për IKE. Qëllimi përfundimtar i direktivës është zbatimi i PSO, mbrojtjen e tyre në nivel operator, brenda kornizës së një strategjietë përbashkët evropiane për të gjitha IKE e përcaktuara.

1.1 Identifikimi i Infrastrukturës Kritike.

Përkufizimi i saktë i një IK ndryshon nga një vend në tjetrin. Përgjithësisht, IK janë infrastrukturë, ndërprerja, dështimi ose shkatërrimi i të cilave do të kishte një ndikim të rëndësishëm në shëndetin publik, çështjet publike dhe civile, mjedisin, sigurinë, mirëqenien sociale dhe ekonomike. Krahë dallimeve në një nivel përkufizimi, shpesh ka diferencime në një nivel më thelbësor, me ndikim në identifikimin e këtyre infrastrukturave. P.sh., në Gjermani, IK-të ndahet në infrastruktura jetike teknike dhe infrastruktura jetësore të shërbimit social-ekonomik⁶. Në Britaninë e Madhe (UK)⁷, ato ndahen në infrastruktura kombëtare kritike dhe infrastruktura të tjera kritike. Referuar literaturave⁸ dhe praktikave ndërkombëtare, gjerësisht të përdorura, një proces formal identifikimi dhe përcaktimi të IK-ve kombëtare mund të zbatohet në katër faza të njëpasnjëshme:

1. **Identifikimi i sektorëve/nësektorëve kritikë.** Këtu identifikohen sektorët dhe/ose nësektorët që konsiderohen të rëndësishëm për interesat kombëtare.
2. **Identifikimi i shërbimeve kritike.** Shërbimet kritike/jetike të sektorit/nësektorit janë identifikuar dhe përcaktuar për çdo sektor kritik.
3. **Përcaktimi i IK.** Për çdo shërbim kritik, asetet/komponentët kritikë që përbëhen nga IK-të janë identifikuar dhe caktuar.

⁵ Burimi: Komisioni i BE-së (2012) Rishikimi i Programit Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike (EPCIP):

⁶ Burimi: Strategjia Kombëtare për CIP (2009) Republika Federale e Gjermanisë

⁷ Burimi: Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes dhe Sigurisë (2015) Qeveria e UK. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/478933/52309_Cm_9161_NSS_SD_Review_web_only.pdf

⁸ Burimi: Gritzalis D, Stergiopoulos G, Kotzanikolaou P, Magos E, Lykou G (2016) Mbrojtja e infrastrukturës kritike: një metodologji holistike për Greqinë. Konferencë për sigurinë e kontrollit industrial dhe sistemeve fizike kibernetike (CyberICPS). Springer, 19–34

4. *Mbrojtja e IK.* Në këtë fazë zbatohen procedurat për mbrojtjen dhe sigurinë e çdo IK.

1.1.2 Identifikimi i Sektorëve/Nësektorëve Kritikë

Në këtë fazë, çdo shtet anëtar harton një listë fillestare të sektorëve/nësektorëve të vet kritik kombëtarë, d.m.th. të atyre sektorëve që gjenden brenda kufijve gjeografikë të territorit të vet dhe që përfshijnë IK-të potenciale. Ky proces përzgjedhje nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë. Jo të gjithë sektorët kombëtarë janë njësoj jetik/kritik në secilin vend. Disa sektorë mund të klasifikohen si kritikë dhe disa si më pak të tillë ose më pak të rëndësishëm. Po kështu, jo të gjitha shërbimet e një sektori/nësektori janë njësoj kritike, gjë që bën të vështirë identifikimin e listës fillestare të sektorëve kritikë në nivel strategjik.

Komisioni Evropian (KE)⁹ njeh diversitetin e sektorëve kritikë kombëtarë në çdo shtet anëtar, pra, njeh vështirësinë e identifikimit të sektorëve/nësektorëve kritikë në çdo vend dhe të identifikimit, përcaktimit dhe prioritizimit të IK-ve brenda çdo sektori kritik. Megjithatë, në funksion të krijimit të një kuadri të përbashkët për Programin Evropian për Mbrojtjen e IK-ve (PEMIK), inkurajohet hartimi i një liste të përbashkët të sektorëve/nësektorëve kritikë¹⁰. (Shih tabelën 1)

Disa shtete anëtare kanë miratuar këtë listë për të identifikuar fushat e tyre kritike kombëtare. Në përputhje me metodologjinë e përdorur gjerësisht për identifikimin e IK-ve sipas sektorëve, ENISA¹¹ propozon një variant të tabelës treguese të Letrës së Gjelbër¹², paraqitur në tab. 1 dhe përfshin konceptin e shërbimit për çdo nësektor. Ky koncept përdoret shpesh si një sinekdokë për termin infrastrukturë, pasi ai është një nivel mjaft abstrakt dhe mjaft përshkrues i konceptit të një grupi asetesh, produktesh dhe procesesh që tek e fundit kanë nevojë për mbrojtje.

⁹ Burimi: KE (2007) Programi Evropian për mbrojtjen e infrastrukturës kritike. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0576>

¹⁰ Burimi: Komisioni Evropian (2005) Letra e gjelbër mbi një program evropian për mbrojtjen e IK, Bruksel, COM, f. 576. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0576>

¹¹ Burimi: Rossella M, Cédric LB (2015) Metodologjitë për identifikimin e asetëve dhe shërbimeve kritike të infrastrukturës së informacionit. ENISA. Bruksel: Agjencia e BE për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (ENISA)

¹² Burimi: Komisioni Evropian (2005) Letra e Gjelbër mbi një program Evropian për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, Bruksel, COM, f. 576. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0576>

Tabela nr. 1 Sektorët kritikë dhe shërbimet e tyre kritike.

Sektori	Nënspektori	Shërbimi
Energjia	Elektricitet	Gjenerimi (Të gjitha format)
		Transport/Shpërndarje
	Nafta	Tregu i energjisë elektrike
		Nxjerrja/Përsosje
		Transporti
		Magazinimi
Teknologjitë e Informacionit & Komunikimit (TIK)	Gazit natyror	Nxjerrja
		Transport/Shpërndarje
		Magazinimi
	Shërbimet e internetit të teknologjive të informacionit	Shërbimet e qendrës së të dhënave
		Softueri si shërbim
		Komunikimi me zë/të dhëna
Uji	Komunikimet	Internet
	Ujë i pijshëm	Ruajtja e ujit
		Shpërndarja e ujit
		Sigurimi i cilësisë së ujit
	Ujërat e zeza	Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të zeza
Ushqimi		Bujqësia/Prodhimi i ushqimit
		Furnizimi me ushqim
		Shpërndarja e ushqimit
		Cilësia/siguria e ushqimit
Shëndeti		Kujdesi shëndetësor urgjent
		Kujdesi spitalor
		Furnizimi me farmaceutikë, vaksina, gjak, furnizime mjekësore
		Kontrolli i infeksionit/epidemisë
Shërbimet financiare		Bankare
		Transaksionet e pagesave
		Bursë

Rendi dhe siguria publike		Ruajtja e rendit publik
		Gjyqësori dhe sistemet penale
Transporti	Aviacioni	Shërbimet e navigimit ajror
		Funksionimi i aeroporteve
	Transporti rrugor	Shërbimet e autobusit/ tramvajit
		Mirëmbajtja e rrjetit rrugor
	Transporti me tren	Menaxhimi i hekurudhës publike
		Shërbimet e transportit hekurudhor
	Transporti detar	Monitorimi dhe menaxhimi i trafikut të anijeve
		Operacionet e thyerjes së akullit
	Postare / Transporti	
Industria	Industritë kritike	Punësimi
	Industria kimike / bërthamore	Ruajtja dhe asgjësimi i materialeve të rrezikshme
		Siguria e njërive industriale me rrezik të lartë
Administrata civile		Funksionet e qeverisë
Hapësira		Mbrojtja e sistemeve të bazuara në hapësirë
Mbrojtja civile		Shërbimet e urgjencës dhe shpëtimit
Mjedisi		Monitorimi i ndotjes së ajrit dhe paralajmërimi i hershëm
		Monitorimi meteorologjik dhe paralajmërimi i hershëm
		Monitorimi i ujërave nëntokësore dhe paralajmërimi i hershëm
		Monitorimi i ndotjes detare dhe paralajmërimi i hershëm
Mbrojtja		Mbrojtja kombëtare

1.1.3 Identifikimi i Shërbimeve Kritike

Për identifikimin e shërbimeve kritike kombëtare sipas sektorëve në literaturë mund të ofrohen dy qasje kryesore¹³; të cilat gjenden në udhëzimet për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të të dhënave^{14 15} e drejtuar nga shteti (nga lart-poshtë) apo nga operatorët (nga poshtë-lart). Këto qasje përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

Qasje e drejtuar nga shteti (nga lart-poshtë).

Në këtë qasje (fig. 2), qeveria ka një rol udhëheqës në përcaktimin dhe prioritizimin e shërbimeve kritike - nëpërmjet një organi koordinues ose një autoriteti kompetent për mbrojtjen e KI. Në nivel qendror, përpilohet një listë e shërbimeve treguese kombëtare të sektorit kritik. Përndryshe hartohet, një listë e shërbimeve kritike kombëtare, në një nivel ndërsektorial (ose tërthor).



Figura nr. 2 Qasje nga lart-poshtë për identifikimin dhe mbrojtjen e shërbimeve kritike¹⁶.

Shërbimet kritike më pas vlerësohen, me kriteret specifike, dhe prioritizohen për të dhënë listën përfundimtare të këtyre shërbimeve. Për çdo shërbim kritik, hartohet një listë e palëve të interesuara-operatorë, nga e cila (ose në b/punim mes palëve) nxirret një listë e mallrave, produkteve dhe sistemeve më kritike që mbështesin këtë shërbim¹⁷. Kjo qasje është aplikuar në Zvicër, Estoni, Holandë dhe Republikën Çeke.

¹³ Burimi: Klaver M (2011) *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikëbërësit në Evropë*. Bruksel: http://www.oaip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf

¹⁴ Burimi: Novotný P, Rostek P (2014) *Perspektiva e kriterëve ndërsektoriale si një instrument kryesor për përcaktimin e IK në Republikën Çeke*. (Vëll. 2).

¹⁵ Burimi: Rossella M, Cédric LB (2014) *Metodologjitë për identifikimin e aseteve dhe shërbimeve të IKI*. Udhëzime për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të të dhënave, agjencia e BE-së për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit. ENISA, Heraklion

¹⁶ Burimi: Rossella M, Cédric LB *Metodologjitë për identifikimin e aseteve dhe shërbimeve të IKI*. Udhëzime për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të të dhënave, agjencia e BE-së për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit. ENISA, Heraklion

¹⁷ Burimi: Klaver M (2011) *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikëbërësit në Evropë*. Bruksel: http://www.oaip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf

Qasje e drejtuar nga operatori (nga poshtë-lart).

Në qasjen e drejtuar nga operatori (fig. 3), roli kryesor u është caktuar operatorëve të IK. Në veçanti, pas identifikimit të sektorëve/nënsektorëve kritikë kombëtarë në nivel qendror (bazuar në Partneritetet Publike-Privat/PPP), hartohet një listë e palëve të interesuara-operatorë të IK-ve, të njohur si *Operatorët Vitalë* (OV), nga të cilët kërkohet të identifikojnë dhe vlerësojnë shërbimet kritike dhe asetet/sistemet më kritike që ato përbëjnë. Në disa vende evropiane, kjo përgjegjësi i është caktuar OV-së përkatëse nga organi përgjegjës përsektorin përkatës kritik (p.sh. ministria përkatëse). Duhet theksuar se në këtë qasje, OV-ja del në plan të parë, në krahasim me konceptin e shërbimit kritik që dominon qasjen e drejtuar nga shteti. Në një farë mënyre, OV-ja është në vetvete një aset thelbësor që ka nevojë për mbrojtje¹⁸. Kjo qasje është përdorur në vende si Franca dhe UK. Çdo qasje kërkon zbatimin e një metrike për të vlerësuar dhe për t'i dhënë përparësi kritikës së çdo asemi (p.sh., shërbime, mallra, sisteme, etj.) të një sektori kritik.




Figura nr.3 Qasja e drejtuar nga operatori (nga poshtë-lart) ¹⁹

Ky proces, pavarësisht rëndësisë së tij, nuk është i dukshëm, pasi pothuajse gjithmonë, kriteret për kritikën e të dhënave të përfshira ndryshojnë nga vendi në vend. Për më tepër, një infrastrukturë mund të jetë kritike për shkak të ndërvarësisë midis shërbimit që mbështet infrastruktura dhe shërbimeve të tjera brendatë njëjtë ose një sektori tjetër.

2.2. Varësitë dhe ndërvarësitë.

Një aktiv (p.sh., infrastruktura, shërbimi ose nënsektori) mund të jetë kritik jo vetëm për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë që mund të shkaktojë në rast të mosfunksionimit ose humbjessë tij (i njohur edhe si efekti i rendit të parë), por edhe për shkak të ndikimit në aktive të tjerakritike. (të njohura edhe si efekte

¹⁸ Burimi: Klaver M (2011) *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikëbërësit në Evropë*. Bruksel: [http://www.oaip.ac.at/fileadmin/ Unterlagen/ Dateien/Publikationen/ FINAL_RECIPe_manual.pdf](http://www.oaip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPe_manual.pdf).

¹⁹ Burimi: Rossella M, Cédric LB *Metodologjitë për identifikimin e aseteve dhe shërbimeve të IKI*. Udhëzime për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të të dhënave, agjencia e BE-së për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit. ENISA, Heraklion

të rendit të dytë ose në përgjithësi me shumë renditje) ²⁰. Efektet e rendit të parë pasqyrojnë vitalitetin e drejtpërdrejtë të një aktiviteti kritik për shoqërinë²¹, p.sh., sipas kritereve ndërsektoriale të përmendura më sipër, ndërsa efektet me shumë renditje pasqyrojnë vitalitetin indirekt të aktivitetit në asete të tjera kritike. Në mënyrë tipike, efektet e rendit të dytë kuptohen ose si varësi, ku një element kritik varet nga një element tjetër ose si ndërvarësi ku dy elementë kritikë preken reciprokisht në nivele kombëtare apo ndërkombëtare²². Konstatohet gjithashtu se varësitë ose ndërvarësitë mund të ekzistojnë ose brenda sektorit / nënsektorit në të cilin operon një shërbim ose midis dy ose më shumë sektorëve / nënsektorëve në nivel kombëtar ose midis dy sektorëve / nënsektorëve që operojnë në shtete të ndryshme anëtare.

2.3 Kriteret për Vlerësimin e Shërbimit/ Infrastrukturës Kritike

Për të vlerësuar kritikitetin (dhe pas kësaj prioritizimin) e një shërbimi ose IK të mundshme, gjenden dy grupe kriteresh që mund të përdoren.

2.3.1. Kriteret sektoriale: Janë kritere teknike ose funksionale me të cilat mund të identifikohen dhe prioritizohen IK-të e mundshme. P.sh., kriteret sektoriale mund të lidhen me vetitë specifike (zakonisht të matshme) ose veçoritë e një infrastrukture që mbështet këtë shërbim sektori. Këto karakteristika mund të jenë ose teknike (p.sh., diametri minimal i tubacionit të naftës/gazit, kapaciteti minimal, fuqia elektrike në Megavat etj.) ose jo (p.sh., koha ose kostoja e riparimit) dhe ndryshojnë në varësi të sektorit. Në rastin e një IKI-je, kriteret sektoriale mund të jenë: shpejtësia e kalimit të të dhënave, koha e rikuperimit të sistemit të informacionit, numri i regjistrave të të dhënave personale të mbajturaose të përpunuara nga sistemi, etj.

2.3.2 Kriteret ndërsektoriale: Vlerësojnë peshën e ndikimeve që do kishte mosfunksionimi /ndërprerja apo shkatërrimi i një IK-je të mundshme. Ky vlerësim pasqyron ndikimin në nivel kombëtar të një incidenti të papritur që prek atë infrastrukture, në një skenar të rastit më të keq, në shërbimin kritik (p.sh., të një sektori/nënsektori ose në një nivel ndërsektorial) të ofruar përmes infrastrukturës së prekur. Një infrastrukturë kritike potenciale kuptohet si një IK kur ndikimi i një incidenti që e prek atë plotëson të paktën një ose më shumë kritere sasiore dhe/ose cilësore. Kriteret e të qenët kritik mund të

²⁰ Burimi: Klaver M (2011) *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikëbërësit në Evropë*. Bruksel: http://www.oiiip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf

²¹ Burimi: Luijff E, Burger H, Klaver M, Marieke H (2003) *Mbrojtja e IK në Holandë: një skanim i shpejtë*. EICAR Danimarkë.

²² Burimi: Rossella dhe Cédric, *Metodologjitë për identifikimin e aseteve të IKI dhe shërbimet*. Udhëzimet për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të të dhënave.

përfshijnë:^{23 24}:

1. **Shtrirjen e zonës gjeografike.** Një infrastrukturë vlerësohet për shtrirjen minimale të zonës gjeografike, e cila mund të ndikohet nga një incident që prek infrastrukturën.
2. **Viktimat.** Kriter është numri minimal i viktimave dhe/ose i lëndimeve që mund të shkaktojë një incident që prek infrastrukturën.
3. **Efektet ekonomike.** Ky kriter është me ndikim makroekonomik (p.sh., humbje në prodhimin kombëtar bruto, humbja e tokës, kostot e zhvendosjes së popullsisë, kostot e ndotjes) dhe/ose ndikimi makro-social, duke përfshirë ndikimet e mundshme mjedisore.
4. **Efektet publike.** Kriteri vlerëson se si një ndikim (i mundshëm) në infrastrukturë mund të ndikojë në një pjesë të madhe të njerëzve që gëzojnë shërbimin kritik, shërbim i cili varet nga kjo infrastrukturë. Vlerësimi kryhet në dy hapa²⁵:
 - a. *Kategoria e incidenteve identifikohet si: (Identifikimi i kategorisë së incidenteve)*

Dëmtimi i shëndetit të qytetarëve.

Humbja e besimit të publikut.

Prishje e jetës së përditshme të qytetarëve.

- b. *Për secilën kategori janë identifikuar: (Identifikimi për secilën kategori)*

Numri i njerëzve (potencialisht) të prekur.

Graviteti i ndikimeve.

Kohëzgjatja e pasojave.

2.3.3 Kombinimi i kriterëve sektoriale dhe ndërsektoriale:

Në mënyrë tipike, kriteret sektoriale dhe ndërsektoriale mund të përdoren të kombinuara gjatë përcaktimit dhe prioritizimit të një IK-je. Kështu, në përputhje me qasjen e miratuar sipas Programit Europian për MIK (European Programme for Critical Infrastructure Protection - EPCIP)²⁶. Për çdo sektor kritik kombëtar dhe për çdo infrastrukturë sektoriale në shqyrtim, zbatohen kriteret sektoriale për të përcaktuar infrastrukturën si një IK potenciale në një sektor. Për çdo IK potenciale kontrollohet nëse infrastruktura plotëson

²³ Burimi: Direktiva e Këshillit 2008/114/EC (2008). Zyrtare J Eur Union 51: 75 Siguria dhe Rezistenca e Infrastrukturës Kritike-PPD-21 (2013) Uashington DC. <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/PPD-21-Critical-Infrastructure-and-Resilience-508.pdf>

²⁴ Burimi: Komisioni Evropian (2007) Programi Evropian për mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike.

²⁵ Burimi: Direktiva e Këshillit 2008/114/EC (2008). Zyrtare J Eur Union 51:75

²⁶ Burimi: Direktiva e Këshillit 2008/114/EC (2008). Zyrtare J Eur Union 51:75

kriteret e përkufizimit të IK. Një IK potenciale duhet të plotësojë të paktën një nga kriteret ndërsektoriale të kritereve të përcaktuar në listën e kritereve në seksion 2.3.2.

2. Praktikrat më të mira në vendet evropiane:

Vitet e fundit, shumica e shteteve anëtare të BE-së kanë, ose janë në proces të hartimit të politikave të qëndrueshme të sigurisë kibernetike për IK-të²⁷. BE-ja thekson nevojën për të përdorur praktikrat dhe metodat më të mira, të zbatuara në vendet e saj, për identifikimin dhe mbrojtjen e IK-ve evropiane. Në tabelën 2, përshkruhen nivelet e pjekurisë për vlerësimin e progresit të bërë nga një shtet anëtar në mbrojtjen e IK-së së tij kombëtare. Për shkak të rëndësisë së mbrojtjes së IK të informacionit për shumicën e sektorëve kritikë kombëtarë sot, (të ndërthurur) Niveli 2 është shtuar për të mbuluar shumicën e sektorëve kritikë kombëtarë për të përfshirë vendet të cilat, megjithëse nuk e kanë ose nuk e kanë përfunduar strategjinë e tyre të mbrojtjes së infrastrukturës kritike, kanë hartuar tashmë një strategji të sigurisë kibernetike për të mbrojtur IKI e tyre dhe atë të komunikimit.

Mëposhtë janë disa raste të zbatimit të plotë ose të pjesshëm të metodologjive të qasjes së identifikimit të IK të përmendura në seksionet e mëparshme. Në veçanti, janë paraqitur aspekte të qasjeve metodologjike të aplikuara nga vende si Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe (UK).

²⁷ Burimi: Paneli i BE-së për sigurinë kibernetike: Një rrugë drejt një hapësirë të sigurt evropiane kibernetike (2015) BSA – aleanca e softuerit. http://cybersecurity.bsa.org/assets/PDFs/study_eucybersecurity_en.pdf

Tabela nr. 2 Vlerësimi i maturimit të mbrojtjes kombëtare të IK në UK²⁸.

Shkallë Kritike	Përshkrimi
Kategoria / Niveli 5	Është infrastruktura humbja e së cilës do të kishte një <u>ndikim katastrofik</u> në UK. Këto pasuri do të jenë të një rëndësie kombëtare unike, humbja e të cilave do të kishte efekte afatgjatë kombëtare dhe mund të ndikojnë në një sërë sektorësh. Pak gjasa ka që të plotësohen këto kritere.
Niveli 4	Është infrastruktura me <u>rëndësi nga më të lartat</u> për sektorët. Ndikimi i humbjes së këtyre asetëve në shërbimet thelbësore do të ishte i rëndë dhe mund të ndikojë në ofrimin e shërbimeve thelbësore në gjithë UK ose për miliona qytetarë.
Niveli 3	Është ajo infrastrukturë me <u>rëndësi të konsiderueshme</u> për sektorët dhe ofrimin e shërbimeve thelbësore, humbja e të cilave prek një rajon të madh gjeografik ose disa qindra, mijëra njerëz.
Niveli 2	Është infrastruktura humbja e së cilës do të kishte një <u>ndikim të rëndësishëm</u> në ofrimin e shërbimeve thelbësore që çojnë në humbje ose ndërprerje shërbimi për dhjetëra - mijëra njerëz ose që prekin qarqe të tëra ose ekuivalentë me to.
Niveli 1	Është infrastruktura humbja e së cilës mund të shkaktojë <u>ndërprerje e moderuar të ofrimit të shërbimit</u> , në një bazë të lokalizuar, duke prekur mijëra qytetarë.
Niveli 0	Është infrastruktura <u>ndikimi i humbjes së cilës do të ishte i vogël</u> (në shkallë kombëtare).

Disa nga këto vende janë ose pionierë në hartimin metodologjik të identifikimit dhe përcaktimit të IK-ve (p.sh., Franca) ose ato referohen në literaturë si praktika të mira (p.sh., UK^{29 30}).

3.1. Franca

Franca, një nga vendet e para evropiane që hartoi dhe zbatoi një politikë

²⁸ Burimi: Paneli i BE-së për sigurinë kibernetike: Një rrugë drejt një hapësirë të sigurt evropiane kibernetike BSA - aleanca e softuerit. http://cybersecurity.bsa.org/assets/PDFs/study_eucybersecurity_en.pdf

²⁹ Klaver M (2011) *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikë-bërësit në Evropë*. http://www.oaip.ac.at/fileadmin/Untertagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf

³⁰ Novotný P, Rostek P (2014) *Perspektiva e kritereve ndërsektoriale si një instrument kryesor për përcaktimin e infrastrukturës kritike në Republikën Çeke*. (Vëll. 2). Punime kërkimore: Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjisë së materialeve, Universiteti i Teknologjisë Sllovaqe.

për identifikimin dhe mbrojtjen e IK, ka përcaktuar 12 sektorë jetikë ³¹ që ndahen në 3 fusha kryesore si mëposhtë:

- a) Sektorët shtetërorë (shërbimet publike, operacionet ushtarake, gjyqësori, hapësira dhe hulumtimi).
- b) Sektorët e mbrojtjes civile (shëndetësia, menaxhimi i ujërave, ushqimi).
- c) Fushat e jetës ekonomike dhe sociale kombëtare (energji, komunikimet elektronike, sistemet audiovizive dhe informacioni, transporti, ekonomia, industria).

Si pjesë e SSK^{32 33}, u ndoq qasja kombëtare e drejtuar nga operatori për identifikimin e IK-ve kombëtare. Në veçanti, qeveria, nëpërmjet vendosjes së mandateve përkatëse përcakton një listë të OV, ku secili operator është i lidhur me një sektor kritik. Administratori i çdo OV-je detyrohet:

- të emërojë oficerë sigurie, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal;
- të kryejë vlerësimin e rrezikut për të identifikuar asetet/sistemet kritike në fushën e tij të përgjegjësisë dhe të krijojë një Plan të Sigurisë së Operatorit (PSO) për ta mbrojtur atë;
- të identifikojë asetet/sistemet që do të jenë objekt i PSO-së, që do të zbatohet nën përgjegjësinë e operatorit, si dhe një Plan Mbrojtjeje të Jashtme, që do zbatohet nga organi publik përgjegjës.

Brenda kuadrit të së njëjtës qasje për mbrojtjen e informacionit kombëtar të IK-ve ³⁴, me dekretet 349, 350, 351 datë 27 mars 2015 u vendosën detyrime për 200 operatorët jetikë në lidhje me sigurinë e sistemeve të tyre të informacionit.

3.2. Gjermania.

Kushtetuta gjermane detyron shtetin gjerman të garantojë sigurinë publike dhe të sigurojë ofrimin e mallrave e shërbimeve thelbësore. Zyra Federale e Mbrojtjes Civile dhe Ndihmës për Fatkeqësitë është përgjegjëse për të stimuluar operatorët e IK-ve për të siguruar në mënyrë proaktive IK-të dhe për të përgatitur plane efektive për menaxhimin e krizave.

³¹ Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike në Francë. (2017). Paris: Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare (SGDSN). <http://www.sgdsn.gouv.fr/uploads/2017/03/plaquette-saiv-anglais.pdf>

³² Klaver M (2011) *Manual i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikë-bërësit në Evropë*. Bruksel: http://www.oaip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FI_NAL_RECIPES_manual.pdf

³³ Letra e Bardhë Franceze për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare (2013) Paris

³⁴ Strategjia Kombëtare e Sigurisë Dixhitale Franceze (2015) Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare (SGDSN). https://www.enisa.europa.eu/topics/national-cyber-security-strategies/ncss-map/France_Cyber_Security_Strategy.pdf

Sipas sektorëve³⁵ në Gjermani, infrastrukturat e mëposhtme janë përcaktuar si kritikë: energjia (energja elektrike, gaz, vaji mineral), uji (furnizimi, asgjësimi), ushqimi (industria ushqimore e shitjes me pakicë, industria ushqimore), kultura dhe media (transmetimi, media e shkruar, asetet kulturore), informacioni (telekomunikacioni, teknologjia e informacionit), financa (ofruesit e shërbimeve financiare, sigurimet, bankat, bursat), shëndetësia (kujdesi shëndetësor, laboratorët, barnat, vaksinat), transporti (aviacioni, transporti detar, hekurudhat, rrugët, logjistike) dhe shteti/administrata (parlamenti, qeveria, gjyqësori, shërbimet e urgjencës).

Në vitin 2009, Gjermania miratoi Strategjinë Kombëtare për MIK³⁶. Ajo angazhon qeveritë federale e vendore të forcojnë mbrojtjen e IK-ve në fushat përkatëse të përgjegjësisë. Në të përfshihen paketat e mëposhtme, të cilat bazohen në qasjen bashkëpunuese të miratuar nga Administrata Federale me përfshirjen e aktorëve të tjerë kryesorë (operatorët dhe shoqatat përkatëse):

- Përcaktimi i objektivave të mbrojtjes së përgjithshme.
- Analiza e kërcënimeve, dobësive dhe aftësive të menaxhimit.
- Vlerësimi i kërcënimeve të përfshira.
- Prioritizimi i objektivave të mbrojtjes, duke marrë parasysh çdo masë ekzistuese.
- Zbatimi i masave për arritjen e qëllimeve kryesisht nëpërmjet: zgjidhjeve specifike të shoqatës dhe rregulloreve të brendshme; marrëveshjet e vetë-angazhimit nga biznesi dhe industria; zhvillimi i koncepteve të mbrojtjes nga kompanitë.
- Procesi i komunikimit të vazhdueshëm dhe intensiv për rrezikun.

3.3. Britania e Madhe (UK).

Në UK, infrastruktura kombëtare përkufizohet si objekte, sisteme, vendndodhje ose rrjete të nevojshme për të operuar vendin dhe për të ofruar shërbime bazë mbi të cilat mbështetet jeta e përditshme e njerëzve në UK³⁷. Disa asete të infrastrukturës kombëtare quhen kritike në kuptimin që humbja e tyre do të çonte në viktima apo pasoja të rëndësishme ekonomike ose sociale në UK. Këto asete kritike përbëjnë Infrastrukturën Kritike Kombëtare (IKK). IKK në UK përbëhet nga 13 sektorë kombëtarë infrastrukture: kimikatet, komunikimet bërthamore civile, mbrojtja, shërbimet e emergjencave, energjia, financa, ushqimi, qeveria, shëndetësia, hapësira, transporti dhe uji. Disa sektorë kanë

³⁵ Raporti Vjetor i BKK (2015) 10–13. Gjermani: Zyra Federale e Mbrojtjes Civile dhe Fatkeqësive asistencë

³⁶ Strategjia Kombëtare për CIP (2009) Republika Federale e Gjermanisë.

³⁷ Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes dhe Sigurisë (2015) Qeveria e UK. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/478933/52309_Cm_9161_NSS_SD_Review_web_only.pdf.

përcaktuar “nën-sektorë”; Shërbimet e urgjencës p.sh., mund të ndahen në polici, ambulancë, shërbime zjarrfikëse dhe roje bregdetare. Çdo sektor ka një ose më shumë Departamente Drejtuese, përgjegjës përsektorin, duke garantuar kështu sigurinë dhe mbrojtjen për asetet kritike të vendosura.

Metodologjikisht, identifikimi dhe përcaktimi i IK-ve në UK është përcaktuar si një hibrid³⁸, d.m.th., ka elemente nga të dyja qasjet e përshkruara më lart (sek. 2). Në fakt, çdo ministri, përgjegjës për sektorin/nënsektorin e saj të kompetencës, përcakton një listë të Operatorëve Kritikë (OK) të shërbimeve që përbëjnë sektorin/nënsektorin dhe secili OK, nga ana e vet, identifikon asetet/sistemet më kritike që përbëjnë shërbimet. Në të njëjtën kohë, Qendra për Mbrojtjen e Infrastrukturave Kombëtare (QMIK), si organi publik përgjegjës, realizon në mënyrë të pavarur studimin e saj për vlerësimin e IK-ve potenciale, sipas kriterëve të vlerësimit ndërsektorial mbi ndikimin në shoqërinë britanike. Në veçanti, një shkallë vlerësimi me 6 nivele, nga niveli 0 deri në nivelin 6 (Tab. 3) është aplikuar për vlerësimin e ndikimit kritik, ku një IK Kombëtare përkufizohet si një aktiv që ka një nivel kategorie 3 ose 4 ose 5, ndërsa çdo aktiv i nivelit më të ulët kuptohet si kritik, megjithëse kritika e tij është më shumë lokale ose rajonale. Çdo infrastrukturë e klasifikuar në kategorinë 0 deri në kategorinë 2 quhet infrastrukturë më e gjerë kombëtare (Wide National Infrastructure).

Tabela nr. 3 Shkalla e vlerësimit të IK-ve në UK.³⁹

Niveli 0 - Mungesa e ndonjë aktiviteti të rëndësishëm për MIK	Kroaci, Irlandë, Portugali
Niveli 1 - Mishërimi i Direktivës 2008/114 (Këshilli i BE, 2008) në nivel kombëtar.	Greqia, Bullgaria, Danimarka, Malta
Niveli 2 - Krijimi i një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen e IK	Belgjika, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Sllovenia, Suedia
Niveli 3 - Zbatimi i Planit të Mbrojtjes Kombëtare për IK	Austria, Franca, Gjermania, Zvicra, Estonia, Spanja, Britania e Madhe, Holanda, Polonia, Rumania, Sllovakia, Çekia, Finlanda

³⁸ Klaver M (2011), *Manuali i praktikave të mira për politikën e PIK, për politikë-bërësit në Evropë*. [http://www.oip.ac.at/fileadmin/ Unterlagen/ Dateien/Publikationen/FINAL_ RECIPE_manual.pdf](http://www.oip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf)

³⁹Kuadri Strategjik dhe Deklarata e Politikës mbi Përmirësimin e Rezistencës së IK ndaj Përçarjes nga Rreziqet Natyrore Londër: Zyra e Kabinetit të MB. [https://www.gov.uk/government/publications/ strategic-framework-and-policy-statement on-improving-the-resilience-of-critical-infrastructure-to-disruption-from-natural-hazards](https://www.gov.uk/government/publications/strategic-framework-and-policy-statement-on-improving-the-resilience-of-critical-infrastructure-to-disruption-from-natural-hazards)

Një metodë e bazuar në rrezik ndiqet për renditjen përfundimtare të një aktivi kritik në UK⁴⁰. Konkretisht, për çdo aktiv, përveç vlerësimit kategori, merret parasysh dhe vlerësimi i probabilitetit të përfundimit të suksesshëm të një kërcënimi ndaj atij aktivi. Ky probabilitet vlerësohet nga njëra anë në dobësitë ose dobësitë e aktivitetit që vlerësohet, dhe nga ana tjetër, mbi gjasat e materializimit të një kërcënimi (p.sh., njerëzor ose fizik).

3.4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

SHBA është vendi i parë që zhvillon iniciativa për të mbrojtur IK-të. Sipas Planit Kombëtar të Mbrojtjes së Infrastrukturës⁴¹, IK përkufizohen si sistemet dhe mjetet, si fizike ashtu edhe virtuale, të cilat janë aq jetike për SHBA-në saqë çdo mosdisponueshmëri ose shkatërrim do të kishte një ndikim të rëndësishëm në sigurinë, ekonominë, shëndetin publik, ose ndonjë kombinim të tyre.

Direktiva e Politikave Presidenciale 21⁴² përcakton Departamentin e Sigurisë së vendit si organin përgjegjës për sigurinë e IK-ve përmes Zyrës së Mbrojtjes së Infrastrukturës. Departamenti Amerikan i Sigurisë Kombëtare ka identifikuar si sektorë kritikë sektorët e mëposhtëm dhe për secilin sektor, si koordinator u caktua një Agjenci Specifike Sektoriale. Këta sektorë janë: 1-sektori kimik, 2-objektet tregtare, 3-prodhimi kritik, 4-digat, 5-shërbimet e emergjencave, 6-TIK, 7-reaktorët bërthamorë, 8-materialet dhe mbetjet, 9-ushqimi dhe bujqësia, 10-bazave industriale e të mbrojtjes, 11-energji, 12-kujdesi shëndetësor dhe shëndeti publik, 13-sektori i shërbimeve financiare, 14-sistemet e ujit dhe ujërave të zeza, 15-objektet qeveritare, 16-sistemet e transportit.

Për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të Partneritetit Publik Privat (PPP) me organet si Këshillat Koordinues të Qeverisë (KKQ) dhe Koordinimit Sektorial, për çdo sektor kritik krijohen Këshilla Koordinues të Sektorëve (KKS). Këshillat e qeverisjes përfshijnë përfaqësues të qeverisë në nivel lokal, rajonal dhe federal, ndërsa Këshillat Sektoriale përfshijnë përfaqësues të Pronarëve / Operatorëve të IK-ve. Kompetencat e palëve kryesore të interesuarapërmblidhen si më poshtë:

- KKS: Janë këshilla të pavarura, të vetëmenaxhuara, aktivisht të përfshirë në hartimin e politikave dhe strategjive specifike sektoriale, dhe përfshijnë dhe përfaqësues të pronarëve dhe operatorëve të sektorit IK. KKS vepron

⁴⁰ Po aty (si më lart)

⁴¹ Austin Smith (2017), *Direktiva e Politikës Presidenciale 21*: Zbatimi: një siguri ndërinstitucionale letër e bardhë e komisionit.

⁴² Siguria dhe Rezistenca e IK – PPD-21 (2013) Uashington DC. <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/PPD-21-Critical-Infrastructure-and-Resilience-508.pdf>

si lidhje kyçe për komunikimin ndërmjet qeverisë dhe operatorit privat të IK.

- **KKQ:** Sipas sektorëve të IK-ve, përbëhen nga përfaqësues të qeverisë dhe shteteve dhe kanë përgjegjësi kryesore koordinimin mes organeve private dhe publike.
- **Këshillat Ndërsektoriale të Infrastrukturës Kritike (KNIK):** Përfshijnë përfaqësues të të gjitha këshillave sektoriale të KSK për koordinimin dhe çështjet ndërsektoriale (p.sh., varësitë/ndërvarenitë).
- **Këshillat Federale të Liderit të Lartë (KFLL):** Lidhin këshillat e sektorit me pjesën tjetër të institucioneve shtetërore në lidhje me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e IK-ve.

Këto struktura janë miratuar nga Komiteti Këshillimor i Partneritetit të IK-KKPIK. Departamenti i Sigurisë Kombëtare zbaton KKPIK⁴³ si mekanizëm për të angazhuar drejtpërdrejt interesat private dhe publike në çështjet e IK me synimin për të krijuar politika të nivelit të lartë për të zbutur rreziqet/pasojat e kërcënimeve të jashtme.

Strategjia e Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike

Nga përshkrimi i strategjive kombëtare të mbrojtjes të përshkruara më sipër, tregohet se pavarësisht dallimeve të tyre, në të gjitha strategjitë mund të gjenden disa fusha kryesore prioritare që kontribuojnë në një strategji efektive të mbrojtjes gjithëpërfshirëse për IK. Këto fusha përfshijnë:

Vizioni/Qëllimet: Zhvillimi i çdo strategjie të mbrojtjes së IK-ve përfshin përmblendhjen e objektivave strategjike (vizionit) që ndahen në qëllime individuale të matshme.

Administrata e Sigurisë e IK-ve: Struktura e administrimit/qeverisjes ka të bëjë me përcaktimin e organeve kompetente dhe të mandatuara për mbrojtjen e IK-ve, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi për organ, si dhe kornizën për bashkëpunimin ndërmjet organeve publike dhe private.

Partneritetet Publike Private (PPP): Çdo program kombëtar i mbrojtjes përfshin bashkëpunimin e palëve të interesuara, veçanërisht përmes PPP, përfshi organet publike dhe pronarët/operatorët e KI.

Shkëmbimi i informacionit: Shkëmbimi i informacionit i referohet ndërgjegjësimit për kërcënimet / dobësitë, sigurimit të paralajmërimit të hershëm për palët e interesuara dhe, në përgjithësi, ndaj shkëmbimit të informacionit dhe njohurive adekuate për rreziqet dhe kërcënimet.

⁴³Chris Boyer – AT&T (2017) *Vështrim i përgjithshëm i partneritetit të infrastrukturës kritike*. AVP – politika publike globale <https://www.oecd.org/going-digital/digital-security-in-critical-infrastructure/digital-security-workshop-february-2018-%20Boyer.pdf>

Kuadri legjislativ/rregullator: Ligjet janë një mjet i rëndësishëm për të siguruar që organet publike e private t'i përgjigjen roleve e përgjegjësisë të tyre, në përputhje me standardet specifike të sigurisë.

Identifikimi dhe vlerësimi i IK-së kombëtare: Identifikimi dhe vlerësimi i aseteve kritike kombëtare (sektorë, nënsektorë, shërbime dhe nënsisteme specifike) është një parakusht për zbatimin e politikave kombëtare për mbrojtjen e IK-së. Një kriter i rëndësishëm për klasifikimin e IK-së është, ndër të tjera, shtrirja dhe rëndësia e ndërlidhjeve dhe ndërvlarësive ndërmjet IK.

Vlerësimi i rrezikut: vlerësimi metodik i kërcënimeve dhe vlerësimi i rrezeve të sigurisë që rezultojnë nga IK-të kombëtare është një element kyç i strategjisë së mbrojtjes së IK-ve.

Rreziqet dhe menaxhimi i krizave: Masat e reagimit ndaj emergjencave sigurojnë vazhdimin e funksionimit ose rikuperimin e shpejtë të aktivitetit kritik.

Përfundime

1. Identifikimi dhe vlerësimi i IK-ve në nivel kombëtar duhet të vlerësohet një nga prioritetet kryesore, siç dëshmohet nga një sërë nismash kombëtare dhe ndërkombëtare
2. Identifikimi i IK-ve kombëtare përcaktohet në rregullore të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.
3. Shpeshherë, dëmtimi apo shkatërrimi ose humbja e një IK në një shtet mund të ketë efekte negative në disa shtete të tjera.
4. Si literatura ndërkombëtare ashtu edhe realiteti kanë treguar se për shkak të ndërvlarësive midis IK, shfaqja e një kërcënimi ose dështimi në një IK shpeshherë çon në ndikime që shkojnë nga lart-poshtë (në formë ujvare -kaskaduese) në IK të tjera të ndërlidhura, duke shkaktuar në këtë mënyrë efekte në shkallë të gjerë⁴⁴. Fenomene të tilla mund të modelohen sistematikisht vetëm nëpërmjet një përjasjeje që merr në konsideratë gjithë situatën, për mbrojtjen e IK-ve dhe që bazohet në metodologji të mirëpërcaktuara dhe praktikat më të mira të testuara.
5. Pavarësisht nëse ndiqet një qasje e drejtuar nga shteti apo nga operatori, identifikimi fillestar i IK-ve kombëtare është një parakusht për vlerësimin e tyre të mëvonshëm sistematik sipas kriterëve sektoriale dhe/ose ndërsektoriale.

⁴⁴ Burimi: Kotzanikolaou P, Theoharidou M, Gritzalis D (2013) Vlerësimi i varësive të rendit midis infrastrukturave kritike. Int J Crit Infrastruct 9(1-2):93-110

Bibliografia:

1. Austin Smith (2017) Direktiva e Politikës Presidenciale 21: Zbatimi/Implementimi: Letër e Bardhë e Komitetit për Siguri Ndërinstitucionale. Komiteti Ndërinstitucional i Sigurisë.
2. Raporti Vjetor i BKK (2015) 10–13. Gjermani: Zyra Federale e Mbrojtjes Civile e Fatkeqësive (BKK).
3. Chris Boyer – AT&T (2017) Vështrim i përgjithshëm i Partneritetit të Infrastrukturës Kritike. AVP - Politika Publike Globale. <https://www.oecd.org/going-digital/digital-security-in-critical-infrastrukturë/digital-security-workshop-february-2018-%20Boyer.pdf>
4. Direktiva e Këshillit 2008/114/EC (2008). Unioni Zyrtar Eur J 51: 75 Metodologjitë dhe Strategjitë për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike.
5. Siguria dhe Qëndrueshmëria e Infrastrukturës Kritike – PPD-21 (2013) Washington DC. <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/PPD-21-Critical-Infrastructure-and-Resilience-508.pdf>
6. Komisioni i BE-së (2012) Rishikimi i Programit Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike
7. Paneli i BE-së për sigurinë kibernetike: Një rrugë drejt një hapësire kibernetike evropiane të sigurt (2015) http://cybersecurity.bsa.org/assets/PDFs/study_eucybersecurity_en.pdf
8. Komisioni Evropian (2007) Programi Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike.
9. Komisioni Evropian (2005) Letra e gjelbër mbi një program evropian për MIK, Bruksel, COM, f. 576. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0576>
10. Strategjia Kombëtare e Sigurisë Dixhitale Franceze (2015) Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare (SGDSN). https://www.enisa.europa.eu/topics/national-cyber-security-strategies/ncss-map/France_Cyber_Security_Strategy.pdf
11. Gritzalis D, Stergiopoulos G, Kotzanikolaou P, Magos E, Lykou G (2016) Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike: një metodologji holistike për Greqinë. Konferencë për sigurinë e kontrollit industrial dhe sistemeve fizike kibernetike (CyberICPS). Springer, 19–34
12. Klaver M (2011) Manuali i praktikave të mira për politikëbërësit në Evropë. http://www.oip.ac.at/fileadmin/Unterlagen/Dateien/Publikationen/FINAL_RECIPES_manual.pdf
13. Kotzanikolaou P, Theoharidou M, Gritzalis D (2013) Vlerësimi i varësive të rendit midis Infrastrukturave Kritike. Int J Crit Infrastruct 9(1-2):93-110

14. Luijff E, Burger H, Klaver M, Marieke H (2003) Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike në Holandë: një skanim i shpejtë. EICAR Danimarkë, Kopenhagë
15. Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes dhe Sigurisë (2015) Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/478933/52309_Cm_9161_NSS_SD_Review_web_only.pdf
16. Strategjia Kombëtare për CIP (2009) Republika Federale e Gjermanisë
17. Novotný P, Rostek P (2014) Perspektiva e kriterëve ndërsektoriale si një instrument kryesor për përcaktimin e Infrastrukturës Kritike në Republikën Çeke. (Vëll. 2). Punime kërkimore Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjisë së Materialeve Universiteti i Teknologjisë Sllovaqe
18. Partneritetet Publike Private (PPP)-Modelet e bashkëpunimit (2017) ENISA. <https://www.enisa.europa.eu/publications/public-private-partnerships-ppp-cooperative-models>
19. Rossella M, Cédric LB (2014) Metodologjitë për identifikimin e aseteve dhe shërbimeve të Infrastrukturës së Informacionit Kritik. Udhëzime për hartimin e rrjeteve elektronike të komunikimit të dhënave, agjencia e Bashkimit Evropian për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit. ENISA, Heraklion
20. Rossella M, Cédric LB (2015) Metodologjitë për identifikimin e aseteve dhe shërbimeve kritike të infrastrukturës së informacionit. ENISA: Agjencia e BE për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit.
21. Kuadri Strategjik dhe Deklarata e Politikës mbi Përmirësimin e Rezistencës së Infrastrukturës Kritike ndaj Përçarjes nga Rreziqet Natyrore (2010) Londër: Zyra e Kabinetit të MB. <https://www.gov.uk/government/publications/strategic-framework-and-policy-statement-on-improving-the-resilience-of-critical-infrastructure-to-disruption-from-natural-hazards>
22. Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike në Francë. (2017). Paris: Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare (SGDSN). <http://www.sgdsn.gouv.fr/uploads/2017/03/plaquette-saiv-anglais.pdf>
23. Letra e Bardhë Franceze për Mbrojtjen dhe Sigurinë Kombëtare (2013).

Përgatitja intelektuale për luftën e ardhshme. Si inteligjenca artificiale do të ndryshojë arsimin profesional ushtarak?

Nënkolonel (R) Msc. Besnik DACI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Çdo ditë e më tepër shtohet nevoja të shqyrtojmë plotësisht aplikimet potenciale të inteligjencës artificiale brenda domain-it ushtarak për të përfitur në mënyrë të sigurt nga zhvillimet teknologjike të së ardhmes. Për të mbështetur dhe ndërtuar këtë avantazh, drejtuesit ushtarakë do të duhet të rimendojnë sistemet profesionale të arsimit ushtarak dhe të mësojnë se si të kombinojnë më së miri inteligjencën njerëzore dhe artificiale.

Vendet e zhvilluara kanë publikuar dhe rifreskuar strategji afatgjata për të udhëhequr botën në zhvillimin dhe punësimin e inteligjencës artificiale. Do ishte e udhës që secili shtet t'i kushtojë rëndësinë e duhur inteligjencës artificiale, një teknologji e së ardhmes, që sigurisht do të ndikojë edhe në të gjithë sektorët ushtarakë dhe civilë.

Fjalët kyçe: përparimet teknologjike, inteligjenca artificiale, robotët, OODA, zinxhiri i komandimit ushtarak.

Hyrje

Apo rezulton agimi i inteligjencës artificiale (IA) dhe i armëve autonome në një revolucion të ri në çështjet ushtarake? Kjo është pyetja që shtron një artikull i kohëve të fundit nga Frank Hoffman¹. Ashtu si me revolucionet e mëparshme, teknologjia nuk është përcaktuesi i vetëm i ndërrimeve të mëdha në mënyrën se si organizatat ushtarake kryejnë me sukses operacionet.

Zhvillimi i organizatave të reja dhe koncepteve të reja të luftës luajnë gjithashtu një rol të madh dhe këto janë fusha të ndikimit njerëzor, jo të pajisjeve. Prandaj, nëse organizatat ushtarake do të përshtaten me sukses me këtë epokë të re, ato duhet të maksimizojnë potencialin e tyre njerëzor për të fituar një avantazh intelektual. Për të mbështetur dhe ndërtuar këtë avantazh, drejtuesit ushtarakë do të duhet të ridimensionojnë sistemet profesionale të arsimit ushtarak dhe të mësojnë se si të kombinojnë më së miri inteligjencën njerëzore me atë artificiale.

Ky artikull do të shqyrtojë se si drejtuesit ushtarak mund të sigurojnë që njerëzit e tyre të përgatitur për sukses në luftën e ardhshme duke përdorur potencialin e inteligjencës artificiale, si dhe se si kjo mund të ndikojë në edukimin profesional ushtarak. Nëse bëhen në kohë, këto ndryshime në modelin arsimor do t'u lejojnë institucioneve të maksimizojnë pikat e forta të njeriut dhe inteligjencës artificiale në një mjedis bashkëpunues në të gjithë ndërmarrjen ushtarake. Duke bërë këtë, Forcat e Armatosura mund të zbulojnë edhe mënyra të reja dhe më të efektshme për të menduar, planifikuar dhe ekzekutuar operacionet ushtarake.

1. Potenciali ushtarak i inteligjencës artificiale.

Organizatat, institucionet dhe agjencitë e inteligjencës ushtarake po ndjejnë presionin konkurrues për të zgjeruar përdorimin e inteligjencës artificiale dhe zbatimin e saj në ushtri dhe më gjerë, në atë të sigurisë kombëtare. Vendet e zhvilluara si: SHBA dhe Kina kanë publikuar strategji afatgjata për të udhëhequr botën në zhvillimin dhe punësimin e inteligjencës artificiale.

Por çfarë është intelijenca artificiale? Përkufizime janë të shumta, por në këtë punim po paraqes mendimin nga Amir Husain në *The Sentient Machine*²: “Intelijenca artificiale është shkenca mbizotëruese që ka të bëjë me algoritmet, nëse mësojnë apo jo nga të dhënat.” Duke u mbështetur në këtë përkufizim,

¹ Winning Wars and Military Education: Crossing Both Spans of the Strategy Bridge.

² Amir Husain, *The sentient machine*. Shih: <https://www.bing.com>.

Genevieve Bell³ nga Universiteti Kombëtar Australian e përshkruan inteligjencën artificiale (IA) si: “Motorin me avull të shekullit të 21-të. Nuk është fundi i përparimeve teknologjike. Por është mjeti për t’i realizuar gjërat.” Së fundi, aplikimet potenciale të përshkruara në këtë artikull supozojnë përdorimin e inteligjencës artificiale që aktualisht është brenda aftësive teknologjike të kombeve të zhvilluara teknologjikisht.



Një arsye kryesore që organizatat ushtarake kanë nevojë për inteligjencë artificiale është konvergjenca e sasive të mëdha të sensorëve, rrjeteve të komunikimit dhe një rrjedhë përshpejtuese e të dhënave dhe informacionit. Ndërsa sasia e informacionit vazhdon të rritet, aftësia e njerëzve për t’u marrë me të nuk po rritet në mënyrë të barabartë. Në të vërtetë,

njerëzit po bëhen shpejt lidhja më e ngadaltë në marrjen e vendimeve. Dhe ndërsa ka shumë debat etik në vendet perëndimore rreth aplikimit të sistemeve autonome të armëve, siç ka shkruar Ian Morris, “kur robotët me OODA (observe, orient, decide, and act); (vëzhgojnë, orientojnë, vendosin dhe veprojnë) fraksionet e nanosekondave fillojnë të vrasin njerëzit me fraksione OODA të milisekondave, nuk do të ketë më debat.”

Në ditët e sotme njohuritë mbi aplikimet e inteligjencës artificiale janë gjerësisht të disponueshme nga bizneset civile si: “Cortana” e Microsoft, “Google’s Now”, “Amazon’s shopping sites”, “Netflix’s streaming algorithms” dhe “Apple’s Siri”. Të gjitha kombinojnë hyrjen e përdoruesve, qasjen në baza të mëdha të të dhënave dhe algoritmet për të ofruar mbështetje vendimi për përdoruesit njerëzorë bazuar në vendimet e tyre të mëparshme dhe ato të miliona përdoruesve të tjerë. Kjo përfaqëson, siç e ka përshkruar Yuval Harari⁴, një zhvendosje të ngadaltë dhe të qëndrueshme të autoritetit nga njerëzit në algoritme. Ka të dhëna në lëvizjen e disa vendimeve të mbështetjes dhe vendimmarrjes në pajisje.

Por kjo u ofron gjithashtu organizatave ushtarake përfitime potenciale në filtrimin e informacionit, eksplorimin e më shumë opsioneve dhe analizën më të thellë të këtyre opsioneve. Kjo mund të sigurojë një vendim më të shpejtë, ose me cilësi më të mirë, në mjedise komplekse operacionale dhe strategjike.

³ Defining the future: The talks of TED Salon: Dell Technologies | TED Blog.

⁴ *Unstoppable Us*, Volume 1: How Humans Took Over the World Yuval Noah Harari.

2. Inteligjenca artificiale dhe përgatitja intelektuale për luftë.

Inteligjenca artificiale, sikurse është përhapur në tregti, ka të ngjarë të përhapet edhe në vendimmarrjet ushtarake. Ajo mund të përdoret në analizën e inteligjencës, mbështetjen strategjike të vendimeve, planifikimin operacional, komandim-kontrollin, mbështetjen logjistike dhe sistemet e armëve në të gjitha mjediset. Por, në qoftë se institucionet do të përdorin IA, ato do të kenë nevojë për përdorues të informuar për të formësuar aplikimin e IA dhe për të siguruar cilësinë. Një sfidë me inteligjenca artificiale është edhe mungesa e “shpjegueshmerisë” së saj. Nuk është gjithmonë e qartë se çfarë bëjnë algoritmet që mbështesin këto aftësi të reja. Kjo cilësi e “kutisë së zezë” duhet të nxisë një qasje të ndryshme në përgatitjen e personelit ushtarak për aplikimet e saj në ndryshime.

Prandaj, organizatave ushtarake do t’u duhen më shumë se vetëm ekspertë të thellë, teknikë në zhvillimin e algoritmeve dhe projektimin e inteligjencës artificiale për sistemet ushtarake. Siç ka zbuluar një raport i fundit i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, çdo fuqi punëtore e kualifikuar që përdor IA duhet të jetë një përzierje e atyre që kanë një mirëkuptim bazë, përdorues më të informuar dhe specialistë me aftësi të avancuara. Gjatë viteve të ardhshme, pothuajse në çdo rang dhe nivel, personeli ushtarak do të kërkojë të paktën nivelin bazë në përfshirjen në inteligjencën artificiale duhet të mendojmë se si të sigurojmë nivel sigurie dhe kontrolli të cilësisë, dhe si ta kombinojmë atë në mënyrë optimale me inteligjencën njerëzore. Sistemet e arsimit ushtarak përëndimor aktualisht nuk sigurojnë këtë qasje të përmirësuar për të gjithë personelin e tyre. Megjithatë, është e nevojshme dhe e domosdoshme në të ardhmen lidhja e ekspertëve teknikë me njohuri të teknologjisë së përparuar në të gjithë forcën që do të lejojë Forcën e Armatosur të shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e inteligjencës artificiale.

Ndërsa ushtarakët duhet të fillojnë e kërkojnë të zhvillojnë edukimin bazë në IA për të plotësuar njohuritë e ekspertëve që projektojnë algoritme, lista leximi, aftësi *online*, si dhe partneritete akademike dhe konferenca që i shërbejnë kësaj fushe të cilat do të jenë të dobishme dhe domosdoshme në të ardhmen. Programet ekzistuese profesionale të arsimit ushtarak duhet të përshtaten për të ofruar këtë standard të lartë të njohurive teknike e teknologjike. Aktualisht, programet profesionale të arsimit profesional ushtarak në përgjithësi duhet të përqendrohen në tre fusha kryesore: politika dhe strategjia e sigurisë kombëtare, lufta e përbashkët dhe fusha e rëndësishme e komandës, udhëheqjes dhe etikës.

Ndërsa ka kurse specialistësh të ofruara në profesionet e ngushta në llojet e armëve dhe shërbimeve të cilat kërkohet të jepen mundësitë për të zhvilluar mirëkuptim më të gjerë mbi implikimet dhe shfrytëzimin e teknologjive më të përparuara të cilat deri më tani kanë qenë më të kufizuara. Shtimi i një shtylle

tjetër në kurrikula duke u përqendruar në format më të përparuara teknologjike, si në nivel teknik po ashtu dhe atë programor. Etika e teknologjisë së përparuar, njësitë prokuruese dhe logjistika do të krijojnë një kapacitet institucional më të gjerë për të kuptuar teknologjitë e reja, për të nxitur kontrollin e cilësisë dhe për të trajtuar rreziqet e paragjykimit dhe algoritmeve të sjelljes së gabuar.

Ky fokus arsimor shtesë, i vazhdueshëm që nga fillimet e studimit apo të shërbimit ushtarak të një individi deri në rangjet e larta, mund të ndihmojë Forcën e Armatosur për të formuar e zhvilluar një potencial kohor të thellë institucional të njerëzve që kuptojnë inteligjencën artificiale dhe vlerësojnë njerëzit të cilët mund të bashkëpunojnë me teknologjinë e pajisjen (makinën) në mënyrë efektive në çdo nivel komandimi, por ndryshime të tilla nuk janë të thjeshta. Ashtu si me të gjitha ndryshimet e rëndësishme institucionale, zhvillimi i arsimit ushtarak profesional për të inkorporuar këtë fushë shtesë të fokusit intelektual do të kërkojë mbrojtje të lartë të udhëheqësit, investime në kurrikula të reja dhe zbatim të disiplinuar në të gjithë programet arsimore të përbashkëta dhe të mëvetësishme të shërbimit.

3. Të mësuarit me inteligjencën artificiale.

Inteligjenca artificiale ka gjithashtu potencial të rëndësishëm për të ndryshuar mënyrën se si ushtarakët edukojnë personelin e tyre. Siç e përshkroi një raport i kohëve të fundit, sistemet e tutorimit inteligjent të drejtuar nga inteligjenca artificiale mund të jenë në gjendje të sigurojnë një tutorim njerëzor të simuluar kokë më kokë. Studentët/kursantët gjithashtu mund të përfitojnë nga një “partner i të mësuarit gjatë gjithë jetës” të inteligjencës artificiale që ata jepen në hyrje në ushtri dhe që i shoqëron ata gjatë karrierës së tyre, një mundësi që përputhet bukur me propozimet që Jensen, Cuomo dhe Whyte, bëjnë në artikullin e tyre “Lufta mbi Shkëmbinjtë”. Nga ana e tyre, pedagogët/instruktorët në institucionet ushtarake mund të përfitojnë edhe nga ndihmësi i tyre mësimor që komunikon me partnerët e studentëve për të interpretuar profilet individuale të studentëve/kursantëve dhe për të dhënë sugjerime mbi mësimin e përshtatur.

Inteligjenca artificiale gjen zbatim edhe në mësimin bashkëpunues, të cilin organizatat ushtarake e kanë përdorur prej kohësh për të ndarë mësim historik dhe për të ndërtuar ekupe efektive dhe kohezive. Sot, shumica e të mësuarit bashkëpunues përdoret për trajnim të tilla si aftësitë taktike të nivelit më të ulët. Megjithatë, IA mund të jetë gjithashtu në gjendje të ndihmojë në zhvillimin e aftësive njohëse që mbështesin planifikimin operacional dhe strategjik të nivelit më të lartë në ekupe. Ajo mund ta bëjë këtë duke ofruar mjedise më autentike për të mësuar në bashkëpunim, duke ofruar sisteme kundërshtare më inteligjente për të sfiduar studentët ose duke përdorur algoritme të projektuara,

me qëllim dhe të dhëna kurrikulare për të bashkuar mësimet nga aktivitetet e mëparshme.

Së fundi, siç e përshkruan Jensen, Cuomo dhe Whyte⁵, IA mund të përdoret për simulime të avancuara në arsimin ushtarak profesional. Aktualisht, shumica e sistemeve të simulimit në institucionet ushtarake janë të fokusuara në rezultatet e trajnimit, të tilla si: armëmbajtja, fluturimi, urat e anijeve dhe vëzhgimi i artilerisë etj. Ka disa simulime të fokusuara në aftësitë njohëse të nivelit më të lartë, të tilla si seminari i përbashkët “Wargaming Adjudication Tool”, konflikti i përbashkët dhe simulimi taktik dhe simulimi “Warfighters” (WARSIM 2000). Këto mjete, të cilat përgjithësisht kërkojnë një numër të madh bashkëveprimtarësh për të dhënë kontributin e sfondit, përfaqësojnë përpjekjet e hershme për të edukuar më shumë oficerë të lartë në luftën e përbashkët dhe të koalicionit. Mjete më të sofistikuar duke përdorur IA mund të përmirësojnë aftësitë njohëse të udhëheqësve të lartë ushtarakë dhe, potencialisht, të politikbërësve civilë.

Përfundimisht, duke lidhur bazat e të dhënave të burimeve njerëzore, literaturën doktrinare, mësimet e nxjerra të bazave të të dhënave dhe hartimin e programeve mësimore, inteligjenca artificiale mund të jetë në gjendje të identifikojë boshllëqet në përvojën e të mësuarit të profesionistëve ushtarakë si dhe zgjidhjet për t’u siguruar që ata të mbeten intelektualisht të përshtatshëm për konfliktin e ardhshëm. Kjo mund të rezultojë përfundimisht në më pak dallime burokratike midis arsimit ushtarak profesional të shërbimit dhe arsimit të përbashkët profesional ushtarak, duke bërë të mundur një vazhdimësi të vetme të unifikuar të arsimit në të gjithë institucionet ushtarake dhe të sigurisë kombëtare.

4. Edukimi dhe inteligjenca artificiale në zhvillimin e koncepteve.

Nëse institucionet arsimore ushtarake mund të shfrytëzojnë përfitimet e inteligjencës artificiale për të ndërtuar idetë rreth konceptit dhe për të ndihmuar studentët/kursantët në përgjithësi, kjo mund të ndërtojë themelin për eksperimentim në konceptet e reja të luftës për shekullin e 21-të. Institucionet arsimore ushtarake duhet të kenë ekspertizë të thellë në ndihmën e forcave të armatosura për të zhvilluar qasje të reja operacionale. Ka gjithashtu një histori të gjatë të institucioneve arsimore ushtarake që po përdoren për të zhvilluar konceptet e ardhshme të luftës, një element kyç i çdo transformimi në aftësinë e luftës.

Oficerë, ushtarakë të arsimuar mirë dhe me përvojë që bisedojnë në pikat e forta dhe dobësitë e inteligjencës artificiale do t’u lejojnë institucioneve të

⁵ Algorithms at War: The Promise, Peril, and Limits of Artificial Intelligence.

ndërtojnë koncepte të reja operative të përbashkëta që paraqesin ekipin e inteligjencës njerëzore makinerike dhe njerëzore artificiale. Nëpërmjet këtyre eksplorimeve, organizatat mund të zbulojnë se shpejtësia me të cilën funksionojnë sistemet autonome i detyron njerëzit të veprojnë më tej në zinxhirin komandues. Siç vuri në dukje Thomas Adams në vitin 2001, lufta taktike mund të bëhet biznesi i makinerive, aspak e përshtatshme për njerëzit, edhe pse këto eksperimente informojnë modernizimin institucional dhe konceptet operacionale dhe gjithashtu, mund të japin “feedback” mbi përdorimin më efektiv dhe etik të inteligjencës artificiale në të ardhmen.

Këto eksperimente mund të sugjerojnë gjithashtu reforma potenciale në pajisjet, strukturën e forcës dhe strukturat e menaxhimit të personelit dhe karrierës. Revolucionet e kaluara industriale krijuan vende pune që nuk ekzistonin më parë. Ka të ngjarë që eksperimentimi i fuqishëm me aplikimin e IA do t'i bëjë shumë kategori ekzistuese të punësimit ushtarak më pak të dobishme dhe do të theksojë nevojën për kategori të reja. Në vitin 1913, nuk ekzistonte një kategori e tillë si “ekuipazhi i tankeve,” por kishte shumë kalorës të hipur mbi kuaj. Në vitin 1945, ne nuk i imagjinonim “luftëtarët kibernetikë” si një aftësi thelbësore ushtarake. Do të ketë kategori të ardhshme personeli që ndoshta nuk e kemi imagjinuar ende se do të na duhet të lulëzojmë në epokën digjitale.

Në luftërat në ditët e sotme përdorimi me efikasitet i inteligjencës artificiale po jep mjaft rezultate si p.sh., ushtria izraelite konfirmon se tashmë ka sulmuar mbi 22 mijë objektiva në Rripin e Gazës. Por si i zgjedh Izraeli objektivat? Në konfliktet ushtarake, kjo zakonisht bazohet në informacionin nga shërbimet e inteligjencës dhe zbulimin e njësive në terren. Por, Liran Antebi i Institutit për Kërkime të Sigurisë Kombëtare në Universitetin e Tel Avivit pretendon se ushtria izraelite po përdor në shkallë të gjerë programet e inteligjencës artificiale IA për të zbuluar dhe për të përcaktuar objektivat e goditjeve ajrore ose ato të goditjeve me artileri. Vlerësimi i tij është se këto janë programe që kanë autonomi relativisht të lartë dhe analizojnë mjedisin e një objekti të mundshëm sulmi. Kështu, ata shumë shpejt zbulojnë dinamikën që mund të jetë një kërcënim dhe e klasifikojnë atë si objektiv të një sulmi.

Përfundime.

Studimet e fundit mbi mjedisin e ardhshëm operativ e përshkruajnë inteligjencën artificiale si “teknologjinë më përçarëse të kohës sonë”. Aplikimet potenciale të inteligjencës artificiale dhe aftësive të të mësuarit mund të jenë një nga aspektet më të thella të Revolucionit të Katërt Industrial. Në të vërtetë, për herë të parë pas dy shekujsh, ekspertë dhe praktikantë të informuar dhe me përvojë po pyesin nëse një ndryshim teknologjik do të rezultojë në ndryshime në natyrën e luftës.

Në konfliktet e ardhshme, ciklet e vendimeve ka të ngjarë të bëhen më të shpejta se aftësia e njohjes njerëzore. Komandim-kontrolli ushtarak dhe vendimmarrësit strategjikë do të kenë nevojë për inteligjencë artificiale që mund të përpunojë informacionin dhe të rekomandojë opsione për marrjen e vendimeve më shpejt dhe me cilësi më të lartë sesa mund të ketë një kundërshtar. Organizatat ushtarake ka të ngjarë të përmbajnë disa mijëra sisteme pa pilot dhe robotike, duke përfshirë të gjitha një formë të inteligjencës artificiale. Në këtë mjedis, ku të gjitha palët mund të zotërojnë inteligjencë artificiale dhe sisteme autonome, gara do të shkojë tek ata më të shpejtët intelektualisht.

Kjo epokë e re e sistemeve autonome, organizatat e reja që përdorjnë konceptet e luftës, do të kërkojnë që një përqindje më e madhe e personelit ushtarak të jenë të arsimuar në inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e tjera të përparuara. Ajo do të kërkojë mënyra të reja për edukimin e njerëzve në ushtri. Dhe shpejtësia me të cilën teknologjia do të evoluojë do të kërkojë gjithashtu riaftësimin dhe riedukimin e shpeshtë të personelit në një sistem të evoluuar profesional të arsimit ushtarak. Në përdorimin e aftësive potenciale të IA në një qasje të re në arsimin profesional ushtarak, në këtë rast, ne mund të ndërtojmë një avantazh intelektual mbi kundërshtarët e ardhshëm.

Bibliografia.

1. Frank G. Hofman, *Decisive Force: The new American way of war*. Foreign Policy Research Institute (fpri.org)
2. <https://www.bing.com>; artificial intelligence in modern warfare.
3. Algorithms at war: The Promise, Peril, and Limits of Artificial Intelligence.
4. Unstoppable Us, Volume 1: *How Humans Took Over the World* Yuval Noah Harari.
5. Mick Ryan, *Intellectual preparation for future war*.

RUBRIKA E KATËRT

STUDIME HISTORIKE

Modernizimi IV i ushtrisë greke, rikthehet dilemën mes “armatosjes politikës së gjalpit”

Dr. Glevin DERVISHI

Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar.

Ky artikull merr në analizë sfidat e sigurisë kombëtare, politikës së jashtme dhe të brendshme, si dhe reflektimin e tyre në shpenzimet që kryen Greqia në fushën e mbrojtjes. Greqia ka pasur një traditë të marrëdhënieve të vështira për sa i takon shpenzimeve për mbrojtjen kombëtare përgjatë gjithë ekzistencës së shtetit modern grek. Që në gjenezën e vet, shteti grek e ka pasur mbrojtjen kombëtare, ruajtjen e sovranitetit dhe pavarësinë territoriale të një rëndësie jetike, madje shpesh përtej funksioneve normale të një shteti. Kjo është një nga detyrat primare për të cilën ekziston shteti, por në rastin e Greqisë, përmbushja e këtyre detyrave është në limitet e sakrificës¹. Kjo marrëdhënie ka nga pas arsyet e saja të thella historike të cilat kanë ndikuar në këtë trajektore, por në themel të saj janë pikërisht sfidat që paraqet trinomi Turqi-Qipro-Egje, një trinom me impakt direkt në çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë kombëtare greke. Marrëdhënie historike e tensionuar me Turqinë, pretendimet

¹ Lynn, Mathew. *Bust - Greece, The Euro, And The Sovereign Debt Crisis*. London: Bloomberg Press, 2012.f. 114.

territoriale mbi ishujt, menaxhimi i hapësirës ajrore dhe delimitimi i Shelfit Kontinental së bashku me ruajtjen e status quo-së së Egjeut kanë qenë burim i vazhdueshëm i tensioneve mes dy vendeve anëtare të NATO-s. Shpenzimet në fushën e mbrojtjes për Greqinë janë ndër më të lartat në botë në raport me buxhetin, duke kaluar vlerën e 4,6% për gati 45 vite rresht, e ndjekur më pas nga Qiproja me 3,8% të buxhetit. Greqia, renditet si vendi i 26-të në botë dhe e para në Europë për shpenzimet ushtarake. Ndërsa sipas Institutit të Stokholmit të Kërkimit për Paqen SIPRI, Greqia ishte vendi i 5-të në botë për blerjen e armëve konvencionale për vitet 2005-2009, me gati 6,14 miliardë dollarë blerje, por gjatë viteve 2000-2004 ajo ka mbajtur vendin e 3-të në botë për këto blerje. Nën tryshninë e vazhdueshme të një fuqie ushtarake si Turqia, dhe shpesh viktimë e lojës së fuqive të mëdha, apo për më tepër e lobit të luftës për të nxitur garën e armatimit, Greqisë i është dashur të bëjë shpenzime të jashtëzakonshme dhe të papërbalueshme nga financat e saj. Të katër herët që financat greke kanë falimentuar, kanë qenë pikërisht shpenzimet ushtarake, ato që kanë përbërë thelbin e borxheve të vendit. Blerja e sistemeve raketore kundërajrore, nëndetëseve, luftanijeve dhe aeroplanëve ushtarakë janë shoqëruar me një faturë financiare prej gati 110 miliardë euro ose 1/3 e borxhit të fundit prej 330 miliardë euro, që Greqia mori hua².

Fjalët kyçe: delimitim, shpenzime ushtarake, mbrojtje kombëtare, trinomi Turqi - Qipro - Egje, kontradiktë territoriale, *status quo*, Zona Ekskluzive Ekonomike, Shelfi Kontinental, fuqi detare etj.

1. Sfidat komplekse të sigurisë kombëtare, kurth strategjik për Greqinë

Trinomi Turqi-Qipro-Egje përbën basenin ekzistencial të Greqisë në politikën e jashtme, të brendshme dhe në sigurinë kombëtare. Mbi këtë trinom ndërtohet hapësira e manovrueshmërisë në terma afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe projektohet hapësira e zhvillimit, mbrojtjes dhe politikë-bërjes së Greqisë. Natyra e këtij trinomi aq sa të shenjtë, por edhe të vështirë për Greqinë përbën sfidën konstante me të cilën ajo duhet të përballet, sepse në sistemin e këtij trinomi gjenden balancat më të vështira dhe raportet e shpërndarjes së forcave më të pabarabarta të mundshme. Në këndvështrimin e politikës së jashtme, të brendshme dhe të sigurisë së Greqisë, elementet përbërëse të trinomit që janë të pandashme, të ndërvarura dhe me ndikim mbi njëri-tjetrin, shihen si:

- **Turqia**, së bashku me nënçështjet, është çështje prioritare e sigurisë

² Manolopoulos, Jason. - *Greece's 'Odious' Debt*. London: ANTHEM PRESS, 2011.f. 71

kombëtare për politikën e jashtme dhe të brendshme të Greqisë.

- **Qiproja**, së bashku me ishujt e Kretës, Korfuzit, dikur edhe Sicilia përbënin këndet e kontrollit në Egje gjatë Greqisë antike dhe sot, kush kontrollon Qipron, projekton fuqi në Lindje të Mesme dhe Anatolinë Jugore.
- **Egjeu**, së bashku me elementet e veta është ekzistenciale, sepse me të lidhet tregtia, mbrojtja, transporti dhe komunikimi. Për grekët, “Pa Egje nuk ka Greqi”.

Marrëdhëniet greko-turke, karakterizohen nga marrëdhënie historike të vështira dhe kontradikta territoriale për zona të veçanta të detit Egje në lidhje me sovranitetin e hapësirës detare dhe ajrore mbi ishujt, si dhe zgjerimin e hapësirës jetike mbi këto zona. Klima konfliktuale permanente mes dy vendeve ngrihet mbi një shtrat të thellë historik dhe me divergjenca e pabarazi të mëdha. Kjo marrëdhënie ka disa fasha, që fillojnë me probleme të mbartura nga e shkuara, pretendime territoriale, minoritetet respektive, rolin e fesë në këtë marrëdhënie dhe përdorimin e aktorëve të tretë nga të dyja palët në funksion të konfrontimit diplomatik apo dhe ushtarak të mundshëm greko-turk. Marrëdhëniet e vështira me Turqinë kanë formësuar traditën greke, të mbështetjes së vendit tek Forcat e Armatosura si garancia më e madhe për të garantuar sigurinë kombëtare.

Qiproja si elementi tjetër i trinomit, ka qenë dilema që ka mbizotëruar marrëdhëniet Greqi-Turqi dhe Turqi-BE në 50 vitet e fundit. Diferenca e madhe për mënyrën sesi palët e shikojnë zgjidhjen politike të çështjes së ishullit por edhe përplasja ushtarake e vitit 1974 kanë lënë gjurmë të pashlyera në skenën politike greke dhe turke. Për Greqinë Qipro nuk është vetëm çështje e rëndësisë historike kombëtare, por Qipro është jetësore për të gjithë rajonin e Mesdheut Lindor dhe Lindjes së Mesme. Qiproja dhe Kreta kanë të njëjtën rëndësi, pasi ato shërbejnë si një aeroplanmbajtëse statike në Detin Mesdhe dhe mund të përdoret si një bazë ushtarake për të kontrolluar Mesdheun dhe Anatolinë³. Hapësira ajrore e Qipros dhe e Kretës janë kryqëzim i rëndësishëm rrugëkalimesh ajrore që lidhin Europën me Azinë, Lindjen e Mesme me Kaukazin, ndaj një pozitë e këtillë e Qipros e bën Turqinë tepër të interesuar për ishullin⁴. Rëndësia e ishullit dhe e shkuara e tij ka bërë që bazat ushtarake britanike ndodhen edhe sot në ishull dhe janë të stacionuara në Olimp, ku ndodhet një bazë radarësh në Larnaka, Limasol dhe Akrotiri, në të cilat janë të stacionuara 25 000 trupa britanike. Ende në ishull ndodhen edhe rreth 40 000 trupa të OKB-së, si dhe rreth 40 000 trupa turke në Qipron turke. Kriza e

³ A. Ahmet Davutogllu, *Thellësia Strategjike*. Shkup, 2010. Logos, f. 221.

⁴ Turkish Ministry of Foreign Affairs, Relations with Bulgaria. Ankara, 2010.

janarit të vitit 1996 e gjeneruar prej përplasjes për sovranitetin mbi ishullin Imia/Kardak e çoj nivelin e konfrontimit mes dy vendeve në buzë të konfliktit të armatosur, por ajo krizë nuk ngeli e lokalizuar me aq, pasi Turqia e ripozicionoi qëndrimin e saj, duke ringritur pretendimin se Kardaku është turk dhe se shumë ishuj të tjerë të Egjeut janë në diskutim. Për të vendosur Greqinë në pozita dobësie, njësitë e ushtrisë turke të dislokuara në Qipron Veriore u vendosën përgjatë vijës jeshile dhe u ripozicionuan për betejën e Egjeut. Kjo lëvizje taktike e vendosi Greqinë në pozitë delikate, sepse nga një ishull i pabanuar tani vendosen në pikëpyetje të gjithë ishuj kufitarë të Egjeut dhe, mbi të gjitha, *status quo*-ja e Qipros, duke kaluar në një fazë të re konflikti dhe menjëherë Shefi i Shtabit i ushtrisë greko-qipriote kërkoi ngritjen e një doktrine të përbashkët mbrojtjeje me Greqinë. Kjo dëshmoi edhe një herë, që me Egjeun ndërliiden disa çështje: demilitimi i hapësirave detare dhe ajrore, Qiproja dhe siguria kombëtare. Për Greqinë ruajtja e sovranitetit qëndron në bazë të marrëdhënieve me Turqinë dhe në këtë rast, kasta ushtarake greke i propozoi lidershit që të mos tërhiqet përballë presionit turk, sepse nëse krijohej precedenti, do të viheshin në pikëpyetje shumë balanca kombëtare⁵.

Egjeu, së bashku me elementet e vet është ekzistencial për Greqinë dhe Turqinë, sepse me të lidhet tregtia, mbrojtja, transporti dhe komunikimi. Për grekët, “*Pa Egje nuk ka Greqi*”. Egjeu është rasti më tipik i një rajoni detar i cili ndërlihdh jo vetëm çështje të së drejtës detare, por të historisë, sigurisë, tregtisë, hapësirës detare dhe ajrore. Mbi Egjeun ndërtohet hapësira e manovrueshmërisë në terma afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe projektohet hapësira e zhvillimit, mbrojtjes dhe politikë-bërjes së Greqisë dhe Turqisë. Egjeu i cili në vetvete është i lidhur me një kompleksitet çështjesh, si: delimitimi i Detit Territorial (përcaktimi me koordinata i kufijve detarë), delimitimi i Shelfit Kontinental, Zonës Ekonomike Ekskluzive, hapësirës ajrore, menaxhimi i trafikut ajror civil dhe ushtarak dhe militarizimi i ishujve. Greqia gjen mbështetje në të drejtën ndërkombëtare dhe në kuadrin bilateral, si: Traktati i 10 shkurtit 1947⁶

⁵ Michael Robert Hickok, *The Imia/Kardak Affair, 1995-96. A Case of Inadvertent Conflict*. European. Security, 19 June 2008 f.186.

⁶ Në seksionin V - Greqia, të Traktatit të Paqes mes Italisë dhe Greqisë në nenin 14 thuhet:
 1. Italia me anë të këtij traktati i jep Greqisë sovranitet të plotë në ishujt e Dodekanezit të përmendur më poshtë, Stampalia (Astropalia), Rhodes (Rhodes), Calki (Kharki), Scarpanto, Casas (Casso), Piscopis (Tilos), Misiros (Nisyros), Calimnos (Kalymnos), Leros, Patmos, Lipsos (Lipso), Simi (Symi), Cos (Kos) dhe Castellorizo, si dhe ishujt e tjerë të vegjël ngjitur.
 2. Këta ishuj do të jenë dhe do të mbeten të demilitarizuara.
 3. Procedura dhe kushtet teknike që rregullojnë transferimin e këtyre ishujve te Greqia do të përcaktohen me marrëveshje midis Qeverive të Mbretërisë së Bashkuar dhe Greqisë dhe do të merren masa për tërheqjen e trupave të huaja jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

për paqen me Italinë, i cili i dha Greqisë 12 ishujt e Dodekanezit dhe disa shkëmbinj ishullorë, duke lënë të hapur një zjarr territorial mes dy vendeve, duke mos përcaktuar qartë listën e shkëmbinjve ishullorë që i kalojnë Greqisë⁷. Shpesh Egjeu konsiderohet si pika më e brishtë e raporteve dypalëshe dhe si fushëbeteja në të cilën demonstron forca, taton pulsi dhe ndërtohet strategjia mbi kundërshtarin. Ishujt e Egjeut ndahen në 6 grupe kryesore: Egjeu Verior, Sporadhet Veriore, Kikladhet, Egjeu Lindor, Dodekanezi dhe Egjeu Jugor. Këta ishuj zënë një sipërfaqe gati 23000 km², e cila është rreth 10% e sipërfaqes totale të detit Egje⁸. Në vitin 1931, Greqia shpalli gjerësinë e ujërave të saj territoriale në 10 milje, por ky hap nuk u prit mirë nga Fuqitë e Mëdha, të cilat i kërkuan Greqisë që të ulë në 6 milje gjerësinë për ujërat e veta territoriale dhe në vitin 1936, Greqia vendosi që të mbajë limitin e 6 miljeve, limit ky që është ende në fuqi në Egje. Objektivi strategjik i Greqisë është që të përparojë nëpërmjet zgjerimit të Detit Territorial nga 6 milje që e ka aktualisht në 12 milje, sepse ky zgjerim do t'i shtonte Greqisë hapësirën e vet detare dhe ajrore, Zonën Ekskluzive Ekonomike dhe Shelfin Kontinental, që mundëson shfrytëzimin e pasurive nënujore dhe resurset natyrore. Aktualisht Egjeu është i ndarë sipas këtyre raporteve: 7,5% e tij i përket Turqisë, Greqia zotëron 43,5% dhe 49% është det ndërkombëtar. Zbatimi i plotë i Konventës së *Montego Bay* i jep Greqisë mundësinë e shfrytëzimit nga 43,5% aktualisht në 71,5% të hapësirës detare dhe ajrore të të gjithë Egjeut; 8,7% për Turqinë dhe 19,2% do të ngelen det ndërkombëtar⁹. Ky është një fakt i papranueshëm në asnjë rrethanë nga Turqia, e cila pretendon se nëpërmjet zbatimit të gjerësisë së 12 miljeve që parashikon kjo konventë, Egjeu do të kthehet në një det të brendshëm grek¹⁰.

Sipas Ankarasë, zbatimi i plotë i këtij kriteri të konventës do të sillte humbje për Turqinë dhe do të ulëshin në mënyrë drastike ujërat ndërkombëtare mes dy shteteve. Për pasojë, aksesit për në portet e Stambollit dhe të Izmirit do të limitohej në maksimum, si dhe kjo bie në kundërshtim me doktrinën detare turke të “Vatani Blu”¹¹, e cila synon zgjerimin e hapësirave detare të Turqisë dhe ambicien e saj si një fuqi detare. Greqia për ta bërë legjitime situatën dhe për të rritur mundësinë e veprimeve të saj, ratifikoi në parlament ligjin e ri të

⁷ Ahmet Davutogllu, *Thellësia Strategjike*. Shkup, 2010. Logos, f. 196.

⁸ Po aty, f. 215.

⁹ Tozun Bahcheli, “The potential for conflicts in Greek -Turkish Relations”, London, The Guardian, 1999, f. 26.

¹⁰ Ahmet Davutogllu, *Thellësia Strategjike*. Shkup, 2010. Logos, f. 216.

¹¹ <https://www.ifri.org/en/publications/etudes-de-lifri/mavi-vatan-blue-homeland-origins-influences-and-limits-ambitious> Mavi Vatan, the “Blue Homeland”: the Origins, Influences and Limits of an Ambitious Doctrine for Turkey, Aurélien DENIZEAU, Etudes de l’Ifri, april 2021.

detit nr. 2321, më 1 qershor 1995, duke i njohur vetes të drejtën e zgjerimit të Detit Territorial nga 6 në 12 milje në një moment të përshtatshëm për të. Më 7 qershor të po atij viti, parlamenti turk ratifikoi një rezolutë, që ngarkonte qeverinë me mbrojtjen e pavarësisë territoriale, të hapësirës detare dhe ajrore të Turqisë në Egje me çdo mjet, në rast se sheh që sovraniteti turk po cenohet. Rezultati direkt i këtij vendimi të parlamentit turk është qëndrimi politik i Presidencës greke, ku që nga viti 1995 asnjë president grek nuk kryen më vizita zyrtare në Turqi, duke shprehur kështu protestën e Athinës. Në vitin 1995 Turqia e akuzoi Greqinë se po përgatiste popullimin e ishujve të pabanuar të Egjeut, të cilët nuk kanë një status të qartë juridik dhe politik, madje sipas saj, kjo bie në kundërshtim edhe me Traktatin e Paqes mes Italisë dhe Greqisë, që parashikon demilitarizimin e tyre¹². Këta ishuj dhe zonat rreth tyre, Ankaraja i konsideron si zona gri dhe pa status juridik, por Greqia i konsideron pjesë të sovranitetit të saj. Athina e ka të qartë që, në mënyrë të njëanshme, nëpërmjet përdorimit të forcës nuk mund ta zgjidhë çështjen e sovranitetit mbi Egjeun dhe, po ashtu, e ka të qartë që Ankaraja nuk mund të tolerojë në asnjë moment që të njohë sovranitetin e plotë të Egjeut të Greqia.

Traktati i Lozanës vendosi që shtrirja e detit territorial të shteteve laterale të ishte deri në 3 milje në vitin 1923. Greqia i zgjeroi ujërat territoriale të saj në gjashtë milje në vitin 1936 dhe *status quo*-ja e tanishme është formuar kur Turqia pranoi kufirin 6 milje në vitin 1964. Sipas Konventës së OKB-së mbi të Drejtën e Detit (UNCLOS), e cila është nënshkruar në vitin 1982 dhe ka hyrë në fuqi në Greqi në vitin 1995, shtetet nënshkruese kanë të drejtë për të zgjeruar ujërat e tyre territoriale deri në 12 milje. Greqia, ndryshe nga Turqia, është nënshkruese e Konventës UNCLOS 1982 dhe ajo e konsideron përcaktimin e gjerësisë së ujërave territoriale një të drejtë sovrane dhe pretendon se do të zgjerojë ujërat territoriale të saj në një moment të përshtatshëm për të. Turqia nuk e ka nënshkruar Konventën dhe Ankaraja e konsideron këtë veprim grek kërcënues si *casus belli*. Greqia pohon se pozicionimi turk si *casus belli* është kundër nenit 2, të paragrafit 4 të Kartës së OKB-së, sipas së cilës anëtarët nuk mund të kërcënojnë integritetin territorial të të tjerëve. Turqia pretendon se pozita e saj buron nga neni 300 i UNCLOS-it, sipas të cilit palët mund të ushtrojnë të drejtat e njohura nga UNCLOS, por pa abuzuar me të drejtat. Sipas Turqisë, Egjeu është një det gjysmë i mbyllur, që kërkon zbatimin e rregullave të veçanta. Greqia nuk e konsideron Egjeun si një det gjysmë të

¹² Treaty of Peace with Italy. Shih në: <https://www.loc.gov/law/help/us-treaties/bevans/m-ust000004-0311.pdf>.

mbyllur, ndaj kjo e bën kufirin e 12 miljeve të aplikueshëm, sipas saj¹³. *Status quo*-ja aktuale duket të jetë zgjidhja më e mirë për të dy vendet, ndonëse ajo nuk garanton stabilitet në marrëdhëniet dypalëshe¹⁴.

Rajoni i Informim-Fluturimit (FIR - Athinë/Flight Information Region), është një pikë tjetër e nxehtë mes dy vendeve që lidhet me Egjeun, i cili është përcaktuar në vitin 1950, bazuar në konventën e ICAO-s të vitit 1944, e cila ngarkon shtetet me ruajtjen dhe menaxhimin e hapësirës së tyre ajrore. Ankaraja, përveç pretendimeve greke për hapësirën detare, ka hedhur poshtë edhe pretendimet për hapësirën ajrore mbi Egje dhe, për udhëheqësit turk, Greqia abuzon me të drejtën e mbajtjes së përgjegjësisë për Informimin mbi Rajonin e Fluturimit (Flight Information Region/FIR) në Egje. Sipas Turqisë, Greqia shkel konventën e vitit 1944 të Çikagos për FIR, kur kërkon planet e fluturimit për fluturimet e avionëve ushtarakë dhe civilë turq në hapësirën ndërkombëtare mbi Egje. Gjithashtu, Turqia ka refuzuar të pranojë pretendimin grek të 10 miljeve si kufij të hapësirës së saj ajrore në Egje, pasi ajo nuk korrespondon me 6 miljet që gëzon Greqia si kufij detarë në këtë zonë. Në vitin 1950, Turqia e ka pranuar (FIR - Athinë) që përfshin hapësirën ajrore greke dhe disa zona të hapësirës ajrore ndërkombëtare, por *FIR - Athinë* dhunohet mesatarisht 10 herë në ditë dhe hapësira ajrore kombëtare greke dhunohet mesatarisht 4 herë në ditë nga avionët luftarakë turq.

2. Mes politikës së jashtme dhe rritjes së kapaciteteve mbrojtëse, në funksion të balancimit të ambicies turke.

Marrëdhëniet greko-turke mbeten në krye të agjendës së politikës së jashtme greke. Gjatë dyzet viteve të fundit ka pasur tri krizë të mëdha në Qipro, tri të tjera në Egje, si dhe një numër incidentesh “të nxehta”. Marrëdhëniet midis Greqisë dhe Turqisë, dy aleate të NATO-s në Mesdheun Lindor, mbetën të tensionuara pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ndërkohë që cikli tradicional i “konflikteve-negociatave-konflikteve” mbizotëron si tipar i përbashkët i epokës së re. Për të mundur një mjedis të sigurt dhe konstant, Greqisë i intereson që Turqia të mbetet e ankoruar në klubin e vendeve perëndimore dhe të mbetet e angazhuar politikisht dhe ekonomikisht me Perëndimin për të mundur modernizimin e saj, sepse një Turqi me një sjellje agresive dhe larg modernizimit, është një shqetësim konstant për Greqinë. Pavarësisht periudhave të qeta dhe normale që mund të ketë ky raport dypalësh, kjo

¹³ Yaprak Gürsoy, *Regime Change in the Aegean after the Second World War: Reconsidering Foreign Influence*. Journal of Modern Greek Studies, Volume 27, Number 2, October 2009, (Article) Published by The Johns Hopkins University Press, f. 347.

¹⁴ Ahmet Davutoğlu, *Thellësia Strategjike. Shkup, 2010. “Logos”, f. 217.*

marrëdhënie do të mbetet në qendër të fokusit grek, dhe pse Greqia mund të fitojë vetëbesim nëpërmjet lojës së saj aktive në organizma si BE dhe NATO. Mjedisi rajonal dhe ndërkombëtar i sigurisë do të mbetet i ndryshueshëm dhe i paqëndrueshëm, ku për arsye të gjeografisë dhe begatisë ekonomike, Greqia do të jetë e ndikuar fuqimisht nga këto prirje. Siguria demografike, politike dhe socio-ekonomike, zhvillimet në Mesdhe dhe në Lindjen e Mesme do të tendosin gjithnjë e më shumë shtetet në jug të BE-së, për kërcënimet që vijnë nga Mesdheu. Gjatë shekullit të 21-të, marrëdhëniet me Turqinë do të dominojnë politikën e jashtme dhe të sigurisë së Greqisë¹⁵.

Politika e Turqisë kundrejt Greqisë është perceptuar nga politikë-bërësit grekë si e ndikuar nga ambiciet e Turqisë për hegjemoninë rajonale dhe nga pakënaqësia e saj ndaj ish-fuqive koloniale mbi perceptimin që kanë ata mbi Greqinë si vend “i vështirë” dhe shpesh “kokëfortë”, por një vend i vogël fqinj dhe pjesë e mëparshme e Perandorisë Osmane. Planifikuesit e sigurisë greke janë të shqetësuar mbi qëllimet revizioniste të Turqisë ndaj Greqisë, siç janë shprehur në deklaratat zyrtare, iniciativat diplomatike dhe veprimet ushtarake (duke përfshirë vendosjen e forcave të saj të armatosura).

Për të balancuar kërcënimet ndaj sigurisë së saj, Greqia është mbështetur në një kombinim “të brendshëm” (forca të armatosura të fuqishme) dhe “balancim i jashtëm” (me pjesëmarrjen në të gjitha organizatat politike dhe të sigurisë të Europës Perëndimore, si NATO e BE), si dhe duke nënshkruar dhe aderuar praktikisht të gjitha marrëveshjet shumëpalëshe të kontrollit dhe regjimit ndërkombëtar të kontrollit të eksporteve të armëve¹⁶. Shtetet e vogla kanë më pak mundësi dhe më pak liri manovrimi sesa fuqitë e mëdha, për të promovuar interesat e tyre të sigurisë, por për ta bërë këtë sa më efikase, Greqia është përpjekur që të ngrejë zërin dhe të integrojë politikën e saj me ato të partnerëve në Bashkimin Europian dhe aleatët e saj në NATO, si mekanizma të cilët gjenerojnë një mjedis sigurie. Shpesh Greqia i ka përdorur këta organizma për të arritur që të kontrollojë apo mbikëqyrë potencialin ushtarak turk, duke përdorur forcën e mekanizmave multinacionalë dhe rolin e tyre të ndërmjetësimit dhe të ndikimit në kontrollin mbi eksportin e armatimeve.

Meqë mbështetja në aleancën perëndimore rezultoi të ishte mjaft e paefektshme, pas pushtimit turk të Qipros Greqia filloi t’i kushtonte më shumë rëndësi “balancimit të brendshëm” (nëpërmjet forcimit të Forcave të saj të Armatosura) dhe më pak mbi anëtarësimin në NATO dhe marrëdhëniet dypalëshe me Shtetet e Bashkuara (kryesisht si rezultat i marrëdhënieve “të

¹⁵ Po aty, f.6.

¹⁶ Thanos Dokos, *Greek Defense Spending in Times of Crisis: The urgent need for defense reform*, Eliamep. March 2013, f. 2.

privileguara” të SHBA-së me Turqinë). Megjithatë, edhe pse përpjekjet për të balancuar së brendshmi kërcënimin turk u kurorëzuan përgjithësisht me sukses, Greqia arriti të realizojë qëllimin e saj afatshkurtër, për të arritur një balancë të forcës me Turqinë, por qëllimi afatmesëm/afatgjatë për Greqinë ishte dhe vijon të jetë “shpëtimi” nga gara e armëve të pafundme, në mënyrë që kjo garë të mos devijojë nga qëllimi i saj strategjik: zhvillimin ekonomik dhe integrimin e plotë në Bashkimin Europian¹⁷.

Greqia është përpjekur të largohet nga perceptimet e lojërave me shumatore zero në krahasim me Turqinë dhe, në përgjithësi, të dy vendet janë shumë më mirë sot në aspektin e marrëdhënieve dypalëshe (duke përfshirë tregtinë dhe kontaktet njerëzore) sesa ishin para vitit 1999. Duke thënë këtë, asnjë nga vendet nuk ka lëvizur me të vërtetë nga pozicionet e tyre të ngurta lidhur me çështjet e “politikave të mëdha”, ku Greqia dhe Turqia vazhdojnë ta perceptojnë njëra-tjetrën nëpërmjet një prizmi *Hobsian*, ku skepticizmi dhe mosbesimi vazhdojnë të zgjaten. Ndër “historitë e suksesit” në marrëdhëniet greko-turke mund t’i referohemi dinamikës së “diplomacisë së qytetarëve”, nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dypalësh të tregtisë dhe energjisë (nëpërmjet ndërtimit të *Interkonektorit Turqi-Greqi* (ITG), që transporton gaz natyror “Azer” në Greqi përmes Turqisë, duke pasur si destinacion përfundimtar Italinë.

Shumica e politikë-bërësve grekë vazhdojnë të besojnë se është në interesin më të mirë të të gjithëve, që Turqia të mbetet e ankoruar në institucionet perëndimore, por kjo mund të mos jetë një opsion, derisa anëtarët e BE-së janë të shqetësuar, pasi ka opozitë të fortë në vendet e mëdha europiane dhe një zhgënjimin në rritje në Turqi. Greqia mbetet përkrahëse e anëtarësimit në BE për Turqinë (me kusht që, natyrisht, të plotësojë kriteret e kërkuara dhe të ketë një zgjidhje të problemit të Qipros dhe normalizim të plotë të marrëdhënieve greko-turke), por edhe ndikimi i saj brenda BE-së dhe kundrejt Qipros (ku, me sa duket, nuk ka vullnet nga ana e Turqisë dhe rrjedhimisht pak entuziazëm të greko-qipriotët për çdo kompromis të ndërsjellë kuptimplotë) është mjaft i kufizuar¹⁸. Menaxhimi i marrëdhënieve shpesh të vështira me Turqinë mbetet prioritet i lartë i politikës së jashtme të çdo qeverie greke. Greqia duhet të shmangë një garë të re të armëve me Turqinë dhe në mënyrë të përsëritur qarkullojnë ide të ndryshme për reduktimin e armëve dhe forcimin e masave për ndërtimin e besimit. Për sa kohë pala tjetër zakonisht nuk ka dëshmuar vullnet, sipas Athinës, për iniciativa të tilla dhe ende ka deklarata nga Turqia për *casus belli*, ndaj për të pasur kapacitete sprapsjeje, që do të mundësojnë paqen dhe stabilitetin në Egje, atëherë Greqia nuk do të kishte zgjidhje tjetër,

¹⁷ Po aty, f. 3.

¹⁸ Thedhoros Pangallos, *Me Papandreun* në Europë. Tiranë, 2017. Botimet “Toena”, f. 185.

veçse të ketë shpenzime të larta të mbrojtjes krahasuar me vendet e tjera anëtare të BE-së dhe të investojë në superioritetin teknologjik dhe shfrytëzimin e plotë të burimeve njerëzore të saj, si dhe forcimin e aleancave strategjike.

Së fundmi, Greqia mbetet anëtare e plotë e BE-së dhe e NATO-s dhe të dy institucionet janë të përfshira në përpjekjet e ndryshme për parandalimin e konflikteve dhe stabilitetin në Europën gjithnjë e më të paqëndrueshme. Ndërsa zgjedhja strategjike e Greqisë është që ajo të bëhet thellësisht e integruar në Arkitekturën e Sigurisë Europiane, edhe interesat e sigurisë së Greqisë janë që ajo të shërbejë nëpërmjet një politike parandaluese për konfliktet, nëpërmjet mbajtjes së hershme nën kontroll të burimeve të paqëndrueshmërisë, duke kontribuar në përpjekje të tilla në bazë të aftësive të saj. Prandaj, Greqia duhet që të strukturojë një pjesë të Forcave të Armatosura, në mënyrë të tillë që të rrisin ndërveprimin dhe pjesëmarrjen në operacionet shumëkombëshe të BE-së dhe NATO-s. Megjithatë, kufizimet aktuale fiskale dhe prioritetet kombëtare të mbrojtjes e kanë zbritur këtë nga një objektiv prioritar, në dytësor. Në të vërtetë, Greqia ka reduktuar dukshëm kontributin e saj në misionet shumëkombëshe (NATO dhe BE) gjatë muajve të fundit, për shkak të kufizimeve financiare. Objektivi afatgjatë për Greqinë do të vazhdojë të jetë pajtimi i përgjegjësive të saj ndërkombëtare me interesat dhe sigurinë kombëtare, ku shpesh hasen dallime të mëdha¹⁹.

3. Modernizimi i Forcave të Armatosura, si instrument parandalimi dhe për të ruajtur *status quo*-në me Turqinë.

Pavarësisht se është anëtare e BE-së dhe e NATO-s, Greqia ndodhet gjeografikisht në një rajon konfliktual, ku përdorimi i forcës në marrëdhëniet ndërshtetërore ende mund të konsiderohet si një opsion (pa dyshim, në rrethana shumë të veçanta)²⁰. Në fakt, në krahasim me vendet e tjera anëtare të BE-së dhe NATO-s, shqetësimet greke të sigurisë paraqesin një rast unik, që pasqyrohet si në nivelin e burimeve njerëzore, ashtu edhe ato materiale, që vendi cakton çdo vit për mbrojtjen.

Nisur nga sfidat e mësipërme, por kryesisht që nga viti 1974, forcat ushtarake të të dy vendeve janë vendosur në gatishmëri të plotë në vitet 1987, 1994, 1996 dhe 2022, ku me vështirësi është arritur që të shmanget konflikti ushtarak midis Greqisë dhe Turqisë²¹. Përballimi me këto sfida i kanë imponuar Greqisë

¹⁹ Thanos Dokos, *Greek Defense Spending in Times of Crisis: The urgent need for defense reform*. Eliamep, 2013, f. 11.

²⁰ Po aty, f. 1.

²¹ Nazmi Akiman, *Turkish-Greek Relations: From Uneasy Coexistence to Better Relations*. Mediterranean Quarterly, Summer 2002, f. 22.

nevojën për angazhimit të vazhdueshëm ushtarak, politiko-taktik dhe të rritjes së vazhdueshëm të kapaciteteve mbrojtëse në Egje²² pavarësisht kostove dhe mundësive. Për t'iu përgjigjur sfidave, Greqia hapi kapitullin e shpenzimeve të shfrenuara për të ruajtur *status quo*-në në Egje dhe të rritjes së kapaciteteve reaguese ndaj Turqisë agresive dhe qartësisht dominante. Përfshirja në këtë vorbull, ku pala që nuk mban presionin do të pranojë kushtet, do ta kthejë Greqinë shpejt në një vend klient dhe subjekt e lobit të luftës në SHBA, Angli Gjermani dhe Francë. Sovraniteti mbi Egjeun ka sjellë një garë të frikshme armatimi mes dy vendeve dhe e ka bërë këtë zonë tepër të militarizuar. Miliarda dollarë investime në teknologji ushtarake dhe ndërtimi të infrastrukturës detare e ajrore ka rritur ndjeshëm ndikimin në buxhetin shtetëror të Greqisë²³. Situata në Egje është e ndikuar edhe nga një sërë faktorësh gjeostrategjikë, pasi Turqia, që shtrihet në hapësirën jetike mes Greqisë dhe Rusisë, mat pulsën e rajonit dhe të këtyre dy vendeve nëpërmjet pozicionit strategjik të dy ngushticave, çka në lojën e madhe gjeopolitike e zhvendos tensionin në një nivel tjetër. Greqia e bën të njëjtën gjë me Turqinë nëpërmjet ishujve të Egjeut, duke i limituar asaj hapësirën jetike dhe strategjinë detare²⁴.

Sfidat e sigurisë kombëtare të vendit nga kufijtë verilindorë dhe lindorë kanë orientuar organizimin dhe shpërndarjen e Forcave të Armatosura në masën 80% të personelit dhe pajisjeve të saj në funksion të përballimit të kërcënimeve, ku mbizotërojnë përpjekjet për mbrojtjen e kufijve detarë dhe ajrorë në Egje. Pozicionimi i njësive ushtarake është më i dendur në ishujt e Egjeut, duke filluar me Lemnosin, Lesbosin, Kiosin, Samosin, Kosin, Rodosin dhe Kretën, të cilët përbëjnë perimetritin e mbrojtjes së unazës së zjarrtë të kufirit greko-turk. Si rezultat i sfidave konstante në sigurinë kombëtare dhe nevojës për të ruajtur kontrollin, si dhe për të ndjekur ritmin teknologjik për t'iu përgjigjur ndaj kapaciteteve ushtarake të fqinjëve, Greqisë i është dashur të kryejë investime të shpeshta në fushën e mbrojtjes, sidomos gjatë 3 dekadave të fundit.

Nga viti 1996 deri më 2005, ushtria greke iu nënshtrua një procesi masiv modernizimi dhe riorganizimi, i cili kishte në qendër modernizimin e njësive të motorizuara të Greqisë kontinentale, për t'ua përshtatur nevojave të reja dhe për të ndjekur hapin teknologjik. Nga ky proces u synua që të ulen kostot për të pasur një ushtri më eficiente dhe, si përfundim, u mbyllën vetëm disa njësive në terren, duke mos arritur dot objektivat e përcaktuar nga procesi²⁵. Mos

²² Christos Kassimeris, *Cyprus invasions*. European University, Cyprus. Small Wars & Insurgencies. Vol. 19, No. 2, June 2008, f. 256-273.

²³ Po aty, f. 195.

²⁴ Po aty, f. 196.

²⁵ Thanos Dokos, *Greek security policy in the 21-st century*. Eliamep, 2007, f.7.

arritja e objektivave të planit të parë solli ndërtimin e një proces të ri modernizimi i bazuar në një program prokurimi të ndarë me tri faza, i filluar në vitin 2006 dhe i konsideruar si një plan realist:

- Faza e parë - 2006-2010.
- Faza e dytë - 2010-2015.
- Faza e tretë - 2015-2020.

Për realizimin e këtij plani, fatura financiare ishte 22 miliardë euro, edhe pse buxheti për mbrojtjen mund të gjeneronte vetëm 37% të këtyre nevojave, sepse shkurtimet gjatë viteve të krizës e çuan buxhetin për mbrojtjen nën 3%, për herë të parë që prej vitit 1974. Ndër prioritetet e këtij plani ishin: blerja e helikopterëve të transportit, e sistemeve të luftimit të këmbësorisë, pjesëve të mirëmbajtjes dhe C4I (*Command Control Communication Computers Intelligence*)²⁶. Kjo periudhë e shtrirjes së këtij plani me tre faza u ndikua fuqimisht nga kriza ekonomike greke dhe si rezultat i masave shtrënguese të imponuara nga Trojka, Athina u detyrua që të ulë shpenzimet në fushën e mbrojtjes nga 3,1% në 2,1% të GDP-së. Sipas Institutit Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS), Greqia shpenzon nga 60-73% të këtij buxheti për personelin ushtarak, por të dhënat e paraqitura më së miri shërbejnë për të analizuar strategjinë e mbrojtjes kombëtare të Greqisë dhe dilemën mes “armatosjes vs politikës së gjalpit”.

Modernizimi dhe forcimi i të tri degëve të Forcave të Armatosura është jetike dhe i domosdoshëm (për shkak të nevojës për operacione të përbashkëta), ku roli i tyre do të jetë mbështetës reciprokisht dhe përforcuës. Për vetë natyrën e sfidave por edhe gjeografisë, me një flotë të dobët, Greqia do të humbiste kontrollin e Egjeut (Lindjes së Mesme) dhe me një ushtri të dobët nuk do të ishte në gjendje të mbrojtë ishujt e saj. Megjithatë Forca Ajrore në asnjë mënyrë nuk mund ta fitojë e vetme një konflikt, ajo mund të veprojë si një pengesë e fortë në kohë paqeje dhe në qoftë se shmangia e konfliktit dështon, ajo mund të krijojë një ombrellë mbrojtëse, nën të cilën dy forcat e tjera mund të luftojnë dhe të fitojnë një luftë. Prandaj parandalimi i superioritetit ajror të armikut duhet të jetë një përparësi kryesore.

Greqia çdo vit ndan një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të saj për mbrojtjen kombëtare. Shpenzimet e mbrojtjes si përqindje e PBB-së janë dukshëm më të larta se mesatarja e BE-së. Gjatë dekadës së fundit barra e mbrojtjes greke është afërsisht sa dyfishi i mesatares së 27 vendeve anëtare të BE-së. Ky nuk është një fenomen i kohëve të fundit, por është më tepër një

²⁶ Po aty, f. 8.

rregull konsistent gjatë pesë dekadave të fundit, për shkak të problemeve akute të sigurisë së jashtme, me të cilat ballafaqohet Greqia në krahasim me partnerët e saj në BE²⁷. Krahasuar me partnerët e saj të BE-së, Greqia përbën një kategori të vetën, kur është fjala për sfidat e sigurisë kombëtare që i vijnë nga vendet fqinje. Prandaj nevoja për të investuar burime të pakta dhe të vlefshme për mbrojtjen kombëtare, duke pasur vështirësi fiskale dhe ekonomike, përbën një barrë për shoqërinë. Kështu, Greqia po përballet sërish me dilemën e vështirë të “armatosjes apo të gjalpit”. Greqia ndodhet në kërkim për arritjen e të dyjave: të parandalimit të konfliktit me Turqinë, që po i kushton shumë, si dhe nevojës për zhvillim ekonomik, duke përbërë një sfidë të madhe për politikë-bërësit grekë.

Pas kalimit të situatës së vështirë dhe masave të imponuara nga Trojka, Greqia i është rikthyer sërish traditës së rritjes së shpenzimeve ushtarake të vendit në funksion të politikës së shkurrëzimit të Turqisë. Për të kapur kohën e humbur qeveria greke ka prezantuar në fillim të muajit prill 2024 një plan ambicioz për të rritur kapacitetet ushtarake të vendit duke shënuar kështu “një nga reformat më të mëdha në historinë e shtetit modern grek”²⁸, siç u shpreh Ministri i Mbrojtjes Kombëtare Nikos Dendias. Synimi i këtij programi ambicioz modernizimi që parasheh rreth 15 prioritetet të veçanta modernizimi është i qartë, të përgatis ushtrinë greke për sfidat e shekullit XXI, duke propozuar disa ndryshime radikale në sistemet e armatimit, inovacionit, në strukturë, në trajtimin e personalit, si dhe duke rritur kapacitetet kombëtare prodhuese në fushën e mbrojtjes në funksion të ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit kombëtar të Greqisë. Programi synon që të prek inventarin e pajisjeve për të tre shërbimet, mjetet ajrore detare dhe tokësore të ushtrisë greke.

Në Forcën Ajrore, synohet modernizimi i saj për të arritur një homogjenitet në shumëllojshmërinë e deritanishme të mjeteve si dhe ndërveprueshmëria më të mirë të sistemeve të armatimit dhe pjesëve të mirëmbajtjes së tyre, duke nxjerrja nga inventari një gamë të madhe modelesh amerikane dhe franceze mosha e shumëllojshmëria e të cilëve kanë rritur së tepërmi faturën financiare të vendit. Objektivi për të modernizuar një pjesë të flotës aktuale dhe për kaluar në gjeneratën e re të 4.5 - 5 të avionëve reaktivë brenda vitit 2030, me një flotë prej rreth 200 avionësh dhe blerjen e të paktën 35 helikopterëve amerikanë Black Hawk të versionit më të fundit M, në dukje tepër ambicioz, ka nxjerrë në pah jo pak probleme për vendin.

²⁷ Thanos Dokos, *Greek Defense Spending in Times of Crisis: The urgent need for defense reform*, Eliamep. March 2013, f. 4.

²⁸ <https://www.ekathimerini.com/news/1234763/defense-minister-hails-radical-changes-to-armed-forces/>

Në Forcën Detare, Greqia synon që të bëhet pjesë e programit të përbashkët të prodhimit të fregatës së klasit “Constellation” për të mundësuar ndërtimin në kantieret greke të 7 fregatave të këtij klasi për marinën greke. Ndërkohë gjatë 2 viteve të fundit Greqia ka nënshkruar një marrëveshje me vlerë 5.9 miliard \$ me kompaninë franceze FNG për blerjen e 3+1 fregata të klasit Belharra, brenda vitit 2027 ku edhe ka filluar puna për prodhimin e tyre, çka shënon një moment historik për marinën greke pas 30 vitesh nga blerja e fregatave të klasit Hydra të modelit Meko nga Gjermania.

Në Forcën Tokësore, Greqia synon që të modernizoi 500 tanket e saj ekzistuese Leopard 1A5²⁹, ajo do të pajiset me 756 autoblanda M-1117 gjatë vitit 2024, si dhe do të pajiset me avion pa pilot me rreze të gjatë veprimi për lartësi të mesme³⁰. Qeveria greke në funksion të shtimit të prodhimeve të brendshme ushtarake do të kaloj në Parlament ngritjen e Qendrës Kombëtare të Ekosistemit të Mbrojtjes, e cila do të shoqërohet edhe me disa nisma të tjera ligjore që do të mundësojnë prodhimin e një sërë mjetesh ajrore pa pilot, mjetesh kundër ajrore dhe mjetesh për luftën anti-dron³¹.

Shfrytëzimi i rëndësisë së Egjeut dhe angazhimi i fuqive detare të Mesdheut në rajon (sidomos Franca) ka qenë në fokus të diplomacisë greke për t'i siguruar vendit një partneritet politik-ushtarak unikal me Francën. Më 27 shtator 2021, Greqia dhe Franca nënshkruan paktin e mbrojtjes reciproke, ku në nenin 2 të tij shprehet në mënyrë eksplicite se palët u vijnë në ndihmë ushtarake reciproke në rast sulmi nga një palë e tretë³². Ky pakt, përveç se u shoqërua me një paketë shitjesh të aseteve të mbrojtjes nga ana e Francës për Greqinë, përbën dhe një precedent jo të zakonshëm për dy vende anëtare të NATO-s, ku dy anëtarë nënshkruajnë pakt të mbrojtjes reciproke përballë një anëtar tjetër të NATO-s (potencialisht Turqisë).

Siç shihet dhe nga plani, shumica e fokusit dhe e burimeve është te forcat ajrore të Greqisë, si një prej aseteve kyç madje që gëzojnë një vëmendje të posaçme në hierarkinë ushtarake, si forca nën mbikëqyrjen direkte të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë. Aviacioni është një armë financiarisht shumë e shtrenjtë dhe me ndryshueshmëri të lartë teknologjike, çka e bën ruajtjen e superioritetit ajror tepër të vështirë. Aviacioni grek prej krizës financiare që kaloi vendi përballë prej një kohe të gjatë me pamundësinë për

²⁹ <https://www.defensenews.com/global/europe/2024/02/16/greek-army-weighs-options-for-breathing-new-life-into-leopard-1-tanks/>

³⁰ <https://www.ekathimerini.com/news/1228385/military-procurements-in-2024/>

³¹ <https://www.ekathimerini.com/news/1235320/dendias-unveils-ambitious-air-force-plans/>

³² https://www.ifri.org/sites/default/files/atoms/files/schmid_dominguesdossantos_france_greece_partnership_2022.pdf

blerjen e avionëve ushtarakë të gjeneratës së 4.5-5. Kjo forcë ka në përbërje të saj rreth 230 avionë dhe ka një përqendrim të forcës së saj kryesisht në kufijtë lindorë të vendit dhe në Egje, ku dhe shpesh tensionet janë bazë për përsosmërinë e aftësive operacionale të personelit ajror grek, të cilët renditen ndër forcat ajrore më të afta në NATO.

Blerja e 24 avionëve shumërolësh me dy motorë, Rafale, nga Franca është padyshim një nga blerjet më të mëdha në kuadër të këtij plani dhe më të kushtueshme të Greqisë në këto vitet e fundit. Greqia dhe Franca kanë një histori të gjatë të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe kryesisht për Forcat Ajrore Greke, ku në vitin 1974 bleu avionët Mirage f 1, më pas në 1989 Greqia bleu 40 avion Mirage 2000 shumërolësh. Avionët e rinj shumërolësh të gjeneratës së 4.5 Rafale duken një blerje që vështirë se do ta justifikojnë faturën e kripur prej gati 3 miliardë eurosh, pasi natyra e këtij avioni tepër të kushtueshëm në operim, mirëmbajtje, sistemet e luftimit, armatimit, supremacia teknologjike dhe rrezja e tij e veprimit prej gati 3700 km është përtej nevojave të Greqisë, për më tepër që rrezja e tyre është sa dyfishi i avionëve Mirage 2000 apo katërfishi i 80 avionëve f-16 tashmë në modernizim e sipër që janë në inventarin e Forcës Ajrore Greke. Këto cilësi dalin përtej sipërfaqes ajrore të vendit, nevojave, natyrës së operacioneve, kapaciteteve dhe rrezes së veprimit të kësaj force, e cila si mision kryesor ka mbrojtjen e hapësirës ajrore kombëtare dhe jo operimin në distanca të mëdha apo përtej vijave të armikut.

Nëse do të analizojmë faktin që avionët luftarakë grekë angazhohen mesatarisht në dhjetë misione “scramble” gjatë 24 orëve mbi Egje, të cilët shpesh përfundojnë dhe në “dog-fights”, ngritja në ajër çdo ditë e avionëve të tillë si Rafale është jashtë çdo logjike ekonomike dhe nga pikëpamja taktike të debatueshme, pasi ata janë një model që justifikon kostot për interceptim të thellë dhe bombardim strategjik. Nuk duhet harruar fakti që korridoret e veprimit të forcave ajrore greke mbi Egje janë të ngushta dhe shumë të shkurtra, ku koha mesatare e misioneve është rreth 20 minuta. Distancat më të mëdha të operimit janë në hapësirën ajrore shqiptare dhe të Maqedonisë së Veriut në kuadër të policimit ajror si vende të NATO-s. Kjo blerje duket qartë që ka një natyrë strategjike politike, për të pasur Francën në krahë ashtu siç dhe u evidentua edhe nga fërkimet në Egje gjatë misioneve të grupit detar turk të kryesuar nga anija Uruç Reis. Roli i Francës në BE si dhe prezenca e flotës ushtarake franceze gjatë verës së vitit 2022 në Egje dhe Mesdheun Lindor i dha Greqisë sigurinë psikologjike por nga ana tjetër ndihmoi si forcë shkurajuese për veprimet turke. Rolin shkurajues duket që tani do ta kenë dhe skuadriljet e avionëve Rafale, por për një vend të vogël si Greqia, me financa të cunguara, është një luks tepër i madh që një aset të tillë ta mbajë kryesisht

për këtë funksion. Thënë ndryshe, është një blerje e Ministrisë së Jashtme të Greqisë dhe jo e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, si blerje e imponuar nga rrethanat gjeopolitike në Egje dhe jo nga nevojat ushtarake. Kjo blerje ka rikonfirmuar dhe njëherë rolin e konsoliduar të Ministrisë së Jashtme në sigurinë kombëtare të Greqisë, shpesh përcaktuese edhe përballë Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare.

Përfundime.

Në doktrinën e mbrojtjes greke përballë Turqisë, zgjidhja e dilemës strategjike që has Greqia do të mbështetet në “Përgjigjen Fleksibël”, që ka në themel krijimin e zgjidhjeve të veçanta në raste menaxhimi krizash, por duke u kujdesur për një shmangie të përplasjeve ushtarake dhe, në të njëjtën, kohë moslejimin e një situatë ku Greqia tërhiqet në misionin e saj për mbrojtjen e ishujve dhe të drejtave mbi to. Për të mundësuar realizimin e përgjigjes fleksibël, Greqisë do t’i duhet të zgjerojë kapacitetet ushtarake në mënyrë të vazhdueshme por racionale, që do t’i garantonte ruajtjen e hapësirës dhe e interesave strategjikë në Egje, por kjo rrezikon të fusë sërish financat kombëtare në kurthin e krizës ciklike. Përballë sfidave të sigurisë kombëtare, Greqia duket se do të zgjedhë thellim të shpenzimeve ushtarake me një motiv shumë sublim dhe të mirëkuptuar nga qytetarët e saj: atë të shpenzimeve për mbrojtjen kombëtare.

Në kushtet e një sipërmarrjeje të ethshme nga Turqia për t’u projektuar si fuqi e mesme – e madhe dhe me programe të ngritjes së kapaciteteve ushtarake në nivele të autonomisë absolute nga ana e Turqisë, Greqia po vendoset shpejtë në pozitën që do t’i duhet të rimarrë kohën e humbur gjatë viteve të krizës. Një Turqi në kërkim të statusit si një fuqi ushtarake në rajon e më gjerë ka predispozitën për të qenë më e prirë që të zbatojë një politikë aktive ushtarake. Ndaj një forcë detare moderne, një aviacion luftarak modern, ngritja e kapaciteteve të mbrojtjes dhe mbajtja gjallë e jetës nëpër ishujt e Egjeut nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe mundësive për banorët e ishujve, do të jetë një sfidë me të cilën Athina do të vijojë të përballet.

Nga ana tjetër, proceset e nisura të mekanizmave të ndërtimit të besimit, konsultimet diplomatike dhe konsultimet eksploratore do të vijojnë të jenë gjithnjë një mekanizëm për reduktimin e presionit dhe të menaxhimit të situatave përtej operimit normal mes dy vendeve, por pa arritur që të prodhojnë rezultate konkrete, pasi çdo vendim për avancim apo për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare mes dy vendeve përveçse angazhon aparatën diplomatik të të dy vendeve, në fund është një produkt që kombinon diplomacinë, mbrojtjen, lidërshtipin, financat, raportet e balancave rajonale, përfshirjen e aktorëve ndërkombëtarë dhe faktorin kohë. Ecuria e raporteve dypalëshe për vetë

rajonin ku shtrihen dy vendet dhe ndërlidhjen e një sërë interesash të fuqive të mëdha, do të vijoje të mbaje të mbërthyer të gjithë aktorët e mëdhenj globalë në mbarëvajtjen e kësaj marrëdhënieje.

Bibliografia:

1. Akiman, Nazmi. - "Turkish-Greek Relations: From Uneasy Coexistence to Better Relations", in: Mediterranean Quarterly: Summer 2002.
2. Bahcheli, Tozun. - "The potential for conflicts in Greek -Turkish Relations". London: The Guardian, 1999.
3. Davutogllu, Ahmet - Thellësia strategjike. Shkup: "Logos", 2010.
4. Dokos, Thanos. - "Greek Defense Spending in Times of Crisis: The urgent need for defense reform". Eliamep, March 2013.
5. Dokos, Thanos. - "Greek security policy in the 21-st century". Eliamep, 2007.
6. Gürsoy, Yaprak. - "Regime Change in the Aegean after the Second World War: Reconsidering Foreign Influence". Journal of Modern Greek Studies, Volume 27, Number 2, (Article) Published by The Johns Hopkins University Press, October 2009.
7. Hickok, Michael Robert. - "The Imia/Kardak Affair, 1995-96. A Case of Inadvertent Conflict". European Security, 19 June 2008.
8. Kassimeris, Christos. - "Greek response to the Cyprus invasion". European University, Cyprus: Small Wars & Insurgencies. Vol. 19, No. 2, June 2008. 57.
9. Kassimeris, Christos. - "The Inconsistency of United States Foreign Policy in the Aftermath of the Cyprus Invasion: The Turkish Arms Embargo and its Termination". Journal of Modern Greek Studies, Volume 26, Number 1, May 2008.
10. Pangallos, Thedhoros. - Me Papandreun në Europë. Tiranë: «Toena», 2017.
11. Lynn, Mathew. - Bust - Greece, The Euro, And The Sovereign Debt Crisis. London: Bloomberg Press, 2012.
12. Manolopoulos, Jason. - Greece's 'Odious' Debt. London: ANTHEM PRESS, 2011.

Përpyjekjet për depolitizimin e Ushtrisë Shqiptare në shtetin shqiptar

Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ
Nënkolonel. Msc. Arben ZAVALANI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Çështja e drejtimit dhe drejtuesve të institucionit të mbrojtjes ka qenë një ndër problemet kryesore të shtetit dhe qeverisë shqiptare në 111 vjet të shtetit.

Në vitet 1912-1919, Shqipëria ishte në hapat e parë dhe ndikimi partive politike në ushtri ishte i pandjeshëm. Në skenë partitë politike shqiptare dolën pas vitit 1920, me ringritjen e Ushtrisë Shqiptare dhe të institucionit drejtues dhe organizues të saj. Politika dhe partitë politike institucionet dhe drejtuesit politiko-ushtarakë të Ushtrisë, për interesa të tyre, i kanë përdorur ushtarakët në periudhat pasardhëse në Shqipëri. Në vitet e Mbretërisë dhe me prishjen e marrëdhënieve me Italinë në vitin 1938 dhe të agresionit fashist më 1939, politika me vendimin e saj, nuk lejoi qëndresë të organizuar ushtarake kundër forcave pushtuese fashiste.

Ndërsa në monizëm nëpërmjet strukturave të partisë zgjidheshin e miratoheshin drejtuesit e lartë politiko-ushtarakë të institucionit të mbrojtjes. Ishte rregull i prerë që drejtuesit e lartë të institucionit të Mbrojtjes, ministri të ishte drejtues ushtarak e politik, anëtar i forumeve të larta të PPSH. Rregulli ishte dhe për drejtuesin kryesor të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Me ardhjen e demokracisë në vitet '90 të shek. XX edhe struktura e ushtrisë

kërkoi një reformim dhe ristrukturim të thellë, por dhe një kohë të gjatë për t'u vënë në jetë. Sidomos kërkonte një tip të ri drejtuesi të institucionit të Mbrojtjes i cili, ndonëse në një shtet pluralist, për shkak se do vinte nga forca politike që kishte fituar të drejtën të qeveriste vendin, duhej të mbante një qëndrim ligjor e shtetëror gjatë kryerjes së detyrës shtetërore.

Fjalë kyçe: mbrojtja kombëtare, institucioni i mbrojtjes, xhandarmëri, komandë e përgjithshme, fuqi armate, “grup puçist”, reformë.

Me krijimin e shtetit të parë të pavarur e modern shqiptar, më 28 Nëntor 1912, të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, si dhe të kabinetit të Luftës (Mbrojtjes Kombëtare) të përbërësve të saj, më 4 Dhjetor 1912¹, çështja e drejtimit dhe drejtuesve të institucionit të Mbrojtjes, ka qenë një ndër problemet kryesore të shtetit e qeverisë shqiptare.

Kur u përhap lajmi i veprës s'Ismail Qemalit, gjithë oficerët dhe ushtarët shqiptarë e nxuarrën në shesh dëshirën e flaktë të tyne për një Atdhe të pavarur. Sikur me u tërhejkun prej një magneti, lanë shumë prej tyne radhët e ushtëris tyrke dhe u drejtuen drej Valonës, ku, mbas kaq shekujsh sundimi të huaj, valaonte prap Flamuri i lir shqiptar.²

Me krijimin e shtetit shqiptar të pavarur, vërtiteshin e dyndeshin probleme dhe vështirësi të mëdha. Ndër të para ishin dhe organizimi i strukturave dhe formacioneve të Forcave të Armatosura Shqiptare. Këto duhej të bënë mbrojtjen e vendit nga pushtuesit fqinj, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të rendit. Në këtë kohë vendi ishte i izoluar tërësisht. Shtetit të ri i nevojiteshin ushqime, armatime dhe municione, pajisjet dhe veshjet e domosdoshme për të mbajtur forcat ushtarake. Sapo ishte krijuar infrastruktura e nevojshme, që ishte e paktë dhe e pafuqishme për realizimin e detyrave dhe qëllimit për të cilat ishin ngritur. Veprimet luftarake mbrojtëse vijonin dhe vendin e kërcënonin rreziqe të reja.

Në institucionin e Mbrojtjes u emërua një oficer madhor, me përvojë të gjatë drejtimi dhe luftarake, gjeneral brigade Mehmet Dëralla³ dhe major Ali Shefqetit (Shkupit) Kryetar i Shtabit Madhor (të Përgjithshëm) të Ushtrisë

Shqiptare. Me këtë drejtim u hodhën bazat e para të krijimit të një tradite në Shqipëri, të drejtimit të institucionit të Mbrojtjes nga drejtues ushtarak me formim, kualifikim dhe me përvojë të gjatë e të pasur drejtimi.

¹ Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, 28 Nëntor 1912-22 Janar 1914, Tiranë, 1962, f. 62.

² Shqipëria në vitin 1937, vëll. II, Tiranë, Shty. “Kristo Luarasi”, 1938, f. 83-84.

³ AQSH, Fondi i Parlamentit Shqiptar, Dosja 42, Viti 1920, f.151 (Bisedimet në Kuvendin Kombëtar).

Mehmet Pashë Dërrala i ndihmuar prej 15 oficerë holandezë, nën komandën e kolonel De Veer, formoi një xhandarmëri prej 4000-5000 vetë si mbrojtje e parë ushtarake për qeverinë e re.⁴ Xhandarmëria u nda në detashmente, kompani dhe kalorësi me 120 ushtarë. Këto kishin veshje italiane, si dhe ishin të pajisur me pushkë, topa dhe mitraloza. Komandën në këtë xhandarmëri e mori Gilhard. Fuqitë e Ismail Qemalit u ndihmuar dhe nga Aqif Përmeti, i cili në SHBA, kishte mbledhur vullnetarë shqiptarë, si dhe organizuar bandën “Vatra”.

Qeveria kërkoi nga komandanti i Beratit, Kara Said Pasha, për të siguruar rezerva me armë, municione dhe material luftarake nga ushtria e tij, para se të largohej për në Turqi.

Në këto rrethana Majori Ali Shefqet Shkupi erdhi në Shqipëri nga fundi i prillit 1913.⁵ Në moshën 30 vjeçare, ai ishte një personalitet i njohur, ushtarak i talentuar dhe atdhetar i njohur dhe i afirmuar. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe Ministria e Luftës i ofruan atij postin e rëndësishëm dhe të vështirë të Kryetarit të Shtabit Madhor (Shtatit Madhnuer).

Kështu më 4 maj 1913 doli vendimi për krijimin e Shtabit Madhor nga Qeveria e Vlorës.⁶ Për ndërtimin e Forcave të Armatosura Shqiptare, Ali Shefqeti me energjinë, dinamizmin dhe talentin e tij, si dhe të bashkëpunëtorëve, gërshtoi mjaft mirë përvojën, mençurinë dhe moshën e gjeneral Dërrallës, duke u përputhur me realitetin shqiptar të asaj kohe.

Ngritja dhe vënia në lëvizje e këtij organizmi pati një rëndësi të veçantë për ushtrinë. Ky veprim shënoi një nivel të ri të organizimit të saj. Vet shtabit përbënte një dukuri dhe praktikë bashkëkohore të përparuar dhe njëkohësisht dëshmonte kulturën e mirë politike e ushtarake të drejtuesve të shtetit. Në pikëpamja organizative shtabi përbëhej nga: qarqet e shtabit madhnuer, shkresina e shtabit madhnuer, komisioni i rregulloreve dhe ushtrimeve, komanda e trajtimit të policisë e xhandarmërisë dhe komisioni i ndërtimit.⁷

Shtabi Madhor ishte konceptuar dhe ndërtuar, por edhe veproi, si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Kjo do të thoshte se ai edhe nga ana praktike ishte përgjegjës kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimeve luftarake të FA-ve.⁸

Misioni i shtabit madhnuer ishte organizimi, përgatitja dhe drejtimi profesional

⁴ Shqipëria në vitin 1937, vëll. II, Tiranë, Shtyp. “Kristo Luarasi”, 1938, f. 84.

⁵ Proletar Hasani, Kush e ka drejtuar ushtrinë shqiptare, Tiranë 2001, f. 62.

⁶ AQSH. Fondi – 245/8. Dosja 2, viti 1913.

⁷ Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, Vlorë, më 22 prill 1913 (Ruhet në Muzeun Kombëtar Historik, Tiranë).

⁸ Historia e Ushtrisë Shqiptare, Pjesa e Parë (vitet 1912-1944), Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 2000, f. 43.

i veprimeve luftarake të Forcave të Armatosura. Shtabi Madhor u strukturua dhe u organizua me disa zyra të nevojshme dhe vijoi ndërtimi i strukturave të FA, ku u përfshinë forcat aktive, rezerviste dhe vullnetare. Në kuadrin e organizimit të forcave aktive të ushtrisë Shqiptare, në linjën e raporteve me Ministrinë e Luftës, të cilën e informonte rregullisht, kryetari i shtabit Madhor e njoftonte më 31 maj 1913, për punën që bëhej për të organizuar kompaninë model në Vlorë, me ushtarë shqiptarë.⁹

Ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor filluan të punonin me përkushtim dhe profesionalizëm në përgatitjen e rregulloreve ushtarake. Në to përcaktohej mënyra e organizimit, rekrutimit ushtarak, drejtimi i forcave, jeta dhe stërvitja e ushtrisë së re shqiptare. Kështu Shtabi Madhor u angazhua për të diskutuar dhe miratuar në Qeverinë e Vlorës “Rregulloren e organizimit (formimit) të Milicisë Shqiptare”, të dokumentuar më 3 qershor 1913.

Krijimi i milicisë ishte i domosdoshëm deri sa të formohej dhe organizohen në një shkallë të nevojshme Ushtria e rregullt shqiptare. Në këtë rregullore, me artikuj (nene) të veçantë qartësoheshin problem të organizimit, të detyrimit ushtarak, të hierarkisë, detyrat luftarake, çështje të administrimit, të rregullit ushtarak etj.

Ky dokument tipik bashkëkohorë, flet edhe sot pas 100 vjetësh për nivelin kulturor dhe profesional të këtyre ushtarakëve, por që dëshmon edhe për përmasat e ushtrisë shqiptare dhe të seriozitetit të saj.

Në vitet 1912-1919 në Shqipëri partitë politike ishte në hapat e parë dhe ndikimi në Ushtri ishte i pandjeshëm. Në skenë partitë politike shqiptare dolën pas vitit 1920, me ringritjen e Ushtrisë Shqiptare dhe të institucionit drejtues dhe organizues të saj. Ministria e Luftës kishte një gjeneral brigade dhe ushtarakun Ali Riza Kolonja, me një formim dhe kulturë ushtarake turko-gjermane.¹⁰ Këtu fillon dhe ndikimi i partive mbi Ushtrinë. Lufta politike e partive u shtua dhe arriti kulmin në vitet 1920-1924. Shqipëria u trondit nga disa kriza dhe kulmi arriti në Revolucionin Demokratik të Qershorit 1924. Në institucionin e Mbrojtjes mbërriti ndërhyrja dhe trysnia e partive në lidhje me drejtuesit e institucionit të Mbrojtjes dhe të Ushtrisë Shqiptare.

Kjo dukuri njihet si politizimi dhe partizimi i institucionit, por dhe i strukturave të Ushtrisë, ku jo të gjithë drejtuesit e Luftës dhe të Ushtrisë shqiptare u pajtuan. Ministri i Luftës, Selaudin Shkoza ishte ndër të parët që e kishte kuptuar nevojën e depolitizimit dhe departizimit të institucionit të Mbrojtjes dhe të Ushtrisë. Ai kërkoi depolitizimin dhe departizimin e Ushtrisë Shqiptare, për rrjedhojë mos ndërhyrjen e partive në pushtet në punët e ministrisë, të Shtabit

⁹ AQSH. Kryesia e Qeverisë së përkohshme të Vlorës, Dosja III-5/1, Dok. Nr. 1127, viti 1913.

¹⁰ Proletar Hasani-Asllan Zemani, Histori Lidershipi, Tiranë, Botimet M&B, 2017, f. 53.

Madhor (të Përgjithshëm) dhe të Ushtrisë Shqiptare. Shqipëria ishte një vend i vogël, me ekonomi të dobët, shtet i pavarur, por i brishtë dhe i pakonsoliduar, prandaj i duhej një forcë e armatosur. Kësaj force i duhej të qëndronte sa më larg nga ndikimet e politikës dhe partive, të cilat ndërhyjnë në emërime të trupës së oficerëve duke u shndërruar në një “ves” për to.¹¹

Në fillimet e viteve njëzet situata politike dhe ekonomike e Shqipërisë ishte e vështirë dhe për Ushtrinë. Ekrem Vlora ka shpjeguar ndërhyrjet e politikës dhe të partive në punët e brendshme të Ushtrisë Shqiptare duke theksuar se “... nuk ishin çliruar nga mendësia e mercenarit dhe psikologjia e Turqve të Rinj...”¹²

Për këtë dukuri titullarit të ministrisë së Luftës në vitet 1922-1923, kolonel Ismail Haki Tatzati, nuk ishte pajtuar me një veprim të kryeministrit (A. Zogut) lidhur me tërheqjen e një ligji për rekrutimin ushtarak, “... pa dijeninë e Ministrit të Luftës, gjë që shkaktoi një konflikt të rëndë midis Zogut dhe I. Tatzatit”,¹³ ndaj Tatzati vendosi të jepte dorëheqjen...¹⁴

Në përfundim të Revolucionit të Qershorit 1924, ishte pikërisht politika dhe partitë që vunë në goditje ushtarakët e lartë të institucionit të Luftës dhe të Ushtrisë! Gjithçka kishte ndodhur me drejtuesit e lartë politik, pasi akuza dhe faji ra mbi ushtarakët.

E gjithë përgjegjësia dhe gjithçka tjetër lidhej me rënien dhe shkatërrimin e Ushtrisë Shqiptare, me shpërndarjen e institucionit të Mbrojtjes. Në analizat e bëra në vitin 1925, fajësohej titullari i ministrisë së Luftës I. H. Tatzati. Ai akuzohej dhe bëhej përgjegjës si drejtuesi kryesor në shpërndarjen e Ushtrisë, të Xhandarmërisë dhe të Ministrisë së Luftës, duke arritur në përfundimin se “Influenca shkatërruese e politikës që i prue ma në fund vdekjen ushtrisë, ... kësaj, sidomos, ndër radhët e oficerëve të naltë, në kohën kur ishte Ministër Luftë Tatzati”.¹⁵ Analistët e kohës theksonin se “turbullirat” politike të shfaqur tek Ministri i Luftës, koloneli Tatzati, ishin shfaqje e ndikimeve nga qenia e tij pjesë e jetës partiake, si dhe e njohjeve personale, ishin shkaqet dhe argumentet që çuan në rënien e ministrisë së Luftës. Shpërndarja dhe riorganizimin e Ushtrisë dhe Xhandarmërisë Shqiptare, në një ristrukturim, në Komandën e Përgjithshme të Fuqive Armate¹⁶, në të cilat bënë pjesë, Ushtria

¹¹ Histori Leadershi. f. 65.

¹² Ekrem Vlora, Kujtime 1895 – 1925, Tiranë, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2003, f.381.

¹³ Sejfi Vllamasi, Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897 – 1942, Tiranë, “Marin Barleti”, 1995, f. 213.

¹⁴ Në shtator të vitit 1923, ministri i Luftës, kolonel Ismail H. Tatzati, u përjashtua nga kabineti i qeverisë. Pas kësaj karriera politike, por edhe ajo ushtarake e tij morën fund.

¹⁵ Shqipëria më 1937, Tiranë, Shtypshkronja “KRISTO LUARASI”, 1938, f. 97.

¹⁶ Historia e Ushtrisë Shqiptare, Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000, f. 168.

dhe Xhandarmëria, të riorganizuar.¹⁷

Në këtë kohë u kalua në një sistem të ri organizimi, të milicisë. Ky model organizimi ushtarak siguronte njëherësh realizimin e disa synimeve, si shkëputja nga sistemi i vjetër tradicional, organizimi i një ushtrie “të kohës, me tipare e mentalitete të reja”.¹⁸ Tjetër qëllim thelbësor ishte shkëputja e Ushtrisë nga ndikimet e grupimeve (partive) ekzistuese politike.¹⁹

Del e qartë se ministri Tatzati ishte arsyeja kryesore që çoi në masat e mësipërme drastike me përmbytje dhe frymëzime hakmarrëse politike-partiake. Me rënien e qeverisë së kryeministrit F.S.Noli, masat e para dhe më drastike u ndërmorën pikërisht ndaj ushtarakëve dhe drejtuesve të tyre, se sa ndaj politikanëve dhe partiakëve që e shkaktuan dhe çuan në rënien e Ushtrisë Shqiptare.

Masa e parë ishte suprimimi i Ministrisë së Luftës dhe ngritja e Komandës së Përgjithshme, me qëllim largimin e strukturave ushtarake shqiptare nga politika.²⁰ Me kryerjen e tyre kishte nisur puna për të zgjedhur oficerët që nuk ishin “përzier në politikë”. Kështu u ngrit gjykata ushtarake²¹ dhe u miratua ligji për zgjedhjet, ku bënte eliminimin e ushtarakut në politikë,²² duke përcaktuar të drejtat e ushtarakut për zgjedhjen deputet. Ndër kohë ishte marrë ekstreme për nxjerrjen në lirim të parakohshëm të mjaft oficerëve të etiketuar se “e kalonin kohën me intriga politike”. Ishte përcaktuar dhe një grup ushtarakësh “të padëshiruarit”, ku bënë pjesë personalitete politiko-ushtarakë, ish-ministri i Luftës i qeverisë Noli, ish-shefi i Parë i Shtabit Madhor të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës,²³ dalja në pension para kohe e shefit të Shtabit Madhor të Ushtrisë, në qeverinë, Noli,²⁴ me trajtime financiare të pakta etj.

Politika dhe grupet partiake ishin hakmarrë mbi drejtuesit e njohur politiko-ushtarakë dhe me pjesën më të madhe të oficerë të të gjitha niveleve. Ajo i përdori ushtarakët për të realizuar qëllimet e saj dhe akuzuar ata për “... mbështetës të Lëvizjes së Qershorit dhe pasojave të saj” dhe “si të përdorur e vegla të politikës”. Politika dhe partitë politike institucionet dhe drejtuesit

¹⁷ Historia e Ushtrisë Shqiptare, Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000, f. 168-169.

¹⁸ Historia e Ushtrisë Shqiptare, Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000, f. 169.

¹⁹ Po aty, f. 166-167.

²⁰ Gjykata u vendos në qytetin e Shkodrës. Ajo përbëhej nga tre anëtarë dy civilë dhe një prokuror ushtarak.

²¹ Bernd J. Fischer, Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri, Tiranë, “ÇABEJ”, 1996, f. 91.

²² Nënkolonel Ali Shefqeti Shkupi.

²³ Major Bajram Fevziu.

²⁴ Historia e Ushtrisë Shqiptare. Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000, f. 166-167

politiko-ushtarakë të Ushtrisë, për interesa të tyre, i kanë përdorur ushtarakët dhe në periudhat pasardhëse në Shqipëri. Në vitet e Mbretërisë dhe me prishjen e marrëdhënieve me Italinë në vitin 1938 dhe të agresionit fashist më 1939, politika me vendimin e saj, nuk lejoi qëndresë të organizuar ushtarake kundër forcave pushtuese fashiste.

Me pushtimin fashist të Shqipërisë dhe vendosjen e pushtetit të pushtuesve në vend, organizimi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, organizatat partiake shqiptare që dolën në skenën politike në vitet 1941-1943, ngritën forcat e tyre luftarake dhe nisën luftën kundër pushtuesve fashistë. Me fillimin e veprimtarisë të forcave luftarake, organizatat që i krijuar i vendosën nën udhëheqjen dhe nën kontroll politik. Kjo dukuri u shfaq në Shtabin e Përgjithshëm dhe Ushtrinë NÇ Shqiptare, që kishin udhëheqëse Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH). Në krye të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, bashkë me komandantin ishte dhe komisar politik, i cili ishte dhe Sekretari i Përgjithshëm i PKSH. Në të gjitha nivelet e formacioneve luftarake të Ushtrisë NÇ, u vendos komisar politik që kishin të drejta të barabarta me komandantin e formacionit luftarak përkatës. Kështu në strukturat e ushtrisë, u ngritën celulat dhe organizatat e PKSH.

Përfundim nuk bënë dhe forcat politike, Balli Kombëtar dhe Legaliteti, të cilat kishin përfaqësues ushtarakë që drejtonin organizimin e forcave luftarake. Partia e Legalitetit komandantin e forcave luftarake e kishte dhe kryetarin e partisë. Historia e Ushtrisë Shqiptare. Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000, f. 166-167. Kështu partitë kontrollonin, bënë analiza, kritika, akuzonin dhe ndërmerrnin masa edhe ekstremiste ndaj drejtuesve të forcave luftarake.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për një periudhë të gjatë, e bashkë me Luftën e Ftohtë, u vendos sistemi politik një partiak, ku PKSH, më pas PPSH, ishte në krye të Ushtrisë.

Nëpërmjet strukturave të partisë zgjidheshin e miratoheshin drejtuesit e lartë politiko-ushtarakë të institucionit të Mbrojtjes. Ishte rregull i prerë që drejtuesit e lartë të institucionit të Mbrojtjes, ministri të ishte drejtues ushtarak e politik, anëtar i forumeve të larta të PPSH. Rregulli ishte dhe për drejtuesin kryesor të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Kontrolli i partisë ishte në çdo qelizë të shtetit dhe të qeverisë u bë më i pranishëm, në vitin 1966, ku në institucionet e Mbrojtjes, në strukturat e Ushtrisë u rikthyen komisarët politikë në poste organike, krahas komandantëve. Ndërkohë u rivendosën organizatat, byrotë dhe komitetet e PPSH, së bashku me komisarët politikë, ishin përçuesit e partisë në institucionet e Mbrojtjes dhe në Ushtri. Politizimi dhe partizimi i institucioneve ishin të ligjërura. Drejtues ushtarakë të lartë dhe anëtarë të forumeve të larta të partisë u akuzuan

për çështje që kishin përmbajtje profesionale-ushtarake. Ngjarjet e vitit 1974, kanë hyrë në historinë e ushtrisë shqiptare si “grup puçist” dhe e dhjetorit 1981 dhe 1982, ishin të lidhura me vdekjen e Kryeministrit Mehmet Shehu dhe ministrit të Mbrojtjes dhe ish-ministër i Brendshëm, Kadri Hazbiu.

Ngjarjet qenë fatale jo vetëm për drejtuesit e lartë të institucionit të Mbrojtjes, por dhe për drejtues të tjerë, si shefi i Shtabit të Përgjithshëm, ushtarakë të lartë të strukturave dhe njërive të mëdha të Ushtrisë Shqiptare. Kështu u godit një pjesë e mirë e drejtuesit ushtarak, organizatorë, drejtuesit kryesorë të Ushtrisë NÇ dhe heronj të Luftës Antifashiste Shqiptare, ushtarakë madhorë, të karrierës, gjeneralë të formuar në shkolla dhe akademi ushtarake të Italisë dhe pas luftës në Bashkimin Sovjetik, ushtarakë profesionistë dhe personalitete në fushën ushtarake dhe të Mbrojtjes me akuza të pabazuara. Në akuza kishte arsyetim partiak e ideologjik, për koncepte apo projekte tërësisht ushtarake, përballë arsyeve dhe argumenteve profesioniste ushtarake, të drejtuesve të institucionit të Mbrojtjes dhe drejtuesve të lartë të njërive dhe organizmave studimore të mendimit ushtarak shqiptar, me akuza “tradhti”, grusht e puç kundër partisë, popullit dhe shtetit.

Këto ishin pasoja të politizimit dhe partizimit të skajshëm të institucionit të Mbrojtjes dhe i Ushtrisë Shqiptare. Thelbi i akuzave kundër drejtuesve të lartë politiko-ushtarakë, të cilët njëkohësisht ishin pjesë e forumeve drejtuese të PPSH, në të vërtetë ishte rrjedhojë e përballjes së udhëheqjes autokratike me logjikën dhe argumentet profesionale të drejtuesve ushtarakë.

Rënia e sistemit dhe e shtetit monist në Shqipëri, në fundin e vitit 1990, shënoi fundin e periudhës së tyre dhe shtroi domosdoshmërinë e shndërrimeve dhe reformave të thella në të gjitha fushat e jetës dhe veprimtarive politike, ekonomike dhe shoqërore.

Reforma përfshiu dhe institucionin e Mbrojtjes dhe Ushtrinë Shqiptare. Ndër çështjet e para të saj ishin pikërisht depolitizimi dhe departizimi i institucioneve dhe ndërtimi i raporteve e marrëdhënieve të reja, midis një tipi të ri drejtuesi civil-politik dhe stafit të tij gjithashtu civil në njërën anë, me drejtuesin tradicional ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ushtrisë, në anën tjetër.

Ky ishte një ndryshim i thellë, i modeleve të drejtuesit ushtarak-politik të traditës së mëparshme afro tetëdhjetëvjeçare 1912-1990 dhe sidomos të asaj dyzetepesëvjeçare moniste me modelin demokratik të drejtuesit të vendeve europërendimore. Kjo nuk ishte aspak e lehtë në një vend të mbyllur e vetëizoluar si Shqipëria. Nuk ishte i lehtë sepse në Shqipëri, fillimi i viteve nëntëdhjetë (1991-1992), por dhe ca më pas, mungonte edukimi, formimi dhe kultura demokratike, ku dominonte ideologjia e fortë partiake, sidomos në

institucionet e mësipërme. Kjo kërkoi një reformim dhe ristrukturim të thellë, por dhe një kohë të gjatë për t'u vënë në jetë. Sidomos kërkonte një tip të ri drejtuesi të institucionit të Mbrojtjes i cili, ndonëse në një shtet pluralist, për shkak se do vinte nga forca politike që kishte fituar të drejtën të qeveriste vendin, duhej të mbante një qëndrim ligjor e shtetëror gjatë kryerjes së detyrës shtetërore. Kjo vinte dhe në përjasje me interesat dhe ndikimet e interesave, të ndërhyrjeve e ndikimeve të partisë së cilës i përkiste.

Periudha e pasvitit 1992, edhe sot pas tridhjetë vitesh vërteton se përparësitë e një qëndrimi të tillë nga udhëheqësit e tipit të ri, ndonëse të domosdoshme, nuk ishin aspak të lehta në përballjen me “traditën” e trashëguar nga e shkuara e gjatë dhe e afërt.

Literatura e shfrytëzuar

1. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, 28 Nëntor 1912-22 Janar 1914, Tiranë, 1962.
2. AQSH, Fondi i Parlamentit Shqiptar, Dosja 42, Viti 1920, f. 151. (Bisedimet në Kuvendin Kombëtar).
3. Proletar Hasani-Asllan Zemani, Histori Lidershipi, Tiranë, Botimet M&B, 2017.
4. Ekrem Vlora, Kujtime 1895 – 1925, Tiranë, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2003.
5. Sejfi Vllamasi, Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897 – 1942, Tiranë, “Marin Barleti”, 1995.
6. Shqipënia më 1937, Tiranë, Shtypshkronja “KRISTO LUARASI”, 1938.
7. Historia e Ushtrisë Shqiptare, Pjesa e Parë (vitet 1939-1944), Tiranë, SHBU, 2000.
8. Bernd J. Fischer, Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri, Tiranë, “ÇABEJ”, 1996.
9. Ligje, dekret-ligje e rregullore të vjetit 1925, Përmbledhje, Tiranë, 1938.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Nr. Tel: 516 /1515
Adresa elektronike: ikshu.afa@aaf.mil.al
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri